Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 16 NËNTOR 2023

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16. NOVEMBRA 2023. GODINE

NËNTOR - NOVEMBAR
2023

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-260 o budžetskim izdvajanjima za Budžet Republike Kosovo za 2024. godinu

<u>Mbledhjen e drejtoi nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.</u>

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
E nderuar zëvendëskryeministre,
Ministra,
Kabinet qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me vetëm një pikë të rendit:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024

Konstatoj se kemi kuorumin e mjaftueshëm për të proceduar tutje.
Atëherë, Komisioni Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka shqyrtuar projektligjin e përmendur dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim. Pa humbur kohë, ftoj kryeministrin Albin Kurti që të bëjë paraqitjen e këtij projekt-buxheti.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare e Kuvendit të Republikës,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2024 do të jetë 3 miliardë e 314 milionë euro.

Ai do të jetë buxhet i mbrojtjes dhe i sigurisë, për çfarë kemi ndarë rreth 370 milionë, euro ose 22% më shumë sesa aktualisht. 153 milionë euro për Ministrinë e Mbrojtjes dhe 216 milionë euro për Ministrinë e Punëve të Brendshme, më së shumti ndonjëherë. Ushtrisë sonë, të cilës ia kemi rritur buxhetin për më shumë se dyfish prej kur kemi ardhur në qeverisje dhe numrin e ushtarëve për më shumë se 2/3-tat, do t’ia shtojmë edhe 600 ushtarë më shumë në vitin 2024. Kurse Policia jonë, që ka 850 policë të rinj gjatë qeverisjes sonë, vitin tjetër do t’i ketë edhe 500 rekrutë të tjerë, dhe 21,7 milionë euro për investime kapitale ose 9 milionë euro më shumë sesa këtë vit.

Buxheti i vitit 2024 do të jetë po ashtu prioritet në programin tonë qeverisës sa u përket nevojave të qytetarëve për një ekonomi të fortë, me më shumë vende të punës; për shëndetësi gjithëpërfshirëse me shërbime më të mira; arsim të zhvilluar me cilësi më të lartë; e sundim të ligjit me drejtësi të reformuar.

Përgjatë gati 32 muajve të mandatit tonë, ekonomisë iu shtuan 60 mijë vende pune, ku gjysma e të punësuarve janë të rinj e të reja nën moshën 25-vjeçare. Vetëm përmes platformës së

punësimit, SuperPuna, për 8 muaj që nga funksionalizimi i saj, janë punësuar mbi 7 mijë e 700 të rinj mes moshës 18 dhe 25 vjeç - që i bie përafërsisht diç më pak se një mijë të punësuar në muaj. Andaj, për të vazhduar me nxitjen e punësimit në sektorin privat, në buxhetin e vitit të ardhshëm kemi ndarë 29 milionë euro për masat e punësimit.

Ndërkaq, për sa i përket sektorit publik, siç kemi thënë edhe në shkurt të këtij viti, koeficienti i pagave në sektorin publik për vitin 2024 do të jetë 110 euro.

Do të vazhdojmë të investojmë në renovimin e spitaleve, përmirësimin e shërbimeve dhe blerjen e pajisjeve të teknologjisë së fundit, ashtu që më të dashurve tanë, në momentet më të vështira të tyre, t'u mundësohet kujdesi i duhur. Për vitin 2024, SHSKUK-së i është shtuar buxheti për 25%, kurse për shëndetësinë si sektor në tërësi kemi ndarë mbi 340 milionë euro, përfshirë edhe grantin për komunat.

Për ndërtimin e çerdheve, zbatimin e reformave, dhe mbështetjen e të rejave e të rinjve me bursa, së bashku me grantin që u ndahet komunave, sektorin e arsimit do ta mbështetim me 370 milionë euro, apo rreth 20% më shumë sesa në vitin 2023.

Ministrisë së Drejtësisë ia kemi ndarë 31% më shumë buxhet ashtu që të zbatohen deri në fund reformat e nisura në drejtësi, sepse edhe zotimi ynë për këtë mandat qeverisës e për këtë legjislaturë të Republikës ishte Punë dhe drejtësi.

95 milionë euro i kemi paraparë për mbështetjen tonë për nënat lehona dhe fëmijët nën 16 vjeç, nga e cila deri më tani kanë përfituar mbi 40 mijë gra nëna të reja dhe 373 mijë fëmijë.

Për vitin tjetër, gjithashtu ndamë 14 milionë euro për banimin social, 11 milionë euro për blerjen e objekteve të ambasadave të Republikës së Kosovës nëpër botë dhe 65 milionë euro për bujqësi.

Do të ketë investime të reja kapitale në infrastrukturë rrugore e hekurudhore, në zona të reja ekonomike, në diga e rrjete të ujësjellësit, dhe në kapacitete të reja energjetike. E për këtë kemi paraparë një buxhet prej 860 milionë eurosh.

Vetëm për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kemi ndarë 58 milionë euro për investime kapitale në sport e infrastrukturë për vitin që po vjen. Sepse festën dhe gëzimin për kandidaturën e suksesshme për Lojërat Mesdhetare 2030 duhet ta përcjellim me investime të menjëhershme dhe përgatitje të hershme për një organizim të suksesshëm. E trendi i njëjtë do të vazhdojë edhe për vitet pasuese deri në përmbushjen e planeve të investimeve deri në vitin 2030 që pritet të kapin vlerën prej 250 milionë eurosh.

Buxheti i komunave në vitin 2021 ishte 547 milionë euro. Sivjet është 654 milionë euro. Në vitin 2024 ai do të jetë gati 200 milionë më shumë sesa në vitin e parë të qeverisjes sonë, ose 742 milionë euro. Prej të cilave 635 milionë euro janë grant për komunat nga Qeveria, kurse pjesa tjetër janë të hyra vetjake të komunave. Pra ky buxhet i Qeverisë është po ashtu edhe buxheti i komunave.

Për më tepër buxheti i vitit të ardhshëm përsëri do të jetë edhe buxhet për shqiptarët e Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. Atij po ia shtojmë edhe një milion, krahasuar me vitin aktual pra, nga dy, në tre milionë euro për vitin 2024. Kjo mbështetje është më e larta ndonjëherë, dhe është më shumë se të gjitha qeveritë paraprake marrë së bashku.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës,
Me projektbuxhetin për vitin 2024 forcojmë mbrojtjen e Republikës, e rrisim sigurinë e qytetarëve dhe e mundësojmë zhvillimin e vendit e mirëqenien e popullit. Andaj ju ftoj secilën dhe secilin prej juve që me votën tuaj ta mbështetni atë.
Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Tani ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere, deputetin Armend Muja, për arsyetimin e raportit të komisionit.

ARMEND MUJA: Atëherë, e nderuar kryesuese!
I nderuar Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Kosovës,
Po flas në emër të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere.
Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka shqyrtuar Projektligjin për ndarje buxhetore të vitit 2024 dhe pas diskutimeve dhe sqarimeve të marra nga Ministria e Financave, e ka miratuar në parim.

Shpenzimet e propozuara buxhetore propozohen të jenë 3 miliardë e 314 milionë euro. Propozimi mbështetet në një projeksion të të hyrave prej 3 miliardë e 28 euro dhe nevojën për financim të jashtëm dhe të brendshëm. Bilanci i propozuar buxhetor është brenda rregullës fiskale, ashtu siç parashihet në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Borxhi i përgjithshëm bazuar në propozimin për ndarje buxhetore parashihet të jetë 20,7% në raport me bruto produktin vendor, që në vete paraqet një rritje të lehtë krahasuar me 19,7% sa parashihet të jetë deri në fund të vitit 2023. Gjykuar sipas klasifikimit ekonomik, Projektligji për ndarje buxhetore për vitin 2024 parasheh 1 miliard e 62 milionë euro në kategorinë e subvencioneve dhe transferove, apo rreth 32% të buxhetit të përgjithshëm. 805 milionë euro për

paga dhe mëditje, apo 24,3% të buxhetit të përgjithshëm, 859 milionë euro për investime kapitale apo 26% të buxhetit të përgjithshëm dhe 519 milionë euro për mallra dhe shërbime.

Gjykuar sipas klasifikimit funksional, buxheti është shpërndarë sipas dëgjimeve buxhetore me ministritë e linjës, agjencitë dhe institucionet e pavarura. Megjithatë, ky projekt-propozim do të jetë subjekt i shqyrtimeve dhe diskutimeve në komisione parlamentare. Sipas Rregullores së Kuvendit, në rast se projektligji miratohet sot, më datën 16 nëntor 2023, në lexim të parë, kërkohet nga deputetët e komisioneve funksionale që të respektojnë këto afate në mënyrë që të zbatohet në përpikëri çdo mekanizëm dhe instrument që parashihet në Rregulloren e re të Kuvendit.

Pra, deri më datën 27 nëntor 2023 është afati kur deputetët duhet të propozojnë amendamente. Deri më datën 30 nëntor 2023 është afati kur komisionet funksionale duhet të dërgojnë raportet me rekomandimet për ndryshime buxhetore. Deri më datën 8 dhjetor 2023 Komisioni për Buxhet do i shqyrtojë të gjitha amendamentet dhe raportet me rekomandime dhe të njëjtat do t'ia përcjellë seancës së Kuvendit. Ne parashohim që buxheti në lexim të dytë të organizohet, të diskutohet dhe të miratohet më 14 dhjetor 2023.

Të nderuar deputetë,
Projektligji për ndarjet buxhetore 2024 përmbush kriteret minimale siç parashihet në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Andaj, lusim deputetët që në mënyrë që të hapet procedura e konsultimeve dhe diskutimeve që ta miratojnë të njëjtin në parim.
A mund të flas edhe në emër të grupit?

KRYESUESJA: Po, mund të vazhdoni edhe në emër të grupit.

ARMEND MUJA: Po flas në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje.
Të nderuar deputetë
Dhe qytetarë të Kosovës,
Ky projekt-propozim për buxhetin e vitit 2024 është pak a shumë konform programit qeveritar, po i cili po ashtu mbështetet edhe në propozimet programore të Lëvizjes Vetëvendosje në vitin 2021.

Janë 5 shtylla ose pika të veçanta, të cilat besoj janë veçoritë kryesore të buxhetit të vitit 2024. E para shtyllë është një propozim për të përmirësuar shërbimet e përgjithshme publike në funksion të zhvillimit ekonomik dhe punësimit. Në këtë shtyllë vërehen disa propozime shtesë dhe të veçanta. 82 milionë euro shtesë për komunat për përmirësim të shërbimeve lokale, 265 milionë euro për investime në modernizim të rrjetit dhe hekurudhave, akseve kryesore nacionale, digave dhe sistemit të ujitjes, 90 milionë euro për bujqësi, për subvencionim të bujqësisë, blegtorisë dhe sistemit të ujitjes, 25 milionë euro shtesë për digjitalizim të Administratës Publike, rreth 100

milionë euro për reforma strukturore në promovim të efiçiencës së energjisë, ristrukturim të ndërmarrjeve publike, themelimin e Fondit Sovran, mbështetje për bizneset, zgjerim të rrjetit dhe të telekomunikacionit dhe rritjes së kapacitetit të prodhimit të ujit. Gjithashtu, edhe skemat për garantimin e punësimin tek të rinjtë.

Shtylla e dytë, e veçantë, konform programeve ose prioriteteve programore të Lëvizjes Vetëvendosje është barazia sociale dhe shëndetësia. Këtu në këtë shtyllë dhe në këtë propozim buxhet vërehen disa veçori. Rreth 51 milionë euro shtesë për shëndetësinë, shërbimin spitalor, barna esenciale, modernizim të aparaturës shëndetësore dhe paga më të larta për mjekët specialistë dhe stafin shëndetësor. 55 milionë euro shtesë për pagesat e lehonave dhe shtesat për fëmijë. Pagesat e lehonave dhe shtesat për fëmijë parashihen të arrijnë deri në fund të vitit 2024 rreth 100 milionë euro. 44 milionë euro shtesë për pensionet kontribut dhënëse, 6 milionë euro shtesë për pensionet me aftësi të kufizuara, sikurse edhe propozimi për banim të përballueshëm.

Te shtylla e tretë, arsimi, vërehen disa aspekte dhe propozime. Rreth 54 milionë euro shtesë parashihet që të shkojë buxheti për arsim. Nga 318 milionë euro që ishte në vitin 2023, parashihet të arrijë në 373 milionë euro për vitin 2024, dhe aty ose propozimet e shpenzimet orientohen në zgjerim të përfshirjes në arsim te grupet e ndjeshme, tek edukimi parashkollor, por gjithsesi edhe përmirësim të cilësisë përmes investimeve në digjitalizim të sistemit arsimor, shtimit të çerdheve etj. Ajo çka vërehet po ashtu është një tendencë që të orientohet zhvillimi i burimeve njerëzore tek fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës përmes rreth 4 mijë bursave, nga të cilat 3 mijë janë në fushat STEM.

Shtylla e katërt, është nevoja për të sforcuar mbrojtjen dhe sigurinë e vendit. Aty çfarë vërehet në këtë propozim buxhet, janë 30 milionë euro shtesë për Ministrinë e Mbrojtjes, për të financuar rreth 600 ushtarë shtesë dhe pajisje moderne për FSK-në. Po ashtu, vërehen rreth 37 milionë euro shtesë për Ministrinë e Punëve të Brendshme për të financuar rreth 500 policë të rinj, pajisje moderne për policinë dhe investime tjera kapitale. Ajo çfarë është e veçantë të potencohet është që buxheti për mbrojtje do të arrijë në 154 milionë euro, që është diku rreth trefishim krahasuar me vitin 2019.

E fundit që dua të potencoj është kultura dhe sporti. Ajo çfarë vërehet është një përpjekje ose një prioritizim i investimeve në sport, edhe trashëgiminë kulturore, në përgatitje për Lojërat Mesdhetare. Rreth 31 milionë euro shtesë parashihen për sportin dhe kulturën, por gjithashtu edhe programe shtesë për mbështetje të artit, muzikës dhe trashëgimisë kulturore.

Të nderuar deputetë,
Të gjitha këto zhvillime kanë ardhur në një kontekst të ndryshuar politik dhe ekonomik. Më lejoni të theksoj edhe dy pika të rëndësishme që duhet të diskutohen dhe të trajtohen në dritën e këtyre propozimeve buxhetore.

E para është te konteksti politik. Qeveria suksesshëm ka administruar katër kriza me të cilat ballafaqohej Kosova që nga ardhja e Qeverisë Kurti 2. E para është kriza e pandemisë, e dyta është kriza energjetike, e treta është kriza e inflacionit dhe e katërta është kriza e veriut të vendit. Të gjitha këto kriza janë administruar suksesshëm në një kontekst të ri politik dhe ekonomik.

Kosova vazhdon të shënojë progres në luftimin e kurrupsionit, njëzet e dy vende më lart në vitin 2022, krahasuar me vitin paraprak. Vazhdon të shënojë progres në liri të mediave, rreth njëzet e dy vende më lart krahasuar me vitin paraprak. Vazhdon të prijë në Ballkanin Perëndimor për nga indeksi i sundimit të ligjit dhe demokracisë elektorale. Në ndërkohë Qeveria e vendit vazhdon të gëzojë përkrahjen dhe mbështetjen e 56 për qind të qytetarëve, sipas Ballkan Barometer 2023.

Të nderuar qytetarë,
Të nderuar deputetë,
Në lidhje me potencialin ekonomik, Kosova ka pasur një rritje mesatare ekonomike prej 8 për qind në dy vjetët e para të Qeverisë Kurti 2 dhe ky aktivitet parashihet të vazhdojë edhe në vitin 2023 edhe më 2024.

GDP-ja në terma nominalë deri në fund të vitit 2024 parashihet të shkojë rreth 10.4 miliardë, që d.t.th. është një rritje sinjifikante krahasuar me 6,7 miliardë gjatë kohë së pandemisë. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve, të nderuar deputetë, edhe në vitin 2023, edhe në vitin 2024 parashihet të ketë një rritje sinjifikante si rezultat i kontributit nga diaspora. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve deri në fund të vitit 2023 parashihet të shkojë diku rreth 3,5 miliardë që është diku rreth dy miliardë më tepër sesa koha e pandemisë e vitit 2020. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve po ashtu parashihet të rritet dhe të shkojë në katër miliardë deri në fund të vitit 2024, që është në çdo instancë dyfishim krahasuar me vitin 2019.

Dy aspektet e tjera që dëshiroj t'i nënvizoj është buxheti qeveritar. I propozuar 3,3 miliardë, është rreth 1.3 miliardë më shumë sesa viti 2019. Të gjitha këto janë mbështetur po ashtu në një përpjekje të sforcuar të Qeverisë për modernizim dhe formalizim të ekonomisë. Dy aspekte që duhet t'i dëgjoni është kështu: të hyrat buxhetore për vitin 2024 parashihet të jenë 3 miliardë euro, që është 1,2 miliardë euro më shumë sesa në vitin 2019. Në vitin 2025 parashihet të jenë 3,3 miliardë euro, që është në esencë dyfishim i të hyrave buxhetore krahasuar me vitin 2020.
Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Nga Partia Demokratike e Kosovës, Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Të nderuar qytetarë!
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuara media,

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2024, prandaj lirisht mund të themi se buxheti i vitit 2024 nuk paraqet kërkesat dhe pritshmëritë e qytetarëve, të bizneseve, por as të organizatave buxhetore. Si i tillë duket më i madh në shifër, por në një situatë krize jo vetëm ekonomike, por edhe mungesës së lidershipit, ku gjithçka është më e shtrenjtë, i lë më të varfër qytetarët e Kosovës.

Pra, sot po e mbajmë një ndër seancat më të rëndësishme të vitit, duke qenë se Ligji i buxhetit ka rëndësinë e veçantë, pa dyshim ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve të vendit tonë.

Sot, para se të flas për planifikimin e buxhetit të vitit 2024, dua t'u them qytetarëve të Kosovës se juve po ju kalojnë tre vjet që ju jeni në pushtet. I keni planifikuar rreth dhjetë miliardë euro shpenzime, prej të cilave nuk rrjedh as edhe një projekti rëndësishëm, asnjë projekt madhor me të cilin mund të krenohen qytetarët e vendit tonë.

Në fushatat tuaja zgjedhore, kryeministri i tashëm i Kosovës, duke u munduar ta trashë e ta çjerrë zërin, ka premtuar se do ta forcojë ekonominë e vendit, do ta ulë importin, do të rritë eksportin, do t'ua heqë TVSH-në produkteve elementare. E po përmendi edhe një premtim se të gjitha manipulimet është vështir t'i mbahen në mend. Premtonte se arka e shtetit të Kosovës, pra e buxhetit të Kosovës, nuk do mbushet më në kufi, në Dogana, me këtë shkas për të manipuluar edhe diasporën, edhe bizneset.

Por, sido që të jetë, është humbje kohe të flitet për manipulimet e këtyre njerëzve, por humbje më e madhe po i shkaktohet vetë Kosovës, po i shkaktohet në financa, në ekonomi, në diplomaci, në kulturë etj. Këta besimin e qytetarëve e kanë marrë si privilegj dhe po mendojnë që ato karriget e pushtetit do të qëndrojnë përgjithmonë. Vetëbesimin e kanë të lartë e dijen dhe implementimin e kanë të ulët.

Fjalimet populliste fatkeqësisht nuk e ngopin qytetarin. Fatkeqësisht s'po e parandalojnë migrimin, por fatmirësisht po i del në pah fytyra e vërtetë, por me një kosto shumë të madhe. Në demagogjinë tuaj, ju keni thënë: nuk jemi të varfër, por jemi të vjedhur. Ndërsa, sot thotë: nuk mund të rrisim pagat, se jemi të varfër. Ndërsa krenohet me një buxhet më të madh. Jashtë këtij debati, por gjithsesi që lidhet me buxhetin dhe sigurinë e vendit, ishin të turpshme deklaratat tuaja se Policia e Kosovës ka paga mbi dy mijë euro, nëse veç e di se çka është paga.

Tash kur jeni në pushtet nuk ju kujtohet të flisni për pagat qeveritare sikurse flisnit kur ishit në opozitë. Po më mirë që nuk flisnit, sepse të paktën i keni mbi njëqind këshilltarë në kabinetin qeveritar që e kanë koston mujore përmbi njëqind mijë euro dhe sigurisht që nuk dëshironi të flisni.

Deri dje akuzonte ata që ndërtuan shtetin për rrugët, shkollat, spitalet e shumë projekte të cilat sot ju vetë krenoheni. Por ku jemi sot, ku është qytetari i Kosovës? A është më mirë apo më vështirë të jetohet sot? Përgjigjja besoj që dihet. Sot flasim për një planifikim buxhetor, i cili nuk ndikon dhe i cili duhet të ndihmonte, por po shihet që planifikimi është aq i dobët sa nuk ka asnjë promovim, asnjë projekt të ri dhe i cili qytetarët e Kosovës nuk do t'ia shohin kurrfarë hairi.

Një planifikim i mirëfilltë i buxhetit do të kontribuonte në përmbushjen e nevojave sociale e shtetërore. Për këtë arsye, buxheti mbetet instrumenti fundamental financiar, me planifikimin e duhur do të ishte edhe mundësi e mirë që të ndihmonte popullin drejtpërdrejt dhe zhvillimin shtetëror në përgjithësi.

Buxheti shtetëror nuk është hajgare. Nëse nuk hartohet siç duhet, i njëjti le që nuk ndihmon, por ka fuqinë ta përkeqësojë edhe më shumë gjendjen në nivele ekstreme, ashtu siç pritet të ndodhë me rastin e këtij projektbuxheti. Nuk ka kurrfarë sensi të shpenzohet nga buxheti i shtetit për ndihma, ndërkohë që ka nevojë për punësim. Pastaj, të rriten çmimet, ndërkohë që as nuk kemi nivel të lartë të punësimit e as rroga mjaftueshëm të larta për të përballuar inflacionin.

Pastaj, nuk ka sens që të ndahet një vlerë buxhetore në një kod buxhetor për pesë a gjashtë komuna, pa e definuar në cilat komuna do të realizohet projekti.

Buxhetin shtetëror e keni shpërndarë në ato komuna ku ju e keni pushtetin në nivel lokal, sikur qytetarët e komunave të tjera nuk ekzistojnë fare. Sikur te qytetarët e Prishtinës, Mitrovicës, Prizrenit, Pejës, Drenicës, Ferizajt e qytetarë të tjerë që po konsiderohen nga kjo Qeveri si qytetarë të dorës së dytë apo të tretë.

Në këtë projektligj parashihet se do të rritet buxheti i shtetit, por duhet të theksojë që në dhjetë vjetët e fundit asnjëherë nuk kemi pasur rritje më të ulët, përjashtimisht kohës së pandemisë. Me këtë buxhet, jo që luftohet inflacioni, por vetëm rrezikohet që të kemi shkallë më të lartë dhe kjo do të ndodhë, sepse mbi një miliard euro janë planifikuar të shpërndahen si ndihma në shërbime sociale. Pra, mbi 32 për qind, ndërsa Ministria e Tregtisë e Ndërmarrësisë ka vetëm 25 milionë euro, d.m.th. as një për qind. Kjo tregon sa do të ketë rritje të kërkesës, andaj çmimet mund të shkojnë edhe më lart, sepse nuk ka investime në rritje të aktiviteteve prodhuese, nuk subvencionohet ndërmarrësia, por qytetarëve u jepet lëmoshë me qëllim për të blerë heshtje momentale.

Pra, dëmi është i madh dhe do të jetë afatgjatë. Është e thjeshtë, kur nuk ka prodhim, domosdo shkaku i rritjes së konsumit, do të ketë rritje të importit. E kur nuk ka prodhim, nuk ka vende të reja të punës e nuk ka as eksport.

Si përfundim, mbi 32 për qind të buxhetit do të investohen për të thelluar inflacionin, për të rritur importin. Mbi 32 për qind e buxhetit shtetëror do të shpenzohen pro shkatërrimit të zinxhirit të bizneseve prodhuese e për më pak vende pune.

Në planifikimet tuaja nuk ka asgjë të destinuar për sigurimet shëndetësore, përkundrazi keni planifikuar një buxhet më të ulët për Ministrinë e Shëndetësisë. E të mos harrojmë, jemi shumë mbrapa me këtë proces krahasuar me vendet e rajonit. Apo të mos harrohet se sigurimet shëndetësore ishin premtuar së paku në dy fushatat e fundit. Qytetarët po presin që ju të realizoni premtimin tuaj.

Me këtë planifikim buxhetor mbi pesëqind milionë janë të ndara për qeveritarët, për mallra dhe shërbimet, pra për luks qeveritar, është rritur ashtu siç është rritur varfëria dhe vështirësia për të jetuar në këtë vend. Për këtë dhe shumë arsye të tjera që do t'i theksojnë edhe deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ne si grup parlamentar nuk do të përkrahim Projektbuxhetin e vitit 2024. Jemi kundër këtij buxheti që nuk sjell asnjë alternativë zhvillimore dhe nuk është buxhet i mirëqenies buxhetore.

KRYESUESJA: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka deputeti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!
Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Anëtarë të Qeverisë,
Qytetarë,
Media,
Sot po e shqyrtojmë projektbuxhetin për vitin 2024. Ky është projektbuxheti i fundit që kjo mazhorancë e sjell në Kuvend dhe besoj që duhet të shqyrtohet në kontekst të komplet zotimeve të kësaj Qeverie. Besoj që ky duhet të jetë vlerësimi që duhet t'i bëjmë krejt këtij projektbuxheti.
Gjatë këtij mandati qeverisës 2021-2024, në total kjo mazhorancë ka menaxhuar me buxhetin e vitit 2024 menaxhohen 11,4 miliardë euro, ka pasur në dispozicion për të shpenzuar. Deri më tani janë shpenzuar, pra me mbarimin e këtij viti shpenzohen 8,1 miliardë euro.

Më duhet ta them, duhet ta përsëris që efektet konkrete janë shumë të pavërejtshme. Njëra ndër arsyet besoj që është shumë e qëndrueshme, është që ka ndërruar struktura e buxhetit. Është përkeqësuar struktura e buxhetit. Nëse e krahasoni vitin 2017 me vitin 2022, investimet kapitale kanë rënë nga 36 për qind në 16 për qind të buxhetit, si shpenzim real, jo vetëm si planifikim, po shpenzim real. Ndërkaq subvencionet janë rritur nga 23 për qind në 41 për qind të buxhetit. Kjo është arsyeja që nuk shohim efekt real në rritjen ekonomike në vend nga ky buxhet.

Kjo është e para, pra rritja masive e subvencioneve. Tash disa prej skemave vërtet mund të kenë qenë të arsyeshme, por kur i sheh ku kanë shkuar subvencionet, ti e sheh që në vitin 2019, ta zëmë, vit para pandemisë, ne 41 milionë i kemi subvencionuar ndërmarrjet publike, në vitin 2022, 233 milionë euro kanë shkuar për subvencionim të ndërmarrjeve publike. Vetëm për subvencionim të energjisë në veri janë shpenzuar 113 milionë euro. Pra, kjo është ndër arsyet kryesore që nuk shohim efekt real të këtij buxheti në ekonomi.

Tani atë që e thashë në fillim, duhet të analizojmë këtë buxhet në kontekst të zotimeve të kësaj Qeverie. Zotimet kanë qenë këto: që të ndërtohen 160 çerdhe, realizimi, janë rreth 10 çerdhe ose janë 5 çerdhe që janë ndërtuar deri më tash, dhe janë disa që janë planifikuar në buxhet, por në vitin 2025, jo në vitin 2024. Në vitin 2025, pra, përtej mandatit të kësaj Qeverie.

Zotimet e tjera nuk kanë filluar fare. Ta zëmë, banimi social që kanë premtimi për banim me kushte të përballueshme, realizimi, nuk ka nisur fare. Te sigurimet shëndetësore. Të nisin sa më parë, realizimi, nuk nisin as në vitin 2024.

Te privatizimi ka qenë që të rishikohen të gjitha privatizimet dhe të përmbyllet ky proces, realizimi është që privatizimi vazhdon valë-valë në Kosovë. Fondi Sovran, ka kaluar ligji në lexim të parë, i cili, ju garantoj, që në bazë të të gjitha analizave profesionale do të shkarkojë probleme të mëdha në ekonomi, te ndërmarrjet publike në veçanti nëse miratohet përfundimisht.

Te Banka Zhvillimore ka mbetur një projekt, më duket, as në letër jo, vetëm në mendje dhe në deklarime.

Pra, le ta analizojmë një herë kornizën makrofiskale, siç e quajnë ekonomistët. Te rritja ekonomike: trendi i rritjes ekonomike, me statistika zyrtare, jo me vlerësime të opozitës, është me trend rënës. Nga tremujori i dytë i vitit 2021 kur ka qenë 16%, që ka qenë e kuptueshme për shkak të pandemisë më herët, muaj pas muaji rritje ekonomike ka përfunduar në 2% në tremujorin e tretë të vitit 2023.

Ka qenë e kuptueshme, viti 2022 për shkak të inflacionit dhe krizës energjetike, por të gjitha i janë kthyer normalitet në rritje ekonomike, në ndërkohë që këtu trendi është në rënie.

Parashikimi për vitin 2023 është ulur nga ajo që ka qenë në fillim të vitit. E kur i sheh shkaktarët, një ndër shkaktarët kryesorë, sepse ne mund të flasim për rritje të eksporteve, por ato janë çështje të biznesit privat.

Mund ta fajësojmë edhe sektorin financiar pse janë rritur normat e interesit, edhe pse aty ka shteti ndikim me ambientin politik që krijon. Por, ta zëmë, shpenzimet kapitale. Nëse shihni me kujdes, kolegë të nderuar, vetëm dallimin mes planifikimit dhe realizimit të investimeve kapitale

në tre vjetët e fundit, ‘21, ‘22 dhe sivjet ‘23, vetëm ky dallim është rreth 1 miliard euro pak a shumë, plus minus disa milionë.

1 miliard janë më pak të shpenzuara në ekonomi për shkak të rënies së investimeve kapitale, nga 23-24% në 16% të buxhetit. Çdo ekonomist me dije elementare e di që kur mungojnë 1 miliard euro si shpenzime në ekonomi, e di që edhe nja 1 miliard e gjysmë ose 2 miliardë janë efekte negative dytësore dhe tretësore nga këto shpenzime që do të kishim pasur mundësi të bëhen.

Tani është komplikuar edhe më tutje çështja me këto masat apo sanksionet e Bashkimit Evropian që janë qindra-miliona euro të bllokuara nëpër sektorë të ndryshëm.

Politika të reja fiskale nuk ka dhe nuk duket që do të ketë as në vitin 2024, nëse e sheh pjesën tekstuale, analitike të buxhetit. Kushtet e të bërit biznes janë përkeqësuar, disa prej elementeve, po ju them. Dhe, e kam thënë këtu në këtë seancë dhe ka pasur reagime shumë të këqija nga anëtarët e Kabinetit.

Ligji për këto investime të qëndrueshme e ka humbur fokusin prej mbrojtjes së investitorëve. E kemi pasur një Ligj për ruajtjen, për promovimin dhe mbrojtjen e investimeve të jashtme, tani është humbur ai fokus, dhe tani është rritur tej mase diskrecioni i Qeverisë tek investitorët e jashtëm.

Marrëveshje të shumta me Shqipërinë, sidomos në fushën ekonomike, te rregullatorët e ndryshëm që kanë pasur qëllim që të unifikohen tregjet e të dyja vendeve, nuk po zbatohen. Dështoi edhe mbledhja e fundit e Qeverisë.

Rregullatorët ekonomikë, shumë të rëndësishëm, ku nuk kemi nevojë të shpenzojmë, por vetëm t’i bëjmë të funksionojnë me rregull, kanë bërë dëm të madh në ekonomi. Ta zëmë, Banka Qendrore ka funksionuar bukur një kohë pa menaxhment, pa guvernator të bankës, me kryetarin e bordit që e ka luajtur edhe rolin e Guvernatorit të Bankës Qendrore.

Trusti pensional ka pasur me muaj të tërë mungesë të bordit, dhe janë miliona euro që kanë humbur në tregjet financiare në pamundësi për t’i marrë vendimet për rialokim të mjeteve nëpër instrumente të ndryshme financiare. OSHP-ja ka qenë e bllokuar për më shumë se 1 vit dhe sigurisht se ka ndikuar në uljen e investimeve kapitale.

Komisioni për Ndihmë Shtetërore bllokohet tash e tre vjet. Nuk zgjidhet ky komision. Dialog social nuk ka fare. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik nuk është mbledhur asnjëherë gjatë mandatit të kësaj Qeverie. Ky është këshill ku mblidhen Qeveria dhe aktorë të ndryshëm socialë për të diskutuar edhe për buxhetin edhe për politikat ekonomike dhe sociale në vend.

Sot, roli i odave ekonomike është praktikisht zero në dizajnimin e vendimeve qeveritare që prekin ekonominë. Pagat e 85 mijë zyrtarëve publikë. Koeficienti i pagave është me rritur me 5 euro, që është 4,8%, që është më pak sesa rritja e inflacionit gjatë këtij viti.

Pra, vitin e ardhshëm nëse ky buxhet shkon përpara kështu siç është, paga reale e 85 mijë zyrtarëve publikë, pra 85 mijë familjeve, mesatarisht 85 mijë familjeve në Kosovë, që është 1/4 e njerëzve që marrin paga në Kosovë, do të ulet në terma real.

Tek të hyrat buxhetore. Kanë reflektuar disa zëra për keqplanifkimin që kanë bërë gjatë këtij viti, por projekti më madhor i fillimit të mbledhjes së tatimit në vlerën e shtuar brenda vendit nuk shkon përpara. Edhe projektligji ka qenë i përgatitur më herët. Pastaj ka filluar pandemia dhe është lënë ai projekt. Pra, as në vitin 2024 nuk do të shkojë përpara. Shteti do të vazhdojë të mbledhë TVSH në kufi ende pa u shitur mallrat.

Rreziqet fiskale nga ndërmarrjet publike mbesin plotësisht. Nëse e shihni analizën që i është bashkuar projekt-buxhetit, aty shihet që të hyrat totale të ndërmarrjeve publike mbesin të njëjta në 6,4% te produktit të brendshëm bruto.

Neto fitimi mbetet i njëjti, detyrimet mbesin të njëjta. Vlera e aseteve dhe kuiteti i ndërmarrjeve publike zvogëlohet. Nuk ka asnjë vizion për zhvillimin e Trepçës më tutje. Kredi ka marrë Telekomi nga buxheti i shtetit për të larguar punëtorë nga puna. Pra, në krejt sektorët e ndërmarrjeve publike nuk ka asgjë të re, është përkeqësim i situatës dhe rreziqet fiskale mbesin të njëjta nga këto ndërmarrje.

Nëse e sheh performansën sipas sektorëve do ta vëreni, te çështjet ekonomike ta zëmë, energjia e ripërtëritshme mbetet në nivel prej 24%. Nuk ka ndonjë projeksion në këtë drejtim. Më duket që edhe ankandi i fundit ka dështuar për shkak të vendosjes së çmimit maksimal në shitjen e MGW-atit.

Tek rehabilitimi i rrugëve: Nga 80 km në vitin 2022 shkon në 150 km në vitin 2024. 150 km rrugë të parapara.

Për ruajtje të tokave bujqësore: Këtu në pjesën tekstuale, thotë: “Do të rritet sipërfaqja e tokave bujqësore nën ujitje nga 18 mijë hektarë në 25 mijë hektarë në vitin 2024”, por kur i sheh investimet kapitale për ujitje të tokave bujqësore janë zero, jo 1 milion, jo 2 milionë, zero.

Pra, nuk ka se si të rritet. E kjo të jep të kuptosh që kjo pjesa e performansës sipas sektorëve është shkruar në një zyrë tjetër, buxheti është bërë në një zyrë tjetër dhe as që kanë komunikuar dhe as që e dinë se çfarë janë sjellë në Kuvend.

KRYESUESJA: Regjia, ia shtoni edhe kohën si deputet.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!
Te shpenzimet sipas sektorëve. Besoj që kjo është pjesa qendrore e buxhetit. Unë i kam analizuar vetëm tre sektorët kryesorë. Në mbrojtje, ku duhet të shpenzojmë rreth 2%. Në fakt, ne duhet të shpenzojmë më shumë për të krijuar stokun e pajisjeve në sektorin e mbrojtjes dhe mandej për t'i mirëmbajtur ato me shpenzime prej 2% të produktit të brendshëm bruto në baza mujore.

Në vitin 2024 planifikimi është që të shpenzohen 1,45% për mbrojtje, dhe trendi është rënës në tri vitet e ardhshme, bie në 1,30%. Në arsim e njëjta gjë. Ne duhet të shpenzojmë rreth 6% të produktit të brendshëm bruto, të dhënat tregojnë se në vitin 2024 do të shpenzojmë veç 3,51% dhe trendi është rënës, dhe bie në 3.20%. Në shëndetësi e njëjta gjë. Duhet të shpenzojmë rreth 6%, këto janë standarde evropiane, por në vitin 2024 shpenzojmë veç 3,26%, trendi është prapë rënës, dhe biem në 2,95% të shpenzimeve në shëndetësi si përqindje e produktit të brendshëm bruto.

Ato që rriten, janë subvencionet, sepse aty e lehtë të shpërndahen mjete përmes platformës e-Kosova. Këto kanë mbërri, ta zëmë, në vitin kaluar në 42% të buxhetit të shtetit. Dhe, siç e thashë më herët, janë ndërmarrjet publike ku po shkojnë. Nuk është që po rriten skemat sociale ose pensionale, me përjashtim të futjes së disa skemave të reja.

Dhe kjo është arsyeja, të nderuar deputetë, që raportet zyrtare të institucioneve kredibile tregojnë që numri i familjeve nën pragun e varfërisë është rritur me 10% krahasuar me vitin 2021.

Tek investimet kapitale: Këtu është problemi më i madh. Edhe në vitin 2019 kur ka qenë vit i zgjedhjeve, është shpenzuar në investime kapitale më shumë sesa në vitin 2022 ose që po shpenzohet sivjet, ku realizimi është vetëm 29% në nëntëmujorin e parë.

Vetëm 9% të projekteve të reja kapitale janë që janë futur në buxhet. Nëse e sheh se si janë shpërndarë nëpër komuna, vazhdon avazi i vitit 2022. Problem në veçanti mbetet kryeqyteti. Tash me një kryetar të ri është një vizion i qartë se si duhet të zhvillohet kryeqyteti, por nuk ka asnjë mbështetje për të realizuar ato projekte madhore që nuk janë vetëm të Komunës së Prishtinës, janë të rëndësisë nacionale.

Ta zëmë, unaza e qytetit, ose rruga A "Xhim Xhema", rreth rrotullimi në Veternik në Hajvali, ai në Lakërishtë, rruga Prishtinë - Hajvali - Graçanicë që nuk janë të parapara fare në buxhetin e vendit.

Tek projektet me huamarrje, një element shumë me rëndësi. Sipas raportit zyrtar janë 7 projekte me kredi në vlerë prej 177 milionë euro që janë ratifikuar për periudhën 2017-2022, zero mjete

janë tërhequr nga ato. Zero mjete. Pra, pavarësisht pse kanë mbetur disa marrëveshje të paratifikuara, nuk ka asnjë rëndësi për Qeverinë kjo çështje.

Në infrastrukturë duket që nuk janë planifikuar buxhetet për projektet kryesore. Unë po e marr një shembull shumë të thjeshtë, që është vërtet e pakuptueshme, ku për vite të tëra ura në Rugovë të Hasit që lidh një regjion shumë të rëndësishëm, tash janë paraparë veç 900 mijë euro në vitin 2024. Një projekt prej 7 deri në 8 milionë euro si urë, me vetëm 900 mijë.

Është futur rruga Prishtinë-Pejë me 198 milionë, ndërkohë që kjo ka qenë e buxhetuar me marrëveshje ndërkombëtare.

Tek investimet kapitale në arsim nuk ka gjasa që të modernizohet sektori i arsimit me këtë qasje.

Të nderuar deputetë,
Për ta përmbyllur fjalën time, ky buxhet ka shpërputhje me zotimet që i ka vetë Qeveria. Ka shpërputhje me prioritetet ekonomike dhe ka shpërputhje me nevojat emergjente që kanë qytetarët.

Unë besoj që është problem të përmirësohet, sepse ne mund ta përdorim atë frazën e famshme, do të bëjmë amendamente gjatë dy leximeve dhe do ta përmirësojmë. Por, do të jetë shumë problem që ta drejtojmë një gjë që nuk është tani e drejtë.

Unë besoj që janë tri elemente që duhet me kujdes t'i shohim gjatë leximeve; pagat dhe skemat sociale, të cilat duhet përfundimisht të indeksohen me normën inflacionit. Duhet të sigurohemi për financimin e nevojshëm të projekteve që janë në vijim e sipër, dhe projektet komunale, Prishtina në veçanti.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka fjalën deputeti Ramush Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ: E nderuar kryesuese e Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Deputetë,
Qytetarë të dashur,
Rritja nominale prej vetëm 102 milionë eurove, praktikisht është zvogëlim real i buxhetit, kur marrim parasysh shkallën e inflacionit këtë vit dhe në vitin që vjen. Kjo është rritja më e vogël e një buxheti që nga çlirimi i vendit.

Rritja e vlerës së koeficientit të pagave nga 105 në 110 euro, nuk është rritje e as harmonizim, por zvogëlim real i pagave. Indeksi i çmimeve të konsumit është 5,1% këtë vit, dhe 2,7% i paraparë për vitin 2024. Pra, e argumenton këtë.

Shqetësues në veçanti është nënçmimi që u bëhet disa kategorive, si Policia e Kosovës, shëndetësia, drejtësia, e të tjerë të dëmtuar nga Qeveria, nga mohimi i pagesës së shtesave për rrezikshmëri dhe punë shtesë të garantuara me ligjin në fuqi.

Investimet kapitale të shtuara vetëm për 48 milionë nuk mundësojnë ndonjë zhvillim ekonomik. Praktikisht, është stagnim kur marrim parasysh se 90% e projekteve të parapara për realizim në vitin 2023 nuk janë realizuar, por barten në vitin buxhetor 2024. Ndërsa, mbi 80% e projekteve kapitale të listuara në buxhetin që po shqyrtojmë sot, janë projekte të paralizuara në 3 vitet e fundit, e të bartura për vitin 2024.

Dështimet në realizimin e projekteve kapitale në vitin 2021 në shumën prej 200 milionë eurove, pastaj në vitin 2022 rreth 300 milionë euro dhe sipas ecurive të paraqitura në raportin e Thesarit për nëntë muajt e këtij viti që gjithsej bëjnë mbi 800 milionë euro, praktikisht paraqesin humbjen e plotë të buxhetit të paraparë për investime kapitale për vitin 2024.

Po ndalem pak te disa nga projektet më të mëdha infrastrukturore, te infrastruktura rrugore. Për rehabilitimin e rrugëve vetëm 3 milionë euro. Ndërsa, 59 milionë eurot e reja që janë bartur, janë kryesisht të bartura ndër vite dhe ato u dedikohen projekteve që po ashtu nuk garanton përfundimin vitin që vjen. Këto projekte veç janë të njohura për të gjithë ne, Prishtinë - Mitrovicë, Dollc- Gjakovë, Kijevë - Zahaq, Deçan - Mali i Zi, Prishtinë - Podujevë, Prizren - Tetovë, Prishtinë - Gjilan, pra vetëm nga mjetet e bartura dhe janë po ashtu mjete të pamjaftueshme për të siguruar jo vetëm përmbylljen e këtyre projekteve, por qoftë edhe zhvillimin e disa prej tyre për të cilat kemi shkuar deri në vendet fqinje për t'i lajmëruar.

Në shëndetësi janë vetëm 2 milionë të reja, pra vetëm 2 milionë shtesë në shëndetësi, ju lutem, ndërsa në arsim vetëm 4,5 milionë. Asnjë nga projektet e infrastrukturës në shëndetësi dhe në arsim nuk do të kryhen vitin që vjen, pra janë bartur ndër vite dhe nuk do të përfundojnë as vitin që vjen. Për Ministrinë e Punëve të Brendshme, ju lutem, nuk është paraparë asnjë cent shtesë mos harroni për vitin që vjen, janë bartur 52 milionë të paimplementuara. Fjala "shpenzim i buxhetit" nuk qëndron, ju lutem! Buxheti shpenzohet kur nuk investohet ashtu si bën kjo qeveri, pra atëherë shpenzohet buxheti, humb. Ndërsa, investimi i buxhetit është fitim për buxhetin, sepse ligji e ka thënë që duhet investuar.

Pra, ju lutem, Qeveria e Kosovës në kohën e zhvillimeve të sigurisë, të rendit e të ligjit bart 52 milionë euro të këtij viti në vitin tjetër për Ministrinë e Brendshme. Në Ministrinë e Mbrojtjes, ku e gjithë bota po investon e po shton investime jo vetëm për vete, por edhe po shton ndihmat

për projekte që gjithë bota është e shqetësuar, e keni parë, vendet si Gjermania e dyfishon ndihmën për Ukrainën, Qeveria jonë nuk ka implementuar 58 milionët e parapara, por i bart në vitin tjetër.

Fondi i subvencioneve dhe transferove është zvogëluar për 35,6 milionë, në krahasim me këtë vit, kjo do të thotë që nuk ka rritje të asnjë kategorie të pensioneve. Pra, përveç pensionistëve kontributpagues dhe lehonave që është vendim i gjykatës, ndryshimet e vogla, pra që kanë të bëjnë me rritjen e numrit të përfituesve të pensioneve, pra ato ndryshime, shuma e mjeteve për invalidët e luftës dhe veteranët është zvogëluar për 3,4 milionë në këtë vit. Këto na kanë ndihmuar edhe ata që kemi biseduar prapa shpinës me ta t'u zbritet shuma. Zbritje, po ashtu ka për pensionistët e Trepçës, deputetët e viteve të '90-ta, për të burgosurit politikë. Kur i sheh këto shifra, e ke të vështirë të lirohesh nga mendimi, pra të vjen një mendim i ligë pse kjo Qeveri e jona i diskriminon këto kategori meritore për lirinë edhe për ekzistencën tonë.

Të ndëshkuar e pa shtesa janë po ashtu edhe të verbrit, invalidët e punës, personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, sepse në vitin e ardhshëm nuk do të marrin asnjë cent shtesë. Ndarja e buxhetit për nivelin lokal, e proklamuar si rritje prej 86 milionë eurosh, nga Qeveria nuk është rritje, pra është mashtrim, vetëm 5 milionë e 700 mijë euro janë investime kapitale për komunat. Shuma tjetër prej 60 milionë i përket fondit të pagave, të cilin me buxhetin e vitit 2023 nuk e kanë shpërndarë dhe janë të detyruar ta pasqyrojnë në buxhetin e vitit që vjen. Problem në vete është ndarja po ashtu, jo e drejtë, e investimeve kapitale për komunat e partisë. Imagjinoni sa e pafytyrë është kjo, ju lutem. Nëse e bëjmë një vlerësim të kujdesshëm dhe të respektueshëm të këtij buxheti, mund të themi me pak fjalë si vijon: kemi të bëjmë me një qeveri, e cila nuk e investon buxhetin dhe atë qëllimshëm ndër vite, pra e thamë, çdo vit 200, 300 e me radhë. Ekonomisë së Kosovës kjo qeveri ia ka munguar 1 miliard investime.

Kjo qeveri, duke mos e investuar buxhetin, i shkakton humbje Kosovës, në të gjithë sektorët. Pra, kisha pritur prej kësaj qeverie që s'ka implementuar buxhetin ndër vite 200, 300 euro me radhë, që të paktën t'ia sjellë një fitore me atë buxhet të painvestuar, i cili për fat të keq, i painvestuar, atëherë është i shpenzuar, t'ia sjellë një fitore. Cila do të ishte kjo? Një rritje e buxhetit, mbrojtje në siguri, sepse situata është e tillë. Sigurime shëndetësore, të paktën, t'i marrin ato para që i kanë bartur prej vitit në vit dhe mandej të kishim sigurime shëndetësore në këtë vend, nuk e di ju siguroj, nuk e di këta njerëz a janë të këtij vendi. Pra, me këtë sjellje të tyre nuk e di këta njerëz a janë të këtij vendi. Bartja e 58 milionë eurove, ju lutem, nga Ministria e Mbrojtjes në vitin tjetër.

Një vend normal, një Qeveri normale, një kryeministër normal kishte bërë kontrata 10-vjeçare, pajisjet ushtarake vonohen, nuk vijnë kur do ti, ato blerje bëhen për 10 vjet dhe vijnë me radhë, mbas viteve, plani ynë 10-vjeçar për ushtrinë, qysh e dimë, është në 5-vjeçarin e vet. Si ka mundësi këto njerëz të bartin para? Dyfishimi i pagave, kryeministër, nëse vërtet je i interesuar për sigurinë, jo veç shtesat e rrezikshmërisë, mos harroni, nuk i shpenzon paratë kur investon

paratë. Paratë i shpenzon kur t'i bartë ministri prej vitit në vit, ju lutem, vetëm atëherë janë të shpenzuara. Dyfishimi i pagave për ushtarin, policin, për AKI-në, për doganat, për gjyqësorin, për zjarrfikësit, për emergjencat ndoshta ka qenë veprim i mençur e fitore e juaja në këtë kohë, ndërsa mosveprimi, por lejimi i kësaj logjike që qeveria jote, ministri yt të ta bartë buxhetin prej vitit në vit, në kohën kur po zbrazet Kosova. Edhe një element kishe mundur ta shtosh, nëse vërtet të është bartur buxheti prej vitit në vit, futeni një pako për të rinjtë e Kosovës të mos e lëshojnë Kosovën më 1 janar. Pra, gjejeni një mënyrë, gjejeni një formulë, vepro! Ne do të ndihmojmë me amendamente për këto shqetësime, por ju lutem, jeni duke i bërë dëm të madh këtij vendi.

KRYESUESJA: Para se të vazhdojmë tutje, të nderuar kolegë, të pranishëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës e kemi deputeten nga Bosnja, Savina Qutiq. Mirë se ke ardhur!

(Duartrokitje)

Tani radhën e ka deputeti Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar Multietnik.

ENIS KERVAN: Kosova Cumhuriyeti tarihinin en yüksek yıllık bütçesi olan 2024 Bütçesinde emeği geçenlere teşekkür ederek konuşmama başlamak istiyorum. Kosova'da yaşayan tüm toplulukların çıkarlarıyla birlikte, temsilcisi olduğumuz toplulukların yaşam şartlarının iyileştirilmesi ve ihtiyaçlarına cevap verebilmek adına yaptığımız girişimler neticesinde, bütçe taslağında yer almasını talep ettiğimiz projelerin eklenmesi ve bakanlıklar tarafından çalışma programlarına alınması bizleri mutlu etmiştir.

Bu çerçevede Ekonomi Bakanlığı ile yaptığımız görüşmelerde, bakanlık bünyesinde bulunan su dağıtım altyapısının geliştirilmesine yönelik mevcut bütçeden faydalanılarak Mamuşa Belediyesi'nin yaşadığı içme suyu sıkıntısının giderilmesi için proje çalışmalarına başlanması öngörülmektedir.

Bununla birlikte Kültür Bakanlığı'nın desteği ile Mamuşa Belediyesinde Kültür ve Gençlik Merkezinin bütcede yer alması ile Prizren'de, Prizren Belediyesi ile işbirliği içerisinde önümüzdeki dönemde Türk Kültür Merkezi inşaat çalışmalarına başlanılması öngörülmektedir. 2023 yılında başlayan topluluk mensubu ihtiyaç sahibi vatandaşlara yönelik başlatılan ev yapımı ve tadilat desteği projesi de önümüzdeki yıl devam edecektir. Ayrıca 2024 yılı içerisinde Başbakanlık Topluluklar Ofisi aracılığıyla topluluk mensubu vatandaşlara yönelik, ihtiyaç sahiplerine maddi destek sağlanması, kültürel ve sportif faaliyetlere destek sağlanalarak sivil toplum kuruluşlarımızın ulusal ve uluslararası organizasyonlarda yer almasının sağlanması, ülkemizin ekonomik kalkınma hedefleri doğrultusunda topluluk vatandaşlarına ait işletmelerin kapasitelerini arttırmaya yönelik destekler sunulması, bu yönde Bölgesel Kalkınma Bakanlığına ek bütçenin sağlanması taleplerimiz arasındadir.

Topluluk mensuplarının kendi dillerinde haber alama özgürlüğünü garanti altına almak için medya kuruluşlarının desteklenmesi ve topluluk mesnubu başarılı öğrencilere burs verilmesi ve Rom Aşkali, Mısırlı toplulukları dışında Türk, Boşnak topluluklarına özellikle kız öğrencilerine burs sağlanması konusunda bütçe ayrılması taleplerimiz arasından yer almaktadır. Bununla birlikte, 2023 yılında topluluklara yönelik yapılan desteklerde yaşanan usülsüzlüklerin önümüzdeki yıl tekrarlanmaması ve tüm topluluklara eşit şekilde yaklaşılması konusundaki hassasiyetimizin altını birkez daha çizmek istiyorum. Son olarak, polisimize, öğretmenlerimize, sağlık çalışanlarımıza, emeklilerimize daha fazla bütçe ayrılması, yaşam şartlarının daha elverişli olması için taleplerimizin ciddiye alınması beklentisindeyiz. Bu taleplerimizi doğrultusunda, 2024 yılı Bütçe Tasarısının ilk okunuşunu destekleleyeceğimizi belirterek saygılarımı sunarım.

KRYESUESJA: Tani e ka fjalën kryeministri Kurti, për të adresuar çështjet që u ngritën nga grupet parlamentare.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare e Kuvendit, kryesuese e seancës së rëndësishme sot për Projektligjin për buxhetin 2024.

Unë po i adresoj disa prej çështjeve që u diskutuan deri më tani, e më pastaj në fushëveprimtarinë e tyre përkatëse ministrat gjithashtu do të flasin për atë çfarë kanë bërë dhe projektet, të cilat do të financohen me buxhetin e vitit të ardhshëm. Së pari, më lejoni të theksoj që në qeverisjen tonë janë dyfishuar edhe eksportet, edhe investimet e huaja. Eksportet kanë qenë të pakta, por sidomos deficiti tregtar ka qenë i lartë. E kemi gjetur 1 me 9, është më mirë se 1 me 6.

Më tej, ekonomisë gjatë kësaj qeverisje ia kemi shtuar mbi 1 miliard për çdo vit. Në vitin 2020 bruto produkti vendor ka qenë 6,77 miliardë euro, në vitin e ardhshëm është mbi 10 miliardë euro. A e dini çfarë do të thotë që bruto produkti vendor i një vendi të rritet për gati 50% për vetëm 4 vjet. Është shumë vështirë të gjeni në histori e në botë shembuj të tjerë, ku bruto produkti vendor rritet për gati 50% për vetëm katër vjet.

Më tej, pagat janë rritur, buxheti për paga në sektorin publik me Ligjin për paga është rritur për mbi 100 milionë euro, kurse në vitin 2024 koeficienti do të rritet do të jetë 110. Qeveria jonë është shquar për investime posaçërisht në katër fusha: në mbrojtje dhe siguri, shëndetësi, arsim dhe bujqësi. Arsimi i lartë publik është falas dhe kurrë s'ka pasur më shumë bursa për studentë. Mbi 4 mijë bursa për studentët, me ç' rast mbi 70% të tyre janë për ata që studiojnë shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë dhe sot që po flasim në Republikën e Kosovës gjysma e studentëve që studiojnë në STEM, pra në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë, janë vajza. Mesatarja e Bashkimit Evropian është 17%, tek ne është 50%. Kjo tregon çfarë ndikimi të madh në orientimin e studimit të vajzave në shkencën natyrore dhe teknologjike ka luajtur bursa.

Më tej, inflacioni, e vërtetë. Në janar ka qenë 12%, në muajin tetor ka qenë 3.3%, në muajin shtator ka qenë 4,2%. Pra, në fillim të vitit ka qenë inflacioni shumë i lartë, por tash është relativisht i ulët dhe është ndër më të ulëtit në Evropën Juglindore. Tash kurrë më vështirë se sot në këtë shekull nuk ka qenë blerja e armatimeve. Jo pse s'ka, po pse radha është shumë e gjatë dhe kurrë më shumë armatim, municion dhe pajisje nuk janë blerë se tani. Kurrë s'ka qenë më vështirë të gjesh, kurrë s'ka qenë më shtrenjtë e kurrë më shumë s'është blerë.

Më tej, vetëm me tri procese të fituara në arbitrazhe ndërkombëtare ia kemi kursyer buxhetit të Republikës së Kosovës 145 milionë euro. Veç me tri arbitrazhe të fituara.

Unë nuk mendoj se po zbrazet Kosova. Ka emigrim, po nuk ka zbrazje të Kosovës dhe nuk do të ketë as pas 1 janarit. Sepse, ju e dini shumë mirë që ata që do të shkojnë tani pa nevojë për vizë në zonën Shengen, duhet të kthehen. Ata nuk shkojnë sikurse në vitet e '90-ta kur kemi qenë të okupuar për azil politik, ose azil ekonomik ose të dyja këto. Ata shkojnë dhe unë jam i bindur që kjo i ndihmon shumë komunitetin e biznesit dhe studentët tanë, po shkojnë për t'u kthyer, se kështu i kanë vetëm 90 ditë brenda 180 ditëve qëndrim atje.

Më tej, ne synojmë ta ulim varfërinë, sepse e dimë që në bazë të të dhënave të disponueshme, ende afër 25 për qind të popullsisë i kemi të varfër, që d.m.th. se një në katër qytetarë të Republikës së Kosovës jetojnë me më pak se 5 euro në ditë, që i bie 150 euro në muaj, çdo i katërti. Në bazë të synimeve për zhvillim të qëndrueshëm, ku kemi edhe bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, me koordinatoren Spens, ne synojmë që këtë në vitin 2027 ta zbresim së paku në 19 për qind. Po besoj që do jemi edhe më të suksesshëm se kaq shumë më shpejt.

Ama, ta keni parasysh që sot që po flasim më 16 nëntor, është bërë një vit, është përvjetori kur Lidhja Demokratike e Kosovës e ka dërguar Ligjin për çmimet tavan në Gjykatën Kushtetuese. Luftimin e varfërisë dhe heqjen e barrës së buxhetit të shtetit për asistencë sociale asgjë nuk do ta ndihmonte sikurse çmimi tavan për produktet bazë të konsumit, i cili tash ngelet i ngujuar në Gjykatën Kushtetuese dhe sot që po diskutojmë për votim në lexim të parë Projektligjin për buxhetin 2024 janë bërë fiks një vit që Grupi Parlamentar i LDK-së këtë ligj të votuar këtu e ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese, duke pamundësuar vendosjen e çmimeve tavan nga të cilët ne do ta votonim edhe varfërinë dhe do ta ndihmonim mirëqenien e qytetarëve e ta lehtësojmë jetesën e tyre.

KRYESUESJA: Janë disa replika në emër të grupeve. Është Besnik Tahiri dhe Avdullah Hoti. Edhe Mërgim Lushtaku në emër të PDK-së.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, nënkryetare!
Kabinet qeveritar,

Kryeministër,
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Kosovës,
Sot, pa asnjë dyshim ka qenë ekspozeja më e dobët në tre vjet e Albin Kurtit në këtë Parlament. Në qoftë se mund të më thoni ju deputetë se qytetarët e Kosovës e kanë mbajtur një premtim, një zotim, një qëndrim rreth temave që ballafaqohet Kosova në raport me krizën ekonomike, me pagat në sektorin publik, me sigurinë në vend, kam dëshirë ta dëgjoj edhe në fjalimet e deputetëve që vijnë.

Ne kërkuam në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës të na jepet një sqarim se çka ndodhi me pagat. Ju keni thënë që rritja ekonomike është mbi 5 për qind. A bën ta dimë pse e rritët pagën vetëm për 5 euro, që i bie zbritje e pagës. A mund të na tregosh pse është bartur ky buxhet dhe pse ka mbetur që krejt buxheti të shkojë në vitin 2024? Ne e dimë këtë, po është buxhet elektoral, për shkak se zgjedhjet, ne sot një vit në kalendarin e rregullt jemi në zgjedhje. Dhe ju doni që këto mjete që i keni bartur vit pas viti, t'i shfrytëzoni vitin e fundit të qeverisjes suaj.

A bën të më tregoni veç një fjalë pse kush prej juve nuk e përmendi fjalën pensionist. Pensionistët, prindërit tanë, prindërit e ju deputetëve janë të gjithë në mëshirën tonë, të fëmijëve. Asnjë fjalë për pensionistë. Në fushata zgjedhore, krejt dhe drejt ke folur vetëm për këtë temë.

E fundit, kryeministër, ju do të mbaheni mend që keni fituar pesëdhjetë për qind, por ju edhe do të mbaheni mend me politikën tuaj për zbrazjen dhe eksodin më të madh që ka ndodhur në Kosovë në këtë kohë, për shkak se ky buxhet, kjo qeverisje asnjë element, asnjë çështje, asnjë politikë normale, sociale dhe zhvillimore nuk e ka ngritur.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Avdullah Hoti tani.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetare!
Tash pa dashur të bëj humor realisht, po të organizohet një kuiz dhe t'u thuhet kush po ia qëllon një projekt madhor që është realizuar për tre vjet, nuk ia qëllojnë njerëzit. Nuk dinë, hutohen, e këqyrin njëri-tjetrin se nuk mund të emërosh një projekt madhor, po them, që është realizuar në tre vjet.

Ka një tendencë kryeministri dhe ministrat realisht t'i dredhojnë pak shifrat. Po shifrat janë kokëforte. Se nuk mund ta krahasosh vitin 2023 me 2020. S'mund të thuash ka qenë GDP kaq në vitin 2020 e kaq në vitin 2023. 2020-ta ka qenë pandemi, krejt vendet kanë rënë në minus 30 a 40 për qind. Pra nuk e krahason. Krahasoje me trendin e zakonshëm të viteve 2017-18-19 edhe mandej shihe se si ka mbërritur GDP-ja ku është sivjet. Mbi të gjitha, shtoja inflacionin që ka ndodhur gjatë kalimit të viteve, edhe vjen te kjo vlerë që e ke.

I përmende eksportet dhe investimet private. Asnjë kontribut nuk e keni, kryeministër, me atë. Pse? S'e keni asnjë politikë fiskale që ka ndikuar të rritet eksporti. Absolutisht nuk e përmend asnjë. Rritja ekonomike nëse do ashtu t'u referohesh shifrave, thuaje, e ke gjetur 16 dhe sot e ke vetëm 2 për qind. Por nëse ke pasur rritje ekonomike qysh po e promovon, pse i ke edhe 10 për qind më shumë familje nën pragun e varfërisë? Pse i ke familje që prej 38 për qind sa kane shpenzuar vetëm në ushqime, tash 60 për qind e shpenzojnë në ushqime. Që i bie, shpenzimet për arsim, për shëndetësi e rekreacion kanë rënë. Pra, është zvogëluar standardi dhe cilësia e jetesës.

Je duke e përmendur disa herë këtë Ligjin për çmimet tavan. Po pse nuk e rrisni listën e mallrave që janë me TVSH të reduktuar prej 18 në 8 për qind. Ligji i TVSH-së ju mundëson këtë pa e ndryshuar fare.

KRYESUESJA: Mërgim Lushtaku replikë dhe Armend Muja, pas deputeti Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!
Realisht ne po e shohim në vazhdimësi demagogjinë e kryeministrit Kurti që edhe këtu del i mbron me kokëfortësi. Është fat i keq që e kemi një demagog dhe një hipokrit në krye të detyrës. Po ne po e shohim që qytetarët çdo ditë e më shumë po varfërohen. Bizneset po shihen si armiq, nuk po shihen si mundësi për t'i punësuar qytetarët e vendit. Ju assesi nuk jeni duke bërë politika zhvillimore që bizneset lëre që të mos falimentojnë e të mos mbyllen, po edhe të mos ikin nga Kosova.

Çdo ditë e më shumë edhe investimet e huaja nuk e shohin Kosovën alternativë, sepse e shohim pamundësinë dhe kokëfortësinë tuaj, edhe duke e përmendur çdo ditë e më shumë edhe luftën. Sigurisht që ne si Kuvend i Kosovës e kemi mbështetur çdo iniciativë për sigurinë e vendit, por nuk është arsye kjo që të mos zhvillohet ekonomia e vendit dhe të varfërohet edhe më tutje qytetari. Ndërsa, me mosimplementimin tuaj të buxhetit që çdo vit e keni pasur për obligim vetë t'i implementoni, tregoni edhe varfërinë edhe më të madhe që ua bëni qytetarëve, sepse nuk implementohen infrastrukturat e ndryshme, qoftë rrugore, qoftë infrastrukturore, dhe kështu shtrenjtohen edhe më shumë çmimet në përgjithësi.

KRYESUESJA: Armend Muja!

ARMEND MUJA: E nderuar kryesuese!
U fol pak për buxhetin për mbrojtje, dëshiroj të jap disa të dhëna për sqarim. Buxheti i paraparë për mbrojtjen për vitin 2024 është 153 milionë euro, që është 1.45 në raport me Bruto Produktin Vendor. Për ta vënë në perspektivë, në vitin 2016 buxheti për mbrojtje ka qenë 49 milionë euro,

apo 0.8 për qind në raport me Bruto Produktin Vendor. Ka dyfishim e trefishim, jo vetëm në terma absolutë, por edhe në raport me Bruto Produktin Vendor.

Meqenëse po ka nevojë për sqarime shtesë, buxheti për mbrojtjen në vitin 2019 ka qenë 58 milionë euro. Këto janë shifra që ne i marrim zyrtarisht. Ka pasur dyfishim dhe trefishim.

E dyta është sa u përket investimeve kapitale. Investimet e parapara kapitale për vitin 2024 janë 859 milionë euro, që në raport me Bruto Produktin Vendor është prapë përtej vitit 2016. Çështja e realizueshmërisë është çështje tjetër, po edhe investimet kapitale janë përtej vitit 2016.

Bruto Produkti Vendor ose formimi i kapitalit bruto që është reflektim i investimeve publike dhe private, edhe për vitin 2023 vazhdon të jetë mbi 3,2 miliardë euro besoj, që është dyfishi krahasuar me vitin 2016. Edhe në terma dhe në raport me Bruto Produktin Vendor prapë është përtej asaj çfarë kemi parë në vitin 2016.

Sa u përket shpenzimeve për paga, të thuhet në njërën anë që ka subvencionim shumë...

(Ndërprerje e incizimit nga regjia)

KRYESUESJA: Kundër-replikë kryeministri Kurti për të gjitha replikat.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Faleminderit, nënkryetare!
Edhe nëse e marrim që viti 2020 ka qenë vit i pandemisë, i pandemisë COVID-19 pa vaksina, para katër vjetësh. Po e marrim vitin 2019, Bruto Produkti Vendor ka qenë 7,0 miliardë. Në vitin e ardhshëm do të jetë mbi 10 miliardë. Është kapërcim i madh. Ju duhet ta kuptoni që Bruto Produkti Vendor nuk rritet qysh kemi ne dëshirë, po mbi një bazë që e trashëgon dhe me kaq bazë të ulët të trashëguar, të kemi mbi 10 miliardë Bruto Produktin Vendor, është vështir të gjesh shembuj të tjerë.

E dyta, ne i kemi ndihmuar eksportuesit. Qysh i kemi ndihmuar eksportuesit? I kemi ndihmuar me subvencionim të kredive investive. I kemi ndihmuar bujqit me dyfishim të subvencioneve. Gjithashtu, kemi ndihmuar edhe duke e mbajtur energjinë elektrike të lirë. P.sh. me dy pako mbështetëse për qytetarët në përballje me inflacionin në përgjithësi me krizën energjetike, janë vlerë 250 milionë euro. Duke e mbajtur energjinë elektrike të lirë, ne i kemi forcuar bizneset tona dhe cilido ndërmarrës mund ta konfirmojë një gjë të tillë.

Më tej, edhe mbrojtjen dhe sigurinë e kemi pasur në fokus si askush tjetër. Konkretisht, edhe një herë po them, 153 milionë euro për Ministrinë e Mbrojtjes dhe 216 milionë euro për Ministrinë e Punëve të Brendshme, më së shumti ndonjëherë është Projektligji për buxhetin 2024. Dhe në

këtë qeverisje janë shtuar 850 policë. Kur është fjala për mbrojtje dhe siguri, faktori njeri është kryesori. Do t'i kemi 500 policë më shumë e 600 ushtarë më shumë.

Te punësimi, gjatë kësaj periudhe të qeverisjes sonë që në javën e ardhshme bëhen dy të tretat, janë 60 mijë vende pune më shumë, që i bie rritje e punësimit përmbi 16 për qind. Ne e kemi pasur zotimin kryesor Punësim dhe drejtësi. Pra, për më pak se tre vjet, ka më shumë se 16 për qind rritje të punësimit.

Ndërkaq, sa i përket drejtësisë është e vërtetë që aty kemi edhe më tutje pengesa, ndonëse sundimi i ligjit e sidomos luftimi i krimit e korrupsionit është vërtetuar edhe nga organizata prestigjioze ndërkombëtare që Kosova qëndron më së mirë në Ballkanin Perëndimor. Po pengesat tona janë, në njërën anë janë ligjet e kaluara në këtë Kuvend që vazhdojnë të ngelen të ngujuara në Gjykatën Kushtetuese dhe fakti që Këshilli Prokurorial i Kosovës nga 120 prokurorë prej 200 gjithsej që i kanë mbi tetë vjet përvojë punë, na thonë kryeprokuror ose ky emër i përveçëm ose askush tjetër. Pra, te ajo punësim dhe drejtësi, te kjo drejtësi ne kemi ngecur në këto dy aspekte, ndonëse luftimi i krimit dhe korrupsionit e sundimi i ligjit po na nxjerr më mirë se çdokush tjetër në Ballkanin Perëndimor, jo sipas neve, po sipas organizatave ndërkombëtare.

KRYESUESJA: Vazhdojmë me deputetët e paraqitur për fjalë. Nga Lëvizja Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, e nderuar nënkryetare, znj. Bogujevci!
I nderuar kryeministër,
Zv. kryeministre,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Ashtu siç u prezantua tashmë nga kryeministri dhe gjithashtu edhe nga kryetari i Komisionit për Buxhet, buxheti për vitin 2024 parashihet të jetë 3 miliardë e 28 milionë euro, gjë që është për 143 milionë euro, apo rreth 5 për qind më shumë sesa të hyrat e buxhetit të rishikuar të vitit 2023. Ndërsa, nëse e krahasojmë këtë me të hyrat buxhetore të vitit 2021, pra të vitit të parë të mandatit qeverisës, atëherë rritja është 27,3 për qind, apo 827 milionë euro më shumë këtë vit.

Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore pritet të rriten në 3,31 miliardë euro në Projektbuxhetin 2024, në krahasim me 3,23 miliardë me buxhetin e rishikuar të vitit 2023, gjë që shënon një rritje prej afro 75,7 milionë, apo krahasuar me vitin 2021, një rritje prej 30,6 për qind në vlerë monetare prej 1 miliard e 15 milionë euro.

Përkundër sfidave globale me të cilat jemi përballur edhe ne që nga fillimi i këtij mandati qeverisës dhe kësaj legjislature, është arritur që deficiti buxhetor dhe borxhi publik të jenë në

kuadër të kufizimeve të parapara ligjore. Të hyrat tatimore brenda tre vjetëve janë rritur në mbi 30 për qind, apo thënë më saktë, në 1.9 miliardë që ishin më 2021, projeksioni për vitin 2024 është 2,7 miliardë euro, e cila përveçse rritjes dhe formalizimit të ekonomisë, tregon edhe rritjen e besimit të taksapaguesve në qeverisjen e vendit, duke e zvogëluar informalitetin.

Buxheti i vitit 2024 pa dyshim se është buxheti i mbështetjes për komunat. Për nivelin lokal është rritur në 82,6 milionë euro krahasuar me vitin aktual. Ndërsa, krahasuar me fillimin e mandatit qeverisës, buxheti për komuna nga viti 2021 është rritur për 185 milionë euro, apo 25 për qind, e cila shifër tregon një përputhje me realizimin e premtimit për skemën e grantit të katërt për komuna.

Të nderuar deputetë,
Nëse e shohim në perspektivën makroekonomike, ekonomia e Kosovës gjatë vitit aktual pritet të ketë një rritje prej 3.9 për qind në terma realë dhe 9,6 për qind në terma nominalë, ndërsa në vitin 2024 pritet të rritet me ritme më të përshpejtuara që është vlerësuar afërsisht në 4,6 për qind në terma realë dhe 7,8 për qind në terma nominalë. Afërsisht, të njëjtin vlerësim e ka dhënë edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, i cili ka parashikuar që Kosova do të ketë rritjen më të madhe ekonomike prej 4 për qind, krahasuar me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Stimulimi i zhvillimit ekonomik zë vend në buxhetin e vitin 2024 në të cilin vit Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve ka ndarë 69,7 milionë euro për programin e ringjalljes ekonomike. Sipas programit të Qeverisë Kurti, mbështetja e të rinjve do të vazhdojë në vitin e dytë me radhë në programin SuperPuna. Nga ky program, siç e ceku edhe kryeministri në fjalimin e tij më herët, në tetë muajt e parë kanë përfituar 7 786 të rinj. Nga ta, 3 914 vajza dhe 3 872 djem dhe gjithsej 5 832 biznese. Ky program ka spikatur potencialin e rinisë për angazhim në tregun formal të punës.

Sfidë deri më tani ishte dhe ende mbetet respektimi i të drejtave të punëtorëve, në veçanti në sektorin privat, çështje kjo e cila ka qenë zotim yni për t’u tejkaluar dhe për të cilin jemi angazhuar gjatë periudhës qeverisëse. Që nga viti 2022, Inspektoratit të Punës i janë shtuar edhe 38 inspektorë të rinj, duke krijuar një kapacitet prej 60 inspektorëve të punës në nivel vendi, numër ky i cili do të vazhdojë të rritet në vitin 2024.

Tejkalimi i varfërisë së skajshme dhe krijimi i rrjetit të sigurisë për kategoritë e ndjeshme zë vend në programin qeverisës përmes buxhetit në të cilin janë buxhetuar mjete në vlerë prej 14 milionë e 250 mijë euro për banimin e sigurt.

Struktura demografike e Kosovës po sfidohet me trendët në rënie, njëjtë sikurse në vendet e tjera të rajonit, me rënie të natalitetit, ndërsa Qeveria Kurti ka filluar zbatimin e politikës së saj programore që nga viti 2021, duke shtuar si skemë të re mbështetjen për nënat lehona dhe shtesat

për fëmijë deri në 16 vjet. Për këtë kategori në vitin 2023 kanë qenë të buxhetuara 60 milionë euro, kurse për vitin 2024 janë buxhetuar 95 milionë euro. Nga kjo skemë çdo muaj përfitojnë rreth 380 mijë fëmijë dhe 191 mijë gra përfituese të pagesave për lehonat dhe shtesat për fëmijë së bashku.

Zotimi ynë për shtimin e çerdheve publike është mbështetur çdoherë me ndarjet buxhetore, ndërsa me vitin 2024, me buxhetin prej 13 milionë euro, do të finalizohet numri prej 77 çerdheve gjatë këtij mandati, prej të cilave 12 janë me mjete buxhetore, 12 janë me programin IPA, ndërsa 53 janë çerdhe modulare.

Barazia ndërmjet djemve e vajzave dhe inkuadrimi i vajzave në programe deficitare reflektohet në buxhet në ndarjen e një mijë bursave për vajza dhe gra në vitin akademik 2023/2024 të regjistruara për herë të parë në programin STEM.

Fokusi për barazi dhe gjithëpërfshirje është edhe te komunitetet joshumicë, të cilat në vitin akademik 2023/2024 janë ndarë njëqind bursa, vlera e të cilave është një mijë euro secila.

Ndërsa, secili student apo studente me aftësi të kufizuara për vitin akademik 2023/2024 gjithashtu do të ketë qasje të palimituar në bursën për vit akademik në vlerë prej një mijë euro.

Në përputhje me planin tonë qeverisës dhe strategjinë për energjinë, të cilën e miratoi Kuvendi i Republikës së Kosovës, janë bërë përmirësime në fushën e efiçiencës, përmirësime këto që kanë efekt të drejtpërdrejtë në llogari të qytetarëve. Gjithashtu, vazhdon të ndihmohen edhe këtë vit me gjithsej 3.6 milionë euro. Numri i përfituesve për vitin që po e përmbyllim ishte 1300 përfitues, ndërsa mbështetja pritet të vazhdojë edhe në vitin 2024. Zbatimi i masave të efiçiencës së energjisë elektrike ka filluar dhe po zbatohet në ndërtesat publike dhe te konsumatorët shtëpiakë të energjisë.

Mbështetja për ndërmarrjet publike është bërë përmes përmirësimit të menaxhimit korporativ dhe përmes ndarjes buxhetore që ka qenë një nga zotimet tona. Ndërsa për vitin 2023 janë ndarë 1 989 720 euro, ndërsa për financimin e investimeve kapitale edhe në vitin 2024 janë ndarë edhe 4 980 720 euro.

Sektori i bujqësisë, siç e dini, është mbështetur vazhdimisht duke u rritur granti dhe duke u rritur subvencionimi për bujqit, nga 150 euro për hektar, është rritur në 614 euro për hektar, duke shtuar kështu edhe mbështetjen për farën dhe plehërimin e naftën, duke rritur shumën totale të subvencioneve për bujqit nga 49 milionë në vitin 2021, në 72 milionë në vitin 2024.

U përmend Ministria e Jashtme më herët. Siç e dini, blerja e ambasadave të Republikës së Kosovës, tashmë me prezencë në qendrat globale është bërë në Uashington, Londër dhe Senegal. Ndërsa, në proces të blerjes janë edhe shtëpitë rezidenciale në Uashington dhe Berlin.

Si asnjëherë më parë, Qeveria Kurti ka bërë ndarje buxhetore meritore për sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë, për të cilin u fol, u përmend dhe u kritikua, por pa arsye. Shuma totale për sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë në vlerë prej 369 milionë eurosh vetëm për vitin 2024. Ky sektor prej vetit 2019-2021 ka pasur total 126 milionë euro. Një dallim substancial në masën prej dyqind për qind rritje. Në veçanti, Ministria e Punëve të Brendshme për vitin 2024 ka rritje buxhetore prej 216 milionë euro, përderisa dikur në qeveritë e kaluara kishte një buxhet prej 58 milionë euro. Te Ministria e Mbrojtjes për herë të parë në vitin 2024 ka buxhet 153 milionë euro, ndërsa 58 milionë euro janë të dedikuara për investime kapitale, përderisa ky buxhet në qeveritë e kaluara ishte 71 milionë euro.

Për policinë e Kosovës gjatë Qeverisë Kurti ka rritje prej 30% të buxhetit total nga të cilat 300% rritje në investime kapitale dhe më tepër se 21 herë buxhet për pajisje operacionale nga rreth 500 mijë sa ishte në vitin 2021, në 9 milionë në vitin 2024.

Një sektor problematik, i cili ka pasur gjithmonë ndikim të madh në buxhet me probleme të realizimit të projekteve si rrjedhojë e mungesës së elaborateve dhe shpronësimeve, si dhe mungesës së planifikimit të mirëfilltë në vitet paraprake, ai i infrastrukturës, me këtë buxhet është bërë përpjekje serioze, jo vetëm të finalizohen projektet e nisura deri më tani, por edhe të investohet në infrastrukturë strategjike, siç janë hekurudhat. Për këtë janë paraparë 201 milionë euro për linjën hekurudhore 10, ndërsa 3 milionë euro për projektim dhe vendkalimet hekurudhore.

Të nderuar qytetarë,
Kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,
Projekt-buxheti i vitit 2024 është në funksion dhe përmbushje të realizimit të programit fitues, i cili ka marrë mbështetjen tuaj dhe mbi atë mbështetje synon të arrijë rezultatin e përafrimit të Kosovës me të gjitha objektivat për një shtet të zhvilluar dhe të mirëqenies. Andaj, ju ftoj të gjithëve që ta votoni. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Ferat Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit, e nderuara nënkryetare e Kuvendit,
Përshëndetje Kabinet qeveritar,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar deputetë dhe media,

Ne sot po diskutojmë për çështjen e projektligjit më të rëndësishëm që kemi, buxhetin për vitin e ardhshëm.

Dhe, nëse ndalemi dhe bëjmë një analizë se si do ta emëronim këtë projektbuxhet, sigurish që hapi i parë do të na shkonte të shohim se në cilat linja orientohet shuma më e madhe e mjeteve. Dhe, doemos nëse e shohim me përqindje, pra 32% e këtij projektbuxheti shkon në kategori sociale dhe subvencione dhe me të drejtë mbi bazën e këtij kriteri, do ta quanim projektbuxhet social.

Buxhet social, sepse tashmë po i marrë edhe disa shifra, vetëm gjatë vitit 2022 rreth 26 mijë persona i janë shtuar listës së varfërisë së skajshme të banorëve të Kosovës, e në total sot kemi diku 16% ose 283 mijë persona që jetojnë në kushte të varfërisë.

Pra, këto shifra të fundit e tregojnë që nuk është zgjidhja më optimale e projektbuxhetit, sepse 3 vjet qeverisje nuk e kanë ndryshuar gjendjen sociale dhe nuk e ka eliminuar varfërinë. Pra, kemi një rritje prej 1.1 miliard euro të buxhetit për kategori sociale, që po vazhdon, por që realisht nuk kemi rënie të varfërisë në Kosovë.

Dhe, kur e krahason këtë me kategorinë tjetër, sepse nuk mund të luftohet varfëria me skema sociale dhe ndihma, por me investime kapitale investuese, prodhuese, zhvillimore, atëherë rrjedh situata kështu; sa kemi investime kapitale në projekte, kemi 26%, që i bie 6% më pak sesa kategoria e subvencioneve dhe e ndihmave.

Pra, logjika e shëndoshë të jep të kuptosh që është shtet social, është politikë sociale nëse mendon që investimet kapitale janë për 6%, i nderuar kryeministër, më pak sesa subvencionet dhe kategoritë sociale.

Edhe kjo mund të jetë politikë juaja, por kur e sheh çështjen e investimeve kapitale të zbërthyera pastaj në përqindje të tjera na rezulton që kemi; nga 26% e planifikimit buxhetor për nivelin qendror të investimeve kapitale, 90.6% janë projekte në vazhdim, i nderuar kryeministër. Pra, 90% e investimeve kapitale janë të bartura dhe këtë saktësisht e ke duke thënë që vetëm 9,38% janë investime të reja në nivelin qendror.

Pra, krahasoji, sepse shifrat mirë i kupton dhe i di. Pra, nga 26% e investimeve kapitale, vetëm 9% janë investime të reja kapitale në nivelin qendror. Çfarë zhvillimi kemi këtu? Çfarë zhvillimi ekonomik pret shteti nga këto?

Shikoni! I nderuar kryeministër, 9,38% janë 60 milionë euro, në nivelin qendror kemi investime të reja kapitale. Pra, vetëm 60 milionë euro. Të tjerat janë krejt mosrealizim i projekteve gjatë vitit 2023.

Por, nëse e marrim një shifër tjetër. Buxheti qendror në raport me buxhetin e komunave. Në total kemi 77,18% buxhet të nivelit qendror për investimet kapitale po flasim, dhe kemi vetëm 22,8% të niveleve komunale.

I nderuar kryeministër,
Baza ekonomike zhvillohet në terren në hapësirë në Kosovë, në gjeografinë e Kosovës, në nivelet komunale, por këtu për mua është pyetja e madhe edhe politike edhe logjike: si ka mundësi që vetëm 22,8% të jetë për nivelet komunale buxheti e investimeve kapital dhe të jetë 77,18, por që realisht nëse i sheh shifrat e realizimit, siç tha kolegu më herët, të vitit të kaluar, del që ne nuk jemi të gatshëm që ta zhvillojmë vendin.

Ose e marrim kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Keni një rritje nga 498.3 milionë për vitin 2023 në 518 milionë për vitin 2024.

I nderuar kryeministër, se ju e prezantuat buxhetin. Keni rritur kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Keni rritur. Kjo i bie që standardi dhe luksi i institucioneve qeveritare po përparon, por jo në proporcion me nevojën dhe ato skemat sociale që thashë në fillim.

Pra, pse është kjo rritje e luksit qeveritar në 518 milionë mallra dhe shërbime, e në anën tjetër, i nderuar kryeministër, pensionet dhe kompensimet për veteranët dhe invalidët e luftës për vitin 2023, do të thotë, praktikisht në planifikim e ke për 3,3 milionë euro më pak. Ke rritur mallra dhe shërbime për Qeverinë dhe institucione të tjera, dhe ke zvogëluar për kategoritë e dala nga lufta. Realisht është mospërputhje edhe logjike edhe humane edhe sociale.

Ose, ndarjet buxhetore për komuna. I nderuar kryeministër, buxhet tipik diskriminues, i papranueshëm në kuptimin njerëzor dhe social. Mbi bazën e vetëm kriterit politik, se kriter tjetër unë nuk shoh që ka.

Më lejo t’i interpretoj këto, të lutem! Gjilani, investime kapitale të planifikuara, të reja po flasim, 22,4%, meritueshëm. Po pse s’i meriton Prishtina që ia keni dhënë vetëm 7,0%? Pse s’i meriton kryeqyteti në raport me Gjilanin. Ose, Shtimja 7,63. Pra, më shumë se Prishtina. Meritueshëm i ka Shtimja, po pse s’i meriton Mitrovica që ia keni ndarë 5,02%?

Edhe këtu fusni një investim të Ministrisë së Brendshme në kampin Belvedere, që s’ka lidhje me pushtetin lokal, por të mashtroni, thjesht. Ose, Kamenica ka 6,86%, meritueshëm, ndoshta edhe pak. Por, qysh ka mundësi Kaçaniku të mos e ketë më shumë se 2,09%? 2,09% Kaçaniku investime të reja për vitin e ardhshëm. Apo, Podujeva 6,13%, meritueshëm. Por, pse Prizreni 2,09% investime të reja? Vushtrria 2,01%, i nderuar kryeministër!

Drenasi im 0,5%, apo Skenderaj 0,4%? Të dyja komunat së bashku 0,9% investime të reja nga Qeveria juaj, i nderuar kryeministër! Krahasojini vetë shifrat, sepse me shifra e di që jeni goxha specialistë.

Ju gjatë referimit e përmendet arsimin. Unë po jua marrë vetëm një shembull nga arsimi. Universiteti i Prishtinës ka më pak mjete këtë vit për 956 mijë euro, ose -2,93%. Edhe në paga e keni goditur rëndë, tash edhe buxhetin ia ulni, dhe thoni që po e mbështesni arsimin. OK! Është çështje që mund ta vërtetojnë ata që realisht e përjetojnë këtë, por nuk e kuptoj pse është kjo sjellje ndaj universitetit shtetëror të Kosovës?! Pse është zvogëlim i buxhetit, nuk e kupto!

Ndërkaq, me Ligjin për Fondin Sovran po doni ta hapni edhe një akademi tjetër atje, se pak kemi universitete.

RTK-në e keni lënë njëjtë. U ka dështuar edhe menaxhmenti totalisht. Çka presim reformë, sistematizim, ristrukturim, nuk do koment kjo punë. Njëjtë e ka buxhetin sikurse në qeveritë e kaluar.

Por, fatkeqësisht, nuk e ke mbylljen e AKP-së. 4.6 milionë i ka AKP-ja mjete. Vitin e kaluar s’e ke marrë asnjë cent nga AKP-ja në buxhet, sivjet ia ke qitur nja 4,6 milionë euro. Por, na ke thënë që do ta mbyllim. Do ta mbyllim AKP-në.

Për shkak të kohës do të ngutem pak. Po e trajtoj Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë, sepse dhe ashtu jam pjesë e komisionit që udhëheq me këtë. Shikoni! E keni zvogëluar buxhetin 25 milionë euro tregti, industri, eksport, gjithçka tjetër, ndërmarrësi. Është keq. Këndej, e keni zvogëluar edhe rezervën shtetërore. Çka ndodhi, kryeministër, me rezervën shtetërore, nga 1 600% që e patët rritur dhe krenoheshit këtu, na e keni sjellë në 5 milionë rezervë shtetërore tash.

Na e thoni, çka u bë me rezervën shtetërore edhe pse ato tjerat po e dimë, s’kanë ardhur, na e keni sjellë në 5 milionë rezervën shtetërore, në rrethana lufte, këndej po blejmë armatim, e rezervat e shtetit në 5 milionë. Ku kanë mbetur? Së paku të mos koriteni me kompanitë polake dhe ata sekserët e tregtisë. E ke faqe 44, tabela 1659.

Ose, Ministria e Ekonomisë. Për shkak të kohës, po shkojmë. I nderuar kryeministër, 0.3 është pesha e organizimit buxhetor të kësaj ministrie që mbulon sektorët më vital të shtetit, ndërmarrjet publike, industrinë e rëndë, Trepçën, KEK-un dhe shumëçka tjetër.

Veç kur e sheh në organogram me 2,03 nënkupton që ju nuk e keni fare prioritet këtë. Energjia e të gjitha këto hyjnë.

Por, çka më bëri përshtypje të ndarjet, nga 58 milionë janë 1.5 milionë paga dhe mëditje, meritueshëm për 202 punëtore. I nderuar kryeministër, 202 punëtore kanë 1.5 milionë euro, ndërsa kanë 15% nga 58 milionëshi ose 9,1 milionë euro kanë subvencione, transfere apo mallra dhe shërbime realisht.

Pra, nga 9 milionë mallra dhe shërbime për 202 punëtorë të Ministrisë së Ekonomisë, ministrja është këtu, na thotë se çka ndodhë kështu. Nëse, kryeministër, e bëj një krahasim me shifrat tuaja... Nënkryetare, edhe një minutë, të lutem!

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

FERAT SHALA: Ministrja e Ekonomisë është këtu, 202 punëtorë me 9 milionë e 100 mijë euro mallra dhe shërbime, pa paga dhe mëditje, se me paga e mëditje shkojnë 10,6 milionë, nëse i pjesëtojmë për 200 punëtorë, në total i bie që kanë 52 mijë euro për kokë të punëtorit mallra dhe shërbime me paga dhe mëditje, që i bie sa 5 punëtorë të Njësisë Speciale që i kalkuloje, thoshe 1 punëtor ose 1 polic në vijën e frontit të Njësisë Speciale ka asete, mjete lufte 10 mijë euro.

1 punëtor i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik i ka 52 mijë euro mjete, paga e mëditje dhe mallra dhe shërbime. Pra, llogarite këtë. Ose, nëse i heqim pagat dhe mëditjet, 1 punëtor i Ministrisë së Zhvillimit i ka 44 mijë euro mallra dhe shërbime për kokë të punëtorit. Krahasoji tash me Njësinë Speciale dhe me ndarjet buxhetore që ke bërë. Nuk kam koment tjetër.

KRYESUESJA: E nderuar deputete Statovci, e keni kërkuar fjalën për sqarim? Procedural, në fakt.

JETA STATOVCI: Mbi temën e cila u ngrit gjithashtu u përmend edhe Komisioni për Ekonomi...

KRYESUESJA: Nëse mundesh, të lutem, e mbani brenda diskutimit kur t'u vije radha e fjalës.

JETA STATOVCI: U përmend çështja e komisionit, kështu që po replikoj në çështjen e komisionit. Gjithashtu, në kuadër të temës që u ngrit, u përmend që nuk është luftuar varfëria.

KRYESUESJA: Vazhdojmë me pjesën e diskutimit, të lutem!

JETA STATOVCI: U përmend çështja e komisionit, po i referohem si nënkryetare e komisionit, kështu që po replikoj në sensin e temës që u ngrit, temës së buxhetit. Nëse mund të vazhdoj, nënkryetare?

KRYESUESJA: Tani e ka radhën deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuara nënkryetare!
Ministra,
Kryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar qytetarë,
Fillimisht, para se të filloj me komentimin e shifrave të buxhetit, të nderuar kolegë deputetë, nga Agjencia e Statistikave të Kosovës kjo është pamja e rritjes ekonomike të Kosovës.

Domethënë, ky është grafi i rritjes ekonomike të Kosovës për mandatin e Qeverisë Kurti. Kështu duket. Kjo rritja. Me 16% e kanë marrë dhe sot është në 2%. Ndërsa, kjo e paraqet normën e inflacionit. Sigurisht, kryeministri është shumë i zënë se dialogu i është bërë prioritet numër 1, po unë po ia lë këtu, sepse janë nga Agjencia e Statistikave që operon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

I nderuar kryeministër,
Ju thatë se e keni rritur buxhetin 31% në drejtësi, 20% në arsim. Shërbimit Spitalor Klinik Universitar 25%. 58 milionë për kulturë. 600 policë. 500 ushtarë të TMK-së dhe 22% mbrojtje.

Por, i nderuar kryeministër,
Asnjëherë nuk e përmendet se ku e keni ulur buxhetin. Për shkak se ngritje e tillë e buxhetit nuk mund të ndodhë me 78 milionë euro.

Të nderuar kolegë deputetë,
Buxheti, planifikimi për vitin 2024 është ngritur me vetëm 2,3% ose 78 milionë euro. Andaj, nuk ka shanse që të bëhen të gjitha këto rritje në përqindje prej 20, 30% e 50% me 78 milionë euro. Do të thotë, ka organizata buxhetore të cilave u është ulur buxheti.

Për shembull, le të përmendim, mallrat dhe shërbimet janë rritur në 26 milionë apo vetëm 5.2%, derisa norma mesatare e inflacionit për janar-shtator të këtij viti është 5.8%. Subvencionet dhe transferet janë ulur për 38 milionë, ndërkohë që investimet kapitale janë rritur për vetëm 30 milionë. Edhe njëherë, rritja e buxhetit është vetëm 2% nëse flasim në terma të planifikimit.

Por, siç e përmendi edhe zoti Hoti në fjalimin e tij, ne kur flasim për buxhetin e këtij viti, duhet ta potencojmë se ky është instrumenti i fundit buxhetor për realizimin e premtimeve të Qeverisë Kurti.

Dhe, të gjithëve na kujtohet, jo vetëm premtime gjatë fushatës elektorale, por në fakt zoti Kurti këto premtime i pati bërë program qeveritar dhe i ka lexuar pikërisht këtu në ditën kur është votuar Kabineti qeveritar.

Ai ka thënë që, do të thotë, premtimet e zotit Kurti kanë qenë që do të lirohet çmimi i energjisë, sepse ne flemë mbi energji. Një litër qumësht, vaj dhe sheqer do të kushtojë më lirë, sepse do ta heqim TVSH-në. Premtoi se do të rritet paga minimale. Se Qeveria nuk do të tatimojë qytetarët për burimet minimale të jetesës.

Pati premtuar 160 çerdhe, 4 mijë banesa për çiftet e reja, sigurime shëndetësore, Fond Sovran, Bankë Zhvillimore, përfundim të procesit të privatizimit ose ndalim siç e quante, ndalje të gjakderdhjes financiare të ndërmarrjeve publike, punë dhe drejtësi, dhe thoshte se familjarët janë për dasma.

Dhe sot, kur tani e planifikojmë edhe po e diskutojmë planifikimin buxhetor për vitin fundit të mandatit qeverisës, e dini se çfarë ka ndodhur. Çmimi i energjisë elektrike nuk është liruar, është rritur dy herë. Një herë 85, respektivisht 104% dhe herën tjetër 15%.

Produkteve bazë nuk u është hequr TVSH-ja. Përkundrazi, shporta bazë e konsumit është shtrenjtuar me 50%, dhe këta kanë marrë taksa më shumë si rezultat i kësaj. Paga minimale nuk është rritur. Ka kalua ligji, është në Gjykatë Kushtetuese për fajin e këtyre, sepse nuk kanë dashur të bëjnë dialog social. Qytetarët vazhdojnë të tatimohen për pagën minimale. Nuk janë ndërtuar 60 çerdhe, as 80 bile, as 40, e për këtë temë mund të flasim në detaje.

Nuk ka ndërtim të 4 mijë banesave, as 400, as 4 nuk janë ndërtuar. Janë planifikuar këtë vit, nuk ka ndodhur asgjë, janë planifikuar për vitin tjetër, vështirë që do të fillojnë.

Nuk ka sigurime shëndetësore. Buxheti mbetet i njëjtë te Fondi i sigurimeve shëndetësore, bile për më tepër, lista esenciale e barnave nuk është rritur as për normën e inflacionit. E kanë bërë Ligjin për Fondin Sovran, i cili është lexim të parë, po edhe me ligj i japin këtij fondi afat 2 vjet për t'u funksionalizuar pasi të kalojë ligji në lexim të dytë.

Privatizimi po vazhdon valë-valë sikurse edhe më parë, ndërsa gjakderdhja financiare e ndërmarrjeve publike po do ta qes në komë Buxhetin e Republikës së Kosovës, sepse siç u tha më herët nga deputeti Hoti, derisa në vitin 2019 ndërmarrjet i kemi subvencionuar me 41 milionë, në vitin 2022 subvencionimi ka arritur 233 milionë vetëm për rrymën në veri, e ky ka qenë një premtim i zotit Kurti se nuk do të vazhdojë ta paguajë rrymën, janë paguar për dy vite 113 milionë.

Sa i përket punësimit, ai po bëhet në Gjermani. Kryeministër, besoj që ju i keni të dhënat. Më shumë se 30 mijë veta, qytetarë të Republikës së Kosovës vetëm me viza pune gjatë muajve të këtij viti kanë ikur për Gjermani.

Dhe, drejtësi nuk e di nëse mund të quajmë që kemi drejtësi, sepse ndërhyrjet tuaja e tregojnë të kundërtën. Po bëhen dy vite që ne e kemi vendin pa kryeprokuror. Sa herë që drejtësia kap të korruptuarit e pushtetit, prej kryeministrit te presidentja, si në rastin Martin Berishajt, deri tek të gjithë eksponentët e Lëvizjes Vetëvendosje, i marrin në mbrojtje ata. Nuk e di nëse kjo mund të quhet drejtësi.

E ke një numër të madh të ligjeve që tanimë t'i ka kthyer Gjykata Kushtetuese si antikushtetuese. Nuk e di nëse këtë ju e quani drejtësi. Ndërsa, nga slogani o se "familjarët për dasma" keni kaluar në situatën kur dasmat lirshëm mund t'i organizoni nëpër ministri, sepse plotë familjarë i keni të mbushura.

Të nderuar kolegë deputetë,
Ka shumë lëvdata që tri vite që buxheti për herë të parë ka arritur 3 miliardë, për herë të parë 3 miliardë, dhe unë jua bëj më dije që në vitin 2021 buxheti ka qenë i planifikuar 2,9 miliardë, por ka ndodhur realizim prej 2,3. Në vitin 2022 ka qenë i planifikuar të jetë 3,1 miliardë, por në terma të realizimit, është realizuar vetëm 2,5.

Në nëntëmujorin e këtij viti janë realizuar vetëm 1.8 miliardë buxhet, e prej këtyre realizimin më të dobët e kanë investimet kapitale, ato të cilat do të duhej që të sillnin impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit.

U përmend këtu shumë që ndryshimi i strukturës kapitale të buxhetit, është tepër përkeqësim. Do të thotë, duke kaluar prej 36% në favor të investimeve kapitale në 16% qysh e kemi ekzekutimin e investimeve kapitale në vitin 2022.

Të nderuar kolegë deputetë,
Ka disa sektorë të cilët janë lënë anash. Prej rreth 1 miliard e 65 milionë të cilat janë të parapara te subvencionet dhe transferet, 430 milionë shkojnë në transfere që nënkupton, janë thjesht pensione të cilat jepen me ligj, dhe pjesa tjetër është subvencione.

Por, nëse e shihni shpërndarjen, kjo është tepër jo transparente. Për shembull, përkushtimin që kjo Qeveri e ka për sektorin privat, mund ta shohim te buxheti i KIESA-s. Për sektorin privat janë parapara 5,2 milionë euro subvencione te KIESA, 5,2 milionë, ndërkohë që Agjencinë e Investimeve të cilën dëshiron ta bëjë kryeministri, e ka paraparë në buxhet me 20 veta staf dhe 260 mijë euro. Domethënë, kaq sa i përket mbështetjes së sektorit privat.

A keni parë diku që ka mbështetje për sektorin ICT-së? A e keni parë sa është buxheti në Agjencinë për Barazi Gjinore? Buxheti për Agjencinë për Barazi Gjinore është rreth 360 mijë euro, dhe janë vetëm 40 mijë euro për subvencione në këtë agjenci.

A keni parë që te Ministria e Kulturës, e cila e ka buxhetin për kapitale 58 milionë, e nëntëmujorin e këtij viti, duhet ta potencojmë se ka qenë në gjendje të realizojë vetëm 3,3 milionë sipas raportit të ministrit të Financave, te rinia kjo ministri i ka të planifikuara vetëm 2,1 milionë euro, te rinia.

Kishin ndarë 50 mijë euro për ndërtimin e deponisë së mbeturinave regjionale në Pejë. Imagjinojeni, atje është një kodër, është një bjeshkë e tërë me mbeturina dhe këta i ndajnë 50 mijë euro. Kryetari i komunës është në gjendje që t'i ndajë 3 milionë euro për atë deponi, këta i ndajnë vetëm 50 mijë euro.

Ka 1 milion për digat dhe ne jemi në krizë të ujit, të mos e përmend faktin që qindra-mijëra qytetarë të vendit po përdorin ujë me mangan ose po e blejnë ujin, dhe Qeveria po i sodit. Ju faleminderit!

KRYESUEJSA: Tani në radhë është Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: E nderuara kryesuese e Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Të dashur qytetarë,
Ne sot po diskutojmë për projekt-buxhetin e shtetit të Kosovës, i cili nuk mund të quhet as buxhet zhvillimor dhe as i suksesshëm, sepse kemi një rritje të buxhetit për vetëm 100 milionë euro dhe realisht Kosova po mbetet aty ku ka qenë. Për ne si AAK ky buxhet ka shumë mangësi dhe nuk përmbush nevojat e kërkesat reale të të gjitha kategorive buxhetore. Ky nuk është buxhet i qytetarëve të Kosovës, sepse po bëhet pa i përfillur kërkesat buxhetore të komunave, të shoqërisë civile, të institucioneve qendrore publike, të sindikatave, të njësive të tjera buxhetore dhe propozime të partive opozitare.

Tani, në pikat e shkurtra do të numëroj disa nga mangësitë kryesore të buxhetit të propozuar nga kjo qeveri. Me këtë buxhet të propozuar nuk ka rritje të pagave, të pensioneve, nuk ka rritje për pagesat ndaj fëmijëve deri në moshën 16 vjeç, nuk ka rritje të pensioneve të veteranëve dhe nuk ka rritje të asnjë kategorie tjetër, madje ato rritje janë qesharake. Me këtë buxhet të propozuar keni rritur koeficientin për vetëm 5 euro dhe në këtë i keni fyer policët, mjekët, mësimdhënësit, zjarrfikësit, shërbyesit civilë, gjyqtarët, e kategoritë e tjera vitale të shtetit. Me këtë buxhet keni planifikuar që për ringjalljen ekonomike të shtetit të ndani vetëm 69 milionë euro. Dhe, nëse e krahasojmë vetëm me pagesën në rrymën Veriore që është 113 milionë, atëherë ku, çfarë zhvillimi keni menduar. Dhe, kjo është për të ardhur keq se si kjo qeveri mendon ta zhvillojë vendin me projekte të reja vetëm me 69 milionë euro.

Mendoj që me këtë buxhet keni rritur buxhetin e Zyrës së Kryeministrit për 408 mijë euro, dhe të Presidentes për 410 mijë euro, ndërsa sa për krahasimin e për hir të së vërtetës, ia keni larguar buxhetit të Universitetit të Prishtinës për 900 mijë euro. Me këtë buxhet tek investimet kapitale që parashihen të jenë 859 milionë euro, kemi sa u përket investimeve qendrore, do të thotë kemi 640 milionë euro, ku 580 milionë euro, apo 91% janë për projekte në vazhdim. Ndërsa, 60 milionë euro apo 9% janë projekte të reja. Dhe paramendojeni se ku ka arritur shpenzueshmëria e investimeve kapitale që u përmend, dhe në këtë vit është diku 16% deri në fund të vitit mund të arrijë deri 29%.

Me këtë buxhet keni krijuar pabarazi dhe diskriminim të komunave dhe qytetarëve, kur projektet e ministrive janë të orientuar tek komunat që udhëhiqen nga Vetëvendosja. Për shembull, më shumë keni ndarë buxhet për një komunë me 40 mijë banorë se për një komunë me 400 mijë banorë, vetëm për faktin që nuk udhëhiqet nga Vetëvendosja. Me këtë buxhet projektet në infrastrukturë, autostrada dhe rrugë janë aty ku kanë qenë, s'keni marrë asnjë vendim për të lëvizur ndonjë gur në projektet zhvillimore, keni vazhduar duke harruar projektet që kanë qenë, si magjistralja e Pejës, Podujevës, Gjilanit, Mitrovicës, ndërsa keni lënë anash autostradën e Dukagjinit e shumë projekte të tjera të rëndësishme të Kosovës. Po e marr vetëm rrugën Gjakovë - Dollc, me të vërtetë e keni lënë në mjerim që tre vjet. Thua se Gjakova nuk i përket Kosovës dhe shihni se si zhvillohet ai projekt, nëse e marrim si tërësi as 5 km nuk janë shtruar dhe është gjendja e mjerueshme. Me këtë buxhet keni rritur vetëm pjesën tek mallrat dhe shërbimet, thënë në numra nga 493 milionë euro në vitin 2023, në 590 milionë euro në vitin 2024, ku po dëshmohet se Qeveria Kurti luksin e ka prioritet ndaj të gjitha nevojave të tjera.

Me këtë buxhet keni rritur pjesën te skemat sociale, ku po dëshmohet se kjo qeveri nuk e ka përmirësuar, por e ka vështirësuar jetën e qytetarëve, familjeve dhe e kategorive të tjera që kanë nevojë për dorën e shtetit. Me këtë buxhet padrejtësisht i keni shkurtuar buxhetin Avokatit të Popullit për 27 mijë euro, Akademisë së Drejtësisë për 29 mijë euro, Gjykatës Kushtetuese për 115 mijë euro, si dhe Kuvendit të Kosovës për 311 mijë euro.

Me këtë buxhet keni nderuar dhe lartësuar Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, ku thënë në numra, nga 4 milionë e 393 mijë euro e keni ngritur në 6 milionë e 639 mijë euro. Me këtë buxhet, te kategoria e shpenzimeve rrjedhëse keni rritur buxhetin për 37 milionë euro, që realisht nuk ka ndonjë efekt dhe ndikim në zhvillimin ekonomik në jetën e qytetarëve. Për fund, ka edhe shumë ndarje buxhetore që janë gabim e që nuk dua t'i përmend, por e çuditshme për mua është e vërteta që si ka mundësi që kjo qeveri në tre vjet ka pasur në udhëheqje afër 9 miliardë euro dhe qytetarët ende nuk kanë parë një projekt të madh të rëndësishëm që do të bënte jehonë në Ballkan e Evropë, dhe që do t'u shërbente nevojave të qytetarëve dhe zhvillimit të vendit. Duke mos dashur të zgjatem, ju bëj thirrje që në mes të leximeve të merrni parasysh kërkesat buxhetore dhe amendamentet që do t'i bëjnë komunat, sindikatat, shoqëria civile, si dhe ne si deputetë.

Kosova ka nevojë për konstruktivitet dhe bashkëpunim pozitë-opozitë, prandaj kjo duhet të fillojë nga buxheti i Kosovës, e për të vazhduar me temat e tjera të rëndësishme që lidhen me të ardhmen e vendit për vitin 2024.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani është deputeti Erxhan Galushi.

ERXHAN GALUSHI: Faleminderit!
E nderuar kryesuese!
I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Meqenëse nga praktika e buxhetit të kaluar dhe nevojës së theksuar pas aprovimit të buxhetit për Zyrën për çështjen e komuniteteve, pranë Zyrës së Kryeministrit, është evidentuar nevoja për rritjen e buxhetit të kësaj Zyre.

Duke marrë parasysh nevojat e theksuara të komunitetit rom, por edhe të komuniteteve të tjera joshumicë joserbe, për të cilat kërkesa Zyra për Çështjen e Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit ka pasur sfida të theksuara të nevojës buxhetore karshi kërkesave të qytetarëve të lartpërmendur. Prandaj, kërkoj nga ju që edhe një herë të rishikoni mundësinë për rritjen e buxhetimit, çka do të kontribuojë edhe në efikasitetin e funksionalizimit të kësaj zyre.

Prandaj, kërkesat konkrete për nga nevojat janë, si në vijim:

- në shëndetësi dhe mirëqenie, pra subvencionimi ose financimi i personave në gjendje jo të mirë,
- arsimim dhe trajnim, pra aftësimi i komuniteteve nëpërmjet trajnimeve profesionale,
- subvencionimi i nevojshëm për organizatat joqeveritare,
- për aktivitete kulturore, sportive, përmes festave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Po ashtu, zhvillim ekonomik, financim i komuniteteve përmes projekteve start-up, subvencionimi po ashtu edhe për bizneset e vogla të komuniteteve joshumicë joserbe. Si dhe, investimin në infrastrukturë të hapësirave publike apo rindërtim i infrastrukturës së degraduar. Po ashtu, si çështje kryesore, media si fushë e veçantë për promovimin e kulturës, si dhe bursa dhe praktika për studentët e komuniteteve joshumicë.

Me këto kërkesa specifike i drejtohem ekskluzivisht zëvendëskryeministres për çështje të pakicave dhe të drejtave të njeriut, zonjës Emilija Rexhepi, ku së bashku me ministrin e Financave Hekuran Murati, të bëjnë më të duhurën për kërkesat e potencuara karshi nevojave të qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Haki Abazi.

HAKI ABAZI: Faleminderit, kryesuese!
Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar qytetarë,
Mendoj që çështja fundamentale e diskutimit sot ka të bëjë me vizionin e kësaj qeverie të ndërlidhur me numrat, kundrejt mirëqenies së qytetarëve. Do të thotë, Lëvizja Vetëvendosje ka ardhur në pushtet me tri premtime: barazi, drejtësi dhe punë. Mendoj që brenda këtyre vlerave duhet të bëhet edhe ndarja buxhetore e të ndërpritet ideja që me rritje e përqindje, të konsiderohet se është duke u siguruar mirëqenia e qytetarëve. Ja pse nuk është barazi: barazi nuk është kur diskriminohet komunat bazuar në pushtetin lokal që kanë. Nuk mund të flitet për bursat për femrat, kur në këto komuna që janë diskriminuar jetojnë edhe femrat, edhe meshkujt. Domethënë, diskriminimi është në palcë, pabarazia është në rritje, kur diskriminohen komunat vetëm pse kanë votuar në një drejtim ose në një tjetër.

E dyta, përkufizimi i drejtësisë, si sistem prokurorial e gjyqësor është gabim fundamental. Drejtësia nuk përkufizohet brenda mekanizmit, drejtësia është e drejtë, është e drejta e punëtorëve, e policëve, e veteranëve, është e drejta e secilës kategori në këtë vend për të marrë mbështetje nga buxheti i vendit. Ideja të reduktohet drejtësia te një prokuror, një emër i përveçëm, është naivitet, në rastin më të mirë, e është manipulim, në rastin më të keq të mundshëm. Hajde ndalemi te puna, cila punë? Ato vende, të cilat janë krijuar si vende të reja të punës janë si rezultat i boshatisjes së klasës punëtore, e cila është profilizuar dhe ka kapacitet të marrë punë diku në Perëndim. Llogariteni proporcionin e njerëzve, të cilët kanë punuar me përvojë pune në sistemin bankar, në sistemin publik, në sistemin privat dhe sot kanë përfundua në Gjermani, Zvicër e shtete të tjera dhe mandej bëjeni krahasimin se sa vende të reja të punës janë krijuar. Mendoj që përfundon në 7 mijë vende të reja të punës që janë krijuar në mënyrë artificiale nëpërmjet një platforme komplet të paqëndrueshme, që quhet SuperPuna.

Por, puna ndërlidhet gjithashtu edhe me vizionin, cili është vizioni i kësaj Qeverie? çka ndjek ky buxhet? Ministria e Zhvillimit Ekonomik është ministria më e dobët përbrenda kompozicionit qeveritar, edhe me buxhet, edhe me iniciativa, edhe me të gjitha veprimet që janë ndërmarrë deri sot. Strategjia për energji, siç ju kam thënë, është një punim seminarik që edhe sot krejt çka bën është të organizojë konferenca për pjesëmarrës, konferenca për panelet solare, konferencë për kreativitet e inovacion etj. Por, jeta e njerëzve nuk përmirësohet me konferenca. Për 23 vjet në këtë vend janë mbajtur konferenca të pafundme, janë shpenzuar fonde të Kombeve të Bashkuara e të Agjencive Zhvillimore Ndërkombëtare deri në pafundësi, me miliarda euro, por ai zhvillim nuk ka ardhur prej konferencave.

E treta, përbrenda punës: me tentimin me i mbajt 900 milion euro në Ministrinë e Financave që nuk ka asnjë kapacitet ekzekutues në kuptimin zhvillimor, tregon që buxheti është i koncentruar te manipulimi, te sadakaja, te mëshira ndaj të varfërve, të cilët realisht tentojnë të konsiderohet trupë elektorale dhe në vazhdimësi të mbeten të varur nga dora edhe mëshira e qeverisë. Nuk është politikë zhvillimore të shtypësh një buton e t'i lëshosh të hollat në llogari të njerëzve. Nuk është zhvillim i qëndrueshëm derisa Ministria e Ekonomisë nuk është në gjendje një Trepçë ta nxjerrë prej baltës për 3 vjet me radhë. Nuk është drejtësi kur negociohet për tri orë me Njësinë Speciale dhe në fund u thuhet "s'kemi çka me ba, se s'kemi buxhet ma shumë", përderisa ka buxhet të paguhet rryma e serbëve në Veri, nuk ka mundësi të jetë e drejtë kjo punë.

E përmendi dikush më herët, t'i zvogëlohet buxheti Universitetit publik, tre vjet pas qeverisjes, përderisa universitetet private, me gjithë respektin për ata që punojnë me përkushtim e kualitet, në shumicën e rasteve janë duke prodhuar njerëz me diploma, të cilët nuk janë në gjendje as minimalisht t'u përshtaten kërkesave të tregut të punës. A mund të ketë turp më të madh se t'ia zvogëlosh Universitetit publik buxhetin. Kjo është mungesë ose tentim të kontrollohet edhe një herë atë pak dije që ka mbetur aty dhe atë pak kapacitet, të cilin e kemi në Universitetin publik. Kjo nuk është politikë e majtë, Universitetin publik ta shkatërroni nuk është politikë e majtë, sepse i krijon hapësirë sektorit privat në anën tjetër. Në rregull sikur t'i kishim Harvard-at e Yale-t, por s'i kemi. Ku është ai buxhet që reflekton vizion e premtim elektoral në këtë vend? Duke e mbytur Universitetin publik, duke e ngulfat secilën kategori shoqërore, e cila ka një zë përbrenda kësaj shoqërie dhe mund të bëjë një sfidim minimal nda politikave qeverisëse.

Këtu është ministrja e Ekonomisë, le të dalë e të thotë sa për qind të ndihmës energji të rinovueshme për bateritë i kemi shfrytëzuar pas tre vjetëve prej Fondit Amerikan të Mileniumit? Sepse ka qenë kryefjala e arritjes së suksesit. Sa për qind? Sa panele solare Qeveria e Kosovës ka arritur t'i instalojë, jo në sektorin privat, sepse është lehtë të shkosh e të bësh prerje të shiritave në investimet private. Cilat politika zhvillimore janë ndryshuar me legjislacion që mundëson investim dhe atraksion në nivel të konkurrueshmërisë me rajonin sa i përket energjisë së rinovueshme dhe efiçiencës në programin nacional për efiçiencë.

Është gënjeshtër se ka pasur rezultat në politikat e subvencionimit, është e kundërta. Fati është që ndryshimi klimatik nuk ka pasur temperatura të larta vitin e kaluar dhe vazhdon të mos ketë temperatura të ulëta këtë vit, rrjedhimisht konsumi i energjisë elektrike nuk ka qenë i lartë, përndryshe politikat e subvencionimit kanë shkuar në duart e tregtarëve. Çmimi i termopompës është rrit për 35% në momentin kur qeveria ka bërë subvencionim, Maqedonia e Veriut e ka 35% çmimin e termopompave me certifikim të Unionit Evropian, ndërsa këtu tregu është mbushur me lloj-lloj termopompa e sisteme të tjera të cilat janë blerë vetëm e vetëm për ta përmbushur një kuotë të analizës. Këtu është pikëpyetja, a po flasim për buxhetin e për numrat, apo po flasim për mirëqenien e qytetarëve në funksion të të cilëve duhet qenë buxheti i vendit.

As veteranët nuk janë më mirë e problemi nuk është zgjidhur, as policët nuk janë më mirë e besa as qytetari i rëndomtë që nuk ka asnjë statut në këtë shoqëri nuk është më mirë.

Habitem me deklaratën e kryeministrit që thotë “do të kthehen ata që do të shkojnë”.

Do të thotë, nuk ka njohuri mininale statistikore për tendencën e qytetarëve, sidomos rrjedhjen e trurit në këtë vend dhe klasës së mesme të arsimuar nga ky vend, sepse kërkesa në Perëndim është e tillë, e cila do të gjejë forma për t’i absorbuar këta njerëz në tregun gjerman, zviceran e vende të tjera. Do të thotë, kjo lehtësi është e njëjtë sikur në qeveritë e tjera që thoshin po ikin e po mbyten shqiptarët në lumin Tisa sepse po kanë dëshirë t’i shohin katedralet e Evropës. E njëjta logjikë, duke mos pasur asnjë strategji të vetme se si të adresohet rrjedhja e trurit dhe ikjen e fuqisë punëtore të kualifikuar nga vendi.

Rrjedhimisht, i bie që ky buxhet vërtet është bërë vetëm me numrat, pa vizion dhe pa idenë se si sektorët komunikojnë me njëri-tjetrin dhe në çfarë forme e rrit mirëqenien e qytetarëve në periudha afatgjate. Dhe e fundit që është shumë e rëndësishme, mos llogaritni rritje në paratë e diasporës të cilat kanë ardhur me vullnetin e madh për ndryshimin e madh, sepse ai nuk është kontribut i qeverisë, por kontribut i vullnetit të qytetarëve. Në fund të fundit, i keni shkurtuar buxhetin Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë aty ku janë inspektorët e premtuar për të drejtat e punëtorëve, inspektorët për rritjen e kualitetit të shërbimeve, inspektorët të cilët shkojnë e kontrollojnë ujin të cilin qytetarët e pinë dhe i cili është i helmuar në shumicën e rasteve me materie toksike. Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për shkak të dështimit ia keni zvogëluar buxhetin, por kjo nuk është forma se si penalizohet mossuksesi, mossuksesi penalizohet me llogaridhënie. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani e ka fjalën ministri Murati.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!
Kërkova fjalën në mënyrë që të adresoj disa prej gjërave që u thanë nga deputetët parafolës, nga grupet e ndryshme parlamentare, por në përgjithësi më lejoni që ta bëj një konstatim që në fillim që ka shumë kundërthënie qoftë brenda vetë fjalimit të një deputeti apo brenda grupit të njëjtë parlamentar që një deputet kërkon ashtu, tjetri ndryshe. Pra, janë në kundërthënie në vetvete vetëm deklaratat e tilla e të mos hyjmë pastaj edhe në analizë të thelbit të çështjes.

Për shembull, thuhet që buxheti është në rritjen më të vogël, e pastaj thuhet që po doni ta shfrytëzoni elektoralisht. Pra, një buxhet që shfrytëzohet elektoralisht, do të duhej ta fuste vendin në borxhe deri në fyt, por nuk po ndodh një gjë e tillë, po ndodh e kundërta. Thuhet pastaj po rriten subvencionet, mirëpo nuk do të duhej të rriteshin subvencionet, mirëpo rriteni pensionet ose skemat sociale, domethënë edhe kjo ka të bëjë me një kundërthënie në vetvete, e aq më tepër që është edhe faktualisht e pasaktë sepse kategoria e subvencioneve dhe transfereve është

kategoria e vetme në kuadër të projektligjit që kemi sjellë para jush e cila ka pësuar reduktim krahasuar me vitin 2023, kurse të gjitha kategoritë e tjera kanë rritje, pra qoftë në paga e shtesa, mallra dhe shërbime, edhe investime kapitale. Por, po ndalem edhe tek deklarimet individuale të deputetëve. Për shembull, deputeti Lushtaku thotë që ka qenë premtim i juaji zhvillimi ekonomik dhe mbushja e arkës të mos bëhet në kufi, por të bëhet brenda vendit dhe këtë nuk e keni mbajtur.

Më lejoni që t'i adresohem me shifra të sakta, pra nga raportet financiare raporte: në vitin 2020, të hyrat që ka mbledhur ATK-ja kanë qenë 446 milionë euro, kurse për vitin e ardhshëm pra planifikohet që të jenë 963 milionë euro. Pra, kemi të bëjmë me një rritje prej 115% në raport me atë çfarë e kemi gjetur. Kurse, në Doganë të hyrat që kanë qenë kur e kemi marrë ne pushtetin kanë qenë 1 miliard e 50 milionë euro, kurse në vitin 2024 parashihet të jenë 1 miliard e 771 milionë euro, apo 68% rritje. Pra, e vërtetë që edhe Dogana do të ketë rritje, për shkak se po luftohet edhe kontrabanda edhe informaliteti, mirëpo nëse shikohet rritja e të hyrave që po mblidhen brenda vendit, është për ritëm dyfish më të shpejtë se sa rritja e të hyrave në kufi. Pra, në kufi rritja e të hyrave është 68%, për shkak kryesisht të luftimit të kontrabandës, kurse në ATK, pra mbledhja e brendshme e të hyrave është rritur për 115%. Pra, është gati dyfishi.

U tha që edhe pagat nuk janë rritur, pra ta bëjmë edhe këtu një krahasim ndër vite, pra kur kanë pasur pushtetin së fundmi PDK-ja zyrtarisht. Buxheti i shpenzuar për paga ka qenë 619 milionë euro në vitin 2019. Pesë vjet pas, për vitin 2024 buxheti parashihet të jetë 805 milionë euro. Pra, kemi një rritje prej 30% në buxhetin për paga, e cila nënkupton një rritje për një periudhë 5-vjeçare normale dhe më se të pritur që tejkalon edhe rritjen mesatare ekonomike. Pra në të kaluarën kemi parë që një herë në pesë vjet janë rritur ndoshta rrogat 20 apo 25 për qind, kurse tani me qeverisjen tonë kemi rritje çdo vit, e cila në kumulativ kur mblidhet pra arrin 30 për qind.

Sa i përket punësimit, u tha që është buxhet i ndihmave e i vitrave, jo i punësimit. Më lejoni të them që për vitin e ardhshëm parashihen 29 milionë euro mbështetje direkte për masat aktive të tregut të punës, gjë që nuk ka ndodhur asnjëherë më parë. kemi pasur masa për punësimin e personave me aftësi të kufizuar, masa për punësim të të rinjve, masa për punësim të grave. Pra, masa në vazhdimësi, e më e fundit është edhe projekti SuperPuna, e cila për vetëm tetë muaj ka arritur të mbështesë punësimin e tetë mijë të rinjve.

Pra, jemi në rrugë të mirë për të arritur edhe cakun e synuar, që kemi thënë që deri në fund të vitit synimi është të mbështetet punësimi i dhjetë mijë të rinjve. Pra, kurrë më parë, asnjëherë më parë nuk ka pasur kaq shumë masa mbështetëse për punësimin sesa që ka tani në këtë mandat.

Sa i përket çështjes së kategorisë mallra dhe shërbime që po theksohet në vazhdimësi, po thuhet po rritet luksi. Edhe kjo është e pasaktë, për shkak se mallra dhe shërbime janë edhe barnat esenciale, mallra dhe shërbime është edhe municioni për sektorin e sigurisë, por mallra dhe

shërbime është edhe karburanti i institucioneve të sigurisë, që tani janë shumë më tepër aktiv sesa që kanë qenë më përpara, sidomos në pjesë të caktuara të vendit. Pra, këto janë ato që po e rrisin kategorinë mallra dhe shërbime dhe nuk është luksi i Qeverisë, përkundrazi.

Sa i përket deputetit Hoti, i tha disa gjëra, p.sh. e tha që norma e interesit nuk ndikohet nga shteti, nga qeverisja. Edhe kjo e pasaktë, për fat të keq. Për fat të keq edhe të kredencialeve akademike që ka, meqenëse norma e interesit, siç e dimë të gjithë që marrin vesh nga kjo fushë është rritur nga Banka Qendrore Evropiane në kuadër të luftimit të shkallës së inflacionit, e cila është krijuar në situatën postpandemike. Pra, edhe një herë tregon ndoshta pak më shumë sa i përket njohurive apo mungesës së tyre sa i përket çështjes në fjalë.

Sa patëm negociuar atëherë më kujtohet në vitin 2020 për programin e përbashkët qeverisës me LDK-në kur tentonim ta bënim koalicionin, njëra kërkesë me të cilën ngulte këmbë LDK-ja ka qenë që buxheti të bëhet 3 miliardë deri në fund të mandatit. Pra, kjo të futet në program qeverisës. Bile më duket edhe pat përfunduar në program qeverisës, që buxheti do të jetë tre miliardë në fund të mandatit. Më lejoni t'ju them që shifrën tre miliardë e kemi mbërritur që në vitin e dytë të mandatit. Mirëpo, le që e kemi mbërritur, por borxhi publik është 17 për qind e GDP-së. Përderisa në qeverisjen e LDK-së, kur këta kanë udhëhequr, borxhi publik ka qenë i paraparë të shkojë 35 për qind.

Pra, ne edhe e kemi mbërritur buxhetin tre miliardë dhe e kemi tejkaluar, edhe borxhi publik është përgjysmë më i ulët sesa këta që kanë pasur ta bëjnë. D.m.th. nuk di se sa të komentoj pastaj edhe për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes që thotë se s'është i mjaftueshëm, kur gjatë mandatit të udhëhequr nga LDK-ja, buxheti për Ministrinë e Mbrojtjes kurrë nuk e ka kaluar 0.7 për qind. As 1 për qind s'ka qenë buxheti, e lëre më më tepër.

Sa i përket buxhetit në qeverisjen tonë, besoj të gjithë qytetarët e dinë, por më së miri e dinë institucionet e sigurisë, të cilët çdo ditë e shohin mbështetjen shtesë nga kjo Qeveri.

U thanë edhe çështje të tjera, siç është p.sh. puna e buxhetit të Komunës së Prishtinës, ose se si komunat po u ndëshkuakan nga kjo qeverisje. Më lejoni t'ju them që buxheti i Komunës së Prishtinës kur ka qeverisur LDK-ja, pra hiç më larg se para dy vjet e gjysmë, buxheti ka qenë 90 milionë euro, tash është 123 milionë euro. Nga këto 123 milionë euro, ne si Qeveri qendrore i japim, ia transferojmë 83 milionë euro. Pra janë vetëm dyzet që i mbledh vetë Komuna e Prishtinës, 83 milionë euro është mbështetja nga Qeveria qendrore.

Për më tepër, nuk është problemi i ndarjes së buxhetit, se buxhet kanë më shumë se kurrë më parë. Komuna e Prishtinës problemin e ka te aftësia për të menaxhuar mjetet që i ndahen. Vitin e kaluar, suficiti i Komunës së Prishtinës ka qenë 48 milionë euro, rekord më i larti ndonjëherë. 48 milionë euro është sa buxheti i Komunës së Prizrenit. Pra komplet Komuna e Prizrenit sa e ka

buxhetin, Komuna e Prishtinës ka pasur suficit vitin e kaluar. D.m.th. veç ta kemi të qartë për çka po flasim. Sivjet do të thyhet edhe ai rekord që ka qenë vjet, d.m.th. do të jetë edhe më i madh. Qe këtu e kanë problemin.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë, ju lutem, pak qetësi, nuk po dëgjohet asgjë.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Kishte edhe deklarime të tjera. P.sh. te deputetja Bajrami, edhe ajo nuk u shërben kredencialeve të veta akademike kur del këtu para jush, para qytetarëve e para mediave e njerëzve që marrin vesh në ekonomi dhe prezanton dy drafte për gjëra të ndryshme, mirëpo njëri është kumulativ, tjetri është margjinal.

Pra, njëri është rritja tremujore, p.sh. te rritja ekonomike, me qëllim për të manipuluar me opinionin publik, për ta paraqitur se gjoja s'ka rritje ekonomike, e paraqet rritjen margjinale tremujore, kurse në anën tjetër sa i përket inflacionit e merr inflacionin kumulativ dhe e ndal te viti 2022, në dhjetor 2022. Se të shkojë më këndej, e sheh që bie inflacioni. D.m.th. ky është manipulim i pastër që deputetja Bajrami e di çfarë po bën, mirëpo nuk u shërben kredencialeve akademike që ta bëjë një gjë të tillë, sepse e humb seriozitetin e fushës.

U përmend edhe çështja e energjisë elektrike si premtim që ne e kemi dhënë. Më lejoni t'ju njoftoj që dimrin e kaluar qytetarët e Republikës së Kosovës, amvisëritë kanë paguar më lirë sesa kurrë ndonjëherë. Për shkak të masave të subvencionimit nga Qeveria e Republikës. Kurse, kur keni qeverisur ju, a e dini kujt ia keni subvencionuar rrymën? Ferronikelit.

Amendament special keni bërë. Deputeti i AAK-së ka bërë amendament special, ju e keni votuar për t'ia subvencionuar rrymën një biznesi të vetëm. Këtë e kujtojnë qytetarët, e mbajnë mend. Kështu që edhe një herë...

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni që ta përfundojë fjalën. Veç ta përfundoni fjalën, zoti ministër.

MINISTRI HEKURAN MURATI: U tha edhe për punësim që gjoja ne paskemi punësuar familjarët, për dasma mund të bëhet edhe me Qeverinë. Në fakt, Prishtina Parking lirisht mund të organizojë dasmë veç vetë pa askënd tjetër, me një fotografi që e pashë që gjithë LDK ishin bërë aty. Bile-bile nuk e di qysh edhe PDK-ja po pranon t'i nënshtrohet kaq lehtë, ku veç LDK-ja krejt i punëson, e PDK-ja asnjë s'e kishte, ose ndoshta e ka, po s'po e dimë, le të na tregojnë. Kjo është hegjomeni e LDK-së ndaj PDK-së në koalicionin qeverisës në Prishtinë.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Kemi disa replika. Hykmete Bajrami, pastaj vazhdojmë me radhë.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!
Ministër, krahasimin me vitin 2020 kur ta bësh, gjithmonë duhet pasur parasysh që një pjesë e atij viti ka qenë kryeministër z. Kurti, d.m.th. ta kesh parasysh, i cili e pati marrë vendimin ta mbyllë krejt ekonomisë. Natyrisht që për atë periudhë kohore mandej nuk ka pasur të hyra.

Tjetër, sa u përket normave të interesit, z. Hoti mundet veç ligjërata të të mbajë aty. Ai veç një faj e ka, që të ka lënë ty të punosh në Ministri të Financave dhe ke dalë produkt kaq i dobët.

Sa i përket buxhetit, kurrë s'e ke mbërritur buxhetin tre miliardë. Asnjëherë. Në tabelën 1 të këtij buxheti që e ke sot, në të dhënat për vitin 2022, shpenzimin e buxhetit deri më 31 janar 2022 e ke 2 miliardë e 539 milionë. Kë po e gënjen? Në dokumentin që vetë e ke prodhuar, buxheti i arritur i shpenzuar në 2022 është 2 miliardë e 539 milionë, ndërkohë që në vitin e pandemisë buxheti ka qenë 2 miliardë e 239 milionë, në kohë të pandemisë, ato që po i përmend.

Sa i përket suficitit të Prishtinës, mos e harroni se atë suficit Përparim Rama e ka trashëguar prej pushtetit tetëvjeçar të Lëvizjes Vetëvendosje në Komunën e Prishtinës. Mos e harroni asnjëherë edhe këtë! Në ndërkohë që kryetari Rama dhe Komuna e Prishtinës po bën punë sa krejt ministritë bashkë, sa krejt ju bashkë. Cila është trashëgimia që ju do ta lini? Kjo është pyetja, sepse në opozitë keni hyrë në histori me gaz lotsjellës, me molotov, me zolla. Çka do t'i lini trashëgimi këtij vendi pas mandatit tuaj katërvjeçar me 11.4 miliard të menaxhuara? Kjo është pyetja.

KRYESUESJA: Tani është Mërgim Lushtaku për replikë.

MËRGIM LUSHTAKU: Me të vërtetë është e çuditshme sesi Qeveria manipulon dhe mundohet edhe deputetët t'i manipulojë.

Unë e kuptoj se disa qytetarë edhe mund t'i manipuloni, siç i keni mashtruar në vazhdimësi. Po ta kishit marrë gjithë këtë energji që ju bëni këtu manipulime këtu në Kuvend të Kosovës, po të merreshit me të vërtetë me hartimin e projektbuxhetit, me implementimin e projektbuxhetit, unë besoj me të vërtetë që kishit dalë më mirë. Por po shihet qartë se ju e keni nivelin shumë të ulët që duhet të merreni me një Prishtina Parking. Aty e keni nivelin, s'di pse jua kanë besuar rastin të udhëhiqni me Ministrinë e Financave. Sigurisht që kjo Qeveri nuk mund të krenohet me rritje të ekonomisë, sepse gjithë dihet që për shkak të rritjes së çmimeve, për shkak të zullumit të madh të inflacionit dhe krizës ekonomike dhe për shkak të paaftësisë tuaj për të realizuar një politikë zhvillimore, ju keni dështuar në implementimin në çdo hap. Sigurisht që qytetarët sot janë më të varfër. Sigurish që qytetarët sot e ndiejnë që i kanë kushtet më të vështira për jetesë.

KRYESUESJA: Gjithashtu replikë deputeti Bekë Berisha.

BEKË BERISHA: Faleminderit, kryesuese!
Kryeministër,
Ti i ke paguar këto ditë 113 milionë për rrymën e serbëve në veri dhe nuk mund ta maskosh me asnjë formë, jo një deputet, Ferronikeli etj., ministër, 113 milionë, bravo të qoftë!

Tash e kam një pyetje tjetër. Zajednica, a ka implikime buxhetore? Qysh jeni marrë vesh, a i paguajnë ata, a do të paguajmë ne ndonjë gjë apo si është kjo punë?

KRYESUESJA: Kundër-replikë në tri replikat që i patëm.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!
Pra, vetëm edhe një herë sa për saktësi, në fund të vitit 2021, suficiti në Komunën e Prishtinës ka qenë 38 milionë euro. Në fund të vitit 2022 ka qenë 49 milionë euro. Ju e keni rritur suficitin. E keni rritur suficitin, këtu është problemi. E sivjet do të jetë edhe më i lartë. Po na shkakton problem edhe në menaxhim të financave publike, se po duhet vit pas viti pastaj t'i ripërshtatim pasqyrat financiare duke i bartur investimet që kurrë s'po bëhen.

Sa u përket punëve, fotografi po, punë nuk e di. Për fotografi e di, p.sh. duke u nisur prej Lojërave Mesdhetare, prej ngrohjes qendrore të qytetit e shumë e shumë punë të tjera. Financimi edhe i koncertit në Pallatin e Rinisë. D.m.th. të gjitha këto fotografitë i ka postuar, madje i pari, se ngjan që ka edhe kohë, se ne pas punëve edhe s'po kemi kohë. Mirëpo, të punosh pak më ngadalë.

Sa i përket çështjes së Prishtina Parkingut, po e kuptoj tash që PDK-ja paska hequr dorë se i është dukur ndërmarrje e vogël ajo.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani e ka kërkuar fjalën edhe ministrja Artane Rizvanolli për të adresuar disa nga çështjet që u adresuan në lidhje me këtë ministri.

Zoti Shala po bëj lëshim këtë herë, por nëse ka të bëjë me adresimin e kundër-replikave tani që i pati ministri, nuk ke të drejtë replikë në kundër-replikë. Nuk funksionon ashtu, kështu që po më vjen keq. Pa marrë parasysh, nuk mund të kesh replikë në kundër-replikë. E përcakton Rregullorja këtë pjesë.

Ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Ju faleminderit!
E nderuar nënkryetare e Kuvendit,
Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,

Kabinet qeveritar,
Do të flas së pari për Ministrinë e Ekonomisë dhe projektet tona. Sa i përket efiçiencës së energjisë që u përmend në disa raste me konotacion pozitiv, disa herë edhe negativ nga opozita, mund të them që në mandatin tonë çdo vit ka qenë një vit rekord. Vit pas viti kemi thyer rekorde për investime në efiçiencë të energjisë. Vitin që po vjen, planifikojmë të zbatojmë masat e efiçiencës dhe bashkë me një renovim të thellë të pesë shkollave në Gjakovë, Gjilan, Prishtinë dhe Ferizaj, me buxhet prej 7.5 milionë euro dhe do të zbatohen masat e efiçiencës në gjashtë institucione shëndetësore e institucione të tjera publike në vlerë prej 1.1 milionë euro.

Do të vazhdojë përkrahja për familjet për të rritur efiçiencën e energjisë me 6.5 milionë euro, ndërsa do të zgjerohen skemat e ngjashme edhe te sektori i biznesit, duke i përkrahur për herë të parë në histori të Kosovës ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për rritje të efiçiencës se energjisë, një skemë me vlerë prej 5 milionë euro.

Të gjitha këto pra janë llogaritur projekte që do të vazhdojnë ose të fillojnë nga Fondi për efiçiencën e energjisë, i cili i ka rreth 20 milionë euro për investime në sektorin rezidencial dhe investime në ndërtesat publike gjatë vitit tjetër.

Sa u përket kapaciteteve gjeneruese, gjatë këtij viti, vitin që vijon dhe në vitin 2025 do të kontraktohen investime në vlerë prej 1.2 miliardë euro, me anë të cilave do të ndërtohen 950 MW kapacitete të reja, përfshirë këtu investime private, investime publike dhe kombinime publiko-private.

Sa i përket projektit të baterive që u brengos dikush për shpenzimet, mund t'ju them që projekti i baterive me MCC-në do të fillojë në kohën më të shkurtër rekorde të planifikuar, tetëmbëdhjetë muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes. Koha e zakonshme e fillimit të zbatimit pas marrëveshjes është dy vjet, pra ne po e fillojmë pas tetëmbëdhjetë muajsh pas nënshkrimit. Kjo është për arsye se duhen përgatitje si në strukturën ligjore e rregullative, ashtu edhe në themelimin e ndërmarrjes së re publike e të tjera, të cilat janë kushte për fillimin e zbatimit.

Për këtë projekt, për vitin 2024 kemi ndarë 12 milionë euro, të cilat do të përdoren për dizajnim të projektit dhe aspekte të ndryshme përgatitore. Pra, nga ato mallra dhe shërbime që i përmendët më herët, 12 milionë në fakt janë të buxhetuara për programin e MCC-së. Ndoshta për të tjerat do të flas më vonë.

Në fund të vitit 2024, në çerekun e fundit do të tenderohet kapaciteti prej 45 MW për rezerva sekondare, ndërsa në vitin pas kësaj, një kapacitet tjetër prej 125 për rezervat terciare në vitin 2025. Po ashtu në çerekun e fundit të 2024 do të shpallen procedurat përkatëse për parkun solar prej 100 MW në KEK dhe ngrohjen solare në Prishtinë. Në total, këto kontrata 180 milionë euro.

Në këtë rast, po e shfrytëzoj rastin t'ju bëj thirrje që të mos i bllokoni investimet në energji që lidhen me marrëveshjet ndërkombëtare.

Me programin e IMF-së kemi siguruar 80 milionë euro për investime në kapacitete të energjisë së ripërtëritshme, që synohet të rritet edhe për 80 milionë të tjera, pra në total 160 milionë, të cilat do të shfrytëzohen për investime publiko-private në kapacitete prej erës prej 150 MW. Ky është një ankand i cili do të lansohet në çerekun e tretë të vitit tjetër. Kjo formë e investimit na mundëson që të kemi pronësi publike në asetet kritike të energjisë, të infrastrukturës kritike të këtij sektori, që është veçanërisht e rëndësishme në kohë të krizave, që është e kundërta me atë çfarë keni bërë ju duke privatizuar infrastrukturë kritike të distribucionit në kohën tuaj.

Këto projekte buxhetohen dhe realizohen një pjesë e mirë prej tyre nga ndërmarrjet publike, si KEK dhe Termokosi, duke supozuar që i miratoni marrëveshjet ndërkombëtare, nuk i bllokoni. Dhe meqë jemi te KEK-u, në fund të këtij viti gjithashtu KEK-u do të shpallë tenderin për rehabilitimin e thellë të njësisë A3 të Kosovës A, ndërsa investimi pritet të fillojë vitin tjetër.

Të gjitha këto mund t'i gjeni edhe në broshurën për vitet 2023-2025 me projekte të sakta, buxhete të sakta dhe burime të financimit të sakta.

Sa i përket sektorit të teknologjisë informative dhe të komunikimit, do të vazhdojë projekti i ekonomisë digjitale. Fakti që kemi lidhur qind për qind të zonave të banuara me internet, rekord jo vetëm për rajonin, por për Evropën, do të vazhdojmë me lidhjen me internet edhe në Rrjetin Kosovar për Hulumtim dhe Edukim të 110 shkollave të Kosovës dhe do të vazhdojnë edhe trajnimet për të rinj. Do të trajnohen gjashtëqind të rinj. Një pjesë e mallrave dhe e shërbimeve, por e vogël është edhe për shkak të trajnimeve, për pjesën tjetër do ta sqaroj më vonë.

Themelimi i Cet-it për energji, pra ekipit të përgjigjes së shpejtë në rast të sulmeve në sektorin e energjisë. Do të fillojë zbatimin gjatë vitit në vijim, duke e rritur kështu sigurinë kibernetike, e cila po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme edhe në përgjithësi për shtetin, mirëpo veçanërisht do të bëhet e rëndësishme për sektorin e energjisë, duke qenë se do të kemi një infrastrukturë më moderne dhe digjitale e më shumë burime të ripërtëritshme të energjisë në të ardhmen.

Do të vazhdojë pajisja e laboratorit në qendrën për inovacion e trajnim në Prizren, duke e zgjeruar laboratorin edhe me pajisje dhe laboratorë të radio-frekuencave, i cili do të shfrytëzohet nga të gjithë studentët e Kosovës. Do të pilotohet smart-set në Gjilan, si dhe do të fillojë ndërtimi i Qendrës për Ekselencë Digjitale, e cila do të jetë shtëpi e rrjetit KREN, i cili do të jetë i zgjeruar, mirëpo edhe hardverit të sistemeve të tjera që janë kritike për ofrimin e shërbimeve digjitale publike, të cilin synojmë ta bëjmë dhe ta rrisim në të ardhmen. Gjithashtu, edhe për sigurinë e të dhënave shtetërore.

Të gjitha këto u shtohen te parku në Prishtinë dhe investimeve që tanimë janë realizuar gjatë këtij viti. Pesë milionë euro shtesë në buxhetin e ekonomisë sivjet janë për investimet në infrastrukturë të ujërave, ku do të prioritizohen rajonet dhe ndërmarrjet përkatësisht që do t’i subvencionojnë projektet infrastrukturore në rajonet e ndryshme, duke përfshirë këtu edhe disa nevoja kyçe të sektorit të Prizrenit, por jo vetëm, nuk do të hyj në projekte specifike.

U tha se 9 milionë euro janë për mallra dhe shërbime te Ministria e Ekonomisë. Nëse shkoni veç një tabelë më poshtë, e shihni që kjo nuk është e saktë. Ministria e Ekonomisë i ka 1.9 milionë për mallra dhe shërbime, ndërsa pjesa ku përfshihen edhe trajnimet, siç e thashë më herët, ndërsa pjesa tjetër janë te ndërmarrjet publike në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare për impiantet e ujërave të zeza në Prishtinë, Gjilan dhe Ferizaj, të cilat gjithashtu buxhetohen në Ministrinë e Ekonomisë, e të cilat janë projekte prej më se dyqind milionë euro së bashku të gjitha.

Sa u përket subvencioneve e transfereve, prapë po e cek 12 milionë lidhen me programin e MCC-së, 5 milionë janë investime në ujëra, 3 milionë janë investime kapitale në ndërmarrje publike. Gjithashtu përfshin edhe investimet në efiçiencë të cilat do të transferohen te Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë.

Një çështje që u ngrit disa herë është çështja e subvencioneve dhe transfereve. Dua të qartësoj disa gjëra për efektin dhe natyrën e këtyre subvencioneve dhe transfereve, qoftë që janë realizuar viteve të kaluara, qoftë që do të realizohen gjatë vitit në vijim e që janë të parapara në këtë buxhet. Janë rritur subvencionet e grantet për bujqit, duke e rritur kështu prodhimin, eksportin, punësimin, sigurinë e shtetit dhe uljen e ndjeshmërisë ndaj krizave të jashtme, siç e kemi pasur edhe këto të viteve të fundit.

Janë përkrahur bizneset prodhuese për kredi në investime, duke rritur konkurrueshmërinë e tyre, punësimin dhe eksportin. Janë subvencionuar tarifat e energjisë elektrike për bizneset duke e rritur, jo vetëm duke e ruajtur konkurrueshmërinë, por madje duke e rritur, duke qenë se në kohë krize, përveç që shtetet e tjera një pjesë të madhe të industrisë e kanë në tregun e liberalizuar, janë ndikuar shumëfish më shumë sesa Kosova nga rritja e tarifave elektrike, përderisa në Kosovë nuk...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Fare herën e parë, ndërsa edhe pas rritjes së herës së dytë vazhdojmë t’i kemi tarifat më të lira, e sidomos për biznese shumë të lira sesa ato në rajon.

Ka filluar zbatimi i sistemit dual që ka ndikim direkt në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe në zhvillimin e shkathtësive që janë shumë relevante për bizneset në fusha të ndryshme, e ky do të zgjerohet edhe në vitin tjetër.

Është ulur informaliteti, duke e rritur kështu drejtësinë dhe konkurrencën fer. Këto të dyja janë dy barriera kyçe të të bërit biznes që janë raportuar nga bizneset kosovare ndër vite. Janë subvencionuar qytetarët për të rritur efiçiencën e energjisë, duke ruajtur kështu buxhetin e tyre, por edhe duke ulur presionin në tarifa.

Nuk është e saktë se masat nuk kanë pasur ndikim. Nuk e di çfarë shifrave u referuan disa prej deputetëve, mirëpo mund t'ju them se përveçse në nivel të vendit kemi parë një ulje prej mesatarisht 4% të konsumit të energjisë te familjet, kemi edhe të dhëna nga anketat që tregojnë se 89% e respondetëve kanë parë masa vetëdijuese, mesazhe vetëdijësuese për kursimin e energjisë dhe kanë marrë masa për të kursyer energjinë si rezultat i tyre.

Ndërsa në familjet që janë subvencionuar, mesatarisht 40% është ulur konsumi i energjisë pas subvencionimit pajisjeve.

Janë përkrahur studentët, e janë përkrahur veçanërisht vajta e gratë në fushën STEM. Janë përkrahur studentët me aftësi të kufizuara, e do të përkrahen. Janë përkrahur politikat aktive të tregut të punës të cilat kanë prekur veçanërisht gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara që janë grupet që kanë shkallën më të ulët të punësimit dhe jashtëzakonisht të ulët në krahasim edhe me rajonin edhe me Evropën.

Këto të gjitha...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: 30 sekonda. Të lutem, e përfundoni fjalën!

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Janë investim në kapital njerëzor. Janë investim në gjithëpërfshirje e drejtësi sociale, të cilat janë edhe premtime të kësaj Qeverie edhe ndikim direkt te qytetarët. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Kemi replikë nga deputeti Ferat Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryesuese!
Sinqerisht, unë broshurën e ministres apo të Lëvizjes Vetëvendosje nuk e kam parë, nuk e di çka po flasim sot me shifra të projektbuxhetit. Prandaj, për broshura në një instancë tjetër.

Në 2023-tën keni pasur 32,8 milionë euro investime kapitale, në 2024-tën keni planifikuar 17,9 milionë euro. Pra, keni zbritje drastike të investimeve kapitale në projektbuxhet. Për Ministrinë e Ekonomisë, po flasim. Ndërsa, në 2023-tën subvencionet i keni pasur 23%, sot i keni 51%. Investime të reja kapitale në këtë ministri për vitin e ardhshëm e keni vetëm 1%.

E nderura ministre,
Menaxhoni me sektorin e industrisë së rëndë, menaxhoni me sektorë të energjisë, menaxhoni me ndërmarrjet publike, investime kapitale të reja vetëm 1%, por pse është bërë ky grumbullim i lëvizjeve nga kapitale në subvencione? Sepse i menaxhon direkt subvencionet Kabineti i ngushtë qeveritar, administrata qendrore e ministres. Dhe, je në rrugën që je duke shkuar, më dhimbsesh, se do të përfundosh, gati veç ke mbërri te ministrja e Tregtisë dhe Industrisë.

E them me përgjegjësi të plotë, të mos veproni kështu se është gabim, sepse e vërteta dhe shifrat nuk mund të manipulohen dhe mbulohen.

Te çështja e Ferronikelit. Për herë të parë ndodh në historinë e Kosovës që Kosova për shkak të kësaj ministreje, Ferronikeli importon thëngjill nga Mali i Zi mbi 10 milionë euro në muaj, dhe sot është para mbylljes, sepse nuk mund të furnizohet nga KEK-u, nga kjo Qeveri.

Kosova importon thëngjill nga Mali i Zi! Ju lutem, ta merrni si shqetësim real. Pa marrë parasysh çfarë rrethana, tri vjet do të duhej t'i ofrohej zgjidhje, sepse i duhet si lëndë e parë energjike, nuk ka zëvendësim në Ballkan, e ka marrë gjithmonë, le ta marrë edhe tash. Ju i jepni, ju i bëni kontrata, por...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Kundër-replikë ministrja Rizvanolli!

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Sa i përket dallimit mes vitit të kaluar dhe sivjet në investime kapitale që janë të buxhetuara te Ministria e Ekonomisë, dua të sqaroj se mbi 2/3 e këtyre investimeve kanë qenë në fakt të planifikuara te ndërmarrjet publike, te KRU Prishtina, Gjilani dhe Mitrovica, dhe kanë qenë parashikime tej optimiste.

Këtë vit janë bërë parashikimet më reale nga ndërmarrjet publike dhe kjo ka qenë arsyeja kryesore që reflekton këtu. Sigurisht, si rrjedhojë e këtij dallimi është edhe dallimi te subvencionet që i përmendet, por subvencionet, unë veç e sqarova më herët se për çfarë shfrytëzohen këto dhe veç tregova më herët se një pjesë e mirë e tyre shfrytëzohen për investime kapitale, pavarësisht se për ne si ministri e Ekonomisë llogariten si subvencione, duke qenë se investimet realizohen nga organizatat e tjera buxhetore.

Sa u përket investimeve në kapacitete energjetike. Unë nuk do t'i përsëris edhe një herë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputetja Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju faleminderit, nënkryetare!
Një gjë është tashmë e sigurt se askush më nuk po flet për nënvlerësim të sektorit të shëndetësisë apo mos investim në këtë sektor. Ky është një debat i përgjithshëm.

Tani jemi në fazën e forcimit të kapaciteteve menaxheriale dhe mbikëqyrëse. Për këtë janë faktet dhe shifrat që janë të pakontestueshme. Nëse flasim për rritjen e vitit të kaluar që ishte rreth 100 milionë euro shtesë për shëndetësi dhe këtë vit rreth 51 milionë euro shtesë, tashmë siç thashë askush më nuk mund ta kontestojë që Qeveria Kurti e ka prioritet shëndetësinë. Vërtet një ndër top prioritetet.

Askush nuk mund ta mohojë që kjo Qeveri pas ardhjes në pushtet u trondit nga një ndër sfidat më të mëdha të shekullit, pandemia COVID-19, dhe jo vetëm që e trashëgoi një sektor aq fragjil siç ishte sektori më i përfolur për të keq, ai i shëndetësisë, por njëkohësisht u dashtë që menjëherë të riproritizojë fondet drejt luftimit, pra, betejës me COVID-19, gjë që ishte sfidë për shëndetësinë dhe sistemet shumë më të konsoliduara në Evropë e tutje. Në Raportin e fundit të Progresit evidentohet si storie suksesi.

Ku është prioriteti i kësaj Qeverie? Që nga fëmijëria e hershme. Investimet që po bëhen duke filluar nga Klinika e Gjinekologjisë dhe Neonatologjisë, sigurimi i rezonancës magnetike në Klinikën e Pediatrisë, rritja e vizitave në shtëpi, mbi 65 vizita për nënat lehona dhe fëmijët deri në moshën 3-vjeçare, zgjerimi i listës esenciale. Pra, nuk mund të themi se nuk ka rritje evidente, ku rreth 24 milionë ishin në vitin 2018, 30 e diçka milionë euro në vitin 2019 dhe sot kemi 60 milionë euro për listën e barnave esenciale. Dhe, nuk flasim vetëm për rritjen me shumën, me koston, por edhe zgjerimin e gamës së produkteve. Rreth 70 produkte i janë shtuar listës së reviduar.

Ne e dimë që ndër vite lista esenciale nuk revidohej. Sot punohet udhërrëfyes dhe protokolle shëndetësore, sepse vërtet që të kemi një zbatim edhe të Ligjit për sigurim shëndetësor, ne duhet të kemi protokolle që kanë munguar, dhe për të caktuar çmimoren e shërbimeve shëndetësore që ofrohen në institucionet publike në rend të parë, për të pasur një listë që nuk e kemi pasur të shërbimeve shëndetësore që ofrohen.

Pastaj janë bërë keqpërdorime ndër vite me trajtimin jashtë vendit, ku janë udhëzuar pacientët, janë lëshuar fletëzotimet dhe asnjëherë nuk u janë paguar ato, shumë prej tyre pra, dhe sot kemi

trashëguar rreth 30 milionë euro borxhe nga ky trajtim kur asnjëherë nuk është bërë as barazimi i faturave me të gjitha institucionet që i kanë ofruar këto shërbime jashtë vendit, dhe sot shumë pacientë e vuajnë këtë pasojë, sepse borxhet e trashëguara ato duhet t'i paguaj dikush, dhe të rikthehet besueshmëria tek institucionet me të cilat duhet të lidhen kontratat edhe në të ardhmen për shërbimet që ende nuk ofrohen në vend.

Është e qartë se gjithnjë do të ketë shërbime që nuk do të kemi mundësi, së paku në të ardhmen e afërt, t'i ofrojmë të gjitha në vend, por ne jemi duke punuar fuqishëm që të evidentohen të gjitha shërbimet që ofrohen në vend dhe të zgjerohet gama e të gjitha këtyre shërbimeve dhe të mos e kemi asnjë pacient panevojshëm të udhëzuar jashtë vendit për trajtim, por të jenë vetëm trajtime shumë më inovative apo ato më të avancuara që vërtet ne si shtet në zhvillim ende nuk kemi mundësi t'i ofrojmë në vendin tonë.

Për SHSKUK-në si një ndër institucionet më të rëndësishme. Pra, QKUK-ja bashkë me spitalet kanë 25% buxhet më shumë për vitin tjetër. Nëse e bëjmë një krahasim, për shembull, në vitin 2019 para pandemisë, ku ka pasur vetëm 121 milionë euro të dedikuara, sot për vitin e ardhshëm planifikohet 174 milionë euro për SHSKUK-në.

Pra, një investim i dukshëm që nuk mund ta mohojë askush. Dhe, pikërisht do të jetë i prioritetizuar në klinikat për të cilat kemi pasur edhe listat e pritjeve dhe vërejtjet më të mëdha deri tani.

Ta përmendi vetëm Klinikën e Onkologjisë, ku ne kemi fokusin kryesor pikërisht, sepse pacientët të cilët janë më së shumti në nevojë, janë pacientët që frekuentojnë Klinikën e Onkologjisë. Mbi 2 milionë euro do të investohen, përfshirë me aksideratorin që edhe falë deputetëve të këtij Kuvendi është blerë dhe është mbështetur nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe 550 mijë euro investim në rritjen e kapaciteteve infrastrukturore, rritjen e shtretërve, mundësinë që kur pacientët të jenë aty të mos kenë pritje në marrjen e kimioterapisë.

Kjo klinikë do të jetë gjithnjë në fokusin tonë, përfshirë dhe decentralizimin e disa prej shërbimeve që ofrohen aty gradualisht me rritjen e specializime, pra ndarjen e specializimeve për onkologë të ardhshëm, si dhe duke filluar me decentralizimin e atyre shërbimeve që janë të mundshme, siç është ajo, për shembull, ndarja e terapisë tabletare, duke vazhduar pastaj edhe me terapi të tjera, siç janë plotësisht të mundshme të kryhen edhe në spitalet regjionale.

Pra, përveç rritjes së kapaciteteve në hapësira dhe në aparatura, ajo çka duhet të theksohet është se do të ketë mbështetje edhe për Klinikën e Neurokirurgjisë, me blerjen e aparaturave më të sofistikuara.

Problemi me specialistët. Ju e dini që po flasim për ikjen e trurit, ikjen e mjekëve, mirëpo askush nuk mund ta mohojë një fakt, i cili ka të bëjë me rritjen sinjifikante të pagës për mjekët, dyfishimi i pagës ka ndodhur.

Unë mendoj që ky është një vlerësim i madh për punëtorët shëndetësorë. Unë nuk them që mjafton asnjëherë, por edhe stafi i mesëm, të gjithë infermierë, mami, teknikë të tjerë do të kenë rritje edhe në vazhdimësi, sepse kjo Qeveri premtoi dhe prapë sot u zotua se koeficienti do të rritet ndër vite. Normal, varësisht me mundësitë, me rritjen ekonomike.

Ne duhet të punojmë të gjithë që të kemi rritje të përgjithshme dhe pastaj edhe rritje të pagave. Mendoj që tash mjekët, duke u përmirësuar kushtet e punës, në anën tjetër edhe rritja e pagesë është diçka tepër e rëndësishme.

Unë e di që mjekët që janë në spitale edhe në QKUK kanë edhe kujdestari dhe besoj që një shumë e konsiderueshme është në konton e tyre në fund të muajit, dhe unë nuk besoj që këta specialistë tash do të kenë motiv që të ikin nga Kosova, ku e dimë që shtetet e tjera është kostoja e jetesës shumë më e madhe. Në fund të fundit, nëse paguajnë të gjitha kontributet që paguhen atje, nuk besoj që do të kenë të ardhura më të larta se sot që mund t’i kenë në sektorin publik në shëndetësi.

Ajo çfarë mbetet të thuhet është që gjithnjë në fokusin tonë është pacienti. Higjiena, për shembull. Është zotim i ri që t’u rriten pagat edhe të higjienistëve që kujdesen për higjienën në spitalet tona, por nga ne kërkohet shfuqizimi i komisioneve për infeksione intrahospitalore, se ne nuk dëshirojmë që suksesi i profesionistëve tanë, intervenimet kirurgjike, pastaj për shkak ndonjë infeksioni eventual aty, që të zvogëlohet rezultati i punës.

Andaj, shpreh gjithë respektin tim për specialistët dhe kirurgët tanë që deri tani kanë qenë të nënvlerësuar ndër vite me pagën jodinjitoze.

Parandalimi është në fokusin tonë. Unë e përmenda vaksinimin. Vaksinimi definitivisht është një storie suksesi të Republikës së Kosovës, përfshirë periudhën e COVID-it kur Kosova për herë të parë negocioi drejtpërdrejt me prodhuesin dhe arriti që të sigurojë vaksina të mjaftueshme, ku për një kohë shumë të shkurtër mbi 60% të qytetarëve u vaksinuan dhe ky vaksinim vazhdon sot e kësaj dite. Mirëpo, vlen të përmendet edhe sigurimi i vaksinave tepër të rëndësishme që do të hyjnë në kalendarin e vaksinimit vitin e ardhshëm, që janë vaksinat pneumokok, meningokok, rotavirus dhe HPV vaksina, që është një mundësi e madhe që ne ta luftojmë kancerin e qafës së mitrës dhe në gjysmëvjetorin e dytë të vitit të ardhshëm, të gjitha vajzat që do ta vijojnë klasën e gjashtë apo grupmosha 11-13 do të vaksinohen me këtë vaksinë që siç e thashë, është mjeti më i fuqishëm në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës.

Investimi në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike me pajisje dhe aparatura, bile edhe me vetura që janë mjeti kryesor i punës së punëtorëve që punojnë në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, po ashtu është shumë inkurajuese për neve si një Qeveri që është e orientuar drejt parandalimit, ku inkurajojmë edhe nivelin parësor, pra, komunat që të jenë shumë të përgjegjshme drejt shpenzimit të mjeteve që merren edhe nga granti specifik për komuna, sepse ne edhe me Odën Mjekëve kur kemi pasur takim kemi kuptuar që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni që ta përfundojë fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Atëherë, për të mos e zgjatur vetëm po e përmbylli fjalinë e fundit. Kemi vërejtur që ka distinim, për shembull, ndahen mjetet për profilet e punëtorëve shëndetësorë, dhe punësohet staf tjetër.

Të mos ndodh kjo, jo vetëm në nivelin e kujdesit parësor, por as në QKUK, sepse ne jemi të interesuar t'i mbështesim profesionistët shëndetësore dhe të rritet numri i tyre, e sidomos i specialistëve të fushave që ne i kemi deficitare.

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, e nderuara kryesuese!
Të nderuar kolegë deputetë,
Kur e dëgjon kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Kurti duke e prezantuar buxhetin për vitin 2024, realisht të mbushet mendja që është duke folur për vitin e parë të qeverisjes së tij dhe jo për projektbuxhetin e vitit të fundit.

Pra, kryeministri Kurti në prezantimin e buxhetit për vitin e fundit të qeverisjes në mandatin e tij qeveritar nuk ka arritur ta prezantojë as edhe një projekt të vetëm në as edhe një fushë, të cilin e përmbyll si kryeministër në kuadër të këtij mandati.

Pra, në cilëndo fushë që e marrim, të nderuar kolegë deputetë, në krejt atë që e prezantoi Qeveria e Republikës së Kosovës, ajo që është konkretet në këtë 4-vjeçar, është SuperPuna e tyre. Edhe këtu nuk i kanë shifrat e sakta. Përderisa ministri i Financave thotë që i kemi punësuar deri tash 8 mijë, kryeministri thotë, 9 mijë, ndoshta fundin e vitit e kanë si cak 10 mijë.

Po edhe nëse krejt kjo është e vërtetë, a besoni që krejt angazhimi juaj në zhvillim ekonomik duhet të reduktohet në SuperPunë në 10 mijë të punësuar për 4 vjet? Edhe këtu kanë dyshime që janë të vërteta. Absolutisht, jo!

Të nderuar kolegë deputetë,
Prandaj, prezantimi i të dhënave, shifrave të pasakta të cilat nuk i bazoni askund, por thjesht i përmendni, është zvogëluar në 16% papunësia, siç e thanë, dhe duke mos përmend sa edhe një shifër të vetme që të dëshmohet para qytetarëve që një gjë e tillë është e vërtetë, qoftë në sektorin publik, qoftë publiko-privat, qoftë në atë privat.

Të nderuar kolegë deputetë,
Manipulimet nuk pinë ujë, sepse këto janë të paqëndrueshme. Dhe, nëse i shohim fushat të cilat i përmendi kryeministri i Kosovës. Ta marrim, mbrojtjen. Por, mbrojtjen e kemi tashmë një transfer të buxhetit të këtij viti, në vitin e ardhshëm. Dhe, kryeministri krejt çka thotë për mbrojtjen, kurrë më shumë armë s'janë blerë. Këtu përfundon. Pra, këtu përfundon angazhimi i kryeministrit, i cili thotë, kurrë më shumë armë s'janë blerë. Por, nuk është gjendje të thotë, as sa, as kur, as qysh, as tek, asnjë të dhënë nuk ta jep, pos që thotë, kurrë më shumë s'janë blerë.

Në anën tjetër, mazhoranca thotë, e bën krahasimin me investimet në ushtri në vitin 2016. Pra, kur s'ka pasur në 2016-tën ushtri. Dhe, ti kur s'ke ushtri, je i reduktuar dhe nuk mund të blesh armatim. Pra, FSK-ja s'e ka pasur mandatin e ushtrisë deri në vitin 2019 kur ky Kuvend ia ka dhënë mandatin.

Prandaj, nuk mund të bësh krahasime me vitin 2016 kur s'ke pasur ushtri, dhe të thuash, s'ke blerë armatim në atë kohë. Nuk mundesh, sepse nuk të shesin. Nuk të shesin armë kompanitë e mëdha pa pasur ushtri. Polica furnizohet me një armatim tjetër, ushtria furnizohet me një armatim tjetër.

Çështje tjetër. Te arsimi, kryeministri reduktohet krejt te bursat. Në vend që na e prezantojë një projekt që po e përmbyll, që flet për modernizimin e arsimit në Kosovë, që flet për universitetet publike, për fuqizimin e tyre, krejt çka flet për arsimin kryeministri, janë bursat. Kurrë më shumë bursa s'janë dhënë, thotë. Po mirë që janë dhënë, por çka po ndodh me çështje të tjera? Çka po ndodh me shërbimet në arsim? Çka po ndodh me cilësinë e arsimit? Çka po ndodh me modernizimin? Me investimet në sektorin e teknologjisë informative, ku po ecë bota. Cilat janë ato? Pra, janë zero, fatkeqësisht.

Në rrafshin e shëndetësisë po qëndrojnë të heshtur, sepse s'kemi çfarë të flasim. Për tre vjet ka qenë një katrahurë. Herë ka ardhur ministri, herë ka shkuar ka garuar diku tjetër, tani u kthye prapë, dhe në anën tjetër, sot investimet i kemi zero.

Ajo që ia ka pasur më së shumti borxh kjo Qeveri qytetarë të Prishtinë në radhë të parë, ka qenë Spitali i Prishtinës. Është vend prej qyteteve të mëdha që s'ka spital rajonal. Nuk ka. Kjo do të duhej të ndodhte pikërisht me juve zoti Vitia, që fatkeqësisht nuk po ndodh.

Sigurimet shëndetësore as në horizont nuk duken. Kurrkund. Pra, zero angazhim sa i përket kësaj çështjeje. E shohim energjinë. Te energjia që tri vjet dështon auksioni solar. Pse? Sepse ka pasiguri të madhe këtu. Nuk vijnë investitorët. Ku është MCC-ja? Ku janë bateritë e MCC-ve? Zero investim. Asnjë angazhim s'e keni pasur sa i përket MCC. Zero!

Ka pasur të fillojë vitin e kaluar. Ka pasur të fillojë edhe në fillim të këtij viti. Ne do ta shohim dhe do t'u mbajmë për fjale. Pra, asnjë angazhim sa i përket MCC. E keni ndërruar projektin, e keni hequr gazpërçuesin, i keni sjellë bateritë, zero angazhim. As stafin nuk e keni kompletuar sa i përket kësaj çështjeje.

Hekurudhat. Krejt çka keni bëri për tri vjet sa u përket hekurudhave, të nderuar kolegë deputetë, është njëfarë fasadimi i një tuneli. Gjysma e Qeverisë, së bashku me presidenten, me kryeministrin e kemi parë te fasadimi i tunelit. Po, mos bre! Pasha Zotin e gjithë kjo humbje dhe mos investime të tilla, është humbje kohe që nuk kthehet.

Kur i sheh, për shembull, investimet në subvencione në ndërmarrje publike. E thanë edhe kolegët më herët, 41 milionë në vitin 2019, 222 milionë në vitin 2022. Pra, janë rreth 130 milionë investime në energji.

Të nderuar kolegë deputetë,
Në asnjë fushë të mundshme nuk mund ta gjeni një projekt tuajin që vitin e fundit të qeverisjes po përmbyllet. Do të kisha dashur sot, për shembull, të them që në shëndetësi po e fillojmë me sigurimet shëndetësore në vitin e katërt të qeverisjes suaj. Nuk po përmbyllet kurrgjë. Por, as nuk po fillon. Janë edhe projekte që po vazhdojnë që janë edhe të qeverive të kaluara.

Kur i shohim në infrastrukturë, autostradat. Për Pejë e kemi gjendjen e njëjtë. Për Mitrovicë e kemi gjendjen e njëjtë. Për Podujeve e kemi gjendjen e njëjtë. Pra, nuk ka lëvizje në asnjërin prej këtyre drejtimeve. Viti i katërt i qeverisjes nuk përmbyllet asnjë projekt madhor i kësaj Qeverie. Është dëm, se ju shkoni. Vijnë të tjetër, vijmë ne, ndërrohen qeveritë, është krejt normale.

Por, ju s'do të mbaheni mend për asgjë. Ky është viti i fundit i qeverisjes suaj dhe nuk do të mbaheni mend për asgjë, për as edhe një projekt të vetëm. Pra, nuk është bre arritje madhe që të plotësohet numri që të mirëmbahen policia e Kosovës, duke plotësuar numrin në vazhdimësi me policë apo me ushtarë. Është shumë mirë që bëhet ajo, por duhet të ndodh ajo. Është normale që duhet të ndodh. Por, kur e sheh modernizimin e teknologjisë së ushtrisë dhe të policisë, këtu lë shumë për të dëshiruar.

Investime të tilla, aty duhet të mateni ju. Jo me pagat dhe jo me rritjen e numrit, sepse janë rritur vazhdimisht. Do të rriten edhe në të ardhmen. Në anën tjetër, ja po jua them një gjë. Regjistrimin

e popullsisë pse s'po guxoni ta bëni? Sepse 200 mijë njerëz për 3 vjet i kemi më pak në Republikën e Kosovës. Nuk guxoni ta bëni regjistrimin e popullsisë.

Kjo është një çështje që e tregon më së miri gjendjen tuaj. Tash do të duhej të ishte i përfunduar regjistrimi i popullsisë, dhe ju nuk mund të hyni, sepse s'guxoni t'i hyni një procesi të tillë.

Në anën tjetër, koeficineti i pagave. Është mjerim bre! Është shtrenjtuar për 50% shporta e produkteve esenciale ushqimore në vendin tonë. Janë të pamjaftueshme. Është koeficient i pamjaftueshëm për rreth 90 mijë shërbyes civilë, njerëz të cilët paguhen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Që ta përmbylli, të mundohem ta përmbyll. Këtë qeverisje e karakterizon kaotizmi. Pra, gjithçka ka qenë kaotike, ka qenë ad hoc. Nuk ka qenë qeverisje bazuar në një program qeveritar, të cilin e keni prezantuar në fillim të këtij mandati. Pra, gjithçka ka qenë kaotike, ad hoce. E kuptojmë që jeni ballafaquar edhe me kriza nga jashtë, të cilat jemi munduar t'ju ndihmojmë, si me pandemi, inflacion, si me Veri, me të gjitha.

Por, në anën tjetër, ajo çka është varur dhe çka ka qenë në dorën tuaj, në fushat të cilat i përmenda, janë zero. Pra, janë 4 vjet të humbura, është buxheti i fundit i kësaj qeverie dhe nuk mbaheni në mend për asnjë projekt zhvillimor që po e lini dhe në fund të ditës që e gëzojmë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ministri Murati ka kërkuar replikë.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!
Deputeti Tahiri tha është viti i fundit qeverisës, më falni, por vetëm sapo kemi filluar, do të jemi edhe gjatë këtu.

Sa i përket punësimit dhe shifrave, e thatë se ka shifra të ndryshme, në fakt, është shifra e njëjtë, domethënë janë 8 mijë vetëm me "Super punën", mirëpo më lejoni ta rikujtoj që përgjatë tërë mandatit janë 60 mijë, e prej tyre 32 mijë janë të rinj nën moshën 25-vjeçare që janë punësuar. Domethënë, punësimi tek të rinjtë dhe tek gratë ka shënuar rritjen më të lartë ndonjëherë. Sa i përket buxhetit të mbrojtjes u tha edhe nga deputeti Haradinaj më herët se s'kisha mundësinë të replikoj, e thatë edhe ju që po barten 58 milionë, e pavërtetë. Ajo shënohet vetëm si bartje e programit, pra Kodi buxhetor ka qenë 58, po bartet edhe një herë si kod i tillë, mirëpo shuma është shpenzuar e do të shpenzohet dhe do ta shihni edhe në raportin vjetor financiar të këtij viti.

Sa i përket edhe arsimit, ka shumë e shumë investime, të cilat janë bërë. Pra, duke filluar prej çerdheve, e duke filluar me furnizimin e pajisjeve nëpër shkolla, shkollimi dual pra që futet si koncept për herë të parë në Republikën e Kosovës, bursa investime në infrastrukturë, e shumë e

shumë investime të tjera, por që normalisht nuk i kemi për obligim që sa herë që ju nuk e dëgjoni dhe dëgjoni vetëm një fjali apo një fjalë, që ta sqarojmë listën, por qytetarët e dinë që ka pasur investime dhe përkushtim si kurrë më parë. Kurse sa u përket fushave të tjera, po besoj që edhe ministrat e tjerë mund të replikojnë.

KRYESUESJA: Kundër-replikë!

ABELARD TAHIRI: Ministri prapë nuk është në gjendje të na sqarojë dhe të na bindë si ka ndodhur punësimi i 8 ose 9 mijë të rinjve brenda një viti. Pra, e thotë si shifër dhe aty mbetet. Pra, nuk mund ta përmendë as numrin e kompanive që kanë përfituar këtu, as rajonet, as qytete, as asgjë. Pra, krejt çka thotë është: “Janë punësuar 8 mijë veta”. Por, mirë bre, edhe unë mund të them “janë punësuar edhe 3 mijë në Prishtinë”, çka dallon prej tëndes kjo? Çka dallon?

As unë s’po arrij ta argumentoj që janë punësuar 3 mijë, ti s’po arrin të argumentosh kurrgjë. Ti thjesht po e përmend një shifër, të cilën as nuk po thua në cilin rajon, as në cilën pjesë të Kosovës, as a janë të Veriut a të Jugut, as a janë të fshatit a të qytetit, të cilave mosha. Kur e di që janë punësuar 9 mijë, aty i ke emrat, i di, e di sektorin, a është në energji, a në tregti, a në prodhim, a ku janë ato vende pune.

Prandaj, ju s’po keni mundësi t’i thoni, ju thjesht po e përmendni një shifër dhe aty mbeteni. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Anton Quni.

ANTON QUNI: E nderuar kryesuese!
Zoti kryeministër,
Ministra,
Të dashur deputetë,
Unë prezantimin tim do të përqendrohem në buxhetin e dedikuar për sektorin e sigurisë, në veçanti në buxhetin e parashikuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, për Policinë e Kosovës dhe Forcat e Sigurisë së Kosovës. Si deputet, por edhe si anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Sektorit të Sigurisë, do t’i theksoj disa çështje, për të cilat po shpresoj që Qeveria Kurti do të tregojë konsideratë.

Që nga invadimi i Rusisë në Ukrainë, thuajse të gjitha qeveritë perëndimore i rishikuan politikat e sigurisë nacionale, i rishikuan strategjitë e sigurisë nacionale, strategjitë e mbrojtjes, përforcuan aleancat bilaterale, ngritën kapacitetet brenda NATO-s, i ngritën dukshëm buxhetet në sektorin e sigurisë, e tjera. Aq sa janë të rrezikuara shtetet e Perëndimit, ne jemi shumëfish më të rrezikuar për shkak të aleatit të fuqishëm të Rusisë, Serbisë, e cila është fqinji ynë. Të jesh në kufi me Serbinë, është njëjtë si të jesh në kufi me Rusinë. Këtë e vërtetoi edhe inkursioni paramilitar dhe

terrorist nga territori i Serbisë në territorin e Kosovës. E kam theksuar këtu në Kuvend, ditën kur e miratuat strategjinë e sigurisë së Kosovës, se nuk ishte në përputhje me nevojat dhe kohën që është inkurajuese për Serbinë, kur të kuptohen dobësitë e saj që nuk premton sigurinë e duhur.

Të nderuar deputetë, po flasim për një fushë, e cila çdo ditë evoluon, e varur nga politikat globale dhe regjionale, gjendjet ekonomike, regjimet autokrate përballë atyre demokratike, migrimet, inovacionet teknologjike, ideologjitë politike nacionale dhe fetare, ku në raport me këto situata qeveria është e ngurtë, e mbyllur dhe jobashkëpunuese, si me aktorët vendorë, ashtu edhe me atë ndërkombëtarë. Qasja e tillë është tregues se Qeveria nuk e ka kujdesin e duhur për sektorin e sigurisë, aq më shumë kur e analizojmë buxhetin e ndarë për këtë fushë, kuptohet manipulimi me shifra, me të cilat tentohet të krijohet bindja se ka trajtim me prioritet. Por, në fakt, është mbijetesë, gjendje pasive dhe marshim në vend. Vetë fakti se për vitin 2024 ka zero investime të reja, po flas për investime kapitale. E përsëris zero projekte të reja. Në Polici të Kosovës dhe në Forcat e Sigurisë së Kosovës zero projekte, është tregues se sa gjendje e mjerueshme është.

Të gjitha investimet kapitale janë të bartura nga vitet paraprake, investimet që barten prej vitit në vit, me rrezikun që do të vazhdojnë me vite. Me këtë qasje po rrezikohet operacionaliteti i njësive të policisë dhe të ushtrisë, po demotivohen pjesëtarët e saj, nuk po ngritën kapacitetet e parapara në personel, pajisje, objekte, e tjera. Po i tregoj disa shembuj, po ilustroj me disa shembuj: policia që gjashtë vjet një pjesë e tyre janë me uniforma të njëjta. Ka raste brenda policisë që prej 4 deri në 6 vjet nuk kanë bërë qitje kondicionale e të mos flas për stërvitje edhe më komplekse. Vinçat dhe makineritë me muaj nuk lëvizin në hapësirat e ndërtimit.

Në çdo konkurs për rekrutim po bie dukshëm numri i interesuarve, largimi dhe demobilizimi është jo vetëm shqetësues, por i frikshëm. Transporti i organizuar çdoherë e më i rrezikshëm, plani gjithëpërfshirës i transicionit tani në pikëpyetje të madhe. Rezervat e veçanta për nevojat e policisë dhe ushtrisë në zero, besueshmëria te partnerët strategjikë në rënie, e kemi rastin e ushtrimit fushor “Defender 2023”. Sigurimet shëndetësore, jetësore pa zgjidhjen në perspektivë, e mos t’i numëroj të gjitha se me të vërtetë nuk po dua që në shpalosjen e të vërtetës ta gëzoj armikun.

Fakti që njësitë elitare protestuan para Qeverisë tregon mjaft. Ata janë në të drejtën e tyre për minimumin e nevojave të tyre. Nuk po kërkojnë luks, por kushtet elementare. Po shpresoj që ju, zoti kryeministër, personalisht do të merreni me këto shqetësime. Mos ju besoni atyre që ju servojnë shifra të manipuluara. Rishikoni buxhetin deri në leximin e dytë, po patët nevojë për ndihmë, këtu jemi.
Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Bahrim Shabani.)

KRYESUESI: Replikë, ministri!

MINISTRI XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë,
Tashmë u theksua fakti se në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka rritje të buxhetit për 97% në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave, për Policinë e Kosovës 17%, për Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit 16% dhe kështu me radhë në agjencitë tjera.

Totali në investimet kapitale është 5,8 milionë, domethënë rritje prej 3,8 milionësh në AME. Në Policinë e Kosovës buxheti në investime kapitale është 21,7 milionë, për dallim prej vitit 2023 kur ka qenë 12,6 milionë euro, pa e harruar faktin se kemi pasur diku 9 milionë euro shtesë të miratuara nga Qeveria për investime në pajisjet policore për operacione speciale, të cilat tashmë janë realizuar. Në çështjen e sigurisë kibernetike ne kemi planifikuar 4,5 milionë investime kapitale në ASHI, që janë 700 mijë euro më shumë se sa në vitin paraprak. Tek Agjencia e Kosovës për Forenzikë totali i buxhetit për Agjencinë Kosovare të Forenzikës është 1,7 milionë euro, që i bie edhe rritje në investimet kapitale për pajisjet laboratorike dhe automjete të specializuara në 371 mijë euro, si dhe 113 mijë euro në ndërtimin e objektit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, vazhdojani kohën ministrit që ta përfundojë fjalimin.

MINISTRI XHELAL SVEÇLA: Dua edhe një herë ta theksoj dallimin midis 2023 tek Policia e Kosovës, meqenëse u përmend Policia e Kosovës. Në vitin 2023 në buxhet kanë qenë të parapara 12 milionë e 667 mijë, kurse në vitin 2024 parashihen 21 milionë e 707 mijë euro. Kjo është rritja më e madhe ndonjëherë pa harruar investimet e deritanishme, të cilat janë substancialisht të dallueshme përkundrejt investimeve të mëhershme që janë bërë në Policinë e Kosovës.

Jemi dëshmitarë, të nderuar deputetë dhe qytetarë, se patjetër që ka probleme, patjetër që ka nevoja të shtuara, por kurrë më herët këtë standard, këto pajisje, këtë investim Policia e Kosovës nuk e ka gëzuar më shumë se sa vitin e kaluar dhe se sa që planifikohet për vitin e ardhshëm.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Replikë, deputeti Quni.

ANTON QUNI: Të gjitha këto që i listoi ministri, ne i kemi të paraqitura në tabelat dhe në listat që na u kanë ofruar nga Qeveria. Edhe në prezantimin tim unë iu kam referuar dokumenteve që janë sponsorizuar nga qeveria, ku thuhet që për automjetet taktike janë ndarë 3 milionë e 700

mijë, armë dhe pajisje 2 milionë e 800 mijë, automjete të transportit 3 milionë e 450 mijë, si investime kapitale totale investimeve kapitale 21 milionë e 707 mijë.

Por, të gjitha të bartura nga vitet paraprake, po e potencoj edhe një herë, asnjë investim i ri. Nëse vazhdohet tutje kështu, vitin e ardhshëm buxheti i Ministrisë së Punëve të Brendshme mund të jetë edhe 300 milionë, por kjo fare nuk luan rol nëse këto investime, parashikime dhe planifikime nuk materializohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, një sqarim të vogël, kundër-replikë e ka.

MINISTRI XHELAL SVEÇLA: Më fal, i nderuar deputet, Kodi buxhetor vazhdon, deklarimi se nuk janë shpenzuar paratë e vitit të kaluar nuk qëndron. Unë mund t' ju them se në autoblinda ne kemi bërë blerje të numrit të autoblindave më shumë se sa të gjitha vitet e mëhershme. Domethënë kemi blerë më shumë autoblinda se sa që kemi gjetur në gjithë historinë e Policisë së Kosovës.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Tash radhën e ka Grupi Parlamentar AAK, fjala për Bekë Berishën.

BEKË BERISHA: Të nderuar deputetë,
Po thuhet këtu se është dyfishuar apo trefishuar buxheti për sferën e sigurisë. Normalisht që nëse i bart paratë, s'i harxhon kurrë, sikur tash në rastin e 58 milionë, ai shkon duke u rritur. A nuk ka pasur nevoja për siguri? A s'keni pasur ku t'i shpenzoni? Normalisht që ka pasur, keni pasur ku t'i shpenzoni, po s'keni ditur. Tash, qysh është gjendja në polici.

Policia është pa çizme, pa uniforma, pagat e vogla, pa sigurim shëndetësor, pa sigurim shëndetësor për krejt qytetarët e Kosovës, se kjo mund të bëhet. Pastaj, ushtria: pagat e vogla, uniformat e arnuara, transporti i dështuar ka qenë premtim edhe i ministrit paraprak, po edhe i këtij, ushtarët bëjnë autostop. Por, edhe këta i kanë çizmet e shqyera. Ashtu janë zjarrfikësit, gardianët dhe krejt sektori i sigurisë. Si rezultat i kësaj plot policë edhe ushtarë i braktisin njësitet si në ushtri, ashtu edhe në polici, domethënë e braktisin punën.

Buxheti i dyfishuar apo i trefishuar sipas këtij buxheti. Ky buxhet nuk është asgjë për situatën edhe për botën e trazuar edhe për atë se çka po ndodh nëpër botë. Domethënë, kryeministri edhe ministri veç më lejoni t'ju ndriçoj pak se çka po ndodh sot në luftën Ukrainë - Rusi. Në ditë, 600 kamionë e furnizojnë ushtrinë e Ukrainës, ushqim, veshmbathje, municion e tjera. Domethënë në ditë 600 kamionë, tash kam dëshirë ta kem vëmendjen e ministrit të Financave. 25 mijë predha të artilerisë Ukraina i lanson në ditë kundër Rusisë, e Rusia ia kthen 95 mijë predha të artilerisë në ditë, pa i përmend ato të tjerat. Tash është mirë ministri i Financave le te kthejë në euro sa

kushton një ditë luftë me këto të dhëna, diku të përafërta janë, dhe e sheh sa është buxheti ynë për sigurinë dhe a mund të krenohemi ne me këtë buxhet. Serbia e ka një industri të prodhimit të armatimit të rëndë e të predhave, të mos flasim për armatimin e lehtë. Buxheti i Serbisë është 1.1 miliardë e 500 milionë për çdo vit, plus rezervave që i ka prej 1943 e tutje.

A duhet që të dhjetëfishohet buxheti i mbrojtjes? Unë ju kisha inkurajuar për ta bërë. Domethënë, krejt resurset i kisha futur në këtë funksion. Ka forma dhe duhet gjetur format. Tash shumë këtu po thonë rrezikun e luftës, pozita po mundohet ta keqpërdorë, kishe ta mbajë, nuk është e vërtetë, rreziku i luftës është real. Ka asi profiterë të luftës, gjithherë gjenden ata, mirëpo rreziku i luftës nuk është tash që mund ta keqpërdorë dikush, sepse është real.

Unë kam çka të flas plot, mirëpo ju kisha inkurajuar po ashtu që të licencohen dhe të ndihmohen kompanitë e investitorët për prodhimin e municioneve të kalibrave të ndryshme. Unë e di këtu, kryeministri na ka thënë unë këtë herën e fundit nuk e kam premtuar bashkimin kombëtar, se nuk po u mund të bëhej, mirëpo kam premtuar barazi, drejtësi. Tash çka është barazia në këtë kur 50 policëve ua blen opingat, e nuk ua blen edhe 9 mijë të tjerëve. Nuk është kjo barazi. Edhe në drejtësi, nëse do të bësh drejtësi, mos u anko që e kanë pushtetin këta, i kanë influencën këta të tjerët, nuk po mund të bëjmë drejtësi. Bëjeni drejtësinë, investo në drejtësi, bëni krejt çka është e mundshme, veç bëje qysh duhet se e ke pasur premtim elektoral.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)

KRYESUESJA: Ministri Sveçla ka kërkuar fjalën për replikë.

MINISTRI XHELAL SVEÇLA: Faleminderit!
Në vazhdimësi është duke u përmendur çështja e uniformave, çizmeve, pajisjeve të tjera. Shumë shpesh duke u manipuluar me numra, me fakte, e duke u keqpërdorur ato. Po dua t' ju informoj drejt, besoj që edhe publiku e kupton drejt.

Prokurimin e këtyre gjërave e ka Policia e Kosovës, nuk e ka Ministria e Punëve të Brendshme. Megjithatë, 4 kontrata aktive për llojet e ndryshme të uniformave janë dhe në vazhdimësi bëhen blerjet. Një kontratë aktive për çizme për këtë vit prej 750 mijë eurosh, 9 milionë euro janë investuar në pajisje vitin e kaluar, si kurrë më shumë. Janë 2,8 milionë euro furnizim me uniforma taktike, të cilat janë në proces dhe janë 1.2 milionë euro furnizim me këpucë, të cilat gjenden në OSHP. Domethënë, vullneti, ndarja e buxhetit maksimalisht në krahasim me të tjera herë. Gjendja plotësisht e ndryshme prej më herët dhe patjetër që ka nevojë për më shumë, ka nevojë për të rritur edhe përgjegjësinë Drejtoria për Prokurim, por nuk besoj se ka hapësirë për keqpërdorim e manipulim me këto shifra dhe me këtë gjendje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë, deputeti Bekë Berisha.

BEKË BERISHA: Faleminderit!
E para, unë e kallëzova një gjendje kështu të përgjithshme, unë ty ministër nuk të lypa as të më përgjigjesh. Nuk është manipulim me këto të dhëna, janë krejt të dhëna të sakta të policëve. Ata këtu janë, kemi familjarë, kemi njerëz që po kallëzojnë që e kanë këtë problem.

Tash, që tre vjet këtu, a është e vërtetë që shtyhet një tender për çizme, jo OSHP-ja po thotë. Pse s'po e bëni njëburimor, qysh i keni bërë plot sene, dhe të mos flitet më për çizme. Pastaj, ne po flasim për një gjendje të jashtëzakonshme, unë ta bëra krahasimin çka është duke ndodhur një ditë në Rusi - Ukrainë, e mu më duhet të flas në Parlament për çizme. Unë po të inkurajoj këto të tjerat t'i bësh, nuk ishte dashur të flitet për çizme.

KRYESUESJA: Ka kërkuar fjalën ministri Arben Vitia.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, nënkryetare!
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të dashur deputetë dhe
Të dashur qytetarë,
Faleminderit për këtë mundësi, sot kur po flitet për buxhetin dhe si çdoherë prej fillimit të mandatit të kësaj Qeverie shëndetësia ka qenë çdo vit prioritet i buxhetimit të Qeverisë sonë. Në fillim të mandatit ai ishte prioritet numër një për shkak edhe të rrethanave të krijuara për shkak të pandemisë, ndërsa për vitin 2023 në buxhetin që do të miratohet për vitin 2024 u buxhetuan pikërisht pikat më neuralgjike që hedhin themelet e transformimit të gjithmbarshëm të sektorit të shëndetësisë. Për ta pasur më të qartë një figurë, sepse jam dakord me disa nga deputetët që thanë nuk mund të bëhen krahasimet në mes të kohës së pandemisë që ishte 2020-2022. Në vitin 2019 atëherë buxheti ishte 233 milionë euro, kurse sot që po flasim në këtë projektligj për buxhetin, buxheti për vitin 2024 në sektorin e shëndetësisë është 345.626.600 euro. Pra pa e llogaritur këtu edhe kreditë, edhe donacionet, po flasim përmbi 110 milionë euro rritje nga viti 2019.

Çfarë kemi buxhetuar dhe po buxhetojmë ne lidhet me listën esenciale të barnave që është pa dyshim çështja kryesore dhe që po shkon drejt stabilizimit dhe reduktimit maksimal të mungesave dhe kjo në tri nivelet e shëndetësisë, dhe do të vijojë si e tillë. Kjo listë në vitin 2019 ka qenë e buxhetuar me 35 milionë euro, kurse sot kjo listë është 60 milionë euro, ku 38 milionë euro, pra tre milionë euro më shumë se i gjithë buxheti për listën e barnave esenciale në vitin 2019 është vetëm për buxhetin në SHSKUK. Buxhetin e listës së barnave esenciale për SHSKUK-në e kemi rritur edhe për dy milionë euro nga viti i kaluar, natyrisht pas skanimit dhe përditësimit të listës së barnave esenciale në mesin e këtij viti dhe tani në listën e re për nivelin dytësor dhe tretësor buxheti total do të jetë pra atë që e thashë, 38 milionë euro. Buxheti i vitit

2024 për listën e barnave esenciale i krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 65,4 për qind, ndërsa nga viti 2023 e kemi rritur me 3,8 për qind.

Këtë vit kemi buxhetuar pas një pune shumë të madhe dhe Sistemin informativ shëndetësor. Ky projekt shënon edhe hapin e parë, po e përsëris hapin e parë për themelimin e sigurimeve shëndetësore. Tentativa më shumë se një dekadë për këtë projekt, tentativa të dështuara, miliona të shkuara dëm, sepse nuk ka pasur as analizë e të them deri në një masë ka shkuar në një mënyrë paushallë, çka e dëshmon edhe dështimi i këtij sistemi. Tashmë kemi nisur punën që pasi të bëjmë të gjitha matjet e nevojshme, Qeveria e buxhetoi edhe nisjen e transformimit më rrënjësor në shërbim të pacientëve e të gjithë qytetarëve, pra të Sistemit informativ shëndetësor.

U ngritën këtu disa dilema nga shumë deputetë duke filluar nga z. Lushtaku, z. Hoti, z. Haradinaj e shumë të tjerë për çështjen e buxhetimit të sigurimeve shëndetësore. Mendoj që është rasti këtu që të sqarohemi se sigurimet shëndetësore nuk buxhetohen nga buxheti i shtetit. Ato janë në fakt buxheti që mblidhet nga të ardhurat e secilit të punësuar apo të vetëpunësuar, i dedikuar për buxhetin e shëndetësisë.

Pra, kur sigurimet të startojnë, secili punëtor do të ndajë nga paga e vet një përqindje dhe secili punëdhënës po ashtu do të ndajë për të punësuarit e vet një përqindje të destinuara këto për financimin e shëndetësisë. Aktualisht në vitin 2024 buxhetin e shëndetësisë e kemi 345,6 milionë euro. Shtimi i pagesës nga secili në sigurimet shëndetësore natyrisht se do ta rrisë këtë buxhet, me të cilin do të kryhen shërbime që do t'u jepen qytetarëve ndaj për sigurimet shëndetësore Qeveria tashmë e ka kryer punën për parakushtin themelor për fillimin e punës dhe buxhetimin për sistemin informativ shëndetësor qysh e përmenda më herët. Në vitet pasuese do të ecim drejt kompletimit edhe të sistemit të sigurimeve shëndetësore, rrugë kjo e pakthyeshme.

Qeveria ka mbështetur si asnjëherë më parë profesionistët shëndetësorë dhe kjo mbështetje do të vijojë edhe për vitin 2024. Kemi buxhetuar po ashtu edhe specializimet e reja për vitin 2024. Infrastruktura themelore është e gjitha e buxhetuar për vitin e ardhshëm, për t'u futur në një fazë të re transformuese e kjo jo vetëm në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, por edhe në spitalet rajonale.

Vlen të theksojmë se kemi zhbllokuar punët për spitalin e Ferizajt, për pediatrinë në Mitrovicë, vazhdohet puna për zhvendosjen përfundimtar të Entit Special në Shtime, ndërtimin e QKMF-ve bashkëkohore në disa prej komunave të Kosovës.

U tha këtu nga z. Tahiri se ne vetëm po vazhdojmë disa projekte të cilat kanë qenë më herët. Besomëni, kisha pasur dëshirë të mos kishin filluar këto projekte më herët sepse më shumë na ka marrë kohë zhbllokimi i tyre sesa puna që kishin filluar më herët. Për vitin 2024 në SHSKUK

buxheti është rreth 174 milionë euro, d.m.th. është rritur për 34 milionë euro, apo njëzet për qind nga viti 2023 dhe kjo shkon për të gjitha kategoritë.

Te investimet kapitale vëmendje i kemi kushtuar blerjes së pajisjeve mjekësore, përmirësim dhe renovim të infrastrukturës nëpër klinika dhe spitale e institucione të tjera të SHSKUK-së që edhe këto shkojnë në favor të përgatitjes së investimeve e buxhetimit që janë si parakusht për sigurimet shëndetësore. Kemi buxhetuar pajisje për paraplegjikët dhe tetraplegjikët. Për këtë kategori janë ndarë 3 milionë e 250 mijë euro, ku do të blihen pajisje, karroca speciale dhe shtretër e pajisje të tjera të domosdoshme për mirëqenien dhe shëndetin e tyre.

Siç e dimë të gjithë, fatkeqësisht sistemi ynë shëndetësor ka një infrastrukturë tejet të dëmtuar dhe të vjetruar, e diku edhe të munguar plotësisht. Për nyjat sanitare të dëmtuara, rrjetet e dobëta të kanalizimit, muret e dëmtuara, dyer dhe dritare jofunksionale apo gjysmëfunksionale, kemi buxhetuar riparimin dhe renovimin e tyre dhe për këtë qëllim janë ndarë mbi tetë milionë euro.

Po ashtu, buxhet kemi ndarë edhe për depon e re të barnave, sidomos për depon qendrore, meqë siç dihet, në njëzet e sa vite tashmë barnat janë ruajtur në kushte tepër të papërshtatshme për të thënë butësisht, prandaj për buxhetimin që kishim për 2023 ku tashmë kanë filluar shumë punë dhe investime dhe të tjera ende janë në proces të fillimit me buxhetin e vitit 2024 ne mund të arrijmë disa nga objektivat themelore që do të dallohen në rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor të dallueshëm për të gjithë qytetarët që kanë nevojë për trajtim.

Natyrisht se të gjitha shqetësimet e ngritura janë shqetësime të cilat besoj se i keni për vullnetin e mirë për të shkuar përpara, mirëpo ta kuptoni edhe një gjë tjetër. Nga viti 2021 nga ne është kërkuar edhe menaxhimi i pandemisë, është kërkuar edhe sigurimi i vaksinave kur s'ka pasur fare vaksina, është kërkuar edhe përmirësimi i infrastrukturës, nga ne është kërkuar edhe përditësimi i listës së barnave esenciale, e cila është përditësuar tashmë edhe në aspektin material, por edhe për mbi shtatëdhjetë produkte të reja po për besë dy vjet e gjysmë është vështirë.

Unë e kuptoj se në këtë drejtim ju mund të keni sinqerisht pritshmëri shumë më të mëdha nga ne sesa nga ajo që është bërë nga qeveritë paraprake. Unë e mbaj mend fushatën e vitit 2019, kur është bërë një garë mes partive politike se për sa mund të bëhen sigurimet shëndetësore. Disa kanë thënë për një vit disa ka thënë për një vit e gjysmë, e disa pak më realistë kanë thënë për dy vjet. Unë vetëm po ju them një gjë: pritjet tuaja që m'i keni thënë mua, për besë, ju falënderoj për gjithë këtë pritshmëri dhe gjithë këtë besim që e keni te ne, mirëpo ju keni qenë shumë më gjatë nëpër qeverisje dhe shumë mirë e dini çka keni bërë për sigurimet shëndetësore, dhe shumë mirë e dini që qysh një dekadë e tash që po flas Sistemi Informativ Shëndetësor përkundër dhjetëra miliona euro të investuara kanë shkuar dëm dhe tash po fillojmë tamam siç duhet, me analizë të plotë, sepse nuk ka kthim prapa.

Sigurimet shëndetësore do të bëhen nga kjo Qeveri. Do ta shihni, sepse këtu jemi gjatë, do të bëhen nga kjo Qeveri dhe një nga arsyet është se ne nuk punojmë paushall dhe nuk do të punojmë paushall edhe nuk do të punojmë pa analizë. Ashtu siç e kemi bërë edhe analizën tani për sigurimet shëndetësore, edhe për Sistemin informativ shëndetësor, i cili natyrisht me këtë analizë dhe me këtë buxhet që e kemi ndarë në këtë drejtim absolutisht se do të mbërrihet.

U përmend edhe Spitali i Prishtinës, atë që e kemi thënë ne çdoherë në çdo fushatë lokale dhe të zgjedhjeve nacionale, Spitali i Prishtinës dhe secili spital institucion shëndetësor që ndërtohet duhet në bazë të një analize paraprake, sepse duhet të jetë komplementar me Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Nuk bëhet një institucion tjetër qysh janë bërë më herët pa asnjë analizë, ku sot kemi mbi 4100 shtretër spitalorë në gjithë Republikën e Kosovës, kurse shfrytëzueshmëria është jashtëzakonisht e ulët dhe, në anën tjetër, të gjitha analizat tregojnë se nuk ka nevojë më shumë se 3200 shtretër dhe të bëjmë ne edhe një spital tjetër pa analiza paraprake, të cilat do t'i shtonin vetëm koston shtetin e qytetarëve, por jo edhe shërbimin, për besë nuk është kjo Qeveri që punon në mënyrë të tillë. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Mërgim Lushtaku ka replikë.

MËRGIM LUSHTAKU: Ministër,
Nëse e kam vëmendjen tënde, unë po e shoh realisht që replikat tuaja për shëndetësi prapë nuk po i realizoni dhe nuk po janë argumentuese sa duhet. Realisht edhe vetë argumentimi juaj po më duket deja-vu, ministër, për arsye të njëjtat arsye i keni dhënë për buxhetin e vitit 2023 dhe, me të vërtetë nuk është arsyetim fare sepse në fund të ditët pacientët e qytetarët presin sigurimet shëndetësore. Në rregull, s'e keni bërë sigurimin shëndetësor, më tregoni sa e keni implementuar ju buxhetin e sivjetmë që në total i bie diku njëzet për qind. 55 për qind i keni implementuar vetëm për barna dhe kjo është me të vërtetë skandaloze, kur e dimë ne se në çfarë gjendje janë pacientet tanë. Sigurisht që ju mund të manipuloni dhe të dilni në foltore, por ne i kemi statistikat, i kemi analizat nga Kuvendi i Kosovës, nuk i kemi nga partia jonë, se edhe ato i kemi, por i kemi marrë nga Kuvendi i Kosovës dhe që reflektojnë të pavërtetat tuaja.

Shikoni, e kemi një krahasim edhe në Ballkan se sa investohet për shëndetin publik. Te ne diku 3,4 për qind, ndërsa në Serbi 5,3 për qind, në Mal të Zi 7,13 për qind, Bosnjë e Hercegovinë 6,84 për qind. Kjo tregon për prioritetet tuaja në shëndetësi.

KRYESUESJA: Kundër-replikë ministri Vitija.

MINISTRI ARBEN VITIJA: Faleminderit, nënkryetare!
Për besë, me tabela dhe me saktësi po flas. Tash nëse doni krahasime, po bëjmë krahasime. Në vitin 2018 kur ju e keni pasur shëndetësinë, merreni vesh sa për qind ka qenë buxheti i ndarë për shëndetësi. E para.

Tjetra, në 2019 po ashtu kur ju e keni pasur shëndetësinë, z. Lushtaku, buxheti ka qenë 233.9 milionë euro. Në vitin 2024 buxheti është 345 milionë euro. Rritja e buxhetit në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë: në vitin 2019, 39 milionë euro, në vitin 2024, 80 milionë euro.

Rritja e buxhetit të SHSKUK-së: në vitin 2019, 121 milionë euro, në vitin 2024, 174 milionë.

KRYESUESJA: Gjithashtu ministri Aliu e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI LIBURN ALIU: Faleminderit!
Unë po përgjigjem më shumë në kritikat e përgjithshme që u dhanë e që kanë të bëjnë me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Një ndër kritikat në fillim ishte përgjithësisht për Qeverinë për rritjen e mallrave dhe shërbimeve dhe po dua të them që Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është njëra nga ministritë, e cila pjesën mallra dhe shërbime e ka të rritur më shumë sesa në vitet paraprake dhe kjo nuk ka të bëjë me ndonjë luks të Qeverisë, po kemi të bëjmë me kategori të shumta, të cilat tash kalojnë në kategorinë mallra dhe shërbime, p.sh. mirëmbajtja e autostradave dhe mirëmbajtja e rrugëve përpara kanë qenë te investimet kapitale, e që me të drejtë kanë kaluar te mallra dhe shërbime. Një pozicion i tillë i mirëmbajtjes e rrit buxhetin për mallra dhe shërbime normalisht shumë.

Çka ka rritur tjetër mallra dhe shërbime te ne? Është projektimi. Meqenëse ka qenë një lloj mënyre a metode e punës që nuk ka pasur projektime të mirëfillta, na është dashur ta shtojmë buxhetin për projektim të rrugëve dhe, në veçanti për mbikëqyrje të tyre. Projektimi dhe mbikëqyrja e urave, e rrugëve, mbikëqyrja e tyre prapë hyn te kategoria mallra e shërbime, gjë që bën që ne ta rrisim këtë pjesën e kategorisë së mallrave e shërbimeve.

Për sa u përket projekteve të reja, ndër të tjera u tha cilat janë ato projektet e reja që pritet ministria apo Qeveria t’i përfundojë. Po dua të them që ministria ku unë drejtoj projektet e reja i ka të orientuara krejtësisht në një drejtim tjetër, i kemi hekurudhat prioritet më shumë sesa rrugët e autostradat, i kemi digat dhe menaxhimin e ujërave më shumë sesa autostradat. Edhe te autostradat kur flasim prapë edhe aty po vazhdojmë. Çka kemi pasur si trashëgimi, e kemi rrugën për Dollc - Gjakovë, për të cilën u fol më herët, e kemi rrugën e Mitrovicës, e kemi rrugën e Gjilanit dhe e kemi rrugën e Podujevës.

Te kjo e Podujevës është dashur ta bëjmë projektin prej fillimit dhe e kemi bërë dhe normalisht, kur fillon nga pozicioni ku je në krejtësisht në një pozicion të ri, duhet të fillosh projektimin dhe tash jemi në ndërtim të saj, e cila po shkon pakrahasimisht ndryshe me projektet të cilat i kemi trashëguar. Kur flasim te rruga Dollc - Gjakovë, rrugë e cila nuk ka pasur as projekt, nuk ka pasur as shpronësime dhe nuk i ka pasur as urat dhe pjesët e tjera të objekteve që janë në rrugë. Qysh mund të pritet që mund të realizohet një rrugë e tillë pa shpronësime dhe pa ndërtimin e

këtyre strukturave. Strukturat tash i kemi dizajnuar dhe i kemi qitur në tender dhe presim shpejt ta kryejmë kontratën për to.

U tha që ka diskriminim në mes të komunave në projektet që ne i bëjmë karshi komunave. Do të duhej të ishit më specifikë, e vetmja që u tha këtu e u përmend mesa më kujtohet ishte Gjakova, e po dua t'ju përkujtoj që Komuna e Gjakovës me Ministrinë tonë i ka dymbëdhjetë projekte dhe është një ndër komunat që ka buxhetin më të madh në investime kapitale, konkretisht 11 milionë e 170 mijë euro është vlera totale e buxhetit të projekteve në Komunën e Gjakovës.

Pra, janë dymbëdhjetë projekte. Kush ia kalon? Ia kalon Ferizaj, i ka 22 498 000 euro projekte. Nuk janë asnjëra e Vetëvendosjes. Asnjëra komunë nuk ka të bëjë me Vetëvendosjen. Vetëm dua t'ju përkujtoj diçka: cili është realizimi i këtyre projekteve. Te rasti i Gjakovës nga këto dymbëdhjetë projekte vetëm tri kanë pasur progres, dymbëdhjetë të tjera progresin e kanë zero.

Dhe, kur po flasim në performansën e ministrisë totale që performansa e shpenzimeve po del e ulët, të mos harrojmë që njëqind nga këto projekte që e kanë performansën zero janë me komunat. Ndër të tjera, e përmenda edhe një herë Gjakova nga dymbëdhjetë i ka tri që kanë performansë, të tjerat e kanë zero dhe totali është 22,26 për qind.

Pra, Qeveria Gjakovën e ka të dytën për nga prioriteti sa i përket numrit të projekteve dhe sasisë së tyre, ndërsa Ferizajn e ka të parën. Po ashtu edhe me komunat e tjera, në shumicën e tyre performansa përgjithësisht është e ulët. U përmend këtu ura e Rugovës. Ura e Rugovës ka qenë projekt i cili nuk i ka takuar ministrisë dhe nuk ka pasur as dizajn për të. Është dashur të bëhet projekti, e kemi bërë dizajnin dhe jemi në fazë të realizimit të tij.

Ndërsa kur flasim për kalimet e mëdha a kapërcimet nga infrastruktura rrugore te infrastruktura hekurudhore, duhet të themi që i kemi bërë punët që duhet t'u paraprijnë projekteve. Nuk mund menjëherë të kalojmë në projekt, se duhet bërë njëherë dizajnin e rrugës Fushë-Kosovë - Pejë dhe Klinë-Prizren, për të mundur të bëjmë rehabilitimin e tyre. Ne do të donim që të kishte pasur në të kaluarën fizibilitete të kryera për digat. Kosova i ka punët tepër keq me ujë, tepër keq. Skenderaj, p.sh. do të duhej ta kishte pasur moti projektin e Kuqishtës, por nuk e ka bërë askush, s'i ka rënë mend askujt përpara. A e di cilën e kemi pasur digën e vetme në Kosovë që është ndërtuar paslufte? Një digë të vogël, e cila duhet bartur ujë për ta mbushur. Është në komunën e Malishevës.

Pra, përderisa jemi në krizë të madhe edhe për ujë të pijes, edhe për ujë për ujitje, e po ashtu për menaxhim të vërshimeve, nuk kemi pasur as plan të rrezikut nga vërshimet, e që jemi tash duke e hartuar hartën e rrezikut nga vërshimet. Pra, neve na ndodhin sot vërshime në befasi gjithandej, sepse nuk kemi asnjë analizë të vetme. Asnjë të vetme. Tash shpejt e përfundojmë hartën e rrezikut nga vërshimet. Shpejt e përfundojmë edhe masterplanin e ujërave. S'kemi pasur kurrë as

masterplan të ujërave. Nga ky masterplan i ujërave, pos digës së Kuçicës e pos digës së Dragaçinës, e pos digës së Pollatës që po e bëjmë tash, do të dalin edhe dhjetë diga të tjera. Pse? Sepse jemi tepër keq me ujë. I kemi veç pesëqind milionë metër kub ujë. As për pije nuk dalin. Po të kishim menduar më herët që jemi në krizë për ujë, së paku t'i kishim do projekte që të mund ne të fillonim ndërtimet, mirë do të ishte, do ta kishim kryer mbase ndonjërin.

Te hekurudhat, një tunel, dolëm, është projekt i Qeverisë së kaluar. Po ai tunel, dakord jam, po s'ka pasur tjetër, çka të bëjmë tash. Ama ka nevojë për projekte të shumta. Ka nevojë edhe për projekte të tjera, në veçanti për lidhjen e rrjetit tonë hekurudhor me Shqipërinë. Edhe kjo po lëviz. Po lëviz edhe projekti i lidhjes me Tetovën, e po lëviz edhe projekti i lidhjes mes Deçanit e Plavës. Te kjo e Deçanit dhe Plavës e kemi realizuar marrëveshjen. Kemi pasur nevojë për një marrëveshje të tillë, e kemi realizuar. Nuk di sa arrijmë ne ta bëjmë, se varet edhe prej Malit të Zi, po së paku në mandatin që vjen do të kryhet. Çka do të mund të kryhet këtë vit?

Çka do të mund të kryhet vitin që vjen. Vitin që vjen e fillojmë pas përfundimit të autostradës së Gjilanit, e fillojmë menjëherë autostradën që na lidh me Dheun e Bardhë. Përfundon rruga e Podujevës, urojmë që të shkojë mirë puna me pjesën e Mitrovicës, nuk e di si do të shkojë më tej dhe sa më shpejt të fillojmë me punët në rrugën nga Kijeva në Dollc, në mënyrë që në vitin që vjen pastaj në pranverën e vitit që vjen të fillojmë me prokurimin e segmentit tjetër që është nga Dollci në Zahaq.

Shpronësimet në rrugën e Gjakovës po i bëjmë, një pjesë e madhe e tyre kanë telashe të mëdha, te pjesa e Klinës në veçanti. Nuk e di si do ta bëjmë, në pjesën e Gjakovës do ta përmbyllim dhe do ta përmbyllim edhe me këtë projektin e infrastrukturës.

Përgjithësisht, dinamika e ngadalësuar e vitit të kaluar që ka qenë si pasojë edhe e rritjes së çmimeve nga lufta në Ukrainë, është shtuar shumë këtë vit e vitin tjetër besoj do të kemi edhe tejkalim të atyre planeve që i kemi pasur.

KRYESUESJA: I nderuar, në emër të grupit mund ta merrni replikën për shkak që nuk keni folur. Domethënë, as nuk iu është referuar me emër apo fjalimit. Kështu që, zoti Lushtaku e ka fjalën.

MËRGIM LUSHTAKU: Ministër, realisht në aspektin e implementimit të investimeve kapitale, kuptohet që veç Ministria e Infrastrukturës e mban këtë pjesën e balancës së investimeve kapitale, sepse këtu nga Ministria e Shëndetësisë e ministritë e tjera, realisht me 10% i kanë investimet kapitale. Kjo tregon për vullnetin, për punën dhe ekipin që duan ta realizojnë.

Por, edhe ato projekte që kanë qenë të planifikuara dhe që kanë qenë të buxhetuara dhe që kanë qenë të tenderuara, qysh ka qenë rasti i Brustit, për shembull, që e keni larguar fare nga projektet

e që keni bërë një padrejtësi të madhe, që kam reaguar edhe në Kuvend, nuk e keni rikthyer këtu si projekt i nevojshëm për qytetarët e asaj zone.

Edhe pse unë personalisht qysh atëherë kam thënë që nuk i votoj projektet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me ujin, por prapëseprapë nuk mundur ta bëj një gjest të tillë, për arsye se nuk kam dashur të bëhem si ju të këqij që të mos votoj një projekt jetësor qysh është ai për Skenderajn e që ka qenë projekti i Brustit në ujë.

Edhe Kuçica ka pasur investitorë gjermanë që ju nuk i jeni përgjigjur. Jo nga administrata që qeveri komuna jonë dhe Partia Demokratike e Kosovës, por ka qeverisur edhe vetë Bekim Jashari, gjë që ju nuk i jeni përgjigjur as për investime në pendën e Kuçicës.

Ju mund të vini dhe të tregoni sa të doni projekte, por nuk janë të realizueshme dhe nuk tregoni vullnet as për projektet e reja, sepse 0.00% keni investime të reja në komunat që nuk janë të mbështetura nga partitë që nuk u takojnë juve.

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Enver Dugolli.

ENVER DUGOLLI: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Kur flasim për Buxhetin e Republikës, ne si deputetë do të duhej të ishim më të përgjegjshëm dhe do të duhej që të jemi më të fokusuar në lëmitë që mbulojmë në komisionet përkatëse, por edhe në njohuritë që kemi sa i përket reflektimit dhe debatit që e bëjmë në këtë Parlament.

U fol shumë se referenca që po merret viti 2021, nuk do të duhej që të merrej për shkak që u fol më herët që ndoshta 2018 do të kishte qenë më korrekte sa i u përket trendëve të buxhetit.

Unë pikërisht po ndalem në vitin 2018 sa i përket buxhetit për mbrojtje, sepse për policinë nuk do të flas dhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme për shkak se është ministri këtu, por do të flas për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Ashtu siç e dini, në vitin 2018 ka pasur në Parlamentin e Kosovës një votim që ka kaluar me sukses dhe ka ndërruar misionin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe që nga ajo kohë ka filluar pastaj implementimi i planit gjithëpërfshirës i tranzicionit, i cili ka paraparë 10 vjet kohë tranzicion që kjo forcë të mbërri operacionalitetin dhe të jetë e aftë për mbrojtjen e territorit, sovranitetit dhe integritetit të vendit.

Sipas dokumenteve dhe fakteve që ekzistojnë, në vitin 2018 ka pasur buxhet Ministria e Mbrojtjes për Forcën e Sigurisë së Kosovës, pra për ushtrinë tonë kanë qenë 54 milionë. Dhe,

kuptohet, u tha edhe nga parafolësit që përpara ka qenë buxheti më i dobët për këtë ministri e për Forcën e Sigurisë së Kosovës, sepse nuk ka pasur mision ushtarak.

E kuptoj këtë, por nuk është e kuptueshme dhe është e papranueshme që të fshihemi pas kësaj, sepse kemi pasur mundësi që të bëjmë investime në infrastrukturë. Kemi pasur mundësi që të bëjmë investime edhe në shkollime edhe në përgatitjet e trajnime e kështu me radhë, shto këtu që edhe me mision e kaluar Forca e Sigurisë së Kosovës ka qenë forcë ushtarake me mision civil, por e armatosur lehtë, që i bie ka pasur mundësi që të blihen armatime të lehta, por nuk është bërë një gjë e tillë.

Dhe, sipas atij plani pastaj është paraparë që çdo vit t'i shtohen buxhetit për mbrojtje nga 5 milionë, e që në vitin 2027 do të duhet që sipas asaj dinamike të arrinte shumën 109 milionë. Diçka mbi 109 milionë euro, e që do të përmbushte nevojat e kësaj force.

Dhe, çka kemi bërë ne? Qysh në mandatin e parë, qysh në vitin 2021 Qeveria Kurti 2 kur e mori pushtetit, Qeveria Hoti që ishte në atë kohë, lerë që nuk e kishte rritur buxhetin sipas dinamikës dhe planit gjithëpërfshirës që ishte i parapërë që në vitin 2021 të ishte 81 milionë euro, por ata e projektuan një buxhet 67 milionë euro.

Më pastaj kornizën afatmesme të shpenzimeve parashihnin një reduktim edhe në këtë buxhet të mangët parashihnin që në vitin 2022 të kishte 2 milionë euro më pak. Nuk bëhej fjalë për realizimin e planit gjithëpërfshirës të tranzicionit, por bëhej fjalë për reduktim të investimeve dhe të buxhetit për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ne edhe pse e trashëguam buxhetin prej 67 milionëve, ne me rishikim të buxhetit me vizion, e me dëshirë e me vullnet, Qeveria e Republikës së Kosovës i shtoi edhe 24 milionë euro, ku arriti shifrën mbi 81 milionë euro qysh në vitin e parë qeverisës. Dhe, kjo ishte një rritje prej 35%.

Kritikat e zotit Hoti nuk qëndrojnë paçka unë e përgëzoj se tani edhe po e shohin që investimet në mbrojtje janë të nevojshme, dhe unë do të prisja edhe prej tij edhe prej deputetëve të jetë që ta përshëndesin një rritje kaq të madhe të buxhetit për mbrojtje. Pra, tani në vitin 2024 kemi një buxhet prej 153 milionë euro.

Por, edhe buxhetet e mëhershme, buxheti i 2022-ës edhe pse ka qenë 103 milionë, një rritje substanciale, me vendime të Qeverisë për blerje strategjike, kësaj force, Ministrisë së Mbrojtjes i janë shtuar edhe 50 milionë për blerje të veçanta dhe këtë askush s'po e përmend. E kjo i ka kaluar edhe parashikimet e optimistëve më të mëdhenj që do të rritej kaq shumë buxheti.

Kështu ka ndodhur edhe në vitin 2022, ku buxhetit bazë prej 123 milionëve i janë shtuar edhe 36 milionë të tjera për blerje strategjike. E kjo do të ndodhë edhe tani me këtë buxhet prej 153

milionëve për vitin 2024, jam i sigurt se me këtë vullnet dhe me këtë vizion të Qeverisë Kurti dhe prioritet që është shndërruar dhe është prioritet i padiskutueshëm mbrojtja, do të ketë edhe programe shtesë dhe buxhet shtesë sa i përket rritjes së kapaciteteve të mbrojtjes për Republikën e Kosovës.

Një deputet, zoti Quni meqë s'qenka këtu, e tha një të pavërtetë shumë të madhe për të cilën po dua të reagoj, për shkak se tha nëse e shohim tabelën e buxhetit për mbrojtje, nuk ka asnjë projekt të ti. Unë habitem, sepse konsideroj që zoti Quni është një profesionist dhe e di çka po flet, por kësaj radhe është totalisht i lajthitur për shkak se projektet e Ministrisë së Mbrojtjes, vitin e kaluar jemi marrë vesh këtu në Parlamentin e Kosovës dhe i kemi rigrupuar. Pra, nuk janë projektet e detajuar për shkak se bëhet fjalë për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, e cila do të duhej që të mbrohej nga ne dhe të mos ekspozonim projekte të detajuara.

Pra, nuk qëndron kjo dhe për këtë jam 100% i sigurt.

U fol edhe për mirëqenien e ushtarëve, pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës që janë gjithashtu pasues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku ka reflektim sa i përket mirëqenies së tyre. Me Ligjin e pagave, për të qenë shumë korrekt, ka pasur rritjes substanciale në pagat e ushtarëve. Dhe, konform programit qeverisës të Republikës së Kosovës dhe të Qeverisë Kurti, ne jemi qeveri e majtë, ne fokusin kryesor e kemi drejtuar te mirëqeni e atyre që janë baza e ushtrisë sonë e që mbi 80% janë ushtarë, e që rritja e buxhetit për paga ka reflektuar kryesisht e posaçërisht te kjo shtresë.

Ushtari përpara e ka marrë pagën 422 euro, ndërsa me Ligjin e pagave e ka 588 euro, por do ta ketë vitin e ardhshëm edhe më shumë për shkak se koeficienti rritet. Që i bie një rritje prej 166 euro apo në përqindje, 39%.

Gjithashtu, edhe tek ushtarët, ushtarit, tetari i karrierës, tetari, rreshteri e kështu me radhë, të gjithë kanë pasur rritje. I vetmi që nuk ka pasur rritje, është komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneral Jashari, por tek ai nuk e kemi ndier këtë ankesë, sepse ai ndjehet shumë, jo që nuk ka nevojë për mbështetje financiare e nuk ka nevojë për para, por prioritet i tij, siç është prioritet edhe i Qeverisë Kurti, është që ushtari të jetë i trajtuar me dinjitet, të ketë një pagë të dinjitetshme, një përkujdesje të merituar karshi angazhimeve dhe karshi shërbimit që bëjnë për vendin dhe Republikën. Ju faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESJA: Më fal, a i është referuar fjalimit tënd? Në rregull! Deputeti Anton Quni, replikë me deputetin Enver Dugolli.

ANTON QUNI: Faleminderit, kryesuese!
E dëgjova me vëmendje kolegun tim si deputet, po edhe si anëtar të Komisionit për Mbikëqyrjen e Sektorit të Sigurisë, kur prezantimin tim e cilësoi si të pavërtetë apo gënjeshtër.

Ai thotë kështu, ka investime të reja kapitale për vitin 2024, por që ato nuk figurojnë, nëse e kam kuptuar mirë, për shkak të konfidencialitetit të natyrës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Atëherë, unë bëj pyetje: Si është e mundur që këto veprime nuk janë konfidenciale për vitin 2023 dhe më herët, dhe tani qenkan konfidenciale. Në fakt, është një e pavërtetë e madhe, sepse dokumenti është prodhuar nga Qeveria. Deri në vitin 2023 i ka të paraqitura të gjitha projektet kapitale.

Thjesht, projektet kapitale bartën që nga viti 2020, 2021, 2022, 2023 dhe kjo është arsyeja pse tani është rritur aq shumë fondi i cili i dedikohet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë, deputeti Dugolli!

ENVER DUGOLLI: Faleminderit, nënkryetare! Jo për diçka, po vetëm sa t'i referohemi të vërtetës. Plani gjithëpërfshirës e parasheh krejt dinamikën e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në një forcë ushtarake që e mbron territorin.

Të gjitha projektet, të gjitha pajisjet, i gjithë armatimi parashihet po në atë plan. Mirëpo, sa i përket rigrupimit të kodeve buxhetore, ne vitin e kaluar e kemi ndryshuar këtë praktikë dhe kemi bërë shumë mirë. Pra, nuk është e thënë që gjithmonë të ecet kur është gabim diçka edhe të ecet në pafundësi. Që të shihen në tabelën e kodeve buxhetore, madje edhe të detajuara.

Ne e kemi bërë një punë të mirë vitin e kaluar dhe për atë sivjet nuk figurojnë kodet e caktuara që ndoshta do t'i ekspozonim pa nevojë në publik disa çështje të cilat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Ishte kundër-replikë. Ti pate replikë me deputetin, pastaj ai e ka të drejtën e kundër-replikës. Në fakt, ministri e ka kërkuar fjalën vetëm për sqarim në raport me diskutimit tuaja, dhe pastaj mund të ta jap fjalën ty.

MINISTRI HEKURNA MURATI: Vetëm një sqarim, sepse po përsëritet çështja e njëjtë. Sa u përket projekteve në vazhdimësi që janë nëpër ministri, po quhet si bartje e mjeteve nga viti 2023, gjoja se nuk janë shpenzuar dhe mjete të reja shtesë nuk ka ose ka pak.

Realisht, çfarë po ndodh është projekti është në vazhdimësi, dhe çka thuhet është që për vitin 2023 ka pasur kaq milionë euro, 53 milionë euro në këtë rast, të buxhetuara fillimisht dhe kësaj për vitin 2024 i shtohen margjinalisht dhe kaq.

Mirëpo, nuk është se janë të pashpenzuara. Përkundrazi, nëse shihet historikisht buxheti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, po, në kaluarën ka pasur raste kur nuk është shpenzuar buxheti në tërësi dhe në fund të vitit i është shkurtuar. Pra, i është marrë si kursim për t'u alokuar nëpër kategori apo projekte të tjera.

Çfarë po ndodh që prej vitit 2021 e tutje, kemi rastin kur buxheti çdoherë është më i lartë, shpenzimi ka qenë më i lartë sesa buxheti fillestar për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Pra, është e kundërta e asaj që po pretendohet.

Nuk ka asnjë bartje të mjeteve të FSK-së për vitin e ardhshëm. Buxheti le që është shpenzuar ose shpenzohet në tërësi për vitin aktual, por madje shpenzimi e tejkalon edhe buxhetin fillestar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Quni ka kërkuar replikë.

ANTON QUNI: Kështu siç e prezantojnë ministri dhe deputeti për opinionin mund të tingëllojë bindëse, por qytetarët nuk i kanë tabelat e paraqitura siç i kemi ne deputetët.

Unë edhe njëherë po u referohen tabelave të cilat janë shtypur, po besoj, në Ministrinë e Financave, ku thotë: "Totali për vitin 2024, 2+3", do të thotë, mjetet e bartura nga viti i kaluar dhe mjetet për vitin 2024. Mjetet për vitin 2024 janë zero në të gjitha fushat, të gjitha projektet kapitale. Nuk ka asnjë projekt kapital të ri.

Sipas shpjegimit të deputetit, do të thotë që në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit për t'u arritur kapacitetet e plota në atë plan, sipas tij, viti 2024 është vit vakum. Nuk ka aktivitete, nuk ka veprime. Unë po flas me kompetencë, se jam anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Sektorit të Sigurisë. Jam ish-ministër i Mbrojtjes, dhe jam në detaje i informuar se si funksionojnë këto gjëra.

Thjesht, për vitin 2024 nuk ka projekte të reja. Të gjitha projektet janë të bartura. Arsyetimin që e bën deputeti, gjoja për sensibilitetin e natyrës së punës e të tjera, nuk qëndrojnë. Kjo është mendësi e sistemeve dhe regjimeve totalitare, por në botën demokratike nuk funksionin kështu. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kemi edhe dy replika. Deputeti Enver Dugolli, pastaj vazhdojmë me deputetin Pal Lekaj.

ENVER DUGOLLI: Faleminderit, nënkryetare!
Për t'i hequr të gjitha dilemat rreth pretendimit të rrejshëm se po barten miliona euro për buxhetin e ardhshëm, nuk është e vërtetë. Vetëm një të dhënë po jua shpjegoj. Për këtë vit, pra vetëm deri më tani është mbi 70% e buxhetit të rregullt të alokuar, është i shpenzuar. Dhe, kemi ende edhe një muaj gjysmë kohë kur i gjithë buxheti i projektuar për Ministrinë e Mbrojtjes do të harxhohet, do të shpenzohet.

Por, ashtu siç e tha edhe ministri, do të ketë nevojë që të shtohet edhe më tej karshi kërkesave dhe nevojave të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Dhe, ato nevoja drejtohen e orientohen kryesisht mbi planet e detajuara të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilat kërkesa iniciohen herë pas here karshi nevojave për mbrojtje dhe siguri.

KRYESUESJA: Replikë, deputeti Pal Lekaj me kartelë të Bekë Berishës.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesuese!
I nderuar ministër,
E përmendet që nuk ka bartje të mjeteve buxhetore për vitin 2024. Ne, edhe në fjalimin tim, por edhe të të tjerëve e thamë qartë që janë projekte në vazhdimësi dhe 91% janë projektet ekzistuese që alokohen mjetet në vitin 2024.

Por, ka edhe bartje të mjeteve buxhetore, sepse nëse e marrim rrugën Kijevë-Zahaq që është huazim prej 198 milionëve, dhe për 3 vjet asnjë cent nuk e keni shpenzuar, ato mjete barten. Dhe, mendoj që këtu ne kemi plotësisht të drejtë kur themi që një pjesë e mjeteve alokohen në vitin 2024.

Prandaj, mund të them lirshëm që edhe projektet që janë në vazhdimësi nuk ka mjete të alokuara. Dhe, kur jemi te investimet kapitale, ju e dini që duhet ngrehur pak veshët ministrave, sepse shpenzueshmëria e parasë publike e alokuar është në nivelin më të ulët të mundshëm që nuk e ka njohur asnjë Qeveri. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ministri, kundër-replikë!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!
Sa i përket asaj që tha deputeti Lekaj. Pra, edhe një herë po konfirmohet që nuk ka të bëjë, sidomos për fushën e sigurisë kur folën, s'ka të bëjë me bartje, është projekt në vijimësi. Pra, në vitin e kaluar është bërë konsolidim i të gjitha kodeve buxhetore në një të vetëm përmes të cilit prokurohen sistemet e armatimit. Ajo s'do të thotë që nuk shpenzohet, vetëm se vijon projekti edhe në vitet në vazhdim.

Kurse sa i përket projektit Kijevë - Zahaq nuk ka as këtu bartje, për shkak se financimi që ju iu referuat, është anuluar. Pra, kredia është anuluar në kohën kur ka vendosur të ndryshohet traseja. As aty s'ka bartje.

KRYESUESJA: Tani në radhë është Rashit Qalaj.

RASHIT QALAJ: Faleminderit, kryesuese e Kuvendit!
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë,
Projektbuxheti që po e diskutojmë sot pa dyshim që është njëri ndër dokumentet më të rëndësishme që duhet miratuar dhe duhet aprovuar në këtë Kuvend.

Çka mund të themi për buxhetin e këtij viti? Është buxhet social apo është buxhet zhvillimor? Për mua është buxhet social, e aspak zhvillimor, sepse ky buxhet është më shumë social dhe se rritja e proklamuar nga Qeveria vjen si pasojë e inflacionit të lartë që ka qenë sivjet. Duhet të kuptohet se një buxhet të tillë nuk mund të jetë krenari institucionale kur kemi parasysh që viti 2023 ka qenë vit i inflacionit të lartë dhe vit i ngritjes enorme të çmimeve.

Rritja e buxhetit për vitin 2024 është më e ulët se sa është proklamuar nga qeveria, sepse projekt buxheti në terma të shpenzimeve është 3 miliardë e 314 milionë, derisa buxheti i rishikuar i këtij viti është 3 miliardë e 238 milionë që i bie diferenca në mes të vitit 2023 dhe 2024 vetëm 76 milionë euro. Ky buxhet nuk reflekton kauzat dhe premtimet që ka dhënë qeveria, as edhe programin qeverisë, për shembull, kanë qenë të premtuara edhe 160 çerdhe dhe nuk janë asgjëkund, kurse ju si Qeveri keni premtuar se edhe banimi social do të realizohet brenda këtij mandati, e jemi në vitin e tretë të qeverisjes, banimi social ende nuk ka nisur, e ku janë premtimet tuaja për sigurimin e banesave për çiftet e reja të sapomartuar.

Është e pakuptimtë të thuhet se ka rritje të lartë ekonomike kur buxheti për skema sociale po rritet vazhdimisht. Investimet kapitale kanë rënë në nivele shumë të ulëta si në planifikim, ashtu edhe në realizim. E në anën tjetër, buxheti për skemat sociale po rritet vazhdimisht që është e pakuptimtë nëse thuhet se ka pasur rritje të lartë ekonomike, ngase rritja ekonomike duhet të zvogëlojë numrin e familjeve dhe personave në nevojë dhe asistencat e tjera sociale, dhe rrjedhimisht duhet të ulen shpenzimet për skemat sociale e të rriten shpenzimet kapitale për nevojat të rritjes ekonomike dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës.

Në kohën tuaj të qeverisjes nuk jemi duke parë asnjë zhvillim dhe nisje të investimeve kapitale që është nonsens për qeverisjet në këto fazë të zhvillimit ekonomik me synim drejt integrimeve evropiane dhe integrimeve ndërkombëtare.

Kur është fjala për projekte kapitale, të dhënat e ofruara nga ju për këtë projekt buxhet dëshmojnë se nga 858 milionë euro të planifikuara për vitin 2024, për investime kapitale vetëm 49 milionë janë projekte të reja, të gjitha projektet e tjera janë projekte të bartura nga vitet e tjera dhe viti paraprak gjë që dëshmon jo profesionalizmin tuaj në këtë drejtim e kur ta kemi parasysh që edhe 800 milionë janë duke fjetur në sirtarët tuaja, vetëm ju e dini pse. Ju planifikoni se për arsim së bashku me grantin që u ndahet komunave mbështetja buxhetore do të arrijë në 370 milionë euro, apo rreth 20% më shumë se sa viti 2023. Planifikoni të ndërtoni fakultete, shkolla për arsimin e mesëm dhe fillor, e nga ana tjetër, kemi ikje masive dhe migrim masiv të të rinjve e zbrazje të studentëve e nxënësve nëpër institucione shkollore. Për kënd po ndërtohen këto shkolla?

Mirë është që ka buxhet më shumë, mirëpo ky buxhet nuk duhet të shkojë vetëm në sasi të objekteve shkollore, po duhet të shkojë pikërisht në rritjen e cilësisë të arsimit në Kosovë. Meqenëse ju e dini që kemi një disbalanc në mes të kërkesës dhe ofertës në tregun e punës dhe kjo duhet që të ndryshojë. Në vend që të stimulohen studentët, asistentët e mësimdhënësit përmes projekteve të ndryshme arsimore e shkencore, ata ballafaqohen me ngarkesa të tyre për publikime e botime të punimeve shkencore e titujve shkencorë dhe vjen deri tek një depresion dhe mosinteresim në këtë fushë. Shkurt, nga ky buxhet del se pjesa dërmuese janë shpenzime të parapara buxhetore për lëmoshë sociale pa asnjë perspektivë të zhvillimit të projekteve ekonomike që do të gjeneronin rritjen ekonomike të vendeve të punës dhe optimizim të rinjve për të mos u dekurajuar dhe që të mos emigrojnë jashtë.

U tha këtu që ka një rritje të buxhetit për shëndetësi, që është mirë. Meqenëse ju e keni parë në Raportin e Progresit se kualiteti i kujdesit shëndetësor përbën shqetësim në Kosovë dhe i njëjti formulim ka qenë në raportin e kaluar, shpenzimet për shëndetësi janë rreth 3% të GDP-së që është e parafundit më e ulëta në rajon dhe tri herë më e ulët se mesatarja e Evropës, që është 11%. Dhe, prapë po them, është mirë që të rritet buxheti për shëndetësi. Në lidhje me menaxhimin e parasë publike, ju e keni pa prapë në Raportin e Progresit që një shumë e madhe e buxhetit është shpenzuar për kontrata të negociuara njëburimore.

Dhe, çka të themi? Ne që shtatë herë po tentojmë që ta konstituojmë Komisionin Hetimor Parlamentar për Rezervat Shtetërore, dhe që atëherë ju të nderuar deputetë nga pozita po e bojkotoni, për çka? Ne vetëm po duam ta dimë, t'i qartësojmë, t'i shohim a janë të vërteta apo jo dyshimet për keqpërdorime. Dhe, çfarë mund të themi për tre vjetët e qeverisjes së zotit Kurti. Kjo Qeveri tash e tre vjet me radhë po mashtron qytetarët e Kosovës, po luan me dinjitetin e të punësuarve publikë përmes pagave, kanë dështuar në përmirësimin e cilësisë në arsim, ka dështuar në përmirësimin e cilësisë në shëndetësi, ka dështuar në rritjen dhe përmirësimin e prodhimit dhe cilësisë së produkteve në bujqësi, ka dështuar në realizimin e projekteve kapitale me efekt në zhvillimin e biznesit dhe mirëqenies së qytetarëve, ka dështuar në rritjen e prodhimit vendor e si rezultat kemi rritjen enorme të produkteve që na vijnë nga shtetet e tjera, të importit.

Të nderuar deputetë,
Kemi parë në këtë buxhet që kemi zvogëlim të parave për të burgosurit politikë, për invalidët e luftës, për veteranët, për pensione të minatorëve të Trepçës, e kështu me radhë. Është e pakuptimtë se si Qeveria Kurti rrit subvencionimin e ndërmarrjeve publike, ndërsa qysh në Qeverinë Kurti 1, në emër të ndalimit të gjakderdhjes financiare ka shkarkuar të gjitha bordet dhe ka emëruar borde të reja, me njerëz të saj dhe prapë kemi subvencionime të ndërmarrjeve publike. Atëherë çka kemi? Ku mbeti gjakderdhja financiare? Çka mund të thuhet sot për këtë punë? Ku i kemi investimet dhe planifikimin e buxhetit për komuna? Mund të them që nga 49 milionë euro projekte të reja për investime kapitale, shumica e mjeteve janë planifikuar për katër komunat që i ka në pushtet qeverisja e Vetëvendosjes.

Për shembull, për herë të parë në historinë politike të Ferizajt kemi shkurtime, më pak buxhet në kategorinë e investimeve kapitale, subvencioneve e shpenzimeve komunale, duke shpërfillur edhe logjikën e buxhetit që duhet të jetë progresiv, pra në rritjen ndër vite, gjë që kësaj radhe është regresiv në rënien në tri kategoritë themelore, të cilat janë shumë të rëndësishme. Kemi vonesa në procedimin e punimeve për spitalin e ri rajonal në Ferizaj, ndërprerjen e memorandumit nga Ministria e Infrastrukturës për zgjerimin e rrugës Talinovc - Rahovicë, nuk është vazhduar memorandumi në Ministrinë e Mjedisit për vazhdimin e projektit për parkun memorial të UÇK-së në Jezerc, nuk është vazhduar, është hequr nga buxheti projekti për ndërtimin e pishinave me gjysmë olimpike, nuk është vazhduar, është hequr nga buxheti rregullimi i fushës së sportit në Dubravë, nënfinancim të projektit për ndërtimin e Qendrës multifunksionale në Ferizaj, pra Pallatit të Kulturës. Çka kemi në Lipjan? Asnjë investim të ri, absolutisht asnjë investim të ri. Të gjitha projektet janë vazhdimësi e viteve të mëhershme, ose janë projekte nacionale ose rajonale.

Shihe shkollën e mesme, e cila ka filluar të ndërtohet që katër vjet dhe tash në buxhet është prapë për tre vjetët e ardhshme, domethënë një shkollë që duhet të përfundohet pas 7 vjetëve. Disa projekte kanë përfunduar këtu e kemi ende në buxhet, për shembull, Stadiumi i qytetit. Absurd të figurojë në buxhet, meqenëse ai është kryer, ose palestra sportive në buxhet, shihen plus 400 mijë euro, kurse kjo palestër praktikisht përfundon tash, është në përfundim e sipër dhe mjetet e pagesat mbyllen në vitin 2023. Përfundimisht në Lipjan asnjë projekt të ri, asnjë shkollë, asnjë çerdhe, asnjë sallë të re, asnjë rrugë, asnjë ujësjellës, as një kanalizim, zero investime të reja.

Kërkesat e komunave të Kaçanikut, rregullimi dhe asfaltimi i rrugës për Luboten, ndërtimi dhe rehabilitimi i sistemit të ujitjes për një sipërfaqe prej 370 hektarë apo përfundimin e ndërtimit të stadiumit të qytetit “Besnik Begunca”. Asnjë nga këto projekte dhe projekte të parashtruara nga Komuna e Kaçanikut Qeveria nuk i ka marrë parasysh. Shkurtimi i buxhetit prej 400 mijë eurove për Komunën e Hanit të Elezit. Është mirë, dëgjova ministrin e Brendshëm, që tha kam blerë autoblinda. Është mirë, është fakt, është mirë për sigurinë e vendit, është mirë për policët, por në anën tjetër qëndron krejt ajo çka tha zoti Bekë Berisha, edhe policit nuk i intereson OSHP-ja, ai i

do këpucët, çizmet, pajisjet, uniformën, pjesët e veturave, ai e do veturën funksionale e tjera, e tjera. Pra, nëse ka mundësi edhe një minutë?

KRYESUESJA: Regjia ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

RASHIT QALAJ: Ne duhet ta çmojmë diçka që bëhet e mirë, po ashtu duhet të kërkojmë që realisht kushtet elementare, mirëqenia e policëve, e ushtarëve të jetë sa më e mirë e mundshme. E dimë që është buxheti i limituar, kurrë nuk ka buxhet të mjaftueshëm, mirëpo sot po e shohim më shumë se kurrë se prioriteti është siguria, dhe për sigurinë duhet të bësh gjithçka.

Prapë e di që janë proceduat e prokurimit mjaft të komplikuara dhe e di që sidomos OSHP-ja ka qenë problem edhe në të kaluarën, edhe tash, mirëpo gjithashtu dihet që kontratat në organizata serioze siç janë ajo e Policisë dhe e ushtrisë, dihet se kur ato mbarojnë dhe duhet të planifikohen shumë më herët që policët, ushtarët, zjarrfikësit, ata që punojnë në shërbimin korrektues të kenë uniformat, pajisjet me kohë dhe ashtu si duhet. Prandaj, edhe një herë ju kisha bërë apel që këto t'i kemi parasysh, të furnizojnë me kohë për shkak se ky shtet varet nga siguria dhe se pa siguri, vështirë se mund të flasim edhe për realizimin e këtij buxheti. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Besian Mustafa.

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryesuese!
Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Mbi të gjitha, të nderuar qytetarë,
Sot jemi mbledhur të flasim për buxhetin e vitit 2024, por po mendoj që para se të flasim për buxhetin e vitit 2024, shohim çka ka bërë kjo Qeveri sivjet këto 9 muajt e parë të vitit 2023.

Teknikisht, nëntëmujori është 75% i vitit, e do të duhej që 75% e shpenzimeve që janë buxhetuar, pra 75% e buxhetit të ishte realizuar deri në shtator. Unë po fokusohem vetëm te projektet kapitale, se rrogat natyrisht që dalin çdo muaj, nuk ua huqin, kështu që po ndalem te kjo pjesë. Para se të filloj me projektet kapitale, ministri i Financave fatmirësisht vazhdon të jetë këtu prezent në seancë. Në vitin 2021 kjo qeveri ka buxhetuar, ka qenë viti i parë, ka buxhetuar, ka projektuar, ka premtuar që do të shpenzojë ose investojë 2.9 miliardë euro gjithsej, por ka realizuar një buxhet prej 2,3 miliardë euro. 600 milionë euro më pak se sa që ka buxhetuar, ka projektuar, ka premtuar.

Mirë, ka qenë viti i parë, kanë qenë duke i mësuar fiokët nëpër ministri. Në vitin 2022 kanë buxhetuar 3,2 miliardë, pra kanë premtuar që do të investojnë, do shpenzojnë 3,2 miliardë euro, i kanë shpenzuar 2,5 miliardë euro. 700 milionë euro më pak se buxhetimi, më keq se viti i parë i qeverisjes. Sivjet në vitin e tretë kanë buxhetuar po ashtu njëjtë si vitin e kaluar 3,2 miliardë

euro, për nëntë muaj thashë është dashur t'i shpenzojnë 75% të buxhetit, i kanë shpenzuar vetëm 1.8 miliardë euro, pra 1.4 miliardë euro më pak se sa që kanë buxhetuar, kanë premtuar se do të shpenzojnë e investojnë.

Po i marr një nga një ministritë e ekzekutivit. Ministria e Financave, ministër u ankove goxha fort në Komunën e Prishtinës, kanë investuar, s'kanë investuar, e para deri në korrik nuk ua ke alokuar mjetet e tyre vetjake të bartura nga viti i kaluar. E në anën tjetër, ministër jeni çuar i madh e i vogël, vëllazëri e motra të Vetëvendosjes t'i ndalni punët në Prishtinë, por mbi të gjitha, ministër, qysh i përgjigjesh ti faktit që deri në shtator ishte dashur t'i realizosh 75% të projekteve kapitale në ministrinë tënde, pra një buxhet prej diku 75 milionë eurove, e i ke realizuar veç 2%. Për nëntë muaj në vend që t'i realizoje 75%, i ke realizuar veç 2%, ministër.

Po shkoj me rend qysh i ka raportuar vetë ministri i Financave në raportin nëntë mujor: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nga 6 milionë euro, 0% realizim, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nga 7,4 milionë euro, 13% realizim, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nga 222 milionë euro, vetëm 31%, e do të duhej të ishte te 75%. Ministria e Shëndetësisë nga gati 24 milionë euro, vetëm 8%, Ministria e Kulturës vetëm 10%, Ministria e Arsimit 27%, e kështu me radhë deri te Ministria e Mbrojtjes, fatmirësisht 55%, Ministria e Zhvillimit Rajonal 30%, Ministria e Drejtësisë 17%, Ministria e Ekonomisë 44% e kështu me radhë, pra asnjëra nuk i afrohet 75% që do të duhej të ishte deri në shtator.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës deri në shtator ka realizuar nga 257 projekte që ka listuar vetë në buxhet për këtë vit, 186 projekte prej tyre nuk e kanë realizuar asnjë cent të vetëm. Nga 257 projekte, 186 prej tyre deri në fund të muajit shtator, pra për nëntë muajt e parë, asnjë cent të realizuar. Ka shumë thashë 257 projekte nuk e kam ndërmend të humb kohë t'i lexoj një nga një, por asnjë projekt rrugor i rëndësishëm nuk ka përfunduar në këto tre vjet, jo vetëm sivjet, po në këto tri vite. Magjistralja Prishtinë - Podujevë s'ka përfunduar, Prishtinë - Pejë s'ka përfunduar, Prishtinë - Mitrovicë nuk ka përfunduar, Prishtinë – Gjilan nuk ka përfunduar, nëse tre vjet janë indikatorë se si të punojë kjo qeveri, vitin e ardhshëm veç po dihet çka do të bëhet.

Ministër, me sa të kuptova the nuk ke gjetur masterplan, ministri për ujitjen, ministri i Bujqësisë njoftoi që nga tetori i vitit 2020 veç është përpiluar, është përfunduar masterplani për ujitje që përfshin edhe Digën e Pollatës, e ke të gatshëm.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: po fokusohem vetëm te çështjet ekonomike, sepse jam ekonomist vetë. Nga 5 milionë e 974 mijë investime kapitale që i ka planifikuar vetë për vitin 2023, e thashë deri në shtator do të duhej të ishin realizuar së paku 75%, ka realizuar 0%. Pajisjet e laboratorit ... të gripit të shpezëve, 0%, pyllëzimin e sipërfaqeve

të zhveshura, 0%, ministër, po i lexoj se ka më pak për dallim prej Ministrisë së Infrastrukturës që ka shumë, nëse doni e bëj një përmbledhje. Nga 16 projekte kapitale, 14 prej tyre, pra 88% të tyre, 14 nga 16 projekte asnjë cent të realizuar. Realizim ka vetëm tek furnizimi me pajisje të IT edhe atë vetëm 4% dhe programi kombëtar i inventarizimit të tokave bujqësore në Republikën e Kosovës vetëm 4%, të gjitha të tjerat nga 6 milionë euro, 0% të rrumbullakuara.

Ministria e Ekonomisë nga 14 projekte kapitale që ka buxhetuar vetë për vitin 2023, deri në shtator do të duhej të kishte 75% të realizuara i ka realizuar vetëm 7%, 7% realizim në vend që të kishte së paku 75%. Laboratori i GJK-së 85%, zbatimi i masave të energjisë në ndërtesat publike, vetëm 32%, ndërsa ministrja proklamoi reklamoi këtë projekt të saj aq shumë. Impianti për ujërat e zeza në komunën e Prishtinës nga 10 milionë euro, asnjë cent i realizuar. Ministri i Financave do të duhej ta pyeste ministren e Ekonomisë pse ky inat me Prishtinën. Ekonomia digjitale në Kosovë nga 3 milionë e 600 mijë euro, vetëm 4% të realizuara, programi i zbatimit të efiçiencës së energjisë 3%, ITP në Prizren nga 78 mijë euro të buxhetuara, asnjë cent të realizuara.

Krijimi i parkut të teknologjisë digjitale në Bërnicë, 90% e realizuar, pilotimi 5G nga 1 milion e 400 mijë, asnjë cent, renovimi i ndërtesës së Qendrës së Ekselencës Digjitale nga 900 mijë euro, asnjë cent. Koncepti Smart City, e përmendi ministrja vetë, nga 200 mijë euro, asnjë cent. Projekti i zhvillimit të ujërave të zeza në Gjilan nga 6 milionë euro, asnjë cent i realizuar, projekti i trajtimit të ujërave të zeza në Komunën e Mitrovicës nga 3 milionë euro të buxhetuara nga vetë ministria, asnjë cent të realizuara. Pra, nga 14 projekte kapitale të buxhetuara nga vetë Ministria e Ekonomisë, 9 prej tyre nuk kanë asnjë cent të realizuar. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nga 9 projekte kapitale gjithsej, 6 prej tyre asnjë cent të realizuar. Do të duhej nga 7 milionë e 390 mijë euro që i ka projektuar ose i ka buxhetuar për këtë vit, deri në shtator të kishte përfunduar së paku 75%, MINT ka realizuar vetëm 13%, krahas 75%.

Inkubatori i biznesit nga 32 mijë euro, asnjë cent i realizuar, ndërtimi i zonave ekonomike nëpër Kosovë nga 4.7 milionë euro, vetëm 19% të realizuara. Vetë renovimin e objektit të Ministrisë së Tregtisë nga 120 mijë euro, 3% e realizuar, as ndërtesën e vetë s’arrijnë ta rinovojnë. Softueri i programit të Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve nga 50 mijë euro, asnjë cent i realizuar. Zhvillimi i fushave të reja të metrologjisë nga 204 mijë euro të projektuara, vetëm 28%, ndërtimi dhe pajisja e Qendra Rajonale të Inovacionit nga 150 mijë euro, asnjë cent i realizuar.

Krijimi i sistemit të Inspektoratit për të gjitha inspektoratet dhe avancimi i menaxhimit të të dhënave nga 2,1 milionë euro të buxhetuara, asnjë cent i realizuar. Softueri për regjistrimin e turizmit që proklamojnë që është sektor shumë i rëndësishëm nga 70 mijë euro, asnjë cent i realizuar. Pajisje mediale për nevoja të ministrisë 6 mijë euro, nuk e kam ditur Ministria e Tregtisë qenka edhe shtëpi mediatike, nga 6 mijë euro, natyrisht asnjë cent i realizuar.

Është diskutim i padobishëm që të flitet për buxhetin e vitit 2024, ku shihet që realizimi i buxhetit, veçanërisht te investimet kapitale, sepse thashë edhe një herë pagat u dalin çdo muaj, i realizojnë qind për qind. Diskutimi për realizimin e projekteve kapitale në këtë qeveri është diskutim koti, i padobishëm, sepse dështojnë vazhdimisht nga viti në vit.

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Shemsedin Dreshaj.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, nënkryetare!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kuvendarë,
Media dhe qytetarë të vendit,
Ky është buxhet i shifrave të mëdha, por në esencë ajo çka shihet është se bëhet fjalë për një rritje minimale.
Si mund ta quajmë këtë buxhet të shpresës, kur në të nuk figuron autostrada e Dukagjinit, pra 600 mijë banorë të Dukagjinit janë pa autostradë. Edhe ata janë taksapagues të Kosovës. njëjtë është puna edhe me rrugën Kijevë- Zahaq që e kemi quajtur "rrugë e vdekjes" dhe vërtet është rrugë e vdekjes. Asnjë baski që tre vjet në të nuk është ngulur. Njëjtë është situata, besa mos më keq është situata Pejë – Rugovë, ajo rrugë është e rrënuar, ajo rrugë nuk arnohet as nuk rinovohet me 1 milion euro, edhe ato të ndara para një muaj dite, kur kushtet atmosferike nuk lejojnë që të punohet në atë pjesë, pra është ngricë, borë, shi.

Dua t'ju tregoj vetëm një gjë që janë vendosur nja 100-200 metra asfalt te Patrikana e Pejës, edhe hala pa filluar qarkullimi i automjeteve në autostradë, ka plasur dhe sot automjetet qarkullojnë në anën e kundërt, pra jo përmbi asfalt, sepse duhet të largohen ajo pjesë. Këtë e di kushdo që ka shkuar andej, a unë kam qenë javën e kaluar. Vërtet një buxhet i këtillë kisha pritur që të ishte buxhet i problemeve, të cilat e kanë evidentuar këtë vit.

Pra, problemet kryesore kanë qenë në shëndetësi, arsim, në siguri të vendit. Ky projektbuxhet i propozuar vërtet nuk e pasqyron situatën reale që e kemi në vendin tonë. Punëtorët shëndetësorë i patën quajt "heronj", por ata mbetëm heronj në letër. Si mund të thuhet që mjekësia është prioritet kur vetëm 3,4% e bruto produktit vendor i përcaktohet Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm t'ju përkujtoj që Mali i Zi ndan 7,13%, Bosnja 6,68%, e të mos i numëroj shtetet e tjera.

Ku janë sigurimet shëndetësore? Që tre vjet i kemi pasur në agjendën legjislative, tri herë është larguar Ligji për sigurime shëndetësore dhe ende nuk e kemi. Vazhdojmë që të mbetemi vendi i vetëm në rajon dhe në Evropë pa sigurime shëndetësore. Ku janë skemat sociale? Ku janë paraplegjikët, emiplegjikët, të verbrit, po ku janë pensionistët? Vetëm t'jua kujtoj që nga ky vit nuk ka nevojë të ketë më Ligj për pensionistët që i kushtëzon me pesëmbëdhjetë vjet, se asnjë s'e mbulon pesëmbëdhjetëvjetëshin para 1 janarit të 1999. Krejt shkojnë në asistencë sociale.

Çfarë përkushtimi mund të kërkoni dhe përgjegjësie mund të kërkoni nga drejtorët, të cilët përmbi pagën e specialistit e kanë simulimin 50 euro? Çfarë cilësie në shërbim shëndetësor mund të kërkoni kur një mjek në specializim paguhet 600 euro sa një kamerier që punon sot në Kosovë? Çfarë cilësie mund të kërkoni nga infermierët, të cilëve nuk u paguhet puna e natës dhe të cilëve nuk u paguhet rrezikshmëria? Këto kërkesa kanë qenë gjatë tërë vitit dhe askund nuk figurojnë në buxhetin e vitit të ardhshëm.

E nderuar Qeveri,
Kështu nuk ndalet migrimi i mjekëve dhe infermierëve. Ju përkujtoj që vetëm gjatë këtij viti 147 mjekë e kanë lëshuar Kosovën. Këto janë të dhënat që i ka publikuar Oda e Mjekëve.

Hajde t’i kthehemi arsimit. Si mund të kemi arsim cilësor dhe rritje të cilësisë kur arsimi merr pjesë me 3,5 për qind në nivel të Bruto Produktit Vendor. Ju përkujtoj që në Bashkimin Evropian mesatarja e investimit në arsim është 4.8 për qind e Bruto Produktit Vendor, ndërsa shtetet që pretendojnë që të rrisin cilësinë e arsimit qysh është Irlanda, e ka dyfishin tonë, 7,7 për qind të Bruto Produktit Vendor.

Si mund të kërkojmë përgjegjësi nga drejtorët e shkollave kur dyzet euro ua rrisim rrogën më shumë sesa profesorëve në punë? Si mund t’i kthejmë në punë vërtet treqind profesorë, të cilët veç sot janë duke kërkuar ta lëshojnë venin e punës? Flas për arsimin e ulët. Si mund të kërkojmë përkushtim në arsim cilësor me stafin akademik kur rroga e profesorit zvogëlohet për njëqind euro? Si mund të kërkoni cilësi në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” kur për 2,93 për qind ia keni zvogëluar buxhetin? Pra, saktësisht për 956 mijë euro. Si mund të kërkoni përparim në shkencë kur 0,7 për qind e GDP-së shkon për hulumtime shkencore, ndërsa me MSA jemi të obliguar që kjo të rritet në tre për qind.

Bazuar në tërë këtë, ky projektbuxhet nuk është i bazuar në kërkesat dhe ankesat e qytetarëve. Këtë buxhet mund ta quani si të doni, por mos e quani buxhet të arsimit, të shëndetësisë, të shkencës. Me një projekt të tillë buxhetor nuk përmirësohet gjendja në vend dhe nuk ndalet migrimi i rinisë. Nuk ndalet migrimi i profesionistëve e assesi të fillojë procesi i rikthimit të trurit që është duke na ikur çdo ditë.
Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Ministri Aliu e ka kërkuar një replikë.

MINISTRI LIBURN ALIU: Veç për informim, projekti i zgjerimit të rrugës Istog-Pejë-Gjakovë-Prizren ka filluar dhe tashmë është duke u bërë, është kontraktuar dhe është dhënë edhe buxheti te mallrat e shërbimet dhe presim të realizohet. Sa i përket autostradës paralele me këtë, nuk e kemi në buxhet.

KRYESUESJA: Kundër-replikë deputeti Dreshaj.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, ministër!
Faleminderit, kryesuese,
Realisht këto që i ngrita janë brenga, të cilat duhet vërtet të gjithëve të na brengosin, por në veçanti juve, ministër Aliu. Arsyeja pse, rruga Pejë-Rugovë besomëni është rrezik për çdo udhëtar, të mos flasim për ata që nuk e njohin. Frikësohem që nesër do të ndodhë një aksident ku ndoshta do të ketë edhe përgjegjësi penale për dikë. Dy, rruga prej Kijevës deri në Zahaq, besomëni është zinxhir i vdekjes. Qe tre vjet ka qenë e buxhetuar, ka qenë e programuar, ka qenë me fizibilitet e krejt. Pra, unë nuk po dua të hyj në detaje të tjera, por me një milion euro që i keni ndarë, ministër, për rrugën Pejë-Rugovë as ta arnosh nuk mjafton, besomëni.

KRYESUESJA: Për shkak që në kundër-replikë e ngrite edhe një çështje tjetër, ministri po kërkon një sqarim, po që mund të kesh edhe replikë pastaj. Pastaj e kemi një replikë edhe me ministrin Vitia.

MINISTRI LIBURN ALIU: Meqë replika ime kishte të bënte me zgjerimin e rrugës nga Istog-Pejë-Gjakovë-Prizren, çështja që u ngritët për rrugën e Rugovës, pajtohem plotësisht, jemi duke e shtyrë këtë çështje me gjykatë dhe me përmasat e sigurisë. Jemi shumë koshientë për këtë punë dhe do të marrim shpejt masa për atë punë.

KRYESUESJA: Ministri Vitia ka kërkuar replikë në diskutimin e deputetit Dreshaj.

MINISTRI ARBEN VITIA: Profesor, faleminderit për të gjitha!
Një pjesë nuk e dëgjova, kërkoj ndjesë se isha në drekë, po ato që i thatë një pjesë të madhe unë i përmenda që janë vendosur në buxhet. tash kur vjen puna te paga e profesionistëve shëndetësorë, a bën të na tregosh sa ta merr mendja ty që duhet të jetë paga e profesionistëve shëndetësorë. Bazuar që në Ligjin e pagave, në fakt, tash profesionistët shëndetësorë, specialistët e kanë nivelin e pagave më të larta në rajon. D.m.th. pagat më të larta në rajon me buxhet, investime në infrastrukturë, të gjitha ato që i thashë, një pjesë që po i përmend për besë janë ato që i përmenda dhe janë të vendosura në buxhet në listën që e keni besoj edhe ju përpara.

KRYESUESJA: Kundër-replikë, deputeti Dreshaj.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, kryesuese!
Faleminderit, ministër!
Realisht, atë që unë e përmenda ishin specializantët, të cilët i kanë diku 600 euro sa paguhet një kamerier. Vërtet ju falënderojmë shumë për specialistët të cilët, vërtet janë trajtuar si duhet. Por kemi probleme të tjera, ministër, që po na shoqërojnë. E kemi punën e natës që nuk u

kompensohet infermierëve. E kemi punën e vikendit që nuk u kompensohet. Ju i dini këtë mirë edhe ju.

Pastaj, sa i përket informatës suaj nga Oda e Mjekëve, 147 mjekë e kanë lëshuar Kosovën vetëm gjatë këtij viti. Në formularin të cilin e plotësojnë mjekët në momentin e tërheqjes së licencës, figurojnë tri sende: dominon paga e ulët, kushtet e punës dhe siguria në punë.

KRYESUESJA: E kemi rastin e njëjtë në kundër-replikë që po diskutohet edhe temë shtesë jashtë asaj që është në replikë. Unë ia kisha dhënë ministrit që ta japë sqarimin dhe natyrisht që keni të drejtë edhe ju pastaj tutje.

MINISTRI LIBURN ALIU: Po mundohem shpejt se një minutë e kam. Për punën e specializantëve, profesor. Janë një grup i specializantëve që me vetëdëshirë në specializimin e ndarë në vitin 2020 e kanë nënshkruar që nuk marrin paga, që do ta paguajnë specializimin dhe s’kërkojnë asnjë benificion tjetër.

Kjo Qeveri në fillimin e këtij viti ka ndarë 4,2 milionë euro për të subvencionuar pagat, për të cilat nuk ka pasur detyrim, sepse ka qenë një nënshkrim me vetëdëshirë nga specializantët me vetëfinancim.

Edhe kujdestaritë po zgjidhen. Ata kanë kërkuar që të lirohet edhe pagesa prej 500 euro. Për besë, ky është akt ligjor, profesor, edhe unë s’mundem me një vendim, pavarësisht a dua unë apo jo për ta ndryshuar këtë pjesë. Nuk është e vërtetë që nuk u paguhet ndërrimi i natës infermierëve. Ndërrimi i natës u paguhen orët e punës qysh i bën secili, profesor.

KRYESUESJA: Replikë, deputeti Dreshaj.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, ministër!
Këto informata që i dhashë, besomëni janë informata burimore, kështu drejtpërdrejt të marra prej infermierëve dhe prej Sindikatës së Infermierëve aty. Këto nuk janë informata të marra nga shtypi ditor ose diku tjetër. Pa kurrfarë qëllimi për të etiketuar dikë. Ju e njihni personalitetin tim çfarë e kam. Nuk merrem me thashetheme. Vërtet janë informata të ditës së djeshme. Ende ankohen që nuk ka pagesa shtesë për punën e natës. Nuk bëhet.

Ministër, unë jam duke folur publikisht, jam duke u thirrur te personeli mjekësor, të cilët këto informata m’i kanë dhënë. Unë uroj që kjo si thoni ju të jetë e saktë dhe unë nesër ta demantoj këtë para punëtorëve të mi shëndetësorë.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani e ka fjalën ministri Faton Peci.

MINISTRI FATON PECI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare e Kuvendit!
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kolegë ministra,
Sa i përket sektorit të bujqësisë, duhet ta bëjmë një krahasim të gjendjes në të cilën e ka marrë drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe sfidat me të cilat është përballur kjo Qeveri, posaçërisht marrë për bazë gjendjen katastrofale që e ka lënë qeveria paraprake. Ta zëmë, në rast se buxheti i vitit 2021 ka qenë 61 milionë euro, buxheti i vitit 2024 është 89,8 milionë euro, që bashkë me projektet ndërkombëtare kap shifrën prej njëqind milionë euro, që nënkupton përmbushje e tërësishme të premtimin tonë qeveritar gjatë fushatës. Aktualisht buxheti i vitit 2024 dhe buxhetin në të cilën gjendje e ka marrë Ministria e Bujqësisë është një rritje prej 45 për qind.

Përveç kësaj, dikush nga kolegët deputetë me të drejtë tha se është shumë e rëndësishme që secili prej nesh ta ketë vlerësimin se për çka do të mbahet mend gjatë mandatit qeverisës. Unë jam njëri nga ministrat që vlerësimin më të mirë e bëjnë fermerët në baza ditore dhe se periudha e kësaj Qeverie në sektorin e bujqësisë do të njihet si periudha kur Qeveria ka vendosur meritokracinë, kur është luftuar krimi dhe korrupsioni brenda këtij sektori, ku ka zero korrupsion dhe ku institucioni është ekskluzivisht vetëm në shërbim të fermerëve dhe të ekonomisë së vendit. Ta zëmë, në vitet e kaluara po edhe sot, disa nga eksponentët e ish-Qeverisë, ish-kryeministri Hoti, nuk e dëgjova diskutimin e ish-ministrit të Bujqësisë, z. Mustafa, po dëgjova disa nga pjesët e prezantimit të tij.

Më lejoni ta bëj një krahasim kur flasim për buxhetin. Buxheti i projektuar i vitit 2021 që ka qenë buxhet i votuar në vitin 2020, ka qenë 61 milionë për sektorin e bujqësisë, ndërsa dyzet milionë apo dy të tretat e buxhetit kanë qenë borxhe.

Meqenëse z. Hoti ka prirje dhe kështu pasion të merret me sektorin e bujqësisë po me huqje kardinalë në çdo vlerësim që e bën d.m.th. kur ky ka qenë kryeministër dy të tretat e buxhetit që i ka dedikuar për buxhetin kanë qenë borxhe dhe obligime.

Sa i përket buxhetit mendoj se përveç aspektit të rritjes buxhetore, është shumë e rëndësishme edhe realizueshmëria e buxhetit. Këtë rast po flasim për realizimin e buxhetit aktualisht në Ministrinë e Bujqësisë shumica e kategorisë së subvencioneve dhe granteve janë të realizuara dhe jemi në pritje të një buxheti shtesë për realizimin total të programit për subvencione dhe grante.

Çka ka ndodhur në periudhën e Qeverisë sonë në sektorin e bujqësisë? Ne e kemi shndërruar fermerin e Kosovës si fermerin më të përkrahur në rajon. Praktika, vuajtjet e fermerëve në të kaluarën t'i tregojnë më së miri ata dhe unë jam në kontakt të vazhdueshëm me ta.

63 për qind kemi rritur përkrahjen në kategorinë e drithërave. Vetëm në kategorinë e drithërave, duke u bazuar në rritjen tonë substanciale të buxhetit të vitit 2023, ne i kemi 66 mijë hektarë të mbjellë me grurë, ndërsa 42 mijë hektarë të mbjellë me misër. Aktualisht kemi 112 ha gjatë këtij viti i kemi pasur 112 ha të mbjellë me drithëra që është rekordi i Kosovës së pasluftës. Vetëm në sektorin e perimeve, perime në serrë ne kemi ngritur 35.5 ha me serra. Në aspektin e bilancit tregtar, produktet bujqësore në mënyrë të vazhdueshme trendi është rritje e progresionit linear.

Sa u përket investimeve kapitale ministria të cilën e drejtoj unë ka vetëm dy për qind të buxhetit të investimeve kapitale për sistemin e ujitjes. Dikush tha që Qeveria nuk bën shpërndarje të barabartë ose të drejtë në mënyrën se si i trajton komunat. 2,4 milionë buxhet të investimeve kapitale në ngritjen e kapaciteteve të sistemit të ujitjes ose kanaleve kulluese është e dedikuar për tetë komuna. Cilat janë ato komuna?

D.m.th. njëra prej komunave që është përfituese është Komuna e Istogut, është Komuna e Junikut, është Komuna e Vushtrrisë, është Komuna e Mitrovicës, mandej është Komuna e Deçanit, është Komuna e Klinës, është Komuna e Kamenicës, po është edhe Komuna e Shtimes. Nga tetë komunat e përzgjedhur, dy janë LDK, dy janë AAK, dy janë PDK, dy janë Vetëvendosje. Çka po doni meritokraci më të madhe në aspektin e shpërndarjes së investimeve kapitale. Të gjitha këto realizime, dy milionë i kam, po kjo është bërë temë e diskutimit. Ai dymilionëshi tregon që edhe një dy milionë është shpërndarë në mënyrë shumë meritore për të gjitha komunat e Kosovës.

Është shumë e rëndësishme të potencohet që investimet kapitale në Ministrinë e Bujqësisë janë projektuar që të realizohen në periudhën shtator-dhjetor për shkak se ndryshe dëmtohet vegjetacioni. Nuk mundemi ne të futemi pjesën e mekanizmit investiv dhe të prishim të mbjellat.

Realizimi i buxhetit vitin e kaluar ka qenë mbi 90 për qind. Realizimi këtë vit do të jetë prapë i njëjtë. Ndërsa për dallim kur në të kaluarën dyzet milionë euro kanë mbetur borxhe, ne e kemi përmbyllur vitin 2022 me zero borxhe dhe njëjtë do ta përmbyllim edhe këtë vit. D.m.th. gjithë ata që krekosen dhe flasin për planifikim të keq buxhetor, le të vijnë dhe le të përballen këtu me realitetin dhe me të dhënat të cilat unë i paraqita.

Buxheti i vitit 2024 do të vazhdojë trendin linear të rritjes në kategorinë e subvencioneve e granteve. Përveç kësaj, ne do të rrisim edhe fondin blegtoral që është shumë i rëndësishëm për shkak të nevojave që Kosova ka për furnizim të freskët me qumësht, mish dhe nënprodukte të qumështit e mishit. Gjithashtu do të kemi edhe risi të tjera, e njëra prej tyre është që Ministria e Bujqësisë në vitin 2024 tashmë e ka të projektuar edhe projektin për ndërtimin e objektit të ri të ministrisë për të evituar qiranë e lartë me të cilën përballet, po edhe njëkohësisht për të plotësuar standardet që ne i synojmë e që kanë të bëjnë me përmbushjen e standardeve IPAD ose IPA.

Edhe një herë po ritheksoj që mbi 214 milionë euro gjatë mandatit tonë janë shpërndarë në kategorinë e subvencioneve e granteve. Kemi rritur në 216 për qind përkrahjen për subvencionet dhe drithërat. Subvencionimi i naftës dhe plehrave është pjesë e mandatit të kësaj Qeverie dhe që ka ndodhur për herë të parë. Rekord kemi të mbjellat e pasluftës, dy të tretat e sipërfaqes të mbjella janë rritur këtë vit. Çdo i dyti aplikues është përfitues i granteve. Sigurimet bujqësore për gjashtë kultura bujqësore dhe kompensimi i primit të sigurimit për 75 për qind dhe mbi 30 mijë fermerë që kanë përfituar këtë vit do të përfitojnë edhe vitin e ardhshëm duke u paraqitur edhe me risi dhe pjesë të tjera të programit që do t'i shpalosim në fillim të vitit 2024.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Besian Mustafa ka kërkuar replikë.

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit kryesuese!
Ministër, faleminderit për raportin!
Në vitin 2023 në buxhet keni pasur të planifikuar 1 milion euro për ndërtimin e ndërtesës së Ministrisë së Bujqësisë. A nuk po më dëgjon? A dal aty?

Dola këtu se s'ka faj ministri, nuk po dëgjohet nga zhurma në sallë.

Ministër, thatë që raportuat pra edhe për vitin 2023 për realizimin e buxhetit. Në buxhetin e vitit 2023 te projektet kapitale keni pas projektuar edhe një buxhet prej 1 milion euro për ndërtimin e ndërtesës së Ministrisë së Bujqësisë. Është fatkeqësi që është paguar gjithë ajo qira. Unë kam tentuar që ta ndërpres këtë kontratë përmes Ministrisë së Administratës Publike. Besoj edhe ju keni bërë tuajën, besoj që edhe ju keni bërë një gjë të tillë. Por më bëri kurioz që thatë që do të ndërtohet në vitin 2024. Desha të pyes pse nuk është ndërtuar në vitin 2023.

Desha edhe një pyetje, e kam parë në media që keni publikuar thirrjen për aplikim për programin e zhvillimit rural, pra për grante për sivjet për vitin 2023, por afati i aplikimit ishte nga 1 nëntori deri në fund të muajit nëntor. Kur prisni që të realizohen këto projekte, pra të zhvillimit rural, pra këto grante dhe me cilin buxhet do t'i paguani projektet që fitojnë në vitin 2023?

KRYESUESJA: Kundër-replikë, ministri Peci.

MINISTRI FATON PECI: Më vjen mirë që edhe ju keni bërë përpjekje si ministër për të adresuar atë problem, po unë nuk kam qëndruar në nivel të përpjekjes, tashmë ne i kemi dhënë rrugë atij problemi dhe kemi të kontraktuar kompaninë, e cila e ka për obligim dizajnin dhe procesin e monitorimit. Nuk pretendojmë që objekti do të ndërtohet në vitin 2024, punimet do të fillojnë në vitin 2024, se cili do të jetë plani dinamik, është çështje e kompanisë që tashmë është e kontraktuar nga institucioni që unë drejtor. Edhe atë përveç kostos financiare, do të jetë e precizuar edhe plani dinamik.

Ndërsa sa i përket çështjes se kur do të implementohen grantet, ne këtë vit kemi implementuar 490 grante në nivel vendi, në të gjitha masat e nënmasat, ndërsa pjesa tjetër e shpalljes, ne qëllimisht e kemi projektuar në fazën që fillimi i procesit të vlerësimit të jetë dhjetori e janari, për shkak se në disa masa është shumë e rëndësishme që nuk mund të fillohet procesi i implementimit nga gjysma e vitit, që nënkupton që do të implementohen vitin e ardhshëm.

KRYESUESJA: Gjithashtu e ka kërkuar fjalën ministrja Rozeta Hajdari.

MINISTRJA ROZETA HAJDARI: E nderuar nënkryetare e Kuvendit!
Të nderuar deputetë,
Derisa është përmendur shpesh Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, unë dua të bëj së pari një krahasim për vitin 2019-2021 cash dhe vitin 2024-2026 vetëm për dy kategori: shpenzimet kapitale pra zonat ekonomike dhe subvencione e transfere. Në vitin 2019 kishit në buxhet 2,5 milionë euro, e jo më shumë, në vitin 2020 2,3 milionë euro, në vitin 2021 1,2 milionë euro, jo më shumë. Në subvencione dhe transfere kishit 1,384 milionë euro, po ashtu 1,384 milionë euro dhe 1,384 milionë euro, jo më shumë, pra as 1,5 milionë euro për grante dhe subvencione. Nëse i krahasojmë tash Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2024-2026, në Qeverinë Kurti tani për vitet në vijim, kemi për shpenzime kapitale për zona ekonomike, pra për parqe industriale dhe parqe teknologjike vetëm për vitin 2024 7 milionë e 850 mijë euro. Për vitin 2025 kemi 12 milionë e 850 mijë euro dhe për vitin 2026 kemi 12 milionë e 950 mijë euro. Është një rritje shumë e lartë në krahasim me atë që e kemi trashëguar nga qeveria juaj.

Po ashtu subvencionet dhe transferet kemi për vitin 2024 5 milionë e 246 mijë euro, për vitin 2025 kemi 5 milionë e 246 mijë euro dhe po ashtu për vitin 2026 5 milionë e 246 mijë euro.

Të gjithë këta indikatorë po tregojnë ose janë tregues se kemi një rritje shumë të lartë në krahasim me atë që kemi trashëguar. Pra, po ju jap një shumë, sa kishit ju 6 milionë e 150 mijë euro për tre vjet, për zonat ekonomike kemi 33 milionë euro e 650 mijë për zonat ekonomike. Po ashtu, sa kishit në total 4 milionë e 666 për tre vjet, ne për tre vjet kemi 15 milionë e 738 mijë euro subvencione dhe transfere për tri vjet. A nuk është ky një ndryshim shumë i madh?

Për më shumë, më lejoni t'ju njoftoj për arritjet e qeverisjes sonë sa i përket përmirësimit të të bërit biznes. Me prioritet të lartë i sollëm reformat e shumë pritura në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Vijuam me plotësimin e zbrazëtirave në Kornizën legjislative në përmirësimin e ambientit për të bërë biznes, klimën e investimeve, mbrojtjen e konkurrencës, reformën në mbikëqyrjen e tregut, fuqizimin e mbrojtjes së pronësisë industriale dhe turizmin e qëndrueshëm që nuk e kishit pasur parasysh asnjëherë.

Kemi miratuar 16 ligje dhe 35 akte nënligjore në harmoni me parimet e standardet ndërkombëtare dhe direktivat e Bashkimit Evropian. Dhe, jam krenare t'ju them sot se pjesa e

Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, progresi i saj përmendet edhe në Raportin e fundit të Progresit nga Unioni Evropian.

Për herë të parë miratuam politikën industriale të shumëpritur edhe nga Komisioni Evropian me vizion të qartë që deri në vitin 2030 industria e Kosovës të jetë e transformuar në një industri të integruar globalisht, e cila është gjendje të prodhojë produkte me vlerë të lartë të shtuar dhe të ofrojë punësim të denjë.

Përkrahëm rritjen e konkurrencës së 322 bizneseve përmes granteve me 11,86 milionë euro dhe subvencionuam kreditë për 395 biznese më 12,4 milionë euro.

Krahas këtyre, edhe 226 ndërmarrje vendore u përkrahen me pjesëmarrje në 33 panaire ndërkombëtare për mallra, për shërbime dhe aktivitete të turizmit, duke promovuar rreth 1 mijë produkte të mallrave dhe shërbimeve.

Për më shumë hapësirë për bizneset tona me kontribut të rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, ndërtuam edhe infrastrukturën në Suharekë, Viti, Lipjan, Rahovec dhe më shumë do të ndërtojmë me 33 milionë euro në buxhetin e 3 viteve të ardhshme.

Për më shumë hapësirë për kreativitet dhe inovacion mbështetëm me 8 milionë euro, financuar Parkun e Inovacion dhe Trajnimit me 40 hektarë hapësirë në Prizren dhe finalizuar investimet kapitale të projektit 1 milionë euro që ishte në Qendrën e Inovacionit dhe të Ndërmarrësisë, dhe po ashtu 4 mijë metra katror në inkubatorin e biznesit në Bërnicë.

Negociuam dhe nënshkruam marrëveshjen për përfshirjen e Kosovës në programin më të madh të Bashkimit Evropian, Tregu i Përbashkët në vlerë prej 4,2 miliardë euro për periudhën 2021-2027, për mbështetje të bizneseve dhe të organizatave me synim fuqizimin e mbikëqyrjes së tregut të brendshëm, përmirësimin e konkurrencës dhe rritjen e konkurrueshmërisë së industrisë në veçanti mikro të vogla dhe të mesme, mbrojtjen e konsumatorit, përfshirë sigurinë e ushqimit, përmirësimin e statistikave dhe përmirësimin e sektorit financiar.

E përmendi edhe kryeministri sot, që kemi arritur përmirësimin e bilancit tregtar në raport sa ishte 9 me 1, tani 6 me 1 në qeverisjen tonë.

Lansimi i negociatave për marrëveshjen e tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të EFTA-s, Zvicra, Lihtenshtajn, Norvegjia dhe Islanda me tri runde të negociatave në fusha të rëndësisë së veçantë, që përfshinë transferimin e teknologjisë, politikën dhe Ligjin e konkurrencës, prokurimin publik, tregtinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe çështje dhe politika të tjera të lidhura me tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, duke përfshirë bashkëpunimin doganor dhe të drejtat e pronësisë industriale.

Fuqizuam mbrojtjen e pronësisë industriale përmes miratimit të pesë ligjeve: Ligjin për patenta, Ligjin për markat tregtare, Ligjin për dizajn industrial, Ligjin për topografi dhe Ligjin për sekrete tregtare.

Kemi zgjidhur 500 lëndë të kundërshtimeve të markave tregtare që ishin në pritje që nga viti 2014 të pazgjidhura. Sillnin konflikte mes kompanive dhe humbje të tregut të tyre.

Nëse mund ta krahasojmë një biznes të cilit i është vjedhur ose kopjuar marka tregtare, ai biznes kishte pasur shumë humbje të tregut, sepse kishte konfuzion te konsumatorët. Regjistruam 30 patenta, 4 mijë 915 marka tregtare dhe 80 dizajne industriale.

Rregulluam dhe mbikëqyrëm tregun e produkteve të naftës pas më shumë se një dekade në aspektin e ligjshmërisë...

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë, ju kisha lutur që ose ta mbani qetësinë ose nëse keni diskutime t'i bëni te pjesa e bufesë!

MINISTRJA ROZETA HAJDARI: Për shitjen e derivateve të naftës, të cilët i gjetëm të pa licencuar. Zvogëluam barrën administrative me thjeshtim të lejeve dhe licencave të produkteve të naftës me kohëzgjatje në 6 vjet sa ishte më parë, në kohëzgjatje 6 vjet tani, sa i ishte më parë në 2 vjet dhe po ashtu thjeshtëzuam lejet dhe licencat e produkteve të duhanit në kohëzgjatje në 5 vjet sa ishte më parë, në 5 vite tani, krahasuar me 2 vjet sa ishte më parë.

Vlen të përmendi reformën e inspektimeve, një ndër reformat kryesore në 10-vjeçarin e fundit që përcakton parimet e inspektimit, koordinimin e mirëfilltë me organet inspektuese në kompetencë të administratës shtetërore dhe komunave dhe rregullon koordinimin e veprimtarive të inspektimit dhe procedurën e inspektimit të veprimtarive.

Bëmë 8 mijë e 150 inspektime, ose 150% më shumë se në vitet 2019 dhe 2020 së bashku. Ishin vetëm 3 mijë e 252 inspektime së bashku në këto dy vite. Larguam nga tregu mbi 12 produkte të cilat janë konstatuar se janë të pasigurta për konsumatorët.

Rritem besueshmërinë e konsumatorëve me adresim të ankesave të tyre në kohë. Në vitet 2019 dhe 2020 ishin trajtuar vetëm 524 ankesa, përderisa në vitet 2021 dhe 2022 janë trajtuar 2 mijë e 239 ankesa. Pra, janë 313% rritje më shumë.

Rezervat shtetërore i gjetëm në greminë. I kemi shtuar përplot tridhjetëfish, tani kemi dukshëm më shumë siguri për qytetarët tanë. Në vitin 2021 kemi rritje prej 85% të turistëve të jashtëm, kurse në vitin 2022 kemi 33% rritje. Numri i net qëndrimeve ka shënuar, po ashtu rritje prej 52% gjatë vitit 2022.

Zhvillimi i turizmit ka sjellë vende të reja të punës me rritje prej 27% të punësuarve në sektorin e akomodimeve dhe ushqimit.

Është me rëndësi përmendi edhe rregullimin e veprimtarive të ciceronëve turistikë dhe të agjencive të udhëtimit. Për herë të parë është rregulluar ushtrimi i veprimtarisë së udhërrëfyesve turistik, ciceronëve. Deri tani grupet turistike kanë përdorur ciceronë edhe nga shtetet e rajonit, përfshirë Serbinë për t'u informuar për trashëgiminë tonë kulturore...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

MINISTRJA ROZETA HAJDARI: Arritur marrëveshje, po ashtu të bashkëpunimit në fushën e turizmit me gjashtë shtete. Dhe, ka edhe më shumë rezultate, por po e lëmë me kaq. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Dreshaj, a e keni kërkuar fjalën për replikë? Time Kadrijaj me kartelë të deputetit Shemsedin Dreshaj. Më fal e nderuar, a keni kërkuar replikë në emër të grupit apo si? Jo! Nuk e ke radhën ende. Pa merak, je në vendin e njëjtë. Tani radhën e ka deputeti Avni Dehari.

AVNI DEHARI: E nderuara nënkryetare e Kuvendit,
Kabinet qeveritarë,
Deputete e deputetë,
Qytetare e qytetarë të nderuar,
Sot jemi mbledhur në këtë seancë për të shqyrtuar dhe për të miratuar në lexim të parë Buxhetin e Republikës sonë për vitin vijues.

Pra, buxheti i vitit 2024 që shqyrtojmë sot, jo vetëm që është më i larti në historinë e Republikës sonë, por edhe më gjithëpërfshirësi dhe reflektuesi i aspiratave dhe i pritjeve të shoqërisë.

Ai përbën një dëshmi të qartë të përkushtimit tonë ndaj qytetarëve, duke u ngritur mbi sfidat dhe që përcakton një rrugë të qëndrueshme përpara. Ky buxhet nuk është thjesht një dokument financiar. Ai është dëshmi e angazhimit tonë ndaj mirëqenies së çdo komuniteti që shikon nga ne për mbështetje dhe solidaritet.

Veçanërisht ajo ku do të ndalem unë sot, te mbështetja ndaj komunitetit shqiptar në Luginën e Preshevës. Lugina e Preshevës është simbol i qëndrueshmërisë dhe i shpresës së komunitetit shqiptar në Serbi që i është nënshtruar diskriminimit të skajshëm.

Buxheti i vitit 2024 pasqyron angazhimin tonë të palëkundur ndaj kësaj çështjeje. Ne kemi ndarë 3 milionë euro për Luginën e Preshevës, një rritje kjo e konsiderueshme prej 50% nga viti i kaluar. Uroj që kjo rritje dhe kjo mbështetje të jetë e përhershme. Kjo nuk është thjesht një dedikim i pashkëputur, është një mesazh se ata nuk janë harruar. Se përpjekjet e tyre janë angazhimi ynë dhe prosperiteti i tyre qëllimi ynë i përbashkët.

Siç edhe e dimë, mbështetja jonë kundruall Luginës së Preshevës nuk është e re. Për herë të parë që prej pavarësisë së Republikës sonë, Presheva, Medvegja dhe Bujanoci kanë një linjë të veçantë dhe të rregullt buxhetore në buxhetin vjetor të Kosovës.

Deri më tash gjatë qeverisjes së Lëvizjes Vetëvendosje janë ndarë mbi 2 milionë euro mbështetje financiare për Luginën e Preshevës, pa llogaritur prej gjysmë milioni euro në përballjen e tri komunave me shumicë shqiptare me pandeminë COVID-19 gjatë qeverisë sonë të parë në vitin 2020.

E kur vërshimet e vitit 2021 goditën Komunën e Preshevës, ndamë 100 mijë euro mbështetje për tejkalimin dhe sanimin e dëmeve. Këto përpjekje tregojnë përkushtimin tonë, jo vetëm për lehtësimin e menjëhershëm, por edhe për fuqizimin afatgjatë.

Gjithashtu, nëpërmjet bashkëpunimit tonë me Këshillin Kombëtar Shqiptar, ne po e ushqejmë gjuhën, artin, kulturën dhe identitetin shqiptar në Luginën e Preshevës. Mbështetja jonë për 75 projekte dhe nisa të ndryshme, nënvizon angazhimin tonë për ruajtjen e trashëgimisë së pasur shqiptare atje.

Gjatë kësaj kohe, çështja e shqiptarëve në Serbi, diskriminimi shtetëror, shkelja e drejtave të pakicave kombëtare dhe pasivizimi i adresave, për herë të parë u ngritën si temë diskutimi në Senatin Amerikan.

Seancës dëgjimore në Senat të muajit maj i parapriu vizita e delegacioni të përfaqësuesve shqiptarë të Luginës, në kryeqytetin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe takimet m senatorë në mars, vizitë kjo që u mbështet me fonde të ndara nga Qeveria jonë në muajin shkurt. Financiarisht e mbështetëm edhe fushatën avokuese të përfaqësuesve shqiptarë në Parlamentin Evropian në qershor të këtij viti.

Më duhet të theksoj se shqiptarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit tani kanë një Qeveri që kujdese për ta, pikërisht atëherë kur shteti serb i injoron e i diskriminon qëllimshëm. Një Qeveri që synon përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Serbi, në kohën kur shteti serb synon një Serbi pa shqiptarë.

Për ta pambyllur, buxheti për vitin 2024 është një plan për shpresë dhe për përparim. Është një rikonfirmim i premtimit tonë për të qëndruar me komunitetin shqiptar në Luginën e Preshevës. Ne do të vazhdojmë të punojmë pa u lodhur për të garantuar sigurinë, mirëqenien dhe lidhjen e tyre të qëndrueshme me Kosovën. Ndërsa ecim përpara, le ta bëjmë këtë me bindjen se mbështetja jonë mund të bëjë një ndryshim të madh në jetën e vëllezërve dhe të motrave tona në Luginën e Preshevës.

Ata mbështeten në ne, dhe ne premtojmë se nuk do t'i zhgënjejmë. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,
Ky nuk është buxhet i qytetarëve të Kosovës, ky është buxhet i qeveritarëve që e rrit luksin për qeveritarët dhe i varfëron qytetarët.

Me një shikim të shkurtër të këtij buxheti e sheh që mbi 2 milionë euro janë ndarë për blerje të veturave për agjencionet qeveritare dhe për institucione të tjera. Nuk po flas për blerje të ambulancave, por për xhipa të zinj, të cilët dikur Vetëvendosje i kritikonte sa ishte në opozitë.

Zero buxhet për protezat e invalidëve të luftës, ndërkaq luksin këndej për vete goxha të mirë. Ky është viti i katërt që invalidët e luftës nuk mbështeten nga Qeveria e Kosovës, nuk kanë mjete as për riparim të protezave, e as për ndërrimin e protezave.

110 euro me këtë buxhet është vlera e koeficientit për paga, që është në shpërputhje me Ligjin e pagës minimale. Koeficient më i ulët, më i vogël është 2 sipas Ligjit të pagave, herë 110 euro e planifikuar me këtë buxhet, i bie që paga minimale në sektorin publik të jetë 220 dhe jo 264 euro siç do të duhej të ishte me Ligjin e pagave.

Kur kjo ndodh në institucionet publike dhe ky propozim na vije nga Ministria e Financave dhe nga vetë Qeveria që me Ligjin e buxhetit të shkelet Ligji i pagës minimale, këtu krejt mund të themi se janë, veç barazi edhe drejtësi, jo. Që ishte dikur një premtimeve kryesore elektorale.

Programi i Qeverisë që është në webfaqe dhe ky buxhet i propozuar kanë një shpërputhje të madhe. Pyetja ime kryesore për kryeministrin që sot mungon ta mbrojë buxhetin që e ka propozuar, edhe për Kabinetin e tij që mungojnë më shumë se gjysma e Kabinetit, ta mbrojnë atë projektligj që e kanë sjellë në Kuvend: a keni lexuar programin tuaj para se ta propozoni këtë projektbuxhet?

Si mund ta propozoni një projektbuxhet, kur prioritetet tuaja në programin qeverisës nuk i keni adresuar me buxhetin e fundit që ju e prezantoni para Kuvendit dhe para qytetarëve, sepse ky është buxheti i katërt që ju e propozoni, dhe rrjedhimisht është buxheti i fundi i qeverisjes tuaj.

Kur Qeveria heq dorë nga programi i saj dhe nuk reflekton atë në buxhetin e fundit të qeverisjes, pse duhet qytetarët apo deputetët t'ua mbështesin një buxhet të tillë kur ju vetë keni heq dorë nga programi dhe premtimet tuaja? Braktisja e Qeverisë nga programi i saj, është premtimi i fundit që Lëvizja Vetëvendosje heqë dorë.

Anëtari më i thjeshtë i Lëvizjes Vetëvendosjes sot mund ta parashtrojë një pyetje: Pse ai të qëndrojë më në Lëvizjen Vetëvendosje.

Demarkacioni u harruar, Zajednica u pranua. Asnjë cent për Komisionin Shtetëror për Demarkacionin tash e 4 buxhete nuk e propozoni. Ndërkaq, këndej 113 milionë euro subvencion për energjinë e serbëve në veri.

Atë të famshmin që dilte e fliste për demarkacionin, tash e keni rehatuar kryetar komune, por kauzën e demarkacionit dhe të Asociacionit e keni harruar.

Lufta kundër korrupsionit dhe nepotizmit, një prej premtimeve kyçe, dhe të Qeverisë me duar të pastra, është konvertuar në një mbrojtje të hajnave dhe të të korruptuarve nga Qeveria Kurti.

Shikojini këta pas meje që janë, sa prej tyre janë me aktakuza, sa prej tyre kanë kallëzime penale, sa janë të akuzuar për hajni, e sa prej tyre për mos deklarim të pasurisë. Pra, nga premtimi "hajnat në burg" ka kaluar në "t'i mbrojmë hajnat". Hajnat e rezervave shtetërore, hajnat e energjisë kësaj radhe mbrohen edhe me Ligjin e buxhetit, me nenin 13, ku përpiqet të justifikohet hajnia e Ridvan Muharremit me rezervat shtetërore.

Qysh rezulton që në vendqëndrimin kyç të Kurtit, pikën kryesore të qëndrimit, edhe rryma te "bukë e zemër" të vidhet. Jo, këto hajnitë me subvencione të energjisë, ku disa prej atyre parave të subvencionimit të energjisë kanë përfunduar në blerje të gjërave ushqimore, por edhe futja e duarve deri te rezervat shtetërore, hajnia me vaj, hajnia me grurë, edhe hajni të tjerat të cilat janë të dokumentuara dhe prandaj bllokohet komisioni hetimor nga mazhoranca që të mos argumentohet ose prezantohet hajnia e rezervave shtetërore.

T'i kthehemi pak programit qeverisës në disa prej pikave kyçe për të cilat unë mendoj që është me rëndësi të diskutohen.

Te programi për shëndetësi që ishte premtuar investime, reformë në shëndetësi, ishte premtuar Strategjia për shëndetësi dhe mbledhja e premiumeve brenda këtij afati qeverisës së kësaj Qeverie.

Ligji për shëndetësi, Ligji për sigurime shëndetësore, asnjë prej këtyre nuk janë realizuar deri në këtë buxhet dhe as nuk janë të planifikuara me këtë buxhet. Mburrja më e madhe e Qeverisë për shëndetësi në vitin e kaluar, ishte ndarja e 60 milionë eurove për barna. Dhe, të gjithë e kishin mirëpritur që po ndahen 60 milionë euro për barna.

Pa më tregoni ju mua, si është e mundshme të ndahen 60 milionë euro për barna e të vazhdohet të kemi mungesë të barnave? Të kemi edhe mungesë të gjërave elementare edhe të gjilpërave edhe të shiringave. Atëherë, kemi të bëjmë me atë që e thotë Raporti i Progresit që ka keqmenaxhim dhe ka keqpërdorim dhe korrupsion në sektorin e shëndetësisë.

Jo rastësisht i kemi të identifikuara sipas Raportit të Progresit që 33% e vdekjeve janë të padiagnostikuara ose me diagnozë të gabuar. Sepse, kemi të bëjmë me lista të gjata të pritjes edhe për procedura diagnostikuese, andaj kemi një situatë të tillë, ku na prezantohet që pacientët vdesin edhe pa u ditur arsyen se pse po vdesin. Dhe, kjo nuk është pak, çdo e treta vdekje nuk dihet arsyeja e vdekjes sipas Raportit të Progresit. Dhe, këtë e kemi ngritur si shqetësim.

Asnjë propozim me këtë projektbuxhet se si të reduktohen listat e pritjes. Si të mbështetën profesionistët shëndetësorë, qoftë për edukim të vazhdueshëm, qoftë për hulumtime shkencore.

Te sektori i sportit. Unë nuk dua t'ju marrë më shumë kohë për sektorin e shëndetësisë, sepse kur vetë Qeveria ka hequr dorë nga programi i saj për shëndetësi, atëherë nuk kemi çka diskutojmë më tutje.

Tek arsimi edhe te sporti huqje totale. Ulje e buxhetit për sektorin publik. Pra, i shkurtohet buxheti universitetit publik dhe kemi më shumë se 16 programe që ka humbur universiteti publik për shkak të mos akreditimit, dhe kjo rezulton edhe më dëshpërim të studentëve të cilët nuk kanë mundësi që në sektorin privat t'i ndjekin këto studime.

Te sporti gjendja reale edhe faktike që na e dëshmon qasjen e Qeverisë tek investimet në sport, është ndeshja e fundit e Kosovës me Izraelin edhe gjendja e fushës së stadiumit "Fadil Vokrri" veç baltë. Pas tri viteve të Qeverisë Kurti, mund të themi që stadiumet e futbollit po kthehen në gjendje edhe më keq se ndoshta ishin dikur edhe para luftës.

Një gjendje të tillë që krejt imazhin e sportit e degradon në atë nivel që fusha kyçe e ndeshjes ndërkombëtare të jetë vetëm baltë, ka ndodhur me këtë Qeveri, sepse ka hequr dorë nga investimet në stadiumin nacional, i ka bllokuar investimet në stadiumin "Adem Jashari", dhe

paramendojeni, investimet në stadiumin e Gjakovës, Pejës dhe të Ferizajt i ka planifikuar për vitin 2026. Pra, deri në 2026-ën me këtë Qeveri kështu e keni...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Bahrim Shabani.)

KRYESUESI: Regjia, ia vazhdoni fjalimin edhe një minutë.

BEKIM HAXHIU: Pra, me këtë Qeveri, gjendja është kjo: baltë, lloç, zhgënjim, dëshpërim dhe varfëri. Kjo është motoja e kësaj qeverie dhe kështu është ky buxhet i planifikuar i kësaj qeverie.

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Replikë, ministri Vitia.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, zoti Haxhiu!
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë,
Tash po flasim për temat që unë besoj se zoti Haxhiu është shumë i njohur edhe i di shumë mirë për shkak se ka qenë një kohë të gjatë edhe deputet, por edhe një kohë të gjatë punëtor në QKUK.

Tash, të flasësh për lista të pritjes sot ku një prej arsyeve kryesore të listave të pritjes është mungesa e anesteziologëve, unë mendoj që është një riciklim i disa temave, të cilat zoti Haxhiu, për besë, nëse keni qenë kaq vizionar dhe po jeni kaq vizionar sot këtu, është dashur t'i flasësh para 5-6 vjetëve, zoti Haxhiu. Ku keni qenë zoti Haxhiu para 5-6 vjetëve, ku asnjë nga deputetët e partisë tuaj, e më keq edhe nga qeveritarët në atë kohë nuk keni menduar që do të vijë një kohë ku specialistët e anesteziologjisë do të dalin në pension dhe do të mbesim në këtë derexhe. Jo, jo, merri shikoji vlerat, tregojnë shumë mirë, nuk është e vërtetë, zoti Tahiri, që kanë shkuar jashtë, merri shikoji të gjitha statistikat, të mos flasim këtu paushall, qysh janë bërë paushall më herët punët, për besë, tash punët po bëhen me analizë dhe ashtu do të bëhen. Sa i përket infrastrukturës e investimeve, zoti Haxhiu, merre shikoje edhe një herë buxhetin janë komplet në korrelacion me premtimet që i kemi dhënë.

Ndreqje e infrastrukturës, rregullimi i infrastrukturës, rregullimi i kushteve të punës, investime në “high tech medical equipment” që të mund të bëhen shumica e operacioneve që tash bëhen jashtë vendit, të bëhen këtu. Të gjitha janë duke ndodhur, por për mungesën e resurseve njerëzore, për besë, pavarësisht që s'dua të flas çka ka ndodh në të kaluarën, ky është problem që i përket vetëm të kaluarës.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: I nderuar ministër,
S'e di sa ke arritur ta përcjellësh Kuvendin kur s'ke qenë edhe deputet, por ndoshta ke qenë me angazhime të tjera besoj që për t' ju kursyer nuk po ju përmend, por kam qenë një prej atyre që kam qenë avokues edhe i përmirësimit të gjendjes në shëndetësi edhe kritikues i madh, pavarësisht se kam qenë edhe deputet i mazhorancës. Një prej kritikëve më të mëdhenj për gjendjen në shëndetësi dhe nuk është e vërtetë që listat e pritjes janë pasojë e anesteziologëve, por edhe nëse është pasojë e anesteziologëve, po jua rikujtoj: me qeverisjen tuaj nga sektori publik në sektorin privat, jo të pensionuar, por nga sektori publik në sektorin privat kanë ikur 22 anesteziologë për shkak të keqmenaxhimit të njerëzve që i keni dërguar nëpër Bordin e SHSKUK-së.

22 anesteziologë e kanë lëshuar publikun, kanë shkuar për të punuar në privat për kushte më të mira sepse jeni vonuar për t' ua përmirësuar kushtet e punës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojani edhe pak kohën deputetit!

BEKIM HAXHIU: Listat e pritjes kanë qenë duke u reduktuar, jo që s'ka pasur, por për herë të parë vijnë në shifra alarmante, në ortopedi në katër vjet, edhe aty ku ka qenë zero, në kardiologji, e keni bërë një vit, edhe aty ku ka qenë zero, në radiologji, e keni bërë 1 vit, dhe janë rritur listat e pritjes me juve. Dhe, unë nuk pashë që ka planifikim për t'i reduktuar këto lista të pritjes, nuk dua t'jua bëj kritikun. Unë dua ta përmirësohet gjendja në shëndetësi që ajo të jetë më mirë për qytetarët, ama Raporti i Progresit, i nderuar ministër, ju ka nxjerrë shumë keq, thotë janë rritur investimet, por shpenzimet janë historike për shkak të keqmenaxhimit, keqpërdorimit.

A më tregon si është e mundur t'i kesh 60 milionë euro për barna dhe të ketë mungesë të barnave. Ose pse të shpenzohen vetëm 25% e atij buxheti? Pse s'janë shpenzuar të gjitha? Edhe këtu kemi të bëjmë vetëm me një çështje, e cila është e ditur, korrupsioni.

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Tash, radha është e Grupit Parlamentar të LDK-së. Fjalën e ka kërkuar deputeti Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Në rrethana normale ky është projektbuxheti i vitit të fundit, që i bie edhe viti i fundit i mandatit të një qeverie dhe natyrshëm i bie që do të duhej të ishte viti i kurorëzimit të punëve, të cilat i keni premtuar, e që i bie ose do t' ju shihnim duke prerë shirita ose do t' ju shihnim duke i promovuar punët e mira që i keni bërë. Por, fatkeqësisht unë po i shoh, e tha edhe parafolësi,

këtu ka një shkarje logjike mes programit qeverisës, buxhetimit dhe në fund materializimit ose zbatimit të atij buxheti.

Pse e them këtë? Sepse Lëvizja Vetëvendosje ka ardhur në pushtet pothuajse me dy postulate kryesore “drejtësi” dhe “punësim”. Kryeministri sot këto dyja gati nuk i përmendi fare, ose sikur u dorëzua që për këto dy çështje s’kemi mundur të punojmë shumë, atëherë filloi kështu tha: “Fokusi ynë është te mbrojtja, arsimi dhe shëndetësia”. Pyetja ime është: po çka ndodhi me drejtësinë që ju e promovuat aq shumë? Po çka ndodhi me punësimin? A e keni shndërruar Qeverinë e Kosovës në administrator improvizues dhe jo si qeveri e shtetit që buxhetin e shtetit e zbaton?! Tash, kryeministri kur e mori fjalën pjesa e parë e prezantimit të buxhetit filloi tha “kaq armë kemi me i ble, mbrojtja është prioriteti kryesor”.

T’ju them të drejtën edhe fillova të mendoj kështu, thashë, “këta njerëz që po ikin prek Kosove a janë duke ikur pse s’kemi ushtarë më shumë, pse s’kemi policë më shumë”. Jo, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar njerëz të Qeverisë. Njerëzit po ikin prej Kosovës sepse nuk po shohin perspektivë dhe ky kryeministër sot nuk foli fare për perspektivën ekonomike të tyre, mirëqenien e tyre. Përkundrazi, foli për “mbrojtjen, arsimin dhe shëndetësinë”. Të tria për këto unë kam vërejtjet e mia për të cilat nuk pajtohem me asnjërën për politikat që i ka zgjedhur.

Unë mendoj që është koha që jo veç me buxhetin e vitit 2024, por edhe me buxhetet e tjera ta trajtojmë problemin e ikjes së popullsisë si një çështje të emergjencës kombëtare. Ne duhet të shpallim gjendje të emergjencës kombëtare për ikjen e njerëzve, sepse edhe sot ikjet janë masive, lëre më pas 1 janarit. Tani, t’i kthehem vetëm çështjeve qysh i ka rendit kryeministri në programin e Qeverisë në mbledhjen kur e ka miratuar Qeveria dhe më pas do të jap shpjegimin sa ka reflektuar në buxhetin aktual.

Çështja e parë që kryeministri në atë kohë u pati drejtuar popullit thotë kështu: “Do të ndërmarrim veting në drejtësi e prokurori dhe pozitat e larta në polici dhe inteligjencë”. As nuk figuron asnjë cent i vetëm në buxhetin e vitit 2024 për vetingun. Jo që s’ka filluar ky proces, as në plan nuk e keni këtë, a zgjedhjet i keni fituar me veting. Nuk keni lënë vend pa i thënë këto gjëra, madje njerëzit po nuk ju kuptonin çka është bre ky veting që Vetëvendosja do ta bëjë, ju thoshit nuk na mjafton veç me prokurorë e gjyqësor, edhe policë e inteligjencë. Ju asnjë cent nuk e keni paraparë fare, fare, as nuk e keni në projeksion. Mashtrim ordiner, gënjeshtër ordinere.

Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë. Po na patët lodh bre këtu, asnjë cent nuk figuron në linjë buxhetore për Byronë Shtetërore! A nuk po doni ta funksionalizoni as vitin e ardhshëm? Gjykata Kushtetuese e ka punën e vet, e merr vendimin çfarëdo që do ta marrë për atë çështje, ama ju, projeksionet e juaja, politike dhe ideologjike, ju duhet t’i parashihni me para këtu. Nëse jo, po them edhe një herë po shndërroheni në komercialistë të këqij që s’dini të menaxhoni më falni në shprehje që përpara thoshim “ni dugojë, diku një zadrugë” diku me një fshat, lëre më

shtetin. Çështja tjetër thotë "nuk do të ketë asnjë qytetar në varfëri ekstreme", po UNDP-ja thotë rritje 10% të varfërisë ekstreme. Çështja tjetër "do të rishikojmë skemat e asistencës dhe do të reformojmë sistemin pensional", as s'po flitet për të, as s'po rriten pensionet, as kurrgjë hiç. Do t'i ndërtojmë thotë 160 çerdhe, e për ironi ato kanë filluar veç 4-5 nejse, po çka e pashë unë në projekt buxhetin, në Prizren ishte paraparë ndërtimi i një çerdheje, po a di kur? Në 2025-ën dhe 2026-ën ishin ndarë paratë, domethënë për qeverinë tjetër që vjen, jo për këtë.

Domethënë, kjo është tallje publike që po i bëni jo këtij Kuvendi, por këtij populli dhe këtyre fëmijëve dhe këtyre nënave dhe prindërve që po mendojnë e po planifikojnë që të ndërtojnë jetë këtu. Do të mundësojmë banim të përballueshëm social për 4 mijë familje, skema 120 e 120, 150 e 150. "Përralla në shkallë, dukati në ballë", thoshte populli. Kurrkund hiç, nuk ka kurrkund s'është projeksioni me të cilin ju i keni fituar zgjedhjet. SISH-i, sigurimet shëndetësore, fjalë, fjalë, ministër, dhe beso, jo që s'po më bind, por as nuk janë në horizont për të ndodhur ato, se s'keni vullnetin minimal për ta bërë atë.

T'i përmend edhe disa çështje tjera që janë më të rëndësishme, sepse të gjitha këto nuk janë realizuar. Shiko çka thoni, jo aplikimi në Kartën e Adriatikut, por anëtarësimin, thoshin sa jemi në pushtet ne. Ndërkohë sot s'ka ndodhur as aplikimi. Do të ofrohemi dhe do të bashkëpunojmë ngushtë me Shqipërinë, kurrë Kosova dhe Shqipëria punët më keq s'i kanë pasur, edhe ato marrëveshje që ne i kemi nënshkruar me të nuk po i zbatojmë, as s'kemi interesin minimal për t'i zbatuar ato. Madje, edhe për ato që jemi marrë vesh t' i ndajmë nga 1 milion euro ne dhe Shqipëria për studimin e fizibilitetit për hekurudhë, nuk po ndodhin, përkundër që i kemi pasur paratë e gatshme prej SHBA-së për ta bërë atë, nuk keni dashur. E ironia më e madhe është kur keni thënë "transparencë radikale në qeverisje". Kjo qeveri, të nderuar kolegë deputetë, është qeveria më jotransparente në krejt proceset, si: në dialog, në shpenzimin e parasë publike, në kontratat njëburimore, si në çdo gjë tjetër. Ama keni thënë "transparencë radikale", sa nocioni i mirë.

Nga ana tjetër, mendimi im dhe vlerësimi im është që qeveritë e majta, si ju punët më së miri do të duhej t'i kishin me sindikata. A ju, në fakt, të nderuar kolegë deputetë dhe ju qeveri, ju u keni shpallur luftë sindikatave, ju s'komunikoni fare me sindikata. Madje, për të shkuar edhe në mënyrë edhe më abuzive. I keni pezulluar, i suspendoni sindikalistët kur ata realizojnë të drejtën e tyre sindikale, veprim i tyre sindikal, as në vendet diktatoriale këto s'ndodhin, tek ne fatkeqësisht ndodhin.

Por, normalisht ne s'mund të themi që kjo qeveri mund të ketë sens të organizimit shtetëror, mund të ketë sens të organizimit edhe financiare, sepse sot të nderuar kolegë deputetë, është dita e 141 që ne kemi sanksione. Ne kemi sanksione, e që vlera e atyre sanksioneve sipas ekspertëve të ekonomisë janë 500 milionë euro. 500 milionë euro nga sanksionet që na vijnë nga BE-ja dhe, nga ana tjetër, që është ironi po ashtu e llojit të vet, është marrëveshjet ndërkombëtare që i kemi

kaluar këtu, që kapin shifrën 177 milionë euro, asnjë cent kjo qeveri nuk e ka tërhequr akoma. Kemi hyrë në kredi, kemi bërë marrëveshje të kredisë, por paratë s'po fillojmë t'i marrim hala, pse? S'po dimë t'i marrim, s'kemi kapacitete për t'i marrë. E kjo është e papranueshme dhe e pakuptimtë.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, unë krejt në fund atë çka po e shoh, nuk do të flas me shifra po do të flas me vlerësimin tim politik, me këtë ligj po ri normohet edhe një herë mashtrimi i madh elektoral që ka ndodhur, po rinormohet edhe një herë padituria e qeverisjes, po rinormohet edhe një herë vazhdimi i gjendjes së rëndë socio-ekonomike të popullit të Kosovës. Veç një pyetje e kisha për kryeministrin, por ai nuk është këtu kisha thënë kështu: po për Zajednicën a ke ndarë para? Edhe sa do të jetë kostoja e Zajednicës financiarisht, jo politikisht? Se për politikisht e dimë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Replikë në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, deputeti Adnan Rrustemi e ka fjalën.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Më në fund deputeti Driton Selmanaj duket që ka lexuar diçka të dobishme, e paska lexuar programin e Vetëvendosjes. Sido që të jetë, më lejoni pak të kthehem në disa aspekte që ndërlidhen natyrisht me sistemin e drejtësisë dhe në përpjekjen e pashpresë të zotit Selmanaj për të paraqitur projektbuxhetin. Është e dukshme edhe në buxhetin, të cilin po e trajtojmë sot përkushtimi i kësaj qeverie për të përmbushur zotimin dhe dedikimin e saj në luftën kundër korrupsionit. Siç shihet edhe nga projektbuxheti, është përkrahur Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me rritje mbi 70% të buxhetit vjetor, gjithmonë në funksion të luftës kundër korrupsionit.

E njëjta gjë ka ndodhur pothuajse me secilin institucion të drejtësisë duke u rritur buxheti natyrisht për t'u dhënë mbështetje financiare dhe të resurseve në angazhimin për të luftuar korrupsionin. Angazhimin për të luftuar korrupsionin është i padiskutueshëm dhe i palëkundur. Natyrisht më lejoni të them tri gjëra, kur bëhet fjalë për luftën kundër korrupsionit janë tre elemente të rëndësishme: e para, vullneti politik. E dyta, buxheti dhe resurset dhe e treta integriteti dhe efikasiteti i sistemit. Dy të parat po përmbushen në vazhdimësi gjatë këtyre dy vjetëve e gjysmë, vullneti politik ekziston, ekziston një qeveri e përkushtuar në luftën kundër korrupsionit dhe e pakorruptuar, mbështetja financiare dhe e resurseve po u ofrohet, por është çështje tjetër dhe pikëpyetje pse sistemi nuk po e përdorë këtë mbështetje të Qeverisë dhe të mazhorancës për të përmbushur mandatin dhe misionin që ka.

Në një sistem normal, sistemi i drejtësisë që e ka mandat luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit do ta mirëpriste një qeveri me vullnet politik kundër korrupsionit dhe me këtë mbështetje buxhetore dhe resurseve. Por, nuk po e shfrytëzon, sepse mbetjet nga ai ish-sistemet,

nga ish-pushtetet po përdoren si barriera për ta luftuar korrupsionin. Natyrisht shihet edhe në projektbuxhet se ka mbështetje të drejtpërdrejtë për institucionet e tjera, të cilat janë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, zgjatjani kohën!

ADNAN RRUSTEMI: Për herë të parë natyrisht është buxhetuar Instituti për dokumentimin e krimeve të luftës në Kosovë pas miratimit të ligjit nga ky Kuvend. Ndërkohë, që sa i përket byrosë, të mos harrojmë, po mos ta dërgonte PDK-ja ligjin në Gjykatën Kushtetuese, tashmë Byroja do të themelohej, do të ndërtohej stafi dhe do të miratohej edhe buxheti për vitin e ardhshëm. Nëse ka dikush një përgjegjësi pse nuk po konfiskohet pasuria e pajustifikueshme, është pikërisht Grupi Parlamentar i PDK-së që e ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese dhe që po e mban peng për më shumë se një vit një reformë të rëndësishme.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, deputeti Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!
Në fakt, ia dhe replikën kot, sepse nuk ia përmenda emrin asnjëherë dhe është në kundërshtim me Rregulloren kjo, nuk e përmenda Adnanin se ia di emrin shumë mirë, e kam madje edhe koleg në komision.

Për dallim prej zotit Adnan që fyen, unë nuk e kam në plan të fyej, por të ofroj argumente. Gjykata Kushtetuese e trajton Byronë, por kurrkush nuk e ndal këtë qeveri të planifikojë financat për të. Gjykata Kushtetuese ka për të dhënë vlerësim edhe për amendamentet për vetingun, por Qeveria është e detyruar t’i reflektojë ato në buxhetin e vitit të ardhshëm, por çka nxjerr kjo.

Këta as nuk kanë qëllim për veting, as për Byro, por këtë e kanë pasur vetëm për t’i mashtruar njerëzit për të marrë votë, sepse po ta kishin qëllim këtë, në vitin e parë kishte filluar realizimi sot e kishim kryer edhe vetingun. Prandaj, unë po them çka kemi bërë me këtë buxhet? Është rinormuar mashtrimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Më falni, deputet, por ka qenë replikë mendoj që, jo. Deputet, do ta keni rastin, e merrni fjalën më vonë, tash e ka fjalën deputetja Time Kadrijaj.

Regjia ia jepni fjalën për replikë.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!
Vitin e parë të qeverisjes juaj qytetarët edhe kanë mundur t'i besojnë konfiskimit, po tash më në këto tre vjet, njerëzit të cilët keni vjedhur bashkë me Ridvan Muharremin, qe ku e keni një ministre, e cila i ka vjedhur rezervat shtetërore, i keni vjedhur mbi 100 milionë euro përmes energjisë elektrike me Martin Berishaj.

Pra, abuzime e abuzime në secilën ministri tashmë keni të jashtëzakonshme. E keni shkurtuar buxhetin për drejtësi, asnjë vend të ri Këshillit Gjyqësor s'ia keni lënë, ia keni shkurtuar buxhetin Prokurorisë së Shtetit. Prandaj, ju jeni duke i gjymtuar institucionet e drejtësisë. Çështja e konfiskimit prej juve është veç një përrallë, sepse jeni duke vjedhur me përmasa të jashtëzakonshme, kurrë nuk është vjedhur, nuk është keqpërdorur buxheti i Kosovës qysh është keqpërdorur këto dy vjetët e fundit në energji. Asnjëherë s'janë vjedhur rezervat shtetërore në grurë e në vaj, qysh po i vidhni ju. Po të flisni ju për konfiskim, duhet t'ju vijë marre. Ajo është marrja më e madhja e juve, kjo është një turp që ka për t'u ndjekur edhe gjatë juve.
Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj. Ministrja e ka fjalën. Ju lutem, deputetë! Ju kam dhënë edhe juve fjalën, fjala është për ministren.

MINISTRJA ROZETA HAJDARI: I nderuar deputet, duhet të të vijë turp, turp për shpifjet që ti po i bën. Gjeje një evidencë kur unë kam vjedhur diçka, gjeje evidencën e plotë kur unë diçka kam vjedhur. I pandershëm, s'po të vjen turp për popullin tonë. I pandershëm!

Ju që "brengoseni" për popullin, ju që "brengoseni" për bizneset, ju keni vendosur Ligjin për masat e përkohshme për produktet bazë në Gjykatën Kushtetuese për orizin, për vajin, për të gjitha. Ju keni vendosur Ligjin për investimet e qëndrueshme në Gjykatën Kushtetuese, ju po i ndalni investimet, ju po e ndalni të mirën e të bërit biznes këtu në Kosovë, turpi duhet t'ju mbulojë!

KRYESUESI: Fjala është për deputetin Abelard Tahiri, kundër-replikë.

ABELARD TAHIRI: Ministre, një grup parlamentar u ngrit në këmbë të të mbrojë, të mos lejohej funksionimi i komisionin hetimor, të mos zbuloheshin hajnitë që i ke bërë. Krejt, krejt ky grup parlamentar ka një angazhim jashtëzakonisht të madh që të mos themelohet komisioni hetimor, i cili ju heton juve për vjedhjen e rezervave shtetërore.

Sa i ke marrë ti, qysh i ke marrë ti, nuk e di, rezervat nuk janë. Vaji nuk ka ardhur, mielli nuk ka ardhur, sheqeri nuk ka ardhur. Prandaj, këto janë çështje që ju do të ndiqeni penalisht. Këta mund ta vonojnë edhe pak, po jo gjatë, sepse është përgjegjësi e juaja direkte. Ndërsa, kush ju ka faj more juve që nuk dini as ligje të bëni, nuk dini të shkruani, s'keni njerëz, s'keni ekspertë, po ai

është ligj mizerie çka keni bërë, po ai s'është ligj për investime të qëndrueshme. Ti je duke e përfunduar mandatin, e po flet për Ligjin për investime të qëndrueshme. Ti do të duhej ta përurosh një investim të qëndrueshëm deri sot, asnjë nuk e ke bërë. Asnjë ministre, nuk e ke bërë. Valla, mjerim, sinqerisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, deputet!
Por, ju lutem mos e keqpërdorni kohën. Fjalën për kundër-replikë deputeti Adnan Rrustemi, pastaj fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

ADNAN RRUSTEMI: Abelardi në emër të partisë së tij të vetmin ngushëllim nga hajnit e tyre po mundohet ta gjejë duke shpif dhe duke etiketuar të tjerët në funksion të barazimit. Këta nuk mund t'i ikin asnjëherë përgjegjësisë për hajnitë dhe korrupsionin që kanë bërë, por pikërisht se e ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese Ligjin për byro për verifikim dhe konfiskim të pasurisë së pajustifikueshme, mos harroni nuk e ka dërguar në mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe rendit kushtetues në Kosovë, e ka dërguar si i pandehuri potencial që i shfrytëzon të gjitha mjetet juridike për të mbrojtur interesat e tij personale dhe grupit të tij.

Domethënë, ky e ka motivin personal dhe grupor, nuk e ka me rendin kushtetues, ky po do të mos i konfiskohet pasuria e pajustifikueshme, e cila është plaçkitur nga pozita zyrtare, nga pasuria publike në Kosovë. Por, ai ligj do të hyjë në fuqi, Byroja do të themelohet, vetingu do të përmbushet, paçka se ky ka dërguar komente në Gjykatën Kushtetuese kundër procesit të vetingut, ky po përpiqet të mbrojë njerëzit e tij në sistem...

KRYESUESI: Faleminderit, deputet. Radha është te Grupi Parlamentar AAK. Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit!
Kjo mazhorancë po të dojë ta luftojë korrupsionin, kishin lejuar të formoheshin komisionet hetimore për t'u zbuluar hajnia që është bërë. Shiheni, janë deputetët e mazhorancës që nuk i përgjigjen këtij komisioni, njëjtë sikurse për Martin Berishën, që ju kujtohet shumë mirë që na keni detyruar që s'është në procedura parlamentare, na keni detyruar t'i bëjmë dy komisione. Pse? Pasi s'keni vjedhur, pse po tuteni ta bëni komisionin hetimor? Pranojeni, krejt kjo e devalvon atë dhe e demanton atë që po thoni që s'keni vjedhur. Ani kur po flet kjo ministrja që ka vjedhur e po rri urtë kishte s'kam vjedhur. Ka vjedhur edhe mirë, se është me fakte.

Sa për ligjet që janë dërguar në Kushtetuese, kjo mazhorancë duhet të jenë të lumtur, të thonë mirë që po ka vetëdije kolektive të deputetëve të opozitës, po i dërgojnë projektligjet ose ligjet të

cilat nuk janë në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe e keni parë se sa herë i jemi adresuar Gjykatës Kushtetuese, ka pasur të drejtë opozita dhe jo pozita.

Gjithë ky buxhet dhe po lavdëroheni që keni buxhet shumë, Qeveri e fjalëve të mëdha dhe punëve të vogla. Për propagandë jeni njëshi, ju po t'ia nisni e të dilni e të shkruani e të publikoni në media, edhe dështimin e bëni sukses, sepse e keni të programuar dhe kështu askush nuk ua kalon se jeni propagandues, po nuk ju vjen keq as në mediume as në studio televizive kur dilni e mashtroni me këtë propagandë.

I treti vit buxhetor dhe ende po thirreni se çka kanë bërë qeveritë e kaluara dhe ende nuk e keni asnjë projekt madhor. Na e thoni një projekt madhor që është kryer nga kjo Qeveri dhe ne po e përkrahim dhe po ju themi që e keni bërë. Për këtë më së miri e tregon Raporti i Progresit, i cili e ka vlerësuar më së miri këtë Qeveri, e cila ka thënë që është Qeveri e regresit dhe se gjithçka është në regres.

Po ne s'po dimë, po ankoheni buxhet i madh, po s'po ka para dhe kur po janë në pyetje që po protestojnë të gjitha këto kategori, edhe arsimtarët, edhe veteranët edhe Policia, edhe minatorët e Trepçës, po thoni që s'po keni para. Shih, shumë lehtë ministri i ka gjetur 113 milionë dhe a e ka paguar rrymën në veri. Nëse një Qeveri tjetër i ka paguar një milion, e keni shantazhuar, e keni sharë dhe s'keni lënë gjë pa thënë dhe tash prej një milion, 113 milionë e keni paguar ju patriotët e Vetëvendosjes e keni paguar rrymën në veri. 113 milionë.

Me Ligjin e pagave, kur të vijë fjala, fol ti syze atje. Po se e sheh dyfish, se ti i ke blerë syzet ta hijeshosh gjithçka këtu, për atë i ke syzet.

Me Ligjin e pagave e ke dëmtuar secilin sektor. Tash çka të them kur ne i takojmë këto kategori shoqërore dhe askush s'po bën lum për juve, se keni bërë diçka të mirë në asnjë sektor buxhetor.

Jeni thirrur për forcimin e subjektivitetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, ndërsa me Ligjin e pagave, ambasadorëve, konsujve, krejt ua keni ulur pagat dhe kush do të punojë në atë drejtim. Po çfarë përforcimi të subjektivitetit? Po kurrë më keq Kosova në arenën ndërkombëtare s'ka qenë. Jemi edhe me sanksione, me masa ndëshkuese. Kjo Qeveri s'ka mundur të bëjë asgjë, të përdorë edhe sulmin terrorist që Kosovën ta vendosë në një avantazh. Përkundrazi, po vazhdojmë në mënyrën e njëjtë.

Për shëndetësi, ky ministër vërtet do të mbahet mend. Tri mandate ministër dhe zero rezultate. Ministër, pacientëve nuk u interesojnë procedurat, jo kjo procedurë se nuk mundëm t'i sigurojmë barnat për sëmundje të veçantë, s'mund të sigurojmë barnat nga lista esenciale. Nuk u intereson pacientëve procedura. Pacientëve u intereson kur shkojnë në një institucion shëndetësor t'i marrin barnat. A ka barna? S'ka barna. A është lista e gjatë e pritjes për pacientët? Është lista e

gjatë. Mos u arsyetoni tash duke u thirrur dhe duke i sharë qeveritë e kaluara. Tre vjet pushtet, nuk keni të drejtë tash të thirreni në qeveritë e kaluara.

Ndërsa te ministri për autostradat, tri vjet asnjë autostradë, të gjitha i keni lënë përgjysmë ashtu siç kanë qenë prej qeverive të kaluara. Absurditeti p.sh. për rrugën Kijevë - Pejë ka qenë se e ndalën, për shkak të shpronësimeve, edhe pse ka pasur buxhet të Bashkimit Evropian të përfundojë ajo rrugë për shkak të shpronësimeve. Asnjë shpronësim s'ka qenë i bërë, ndërsa tash desha ta pyes ministrin, me çfarë lloj shpronësimi, me cilat procedura po i shpronësoni tokat që po e bëni autostradën për Tetovë se ne nuk jemi kundër. Nuk jemi kundër, jemi për bashkim të gjitha trojeve shqiptare, po së pari duhet kryer punët e shtëpisë dhe ju po i kryeni punët e shtëpisë.

Pse po i anashkaloni dhe pse i keni sanksionuar komunat, të cilat nuk udhëhiqen prej Lëvizjes Vetëvendosje? I keni penguar në projekte madhore. Unë sot do t'i përmend ministër i Financave, disa projekte që i kam edhe me shifra buxhetore për Deçanin dhe do të ishte mirë t'i përfshini, se për besë kur vjen këtu e shohin që i keni anashkaluar aq keq e as turpshëm, është marre, atëherë mos lypni përkrahje prej opozitës as për marrëveshje ndërkombëtare, po mos lypni përkrahje për asnjë send. Sepse nëse sot nëse po silleni me arrogancën e numrave, atëherë atë çka e ka në dorë opozita, do ta zbatojmë.

Rregullimi dhe ndërtimi i qendrës së qytetit të Deçanit, ndërtimi i objektit të ri të Komunës së Deçanit, kanalizimi për shtatëdhjetë për qind të fshatrave të komunës së Deçanit, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës dhe urës në fshatin Vranoc i Vogël. Ndërtimi i kompleksit memorial Dëshmorët e Dukagjinit në Gllogjan, ndërtimi i lapidarit Memoriali i Dëshmorëve në Bjeshkët e Belegut, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës për në fshatin Kleqe.

Kisha dashur ta përfundojë me veteranët. Le që nuk ju erdhi turp që nuk i përfshitë në Ligjin për pagën minimale, po këtë vit buxhetor, ju për kategoritë e luftës e keni zvogëluar buxhetin. A e dini se gjithë ata invalidë të cilët kanë proteza, nuk ua keni mundësuar të shkojnë t'i ndërrojnë ato proteza.

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Replikë, ministri Vitia.

MINISTRI ARBEN VITIA: Ministër, tash m'u drejtove mua, shëndetësia...
Faleminderit, deputete Time!
Për besë, është mirë t'i mendoni disa probleme të reja, të cilat i adresoni, sepse problemet që folët ju tash janë adresuar dhe janë zgjidhur dhe një pjesë edhe janë duke u zgjidhur. Ju thatë për barna, nuk e di sa e keni informatën, po informatën që ma keni dhënë para një muaj dy për barnat të cilave ju u adresuat, ajo është zgjedhur, është harruar.

Edhe të gjitha problemet e tjera, të cilat i adresuat, një pjesë e mirë janë zgjedhur, një pjesë e mirë janë duke u zgjedhur. Tash po më thoni mos i kritikoni qeveritë e kaluara. Dakord jam, për besë. Mirëpo ju thatë tre vjet, ekzakt tre vjet, po një anesteziologu nuk i duhen tre vjet për të specializuar, oj Time, e dini edhe ju jeni mjeke, doktoreshë jeni. Një send që nuk e keni bërë më herët. Këtu bile mund t'i them z. Haxhiu, s'qenka këtu, se edhe atëherë e ka ngritur edhe me ministrin e partisë së vet e ka ngritur këtë çështje, nuk është bërë, nuk është bërë. Tash ne nuk kemi ndonjë mekanizëm ta bëjmë anesteziologun për një vit. Nuk mundemi.

Diçka tjetër që nuk isha këtu, në raport me sigurimet shëndetësore dhe deputetin Selmani. Nuk e di a është i vetëdijshëm deputeti Selmani se sipas asaj që është folur, ne më 2015 kemi filluar primet t'i marrim. Në 2015-ën veç janë bërë sigurimet shëndetësore, sipas Qeverisë atëherë. Në 2015-ën realisht edhe vizat i patëm liberalizuar nëse nuk gaboj. Por e vërteta fatkeqësisht, edhe dorën në zemër, është se edhe nyjat sanitare sot, edhe muret e prishura të spitaleve sot, edhe mosinvestimet që janë bërë gjithë këto mosinvestime, të gjitha këto vite, fatkeqësisht është e vërtetë.

KRYESUESI: Kundër-replikë ka kërkuar deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Po, faleminderit!
Problemet të reja e të vjetra, janë probleme me të cilat po ballafaqohen qytetarët. Tash janë tre vjet, ministër. Na trego çka ke bërë për tre vjet. Është buxheti i tretë që po miratohet nga kjo Qeveri. Çfarë ke bërë për shëndetësinë? Ta shohim një sukses, një rezultat. A është e vërtetë se mungojnë barnat esenciale? A është e vërtetë se janë listat e gjata të pritjes? A është e vërtetë? Tregona, nëse e ke një rezultat, na trego a do të ketë sigurime shëndetësore, sepse qytetarët po kërkojnë. S'mund t'u themi ne prit se ato qeveritë e kaluara nuk kanë punuar sa duhet edhe ne s'po mundemi për tre vjet, se keni premtuar. Keni premtuar se e keni shkopin magjik dhe do t'i zgjidhni të gjitha problemet, po ju ka hasur sharra në gozhdë. E thashë jeni Qeveri e fjalëve të mëdha dhe e punëve të vogla dhe për këtë po më vjen keq për juve.

KRYESUESI: Deputeti Haxhiu ka replikë me ministrin.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesues!
I nderuar ministër,
Kuptoje, unë nuk kam qenë kundër asnjë ministri, nuk jam as kundër teje. Jam kundër gjendjes që është në shëndetësi dhe po vazhdon të përkeqësohet dhe që Raporti i Progresit po e thotë. Unë jua argumentova, besoj që e dini shumë mirë, 22 anesteziologë pres sektorit publik kanë kaluar në sektorin privat prej vitit 2020 dhe katër anesteziologë, ministër, që i ke në sektorin publik nuk e ushtrojnë detyrën e tyre. Ti e di, i ke çuar në bord, i ke angazhuar në detyra të tjera. Si është e mundur të ketë anesteziologë në mungesë dhe anesteziologë të angazhosh në detyra të tjera e ata të mos marrin pjesë nëpër operacione. Janë katër anesteziologë që paguhen nga buxheti i

Republikës së Kosovës në sektorin publik dhe nuk marrin pjesë në operacione dhe ju nuk ndërmerrni asgjë, as nuk i ktheni ata ta kryejnë punën e tyre kur kemi mungesë të anesteziologëve. Nuk keni bërë asgjë për t'i kthyer ata anesteziologë që kanë shkuar në sektorin privat, t'i ktheni në sektorin publik që janë në Kosovë.

Pra Ligji i pagave e jep mundësinë e pagës shtesë deri në 50 për qind për ato programe deficitare, për kuadrot deficitare për t'i kthyer ata anesteziologë që na kanë ikur prejse keni ardhur ju në Qeveri prej sektorit publik në sektorin privat. Është vonuar Ligji i pagave, prandaj kanë ikur këta anesteziologë. Pra, numri i anesteziologëve që ka qenë para se ju të vini në Qeveri dhe anesteziologëve që janë sot është reduktuar. Duhet punuar për t'i kthyer ata anesteziologë prej sektorit privat në sektorin publik, nëse kjo është arsyeja kyçe pse janë rritur listat e pritjes.

Arsyeja tjetër dhe ne e dimë shumë, e edhe ju e dini që nuk është veç kjo, ka këtu të bëjë me çështjet biznesore në sektorin privat, sepse pacientët nuk mund t'i durojnë dhimbjet, edhe prandaj detyrohen të shkojnë në sektorin privat. Ju e dini që është reduktuar edhe numri i shtretërve.

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Një minutë kundër-replikë për ministrin e Shëndetësisë.

MINISTRI ARBEN VITIA: Shkurt, z. Haxhiu,
Që po e përmendni shpeshherë, po duhet ta përmendim edhe faktin që ka shumë anesteziologë që kanë nisur të kthehen në sektorin publik nga sektori privat. E para.

E dyta, po e dini edhe ju tash. Me ironi, me cinizëm, pa cinizëm, ju e dini. E dyta, pjesa e menaxhimit e keqmenaxhimit. Është hera e parë, z. Haxhiu edhe ju e dini shumë mirë, e di që e dini, është hera e parë që menaxhmentet, menaxherët në QKUK zgjidhen pa libreza partiake. Shumë mirë e dini. Krejt kanë qenë me libreza partiake.

Znj. Time, harrova të të them, 345 milionë euro në buxhet, 60 milionë euro në barna, të gjitha këto probleme që i thatë janë duke u adresuar në këtë drejtim. Sot jemi duke folur për buxhetin, buxhet që në mënyrën më të mirë do t'i zgjidhë këto probleme.

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Tash fjalën e ka kërkuar ministri i Kulturës, z. Çeku.

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë,
Më lejoni fillimisht t'ju njoftoj që rritja e buxhetit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit është mbi 50 për qind, duke e krahasuar këtë vit me vitin e ardhshëm. Kjo rritje reflekton edhe zotimin tonë për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Të gjitha investimet kapitale për Lojërat Mesdhetare janë në këtë buxhet.

Përveç sportit, edhe infrastruktura kulturore merr prioritet të shtuar. Gjatë këtij viti jemi duke i përmbyllur disa projekte të hartimit të projekteve të renovimit dhe të restaurimit, ndërsa vitin e ardhshëm janë buxhetuar ndërhyrjet restauruese në Teatrin Kombëtar, Bibliotekën Kombëtare, Muzeun Kombëtar, Galerinë Kombëtare dhe në Agjencinë Shtetërore të Arkivave.

Një plan i veçantë për infrastrukturën e futbollit, ai pesëvjeçar, në bashkëpunim me Federatën e Futbollit dhe gjashtëmbëdhjetë komuna të Kosovës, që parasheh ndërhyrje në 25 projekte të stadiumeve të kategorive të ndryshme, si renovime, ashtu edhe të reja. Në buxhetin që po e prezantojmë sot janë edhe stadiumet në Gjilan, në Mitrovicë, në Gjakovë, Ferizaj, Pejë dhe shumë të tjerë.

Dinamika në trashëgiminë kulturore vazhdon të jetë e lartë edhe vitin e ardhshëm. Në vitin 2024 sipas buxhetit për ndërhyrje restauruese në monumente synojmë të arrijmë dhe të tejkalojmë numrin dyqind të ndërhyrjeve në monumentet e trashëgimisë kulturore prejse e kemi marrë detyrën si Qeveri. Ndërsa, prioritet i veçantë në trashëgimi kulturore vitin e ardhshëm do të jetë arkeologjia. Tashmë janë nisur procedurat e shpronësimeve në lokalitetin e Ulpianës dhe të Dresnikut, por po ashtu kemi buxhetuar edhe për menaxhimin e këtyre lokaliteteve, edhe të Novobërdës, edhe të disa kalave të tjera në gjithë vendin tonë.

Buxhet i rritur në vitin e ardhshëm edhe për mbështetje direkte për sportin dhe për kulturën, për federatat, klubet e sportistet, si dhe për organizatat dhe artistet në fushën e kulturës. Institucionet publike të kulturës do të vazhdojnë të kenë buxhet të rritur. Po i jap vetëm disa shifra. Në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026, QKK-ja dhe filmi kanë 11.5 milionë, Filarmonia e Kosovës ka 3 milionë, Teatri Kombëtar 2,1 milionë dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës 1,3 milionë.

Në buxhetin e vitit të ardhshëm do të jetë edhe Muzeu i Artit Bashkëkohor, pra një institucion i ri. Do të jetë edhe Muzeu i Luftës, që tashmë është në fazën e konceptimit, si dhe Qendra Memoriale për Fëmijët e Vrarë gjatë luftës së fundit. Ndërsa, vazhdojnë edhe dy projekte të rëndësishme, të cilat janë në fazën e projektimit, Teatri i Operës dhe i Baletit në Prishtinë dhe Kompleksi Memorial Adem Jashari në Prekaz.
Ju falënderoj për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Deputeti Haxhiu për replikë, ju lutem!

BEKIM HAXHIU: I nderuar ministër i Sportit!
Përpara se të na tregosh për të gjitha këto arritje tua të famshme në fushën e investimeve në sport e kulturë, më e pakta që do të duhej të bëje, do të duhej të ishte dorëheqja pas gjendjes katastrofë të stadiumit “Fadil Vokrri” në ndeshjen e fundit, ku Kosova është përballur me Izraelin. Gjendja plot baltë e këtij stadiumi tregon krejt punën tuaj. Pa i kërkuar një llogari tjetër, pse e keni

larguar stadiumin nacional nga investimet? Pse e keni lënë stadiumin “Adem Jashari” në gjendje si të Kandaharit. Edhe flisni për investime të tjera që i keni planifikuar për 2026-ën.

Tani, edhe pse Ballkani rrezikon që të mos zhvillojë ndeshjet më në këtë stadium dhe si klub nuk ka ku t’i zhvillojë ndeshjet. Kombëtarja mund t’i zhvillojë në Shqipëri, por klubet në Champions Ligë jo. Kjo është pasqyra e vërtetë e strategjisë suaj të investimeve, stadiumi plot baltë “Adem Jashari” pas tre vjetëve të qeverisjes suaj. Keni vazhduar t’i injoroni me qëllime politike edhe regjionale, ta largoni nga procesi i investimeve stadiumin nacional, vetëm pse ka qenë studimi i fizibilitetit në Drenas, afër aeroportit. Projektin e ke pasur të detajuar, ke mund të zhvillosh procedurat dhe pastaj krejt arsyetimet edhe për stadiumin “Adem Jashari” e ke që është bërë studimi i fizibilitetit, e ke pasur studimin e fizibilitetit për rrugën rreth stadiumit “Adem Jashari”, sepse “Adem Jashari” është shpronësuar më 1976 dhe s’ke pasur të drejtë të ndalosh investimet dhe ta lësh në atë gjendje.

KRYESUESI: Kundër-replikë, ministri Çeku.

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: Nëse duhet dikush të japë llogari për gjendjen e barit në stadiumin “Fadil Vokrri”, është pronari i stadiumit që e ka për detyrë edhe ta mirëmbajë, edhe ta menaxhojë. Pra, Komuna e Prishtinës. Ne i kemi ofruar edhe federatës mbështetje financiare për renovim. Ata ka thënë që do ta rregullojmë me komunën dhe kanë bërë marrëveshje në lidhje me stadiumin. Kaq.

Edhe sot kemi gatishmëri që ta mbështesim edhe komunën edhe federatën, por ata kanë vendosur vetë që ta bëjnë, dhe ja ky është rezultati i kësaj pune. Nuk është larguar stadiumi nacional nga investimet. Është me kontratën që e kemi për Lojërat Mesdhetare. Pra, e kemi edhe obligim ndërkombëtar, zoti Haxhiu. Do të bëhet. Ndërsa, edhe stadiumi olimpik në Mitrovicë edhe ai i Gjilanit i kanë kryer procedurat dhe shumë shpejt fillojnë punimet edhe në Mitrovicë edhe në Gjilan, dhe unë po besoj që shumë shpejtë do të kemi edhe dy stadiume...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Tash është radha e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes. Fjalën e ka kërkuar deputetja Jeta Statovci.

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Të nderuar kolegë deputetë,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar, si dhe të dashur qytetarë,
Në kuadër të këtij adresimi do të fokusohem në përgjithësi në trajtimin e buxhetit për vitin 2024, në kuadër të pikave kryesore, të cilat trajtojnë dhe mundësojnë një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik.

Kryesues, nëse mundesh ta mirëmbash pak më shumë qetësinë, në mënyrë që ta vazhdoj fjalimin!

KRYESUESI: Ju lutem pak qetësi, ta dëgjojmë deputeten!

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Faleminderit kolegë për mirëkuptimin!
Andaj, në kuadër të buxhetit fokusi është që përveçse të mbështetet ekonomia si tërësi, të kemi edhe një fokus të veçantë tek ajo që quajmë investim shoqëror apo investimi që i dedikohet aspektit human, aspektit njerëzor dhe në kuadër të aspekteve të tjera.

Kryesues, më duhet edhe një herë të kërkoj pak më shumë qetësi, në mënyrë që të koncentrohemi në fjalim.

KRYESUESI: Deputetë, ju lutem qetësi ta dëgjojmë fjalën e deputetes! Ju lus pak për qetësi!

JETA STATOVCI: Buxheti i cili është prezantuar nga ana e Qeverisë adreson qëllimet kryesore të cilat janë edhe zotim politike, mirëpo shprehur pra edhe përmes buxhetit më mbështetjen e nevojshme, në mënyrë që të fokusohem te zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik. Gjithashtu, edhe të mbështeten sektorët të cilët konsiderohen si sektorë kyç.

Pra, një pjesë e konsiderueshme e debatit u theksua në aspektin e sektorit të sigurisë si sektor prioritar. Gjithashtu, arsimi, shëndetësia dhe bujqësia si sektorë të cilët përveç që mundësojnë zhvillimin, gjithashtu krijojnë edhe pavarësim sektorial.

Buxheti përveç si manifestim i aspiratave tona dhe në kuadër të synimeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë, kjo prezantohet edhe në kuadër të ruajtjes së një stabiliteti fiskal, në këtë rast, duke e ulur borxhin publik.

Janë një varg suksesesh të cilat i ngërthen ky buxhet dhe besoj që duhet theksuar. Dhe, një prej çështjeve është që përbrenda dy vjet e gjysmë, buxhetit të Republikës së Kosovës i shtohen 1 miliard euro, duke e çuar këtë në rekord të ri, pra prej 3,3 miliardë euro buxhet për Republikën e Kosovës.

Të mos harrojmë se kjo arritje bëhet në një periudhë mjaft sensitive dhe një varg krizash. Fillimisht duke filluar nga ajo që quhej si krizë shëndetësore, e pastaj krizë e rrethanave të ndryshme ekonomike, e globale dhe gjithashtu krizë e sigurisë.

Për të shtuar rreth 1 miliard në buxhet, nëse kthehemi pak në retrospektivë, pra shohim që në të kaluarën as një dekadë e tërë apo mbi 10 vjet nuk ishin të mjaftueshme që Buxhetit të Kosovës t'i shtoheshin 1 miliard, kurse tani është bërë për 2 vjet e gjysmë.

Një prej pyetjeve mund të jetë se si shtohet Buxhetit i Republikës së Kosovës? Një prej arsyeve është aktiviteti ekonomik. E dyta, është formalizimi i ekonomisë. Mirëpo, duhet përmendur edhe faktin që kjo bëhet përderisa kemi ulje të borxhit publik. Pra, në qoftë se kemi rritje të buxhetit, kjo nuk bëhet duke e futur shtetin në borxhe, sepse borxhi publik ulet në këtë rast, mirëpo kemi një rritje të tërësishme e cila është mundësuar përmes aktivitetit ekonomik, gjithashtu edhe formalizimit të ekonomisë.

Një sukses tjetër që ia vlen të përmendet, padyshim ka të bëjë me të hyrat tatimore, dhe jotatimore, të cilat aktualisht shënojnë një vlerë rekord.

Një prej pyetjeve mund të jetë se kur ka kapërcime të tilla të të hyrave tatimore nga një trend, i cili në shikim të parë mund të duket normal? Kjo ndodh për dy arsye kryesisht: e para, ndodh kur ka aktivitet të shtuar ekonomik dhe e dyta, kur rritet besimi i qytetarëve në sistem.

Pra, në momentin kur bizneset dhe qytetarët e vlerësojnë se ajo para e dhënë si taksë nuk keqpërdoret, mirëpo kthehet në një të mirë publike, ajo e rrit edhe gatishmërinë për të kontribuuar në një sistem. Kështu që, këto të dyja si faktorë kryesorë e sjellin në një rrethanë, ku në qoftë se krahasohet viti 2021 me vitin 2024, pra të hyrat tatimore dhe jotatimore shtohen për diku 750 milionë.

Aspekt tjetër me rëndësi ka të bëjë edhe me kategorinë e pagave dhe shtesave. Në qoftë se shihet ndër vite, pra nga viti 2021 kjo kategori kishte diku rreth 668 milionë, kurse tani janë të parashikuara 805 milionë. Pra, në një krahasim përqindjesh, kjo është një rritje prej 20%. Një rritje e tillë prej 20% çka nënkupton për ekonominë? Nënkupton rritje të mirëqenies, sepse mund të jetosh në kushte më të mira, gjithashtu aktivitetet më lartë ekonomik, mirëpo gjithashtu edhe fuqi blerëse. Duke pasur të hyra më të mëdha, gjithashtu e rrit aktivitetin ekonomik përmes ndërveprimit që ke me biznese dhe kjo e stimulon një qarkullim të mëtutjeshëm.

Aspekt tjetër i cili është mjaft me rëndësi edhe që besoj që u diskua dukshëm edhe sot, ka të bëjë me investimet kapitale. Në qoftë se vetëm në vlera numerike krahasohet viti 2021, kishte buxhet 424 milionë. Në buxhetin e vitin 2024 flitet për 860 milionë, të cilat janë të dedikuara për investime kapitale.

Investimet kapitale janë të rëndësishme për aspektin e zhvillimit ekonomik, mirëpo çka i bën ende më të veçanta këto investime janë se janë investime të cilat mbesin. Pra, në realizimin e këtyre investimeve këto mbeten si shpenzim i tillë, i cili i kontribuon në përgjithësi vendit.

Por, edhe pse u kritikua në aspektin e ndarjes buxhetore, në qoftë se e shohim Buxhetin e Republikës së Kosovës, investimet kapitale dhe shpenzimet për investime kapitale janë faktikisht 1/4 e buxhetit, dhe mes viteve që i krahasuam kemi dyfishim të buxhetit të cilat i dedikohen këtij sektori.

Një aspekt tjetër, e besa shpesh e bëri këtë që të quhej edhe buxhet social, kishte të bënte me sektorin e subvencioneve dhe transfereve në të cilën kemi të dedikuar 1,1 miliard euro. Mirëpo, mendoj që ekziston një diferencë substanciale mes asaj çka quajmë asistencë sociale dhe investim social. Në këtë 1,1 miliard euro, po është e vërtetë që ka mbështetje për lehonat dhe për nënat, pra për diku rreth 380 mijë fëmijë dhe 191 mijë gra. Po, është e vërtetë që ka mbështetje për ringjallje ekonomike dhe mbështetje të bizneseve prodhuese me një pako diku rreth 70 milionë.

Po, është e vërtetë që mbështetet Agjencia e Punësimit me dikur rreth 32 milionë përmes programeve, siç u përmend çështja e super punës, e cila diku deri në 10 mijë dhe të reja pretendon që t'i punësojë, dhe përveç se aktivitetit ekonomik, ka të bëjë edhe me takimin për herë të parë me tregun e punës.

Dhe po, është e vërtetë që në kuadër të kësaj skeme ka mbështetje për bujqit, e kjo nuk është asistencë sociale, por është asistencë zhvillimore e cila e ndihmon një zhvillim të qëndrueshëm.

Në kuadër të këtyre, ne e shohim që ka edhe një ndihmë direkt karshi ndërmarrjeve publike. Ndërmarrjeve publike, ku pjesa më e konsiderueshme e buxhetit fokusohet te sektori i ujërave, dhe gjithashtu edhe aspekti tjetër, i cili konsiderohet si aspekt strategjik, e ka të bëjë me politikat e efiçiencës së energjisë në të cilën kemi diku rreth 4.5 milionë euro të cilat vazhdojnë si mbështetje, në mënyrë që përveç investimeve që bëhen në rritje të kapaciteteve gjeneruese, të rritet edhe efiçienca në mënyrë që sektori të ulë konsumin e përgjithshëm.

Këto janë disa aspekte të cilat janë adresuar përmes këtij projektligji. Një gjë e cila u ngrit sot, kishte të bënte me mos luftimin e varfërisë. Dhe, çështja që e bën interesante është që në qoftë se e shikojmë çështjen e çmimit të produkteve esenciale në të cilat ndërveprojmë ne dhe qytetarët në përgjithësi, ne e shohim që rritja ose inflacioni sa u përket produkteve esenciale bazë e ka një kontribut kryesor në çmimet të cilat përballen me këtë inflacion.

Dhe, ai kontribuues kryesor është marzha e profitit. Andaj, besoj edhe kjo ka qenë edhe iniciativa e cila përfundoi në Kushtetuese me vendosjen e tavanit për çmimet e produkteve bazë, në mënyrë që të luftohet varfëria dhe gjithashtu të kemi stabilitet sa u përket produkteve bazë.

Këto kanë qenë mekanizma të cilët janë përdorur dhe besoj që përveç rritjes në të hyra, përveç shtimit në buxhet, përveç dyfishimit të buxhetit për investime kapitale, paraqet edhe një

dimension të ri, i cili ka të bëjë me investimin në shoqëri dhe investimin e qëndrueshëm, ku ndihmohet qytetari, ndihmohet biznesi dhe në përgjithësi kthehet një atmosferë, ku ndërveprohet me një besim të ndërsjellë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Tash është radha e Grupit Parlamentar të PDK-së. Fjalën e ka kërkuar deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës që sot jeni sy e veshë para ekraneve tuaja për të parë e dëgjuar se çfarë ka planifikuar për ju Qeveria e Kosovës për vitin 2024.

Ju që me padurim prisni të dini a ka ndonjë përmirësim për jetën tuaj dhe a ka ende ndonjë fije shpresë që mirëqenia juaj do të përmirësohet dhe ky vend do të bëhet i jetueshëm për qytetarë e saj.

Të nderuar policë, ushtarë, mjekë, mësimdhënës, zjarrfikës,
Të nderuar veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Punëtorë të administratës,
Të nderuar minatorë, e ju pensionistë, nxënës e studentë, bujq e fermerë,
Të nderuar familjarë, të rinj e të reja që për tri vjet rresht u keqtrajtuat, u ofenduat dhe u poshtëruat nga Qeveria e Albin Kurtit.

Unë sot, pas 13 vjetëve në Kuvend, sinqerisht e kam të vështirë të ndaj të vërtetën nga gënjeshtrat e kësaj Qeverie e cila ngarend nga një event në tjetrin me prezantimet e tyre mega luks dhe pa asnjë rezultat për vendit.

Por, të dashur qytetarë,
Sot, ju e keni më lehtë sesa secili prej nesh që ta nxirrni të vërtetën në shesh. Mjafton që secili prej jush ta bëni një analizë të thjeshtë të xhepit tuaj dhe ta pyesni veten se si ia keni dalë për këto 3 vjet të mbijetoni, sepse për jetesë as që bëhet fjalë me çmimet që kanë shkuar në qiell e me pagat që kanë përtokë.

Secili prej jush shikojeni sot se sa është çmimi i miellit, sa është çmimi i vajit, i sheqerit, djathit, qumështit, vezës, çmimi i derivateve, i energjisë elektrike, çmimi i ngrohjes, çmimi i ujit, çmimi i barnave, çmimi i kopshteve për fëmijët tuaj. Dhe, po ashtu shikojeni edhe vlerën e pagës suaj që shpenzohet ende pa dalë në xhirollogaritë tuaja, dhe këtu e gjeni të vërtetën mbi mashtrimet që kjo Qeveri ua bëri juve, që i besuat fatin tuaj dhe fatin e fëmijëve tuaj.

Sot, të gjithë deputetët e opozitës do të flasin dhe me lehtësi do ta demaskojnë mashtrimin e kësaj Qeverie, por cili është rezultati në fund të ditës kur fuqia politike vendimmarrëse nuk

mjafton që të bëjmë ndryshim në këtë projektbuxhet, sepse 50% e këtij Kuvendi që përfaqëson 40% të qytetarëve që kanë dalë në zgjedhje dhe e kanë sjellë këtë Qeveri në pushtet, nuk qajnë kokën për vërejtjet e opozitës, e as për hallet e brengat e vështirësitë e qytetarëve.

Të dashur qytetarë,
Se sa hakmarrëse e inatçore është kjo Qeveri, mjafton ta shihni shpërndarjen e buxhetit nëpër komuna. Në katër komuna, ku qeverisja e Vetëvendosjes është në pushtet, është ndarë dukshëm më shumë ose miliona buxhet më shumë se në komunat ku qeverisin partitë e tjera.

Për ta vërtetuar këtë që po e them dhe për të qenë e qartë për qytetarët që po e përcjellin këtë seancë, unë do të përmend katër komunat ku qeveris Vetëvendosje dhe katër komuna ku qeverisin parti të tjera. Për Komunën e Kamenicës, e cila qeveriset nga Vetëvendosja, Qeveria ka ndarë 2 milionë e 100 mijë euro. Për Komunën e Shtimes, ku qeverisë "çlirimtari" i Vetëvendosjes janë ndarë buxhet 2 milionë e 333 mijë e 333 euro. Për Komunën e Gjilanit që qeverisë Vetëvendosja janë ndarë buxhet 6 milionë...

KRYESUESI: Deputetë, ju lutem për qetësi! Ta dëgjojmë deputeten.

GANIMETE MUSLIU: Për Komunën e Podujevës, që po ashtu qeveriset nga Vetëvendosja, janë ndarë buxhet 1 milion e 875 mijë euro. Pra, në të gjitha komunat e lartcekura që qeverisen nga Vetëvendosje, është ndarë buxhet milionësh. Dhe, unë personalisht nuk kam asgjë kundër dhe e përshëndes ndarjen e këtij buxheti për të cilin qytetarët kanë nevojë, mirëpo këtë ndarje buxhetore e shëmton inati e hakmarrja e Albin Kurtit ndaj qytetarëve të atyre komunave që nuk ia besuan pushtetin Vetëvendosjes, të cilat janë diskriminuar e po diskriminohen nga Albini me këtë projektbuxhet.

Në Komunën e Vushtrrisë, ku qeverisë Partia Demokratike e Kosovës janë ndarë vetëm 650 mijë euro. Në Komunën e Prizrenit, ku qeverisë Partia Demokratike e Kosovës janë ndarë vetëm 900 mijë euro. Dhe, krahasojeni numrin e popullsisë së Prizrenit me popullsinë e Shtimes apo edhe të Kamenicës.

Në Komunën e Suharekës, ku qeverisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës janë ndarë vetëm 100 mijë euro. Në Komunën e Drenasit, ku qeverisë Partia Demokratike e Kosovës janë ndarë vetëm 185 mijë euro. Në Komunën e Lipjanit, ku qeveris Lidhja Demokratike e Kosovës janë ndarë vetëm 400 mijë euro. Pra, asnjëra prej këtyre komunave nuk e prek shifrën milionëshe.

Prandaj, kjo e bën të shëmtuar e diskriminues ndarjen e buxhetit për vitin 2024. Prandaj, nga përvoja e tri vjetëve, duke e ditur se ashtu siç është hartuar me inat ky projektbuxhet, ashtu me inat edhe do të votohet.

Sot, deputetët e opozitës hezitojnë edhe të propozojnë dhe të dorëzojnë amendamente, sepse e kemi të qartë që kjo Qeveri nuk do t'i marrë parasysh, ashtu siç nuk i merr parasysh as nuk ka qenë në kohën as kur është në pyetje uji i pijes për qytetarët e Komunës së Skenderajt.

Gjatë gjithë kohës e dëgjoni këtë Qeveri mashtruese se si e ka arritur buxhetin për ministri të caktuara, por e shtrojmë pyetjen, si është menaxhuar buxheti për qytetarët? Për shembull, Albini thotë se e ka rritur buxhetin në Ministrinë e Brendshme, ama policët e Kosovës janë pa këpucë dhe po e braktisin uniformën çdo ditë. E vetmja arsye pse policët e Kosovës ende qëndrojnë në Kosovë janë kreditë që i kanë nëpër banka dhe i kanë shtëpitë e banesat e tyre nëpër hipoteka.

E ka rritur buxhetin për Ministrinë e Mbrojtjes, ama makinat e ushtrisë së Kosovës janë të pa servisuara dhe demobilizimin i ushtarëve dhe oficerëve po ndodhë sikurse kurrë më parë. Mbi 40 automjete të ushtrisë dalin në rrugë çdo ditë pa regjistrim, duke shfrytëzuar autoritetin e uniformës.

E ka rritur buxhetin në bujqësi, ama fermerët tanë janë sistemuar tashmë në Gjermani, Zvicër e gjetiu nëpër Evropë.

Unë do të ndalem shkurt te Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ta demaskuar këtë keqqeverisje. Është viti 2024, viti i katërt i kësaj Qeverie dhe i këtij ministri, qoftë i fundit, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që bën një planifikim të keq të buxhetit, dhe si rezultat i këtij planifikimi të keq ka edhe realizim të keq të përcjellë me shumë shkelje e keqpërdorime të buxhetit. Këtë e them, mbështetur në të gjeturat e auditorit.

Është shqetësuese që auditori jep opinion të kualifikuar, pra, për dijeninë e qytetarëve, auditori jep opinion të keq për këtë ministri për shkak të shkeljeve të mëdha që kanë ndodhur në këtë ministri gjatë vitit 2022.

Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është ministra përmes së cilës qytetarët përfitojnë më së shumti nga investimet kapitale, dhe ky ka dështuar në realizimin e këtij buxheti.

Për fund, sepse po e shoh se edhe koha po shkon, unë duke e ditur që amendamentet tona nuk kalojnë dhe vetëm se pse ne propozojmë diçka, mund të ndëshkohen qytetarët e Kosovës, do t'i drejtohem kryetarit të Komisionit Parlamentar për Buxhet, zoti Armend Muja që është nga Mitrovica, dhe do t'i kërkoj publikisht që gjatë dy leximeve të projektbuxhetit të propozojë një amendament për ndarjen e buxhetit për ndërtimin e objektit të ri shkollor për shkollën "Abdullah Shabani" në Mitrovicë.

Arsyeja e këtij propozimi mbështetet në dëshmi faktike, duke e pasur parasysh gjendjen në të cilën është kjo shkollë, e cila është shumë e vjetër dhe daton nga viti 1943.

Kjo shkollë ka pësuar dëmtime të rënda gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe ka probleme infrastrukturore. Mësimdhënësit në shkollë hasin në shumë vështirësi në realizimin e plan-programit për arsye objektive që kjo shkollë nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e metodologjive sipas kërkesave të arsimit të mirëfilltë.

Bodrumet e kësaj shkolle hasin në shumë vështirësi në realizimin e plan-programit për arsye objektive. Kjo shkollë nuk i plotëson kushtet për asgjë. Bodrumet e kësaj shkolle ku janë të sistemuara klasat e parafillorëve që shënon edhe hapin e parë drejt nxënies së dijes për parafilloristët, mban erë myku e lagështie. Dhe, përveç pasojave shëndetësore te fëmijët, është edhe mjaft demotivues si ambient.

Ndërtimi i kësaj shkolle është urgjencë para se të ndodhë ndonjë tragjedi. Kështu që, Armend Muja si mitrovicas që je dhe si kryetar i Komisionit për Buxhet, të thërras në ndërgjegje dhe në përgjegjësi që në vitin 2024 të ndash buxhet për shkollën "Abdullah Shabani" në Mitrovicë dhe që mitrovicasit ta ndiejnë pozitën tënde në këtë Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Tash fjalën e ka kërkuar deputetja Marigona Geci.

MARIGONA GECI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Bazuar në të dhënat e paraqitura, Projektligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 kap vlerën 3 miliardë e 28 milionë euro.

Ky buxhet mund të jetë më i madh në krahasim me vitet e kaluara, por nuk shoh të adresohet në vendet përkatëse që ka nevojë ekonomia e vendit tonë.

(*Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.*)

KRYESUESJA: Më fal, e nderuar deputete! Të nderuar deputetë, e kuptoj që jeni lodhur. Është diskutim i gjatë, por qetësi ju lutem! Ta dëgjojmë njëri-tjetrin kur flasim. E nderuar, të lutem veç një moment! Deputete Geci, veç një moment.

Është tepër zhurmë. Mendoj që është e papranueshme që në Kuvend kur debatohet ka kaq shumë zhurmë dhe është tepër e vështirë t'i dëgjojmë kolegët. Të keni pak respekt gjatë diskutimeve. Nëse doni të keni diskutime me njëri-tjetrin, ka hapësira të tjera të Kuvendit ku mund t'i

shfrytëzoni, por jo në sallë plenare me gjithë këtë zhurmë. Mund të vazhdosh. Regjia, ia kthe minutat të cilat i humbi gjatë diskutimeve.

MARIGONA GECI: Besoj që tash u qetësuat, dhe kulturë është ta dëgjosh tjetrin kur flet. Po flitet për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin e ardhshëm, për vitin 2024, ndërsa nga deputetët e mazhorancës nuk ka asnjë interesim për t'i dëgjuar nevojat dhe kërkesat e deputetëve opozitarë.

Po e përsërisë edhe njëherë. Bazuar në të dhënat e paraqitura Projektligj mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, ka vlerën 3 miliardë e 28 milionë euro. Ky buxhet mund të jetë më i madh në krahasim me vitet e kaluara, por nuk shoh të adresohen në vendet përkatëse që ka nevojë ekonomia e vendit tonë.

Ju na bëtë një rezyme të parave që janë në dispozicion dhe të shpërndarjes së tyre, por kjo shpërndarje dhe ky buxhet për vitin 2024 nuk mund të quhet buxhet zhvillimor, duke e marrë parasysh inflacionin e lartë dhe ngritjen e çmimeve të shumë produkteve.

Sipas këtij projektbuxheti 1 miliard e 62 milionë e 315 mijë e 550 euro janë ndarë për subvencione dhe transfere. Nuk po mund ta kuptoj se si mund të thuhet se ka pasur rritje të lartë ekonomike, kur buxheti për skema sociale rritet vazhdimisht dhe ka rënie të investimeve kapitale.

Zakonisht qeveritë majtiste kanë tendencë të përdorin subvencionet si një mjet për të ndikuar në ekonominë e vendit në përputhje me politikat e tyre të orientuara në mbështetje sociale.

Ju paguani social për t'i marrë votat nga kjo shtresë. Pra, ju paguani ata që nuk duan të punojnë, ndërsa fuqisë punëtore ia keni dhënë rrugën për Gjermani e vende të tjera të Evropës.

Duke e marrë parasysh inflacionin dhe ngritjen e çmimeve, buxheti i ndarë për vitin e ardhshëm nuk do të jetë buxhet zhvillimor. Ky buxhet do të jetë më tepër i natyrës sociale. Kosova ka nevojë për vende stabile të punës. Kjo arrihet duke investuar në fabrika prodhuese, të cilat përveç që e ulin përqindjen e papunësisë, sjellin edhe të ardhura, mirëpo kjo nuk arrihet duke ndarë nga 100 euro për të gjithë punëtorët e sektorit publik e privat siç e keni zakon ju.

Mund ta imagjinoni se çfarë mund të shtojmë në shportën e konsumatorit me 100 euro, duke marrë parasysh çmimet e larta. Shumica e investimeve kapitale të parapara me buxhetin për vitin 2024 janë projekte të bartura nga vitet paraprake.

Buxheti total për projekte kapitale të nivelit qendror, është 640 milionë euro, ku 90,62% janë për projekte në vazhdim nga viti 2023, kurse vetëm 9,38% janë për projekte të reja.

Pavarësisht se janë paraparë disa projekte në buxhet, ato nuk po realizohen. Në këto tri vjetët e fundit sa ju jeni në pushtet janë menaxhuar 8.63 miliardë euro, por nuk ka asnjë projekt madhor që së paku ka nisur të realizohet. Ju që keni propaganduar me vite të tëra se nëse ju vini në qeveri do të jeni ndryshe nga ata që kanë shkuar, dhe se do të përmirësoni standardin jetësor në Kosovë, jo që nuk jeni ndryshe, por vetëm se po ua vështirësoni çdo ditë e më shumë jetën qytetarëve, duke mos ndërmarrë asgjë për përmirësimin e problemeve të tyre.

Kur flasim për pagat. Rritja e koeficienti prej 5 euro, nga 105 në 110 euro nuk përbën rritje reale, derisa inflacioni në shtator të vitit 2022 ka qenë 12,7%. Rritja e koeficientit për 5 euro, është vetëm një mashtrim për qytetarët, e as për së afërmi nuk reflekton shkallën e inflacioni në vend.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 4,2% në muajin shtator 2023, krahasuar me muajin shtator të vitit 2022. Brenda kësaj periudhe sa ju jeni në Qeveri, e kam parë se ju jeni një Qeveri populliste, manipuloni me shifrat e të dhëna, por që nuk keni treguar aftësi menaxheriale as afatshkurtër as afatmesme e as afatgjatë të daljes nga ndonjë krizë e mundshme që po përballet vendi ynë.

Kam disa shqetësime në lidhje me mekanizimin e shpërndarjes së buxhetit, si dhe kërkon një angazhim më të madh buxhetor për shëndetësi dhe arsim.

Shuma e ndarë sipas projektbuxhetit për vitin 2024 për shëndetësi si përqindje e bruto produktit vendor është 3,4%. Prej të dhënave të fundit të vitit 2020, vendet e rajoni shpenzojnë një përqindje më të madhe në shëndetësi, ndërsa Ministria e Shëndetësisë për vitin 2024 ka paraparë që të ulë shpenzimet buxhetore në vlerë prej 611 mijë e 548 euro.

Edhe në arsim shuma e buxhetit të ndarë është vetëm 3.5% e bruto produktit vendor, ndërsa vendet e BE-së për vitin 2021 shpenzonin disa herë më shumë sesa Kosova, përderisa mesatarja e 27 vendeve të BE-së për shpenzimin në arsim si pjesë e BBV-së ishte 4,8%. Ndërkaq, ju Universitetit të Prishtinës ia keni ulur buxhetin për 2,93%.

Ju, Lëvizja Vetëvendosje që 3 vjet jeni në pushtet dhe nuk mund të mburreni me asnjë ndryshim të vetëm që e keni bërë për të mirën e vendit tonë. Me këto politika ekonomike çfarë ju po u servoni qytetarëve, mijëra punëtore e qytetarë do të ikin nga këtu.

Problemi tjetër te buxheti i komunave lidhet me shpërndarjen e projekteve të ministrive nëpër komuna, duke i favorizuar komunat që udhëhiqen nga Lëvizje Vetëvendosje. Dua të ndalem pak te Komuna e Vitisë, ku shumica e projekteve për vitin e ardhshëm, për vitin 2024 janë projekte të bartura nga vitet paraprake.

Vlen të theksohet se nga viti 2016 është nis të ndërtohet shkolla e re në fshatin Pozhoran, dhe që 70% e punimeve janë përfunduar deri në vitin 2021. Që nga viti 2021 nuk kanë vazhduar punimet dhe më shumë se 1 mijë nxënës mbajnë mësim me orar të shkurtër në 25 minuta orë mësimi dhe me 5 ndërrime. Për vitin 2024 në tërësi buxheti është përkeqësuar, edhe struktura e buxhetit është përkeqësuar, investimet kanë rënë në 16% të buxhetit, si shpenzim real dhe subvencionet janë rritur nga 23% në 41%. Nuk po shohim ndonjë efekt real në rritjen ekonomike në vend nga ky buxhet i paraparë për vitin e ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është Albana Bytyqi me kartelë të Shemsedin Dreshaj, apo do të dalësh në foltore? Në rregull.

ALBANA BYTYQI: Faleminderit, nënkryetare!
Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë të Kosovës,
Buxheti për projekte kapitale do të duhej të ishte i koordinuar efektivisht të ishte në përputhje me çdo objektivë strategjike, të jetë i realizueshëm pa dallim në secilën pjesë të Kosovës.

Ky buxhet do të duhej të ishte në pajtueshmëri me politikat dhe strategjitë afatgjate, mirëpo në fakt, ky buxhet i ndarë është fund e krye një dështim. Fillimisht është shqetësuese se ne si deputetë të Republikës së Kosovës e kemi pranuar vetëm buxhetin total. Pra, vetëm Kabineti qeveritar ka pasur qasje në detalet e ndarjes së këtij buxheti. Kjo në parim lë një hije aspak të dëshiruar.

E dyta, nuk mund të llogaritet që ky buxhet do të jetë buxhet zhvillimor. Do të jetë shumë më tepër një buxhet social, me një komponentë shtesë të sigurisë se sa për zhvillim ekonomik. Kjo është edhe padrejtësi për komunat e vendit tonë apo më saktë komunave që nuk udhëhiqen nga Lëvizja Vetëvendosje. Tendenca për mospërkrahje të komunave në investime kapitale, të cilat vetë nuk mund t'i arrijnë në buxhetin më të vogël që kanë, e shfaq haptazi dëshirën tuaj për hakmarrje ndaj partive opozitare.

Duke filluar nga largimi i buxheteve, projekteve madhore që lidhin qytetet nëse mendoni se do të lihen në harresë, e keni gabim. Ne do të kërkojmë përgjegjësi për premtimet tuaja me të cilat keni gënjyer qytetarët. Ministër Aliu, kur do të fillojnë punimet për autostradën Prishtinë - Mitrovicë - Dukagjin? Dhe, pse është larguar projekti i autostradës Prishtinë - Gjakovë? Ministër Çeku, kam një pyetje gjithashtu që keni ndarë buxhetin prej 100 mijë euro për stadiumin e qytetit të Suharekës, gjë që është shumë qesharake, sikur të mos mjaftojnë kërkesat që keni kërkuar lokacionin, keni kërkuar të gjitha, po të gjitha i keni gati dhe pse i keni ndarë vetëm 100 mijë euro? Apo për të qëndruar pezull këto para? Kisha dashur një përgjigje, ministër Çeku, ta kesh këtu.

Kush më shumë se fotografitë që shpërndani në rrjetet sociale për t'u shpërlarë trurin i qytetarëve të Kosovës e shfaq më shumë dështimin tuaj si qeveri. Kush më shumë se ju vetë ministër Peci po rrezikoni qëndrueshmërinë e prodhimit vendor, duke ndikuar kështu edhe në moskrijimin e vendeve të reja të punës, me mosinvestim të infrastrukturës bujqësore dhe teknologjinë e nevojshme. Investimet kapitale janë thelbësore për të rritur kapacitetin prodhues në bujqësi. Këto investime sjellin modernizimin e praktikave bujqësore, uljen e varësisë nga importet dhe rritjen e cilësisë së produkteve. Në mungesë të këtyre investimeve në vend ky sektor rrezikon të mbetet shumë prapa në konkurrencën ndërkombëtare. E në anën tjetër, me buxhetin prej 860 milionësh sektori privat do të përjetojë një thyerje pikërisht për shkak të mungesës së investimeve kapitale.

Si do t'i përgjigjeni kësaj, ministre Rizvanolli e ministër Murati? Më e rëndësishmja, e mbi të gjitha me këtë ndarje ju vetëm se po i ndihmoni shumë krimit dhe cenimit të sigurisë publike, sepse në sektorin e sigurisë buxheti që keni ndarë nuk i plotëson nevojat aspak, është qesharake dhe njëkohësisht për t'u dhimbsur sepse me këtë ndarje ju vetëm që nuk po i përfillni nevojat e njësive tona ushtarake, por ju madje po e poshtëroni krenarinë e vendit tonë. Ne i dimë dështimet tuaja si në qeverisjen lokale, ashtu edhe në atë qendrore.

Por, po ju them që komunat, të cilat udhëhiqen nga Aleanca, janë shembulli i menaxhimit dhe punës së mirë. Juve ju mungon thellësisht një strategji serioze për një zhvillim të duhur ekonomik. Prandaj, marrë parasysh punën tuaj dhe ndarjen buxhetore, ne nuk do të votojmë pro këtij buxheti, i cili është buxheti politik, elektoral dhe diskriminues.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani e ka fjalën ministri Elbert Krasniqi. Të nderuar deputetë, edhe një herë, ju lutem, pak qetësi!

MINISTRI ELBERT KRASNIQI: E nderuar kryesuese,
Të nderuar kolegë ministra,
Deputetë,
Më lejoni që në pika të përgjithshme të prezantoj se cili është buxheti, plani dhe projektet për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin 2024.

Sigurisht që granti i performansës do të jetë një ndër shtyllat prej të cilës do të përfitojnë komunat. Këtë vit do të jetë numër më i madh i komunave, të cilat do të jenë përfituese të grantit të performansës, gjithsej do të jenë në dispozicion 8 milionë euro për komunat përfituese. Ju rikujtoj që në përgjithësi për katër vjetët e mandatit tonë janë mbi 30 milionë euro nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe donatorëve të dedikuara për projektet për komunat përfituese nga granti i performansës. Këtu duhet me përmend gjithsesi që tashmë granti i performansës bazohet edhe në Ligjin për performansën komunale dhe nuk kemi të bëjmë me Rregulloren e vjetër.

Gjithashtu nga programi tjetër për financimin e projekteve komunale, ndërkomunale janë në dispozicion 2 milionë euro për financimin e iniciativave të ndryshme nga komunat, të cilat do të kenë projektet e përbashkëta ndërkomunale. E rëndësishme gjithashtu për ministrinë tonë do të jetë vazhdimi i programit IPA 3, për programet ndërkufitare me Kosovë, Mali i Zi - Kosovë, Shqipëri dhe Kosovë - Maqedoni e Veriut.

Nga ky program, i cili administrohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, do të mbështeten disa projekte shumë të rëndësishme për komunat e Republikës së Kosovës dhe sidomos për komunat, të cilat janë në kufi me komunat e tjera të Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Gjithashtu, programi "Komuna për të rinjtë' është viti i fundit i implementimit të tij 2,7 milionë euro janë të mbështetura nga Qeveria japoneze përmes Bankës Botërore. Mbështetja për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive për komunitetet në komuna do të jetë edhe në vitin 2024, nga ku 3 milionë euro do të jenë në dispozicion të qytetarëve, të cilët do të mund të përfitojnë.

Shumë e rëndësishme për komunat e Republikës së Kosovës është edhe faza e tretë e programit "e-Komuna", kjo platformë nën platformën "e-Kosova" do të jetë zgjidhje e qëndrueshme për raportimin e komunave për qasjen në shërbime të qytetarëve në komuna dhe ndërlidhja e saj me ueb sajtet e komunave. 2024 është viti kur do të fillojë edhe implementimi i planit të veprimit nacional 204-2027 për Kosovën nga programi i OGJP-së. Këto janë disa nga programet, të cilat janë në dispozicion për komunat e Republikës së Kosovës dhe për qytetarët e saj përmes programeve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Armend Muja.

ARMEND MUJA: Pata vetëm një sqarim të shkurtër në lidhje me fjalën e deputetes Musliu. Komuna e Mitrovicës këtë vit me propozimin e buxhetit do t'i ketë 3.4 milionë euro shtesë dhe buxhet të mjaftueshëm ka Komuna e Prishtinës, kështu që unë e këshilloj Bedri Hamzën që ta fillojë riparimin edhe në "Avdullah Shabani", edhe në shkollën e Zhabarit, të cilat po neglizhohen.

KRYESUESJA: Replikë, Ganimete Musliu!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetare!
Zoti Muja, edhe një herë po e shfrytëzoj këtë foltore të të thërras në përgjegjësi edhe njerëzore e morale, por mbi të gjitha nga pozita që ti mban, si mitrovicas dhe si kryetar i Komisionit për Buxhet, Komisionit Parlamentar. Të lutem, bashkë me Arjeta Fejzën amendamentojeni, bëjeni një amandament për ndërtimin, sepse ajo shkollë nuk rinovohet, sepse thashë, është e vitit 1943

dhe është djegur në luftë. Ajo shkollë përbën rrezik për jetën e qytetarëve, për jetën e nxënësve e të mësimdhënësve në atë shkollë.

Prandaj, kërkoj nga ju që të ndani buxhet për ndërtimin e objektit të ri shkollor, sepse e thashë edhe një herë, është nevojë emergjente sa s’ka ndodhur ndonjë tragjedi në atë shkollë. E keni obligim, nëse hiç për asgjë tjetër, si qytetar i atij qyteti kontribuoni për atë shkollë, për ata nxënës e mësues.

KRYESUESJA: Vazhdojmë me deputetët në radhë, tani është Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Ligji i buxhetit është një ndër ligjet më të rëndësishme që e miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Qytetarët e Republikës së Kosovës kur diskutohet për buxhetin e tyre për vitin e ardhshëm, janë me fokus të veçantë, me vëmendje që çka ofrojnë institucionet e tyre, si e menaxhojnë institucionet e tyre paranë publike apo thënë shkurt, djersën e tyre. Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar në Qeveri një projekt buxhet, i cili ka vlerën 3 miliardë e 314 milionë euro. Ky buxhet nuk siguron zhvillim ekonomik, mandej stagnon atë edhe më tepër. Është një buxhet për të blerë paqe sociale, apo të mos them më shumë, është buxhet elektoral, duke pasur parasysh se edhe po flasim për vitin e fundit të Qeverisë, e cila qeveri sikur ta kishte buxhet të parë, ndoshta edhe do të ishte i besueshëm për qytetarët, por fatkeqësisht është buxheti i fundit i kësaj qeverie, e ende është me projekte të vitit të parë. Kurse me shifra ndoshta disa i ka të bartura, disa shifra ose është rrit buxheti për shkak të rritjes së çmimit dhe nga rritja e çmimit kemi edhe rritjen bazë të TVSH-së apo edhe të tatimeve të tjera.

Nëse e shikojmë me vëmendje, ky buxhet 1/3 e tij ndahet për subvencione dhe transfere. Kjo të bën të kuptosh që ky më shumë ka për të blerë një paqe sociale, se sa ka të bëjë për të zhvilluar vendin ekonomikisht. Nuk dua të ndalem në ndarjet e nivelit lokal, sepse për ato ndarjet buxhetore përgjegjëse janë kryetarët e komunave, janë kuvendet komunale, por isha fokusuar te ndarjet që kanë të bëjnë te niveli qendror. Ne e kemi parë me vëmendje, e kemi analizuar Ligjin e buxhetit dhe në të njëjtën kohë jemi konsultuar me aktorët që i përkasin çështjes së ekonomisë dhe janë njohës të fushave ekonomike dhe e bëjnë këtë punë edhe në terren, edhe në kuptimin praktik, por edhe në kuptimin studimor. Nëse e shikojmë si është ndarë ky buxhet, e them me një sinqeritet të lartë se është një diskriminim që po u bëhet komunave nga Qeveria Kurti.

Është e papranueshme, e padrejtë, e paarsyeshme dhe e paligjshme nëse i bëjmë diskriminimin e këtyre komunave. Nuk dua të ndalem tek ndarjet veç e veç, por megjithatë do të kisha përmendur

një pjesë. Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, kemi një rritje ekonomike, nëse ka qenë rritja ekonomike rreth 16% kur e ka marrë kjo qeveri pushtetin, tani nëse i marrim në tremujorin e dytë dhe të tretë e kemi diku 2% dhe është një rënie drastike.

Në të njëjtën kohë, nëse e shikojmë si është ndarë buxheti nga niveli qendror për nivelin lokal, diku 42,87% e buxhetit është ndarë për komunat, të cilat udhëhiqen nga Vetëvendosja. Nuk jam kundër, përkundrazi duhet të përkrahen të gjitha komunat, por nëse e shikojmë përqindjet Gjilani është diku 24%, flas për investime kapitale, nëse e marrim Prishtinën 7%, Mitrovica diku 5%, Prizreni 2,9%, Vushtrria 2%, Peja 3%, edhe Gjakova është në përqindje të ulët, të mos flas për Skenderaj, Drenas, Kaçanik, mund të them janë gati si të përjashtuara nga ky buxhet, edhe në projekte elementare, siç ishte rasti me ujë të pijes.

Përveç kësaj, fatkeqësisht kjo qeveri ende s'ka arritur as t'i bëjë kompensimet në komuna, të cilat nuk udhëheq vetë dhe fatmirësisht nuk i udhëheq vetë shumicën e atyre komunave që kanë pasur vërshime, ende me një mashtrim të radhës e ka kaluar një marrëveshje ndërkombëtare në emër të kompensimit të dëmeve dhe nuk ka bërë ende kompensim as në Mitrovicë, as Vushtrri, as Skenderaj, as Drenas, as Klinë e për këtë duhet ta japë përgjegjësinë Qeveria.

Ky buxhet më shumë i stimulon punëtorët e kualifikuar në vendin tonë të ikin nga vendi, të ikin mjekët, mësimdhënësit, policët, inxhinierët, IT-ja dhe të gjitha profilet, sepse kjo qeveri nuk po ka mundësi ta përcjellë inflacionin dhe ta përcjellë ngritjen e pagave të sektorit publik, por në të njëjtën kohë as të përkrahjes apo subvencionit të sektorit privat që të përcjellin inflacionin me rritjen e pagave. Andaj, unë do të ndalem fatkeqësisht edhe plani buxhetor për vitin 2024 nuk ka projekt transformues dhe nuk pritet që të jep rezultate të ndryshme nga vitet paraprake

Shumica e investimeve kapitale janë të parapara me buxhetin e vitit 2024 janë projektet të bartura nga viti 2023, por fatkeqësisht kemi projekte të bartura nga viti 2018, 2019, pastaj janë projektet që i ka nxënë pandemia e i ka nxënë Qeveria Kurti 1, dhe tash edhe Qeveria Kurti 2 po i lë ato projekte të parealizueshme. Nëse e shikojmë në vlerë, projektet kapitale nga niveli qendror janë diku 640 milionë euro. Nëse shikojmë sa janë projekte të bartura nga vitet paraprake, janë 580 milionë euro, nëse shikojmë në aspektin e përqindjes, i kemi diku 90,62% të projekteve që janë të bartura, kurse gjithsej i kemi 9,3% projekte të reja që i ka kjo qeveri.

Nuk po flas, për shembull, në të gjitha ato premtime që i ka pasur gati mund të them lirisht kemi dështim, kemi tkurrje në buxhet të drejtësisë, nuk i kemi të parapara ato reforma në drejtësi t'i mbulojmë me ligj, përkundrazi nëse e shikojmë edhe Raportin e Progresit kemi vërejtje te efikasiteti në këtë rast i funksionimit të sistemit të drejtësisë, por në të njëjtën kohë ka mungesë të numrit të gjyqtarëve, prokurorëve, të bashkëpunëtorëve profesionalë dhe nuk kemi parë që ka projekt që i përkrah këto kategori, përveç një projekt që më ka rënë në sy që është kapital, është projekti që ka të bëjë me rregullimin e burgut për të realizuar marrëveshjen me Danimarkën,

respektivisht për t’u sjellë kriminelët që vuajnë burgun në Danimarkë që nuk janë shtetas danezë për të ardhur në Republikën e Kosovës dhe nuk mendoj që është një shembull që mund të bëjmë ndonjë reformë në drejtësi.

Për t’u ndalur pak, për t’u fokusuar në disa çështje më konkrete, kam pasur dëshirë ta pyes ose t’i pyes ministrat përkatës, të cilët nuk janë këtu a kanë lexuar raportin për Kosovën, i cili gati çdo fushë jep një goditje ose si vitin e kaluar ose edhe më të madhe, si në luftimin e korrupsionit, në sundimin e ligjit, në prokurimin publik, e mos të flasim për sektorin e energjisë apo për ajrin apo për ambientin. Unë mund të pyes këtë Qeveri, e cila atëherë kur e ka marrë mandatin, tash po e lë mandatin, sepse po i bën katër vjet, ku mbet, çka po bëhet, ku janë sigurimet shëndetësore? Kur do të ndodhin sigurimet shëndetësore? Nuk janë të parapara as tani, as për buxhetin e ardhshëm.

Ku janë banesat për çiftet e reja, të cilat janë premtuar në mandatin e parë, në vitin e parë. Jemi në vitin e fundit, e ende nuk e kemi asnjë banesë që u nda për asnjë çift të ri. Ku janë çerdhet? Janë paraparë 160 çerdhe të ndodhin në mandatin e kësaj qeverie, fatkeqësisht nuk janë të realizuara as 6 çerdhe, e jo 160, po nuk i kemi as 6 çerdhe, edhe shumë premtime të tjera, të cilat janë bërë nga kjo qeveri. Nuk po flas për investime që kanë mbetur në gjysmë, nëse i marrim edhe rrugën që e lidh Prishtinën me Podujevë, Prishtinën me Mitrovicë, janë më keq gati se kur e ka marrë kjo Qeveri mandatin. Nuk po flas rruga që lidh Gjakovën me Klinën apo Dollc - Gjakovë, është situatë tmerruese. Kemi arnime të rrugës së re, por nuk kemi ndërtim, me standarde, edhe disa projekte të cilat lidhen, për shembull, me investime nga qendra kanë mbetur në ngecje, ndoshta do herë kanë marrë edhe lëvdata, për shembull, siç është rruga që lidh Jabllanicën me Kralanin që është një vatër që kanë dhënë shumë për këtë vend dhe nuk mund t’ua bëjmë një rrugë, e cila është më shumë se meritore për ata qytetarë.

Ura e Rogovës, është bërë histori, jo është problem lokal, jo problem qendror, por qytetarët e asaj ane, të Hasit, Gjakovës, e cila lidh edhe me Rahovecin, Prizrenin, Gjakovën, kanë mbetur tani me fillimin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën deputeti!

HAJDAR BEQA: Tash fillojnë edhe të reshurat atmosferike, qytetarët e Rogovës nuk mund të dalin të lidhen me rrugën regjionale Prizren - Gjakovë.

Andaj nuk po flas për projektet e tjera që i ka premtuar kjo qeveri, por fatkeqësisht ky buxhet nuk është buxhet zhvillimor, është buxhet i arnimit, i varfërisë, i cili e blen paqen sociale apo është buxhet elektoral, po mendoj se qytetarët nuk i besojnë vitin e fundit premtimeve që janë të

vitit të parë. Premtimet barten, projektet kanë mbetur. Unë ju falënderoj, po kërkoj që Qeveria të jetë serioze dhe të mos na vijë me kësi buxheti pa vizion.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputetja Vlora Dumoshi.

VLORA DUMOSHI: Faleminderit, nënkryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar ministra,
Të dashur qytetarë,
Projekt-buxheti i vitit 2024 është i mbushur me numra marramendës dhe mbas vete nuk kanë asnjë indikacion të rezultateve potenciale. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në projektbuxhetin e vitit 2024 dhe në përgatitje të organizimit të Lojërave Mesdhetare 2030 ka të alokuara 58 milionë euro për investime kapitale. Në vitin 2023 kishte 33 milionë të alokuara për investime, pra kjo është vetëm 25 milionë më shumë sesa në vitin 2023. Do të thotë, deri në fillimin e lojërave janë edhe 6 vjet punë dhe janë alokuar vetëm 25 milionë më shumë sesa buxheti i zakonshëm.

Në anën tjetër, është vlerësuar se për infrastrukturën e Lojërave Mesdhetare janë të nevojshme ndërmjet 250 deri në 300 milionë euro, të cilat duhet të shpenzohen deri në fund të vitit 2029 për të qenë gati për vitin 2030. Me këtë llogaritje, do të duhej të ndaheshin së paku rreth 50 milionë shtesë, pra rreth 50 milionë enkas për infrastrukturën e Lojërave Mesdhetare, mbi buxhetin e zakonshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Duhet një seriozitet më i madh dhe ky seriozitet duhet të reflektohet në buxhet dhe punë. Nëse nisemi nga përvoja e deritashme me këtë Qeveri, infrastruktura e paraparë nuk do të ketë shanse të përfundojë. Ky konstatim mund të bëhet lehtë nëse i shohim vetëm shpenzimin e buxhetit të vitit 2022, në nëntëmujorin janar - nëntor të vitit 2023, nga 33 milionë euro buxhet të ndarë, ministria ka arritur të shpenzojë vetëm 3,3 milionë euro, do të thotë vetëm 10% të buxhetit.

Nuk e di faktikisht ku është faji. A është vullneti politik apo te kapacitetet, por me këtë rend, kjo ministri duhet të rrisë performansën rreth një mijë për qind për të shpenzuar rreth gjashtëdhjetë milionë euro në vit.

Deri më 30 shtator, nga 165 projekte, asnjë projekt, pra zero projekte janë implementuar nga Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe Sportit. Pra, aftësia e kësaj Qeverie për zbatim të projekteve dhe shpenzim të buxhetit janë shqetësuese, të mos them edhe alarmante.

Më tutje, e kemi parë se kjo Qeveri nuk e ka prioritet kulturën, rininë dhe sportin, sepse në vitin 2021 dhe në vitin 2022 ka pasur buxhet më të ulët sesa në vitin 2020. Në vitin 2020 kishte mbi

44 milionë euro buxhet, në vitin 2021 me 35 milionë, ndërsa në vitin 2022, rreth 33 milionë. Pra në total buxhet më të ulët. Në vitin 2024, siç e thashë më herët, ka ngritje, por kjo vjen për shkak të investimeve për Lojërat Mesdhetare.

Më tutje, rreth projekteve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, ne shohim ku edhe ministri iu referua, kemi renovimin e Galerisë së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pastaj e kemi Teatrin e ri Kombëtar dhe disa projekte të tjera.

Te trashëgimia kulturore rritja e buxhetit është e ulët dhe nuk përmbush standardet e projekteve. Shumica e projekteve janë vetëm bartje, nga 59 projekte që ishin, kishin lënë vetëm 44 dhe vetëm pesë projekte të reja i kemi në këtë buxhet, pra Muzeu i filigranit në Prizren, Hamami i Qytetit në Mitrovicë, Hamami i Gazi Mehmed Pashës në Prizren, ekspozita e përhershme në Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Muzeu i Nënë Terezës janë projekte të reja. Krejt bashkë arrijnë vlerën në 430 mijë euro.

Në fushën e rinisë, fatkeqësisht kemi një ulje radikale të subvencioneve. Kjo tërësisht është e palogjikshme. Duke marrë parasysh që shumica e popullatës sonë është mbi 35 vjet dhe duke marrë parasysh që rinia është një pjesë e aseteve më të mëdha dhe kryesore që ka Republika e Kosovës, në vitin 2021 kishte subvencione në vlerë prej 1 779 000, në vitin 2022 ulet në 546 mijë, ndërsa në vitin 2023 në 303 mijë. Pra, për dy vjet kjo Qeveri ka ulur subvencionet e rinisë nga rreth 1,8 milionë në vit, pra i bie gjashtë herë më pak se gjatë viteve të tjera.

Në përfundim, dua të shpreh shqetësimin tim të skajshëm, i cili shqetësim është i bazuar në fakte dhe dëshmi sipas performansës së vitin 2022 dhe 2023. Kjo Qeveri nuk i ka në prioritet këta sektorë, të cilët janë vitalë për shtetin tonë. Kam brengën e madhe që do të rrezikojmë seriozisht edhe me Lojërat Mesdhetare të vitit 2030. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani e ka fjalën deputeti Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, nënkryetare!
Të nderuar deputetë,
Ministra,
Qytetarë të Kosovës,
U bën nëntë orë që po diskutojmë dokumentin më të rëndësishëm, miratimin e buxhetit, buxhet i cili në fakt është letërnjoftimi dhe CV-ja reale e kësaj Qeverie.

Tani kur po e diskutojmë, fatkeqësisht këtu prezentë i kemi veç dy ministra, tre në fakt qenkan. Ministrin e Financave, ministrin e Punëve të Brendshme dhe ministrin e Kulturës.

Ministri në ardhje, Dimal Basha.

Do ta nisja me një pyetje për dy ministrat. A shkoi? Këtu qenka Xhelali. Kemi nevojë për një sqarim të na e japë ministri Xhelal Sveçla dhe ministri Hekuran Murati. Qysh është e mundur që për dhjetë muaj këta dy ministra nuk kanë arritur të miratojnë rregulloret dhe t'i buxhetojnë rregulloret për shtesat e zyrtarëve në administratë publike? Këtu njëri duhet ta marrë fajin sot. Ose duhet ta marrë Hekuran Murati e të thotë mua më kanë ardhur rregulloret dhe nuk i kam ekzekutuar rregulloret, ose duhet të thotë Xhelal Sveçla unë nuk jam marrë me këtë punë dhe që dhjetë muaj i kemi dhënë dikujt tjetër këtë detyrë dhe nuk i ka dërguar dhe të shkarkohet personi në fjalë. Po nuk ka sot pa u sqaruar prej këtyre dy ministrave kush është fajtori. Njëri është fajtor.

Mos harroni, dhjetë muaj ditë, të nderuar deputetë, po ju drejtohem juve deputetëve të Vetëvendosjes, dhjetë muaj nuk kanë qenë të zotë këta dy ministra t'i miratojnë rregulloret e shtesave. Këta dy njerëz duhet të tregojnë ku është faji. A nuk i ka dërguar rregulloret në ministri Xhelal Sveçla, apo ministri i Financave krye në vete nuk ka dashur t'i ekzekutojë? Unë nuk e di të vërtetën, po e di procedurën duke qenë pjesë e kabinetit qeveritar.

Çështja e dytë që është tepër e rëndësishme edhe që më kujtohet është folur vitin e kaluar, kur kemi folur për punën e rritjes së pagave, ministri i Financave ka folur për rritjen ekonomike si elementin krahasues bazë i rritjes së koeficientit. Tani, gjatë diskutimit publik që ka ndodhur këta muaj, është proklamuar që rritja ekonomike është mbi 5 për qind. Inflacioni, tha kryeministri, ka qenë më shumë se 12 për qind muajt e parë të vitit dhe muajin e fundit ka qenë 4 për qind më duket, që nënkupton mesatarja ka qenë 10 për qind. Kur të ballafaqohet inflacioni që është rritja e çmimeve në Kosovë dhe rritja ekonomike 5 për qind, i bie që pagat është dashur të rriten minimumi të shkojë koeficienti në 120 euro.

Në qoftë se e shohim buxhetin për paga dhe shtesa, është 805.389.668 euro. Këtu po flasim edhe pa një numër të madh të vendeve që nuk janë, mbi dy mijë vende të punës nuk janë të mbushura, pra janë të hapura. Pra, duhet të dalë ministri i Financave dhe të tregojë pse? Njeriu i cili ka qenë i thirrur, një njeri i cili me të vërtetë ka debatuar për politikat publike, si është e mundur që gjithë politikat publike që lidhen me ngritjen e koeficientit asnjëherë të mos i debatojë me asnjë sindikatë. Hajde, po i lëmë sindikatat anash, po të thirren profesorët, qe ku është Ardiani këtu, të thirren profesorët njëherë e t'u thuhet si po e mendoni ju që duhet shkuar në këtë proces. A e keni parë ndonjëherë ndonjë ministër të kabinetit të Albin Kurtit, të cilit kanë mbledhur një grup njerëzish dhe kanë diskutuar për të bërë një politikë të përbashkët me dikë? Kurrë asnjëherë.

Le të dalë ministri i Financave le të tregojë cilën politikë tatimore, cilën politikë financiare, cilën politikë të taksave e ka përpiluar me dikë? Pos krye në vete dhe në shpinë të Albin Kurtit. Se këtyre ministrave, kur t'u lëvizë pozita, kthehen te Albini, e Albini e ka flamurin dhe elementin patriotik. Pra, këta ministra janë ministra që nuk kanë arritur ta ekzekutojnë mbi 1 miliard e 300 mijë euro investime kapitale. Shiko çka ndodh, sot lavdërohet kabineti qeveritar, thotë e kam rritur mbi një miliard euro. Më fal, po ti nuk i ke investuar 1,5 miliardë euro që i ke pasur, se për

shkak se nuk ke dashur të investosh, për shkak që ose s’ke dashur, ose s’ke ditur ose ke pritur Albin Kurti ta lërë krejt agjendën ndërkombëtare e të vijë t’ju tregojë juve çka të bëni.

Pra, niveli i papërgjegjësisë në shumicën e dikastereve është i jashtëzakonshëm. Unë nuk e kam problem t’ia pranoj një punë të mirë Hekuran Muratit. Mua më ka pëlqyer projekti Superpuna. Nuk di të dhëna, në jetën time që kam marrë një raport si kryetar i komisionit, për një të vetmin raport që të thuhet prej SuperPunës kanë përfituar kaq njerëz, kaq të rinj, kaq. Unë ju inkurajoj që SuperPunën ta shtyni përpara, ta rrisni, ashtu siç tha kryetari i Aleancës, Ramush Haradinaj, prej 1 janarit, për shkak të eksodit të mundshëm të rinisë.

Po të më pyes dikush diçka, edhe po ju pyes edhe juve haptazi, cila është një punë që të thuash kjo punë është bërë me këtë buxhet. Besoni, e kam problem ta them. Unë po e shoh p.sh., prapë po e pranoj, autorruga Prishtinë-Podujevë është duke u punuar, mua më bie të shkoj, është duke u punuar. Nuk e di kur kryhet, po është duke u punuar me intensitet më të lartë se më përpara. Mirëpo, rruga Prishtinë-Gjakovë është rrugë e marres, është rruga e cila është lënë dhe e cila është duke e dëmtuar në esencë qytetarin që jetojnë atje. Rruga Pejë - Zahaq është e njëjtë. Autostrada e Dukagjinit është e njëjtë. Rruga Prishtinë-Mitrovicë është e njëjtë, është saktësisht e njëjtë. Rrugën e Gjilanit nuk e kam parë, nuk di. Pra, këto rrugë janë rrugë të cilat nuk do të arrijnë prapëseprapë të hyjnë në to.

A bën prapë të flas për dy-tri kategori, për shkak se e lashë fjalimin në fund t’i kem. A bën t’ju pyes dy ministrave këtu, ministrin e Financave, për shkak se është portfolio e tij. A mund të dalësh në këtë foltore të flasësh një fjalë për pensionistë? Veç një fjalë. Je ai që ke kërkuar votën për reformën në skema pensionale. Ta kemi votuar pa asnjë kushtëzim si Aleancë, ka kaluar reforma pensionale. A mund të tregosh qysh dhe çfarë forme do të rriten pensionet që kurrë s’jeni ndalur duke folur për këtë çështje?

D.m.th. ju pensionistët, prindërit tanë, e thashë edhe në fjalimin më herët, i kategorizoni të votuesve pat. Për shkak se në qoftë se e shohim buxhetin, çka shohim ne? Ne e shohim një buxhet elektoral, i cili me metodologjinë e investimeve në komunat ku ju udhëhiqni, kisha thënë janë disa projekte, mirëpo komunat si entitet, si shkalla kryesore dhe dora kryesore e shtetit për të ofruar shërbime, i keni neglizhuar totalisht. Më falni, 60 milionë euro i keni për projekte të reja. Çka keni për të folur?

Po e përmbyll me politikën e jashtme. Nuk po flas për arsim, se as nuk kam kohë, po flas për politikën e jashtme.

Të nderuar deputetë,
Deshëm ne apo jo ta pranojmë, si Kosovë nuk jemi në një situatë të mirë në raport me agjendën tonë ndërkombëtare. Jemi para një kryqëzimi të madh, jemi para një situate kur kauza jo

negociata, që ka qenë kauza juaj kryesore, është kthyer në mjet pune. A e kuptoni që ju keni ardhur në pushtet duke thënë: jo negociata! Kauza, mjeti kryesor i punës suaj është se jeni në negociata që tre vjet. Ndërsa ju emrin e keni Vetëvendosje.

Dhe, për politikat e brendshme, mos harroni, për politikat e brendshme, ju e keni transferuar vendimmarrjen e brendshme te një kategori tjetër, te Brukseli. Ne e kemi bërë të njëjtën, po ne veç nuk kemi thënë Vetëvendosje, as jo negociata. Pra, ju jeni në këtë vijë dhe politikën e jashtme trajtojeni me kujdes, për shkak se në qoftë se nuk bëni investime serioze dhe lejoni në avazin siç e keni lejuar deri tash, me të vërtetë do të jemi të dëshpëruar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ministri Murati, replikë!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, nënkryetare!
Në lidhje me atë që e tha deputeti Tahiri, sa u përket rregulloreve, edhe janë të miratuara, edhe janë të buxhetuara, edhe po ekzekutohen.

Sa i përket çështjes së pagave, duhet edhe një herë të kthehem edhe te fjalimi i deputetit Haradinaj, meqenëse nuk kisha kohën e mjaftueshme kur replikova në fillim, i cili tha që kategorive të sektorit publik duhet dyfishuar paga. D.m.th. tash kur është në opozitë, po e di shumë mirë kujt duhet dyfishuar paga, mirëpo kur keni qenë në Qeveri, dihet kujt ia keni dyfishuar pagën, vetes.

Kur keni qenë në opozitë, paga minimale, Haradinaj pati thënë kur garonte atëherë, bile qe një incizim që e prezantoi deputeti Bajqinovci, pati thënë paga minimale do të bëhet një mijë euro. Një mijë euro pati premtuar se do të bëhet paga minimale. Normalisht që pagë minimale një mijë euro s’kemi parë, kemi parë dyfishim të pagave të veta. Por tash kur më në fund erdhi në Qeveri që po e rrit pagën minimale, ju e keni çuar në Gjykatë Kushtetuese, e keni bllokuar. D.t.th. këto janë veprime konkrete, të cilat ju i keni bërë kundër qytetarëve kur keni pasur mundësi, e kur ju kanë vyer për vota, jeni shprehur për qytetarët.

Sa i përket çështjes së SuperPunës, faleminderit për vlerësimin! Unë vazhdimisht postoj njoftime dhe informata sa i përket këtij projekti dhe kësaj platforme. Informata më e fundit është që janë 7786 të rinj, të cilët kanë përfituar përmes kësaj platforme, e nga ta 3 914 janë vajza dhe 3 872 djem. Pra, dominojnë vajza, përkundër që proporcioni është goxha i barabartë dhe kjo është tepër e mirë. Kurse, bizneset të cilat përmes platformës SuperPuna kanë punësuar këta të rinj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Ishte replikë, kështu që të lutem e përfundon, mundesh pastaj me kundër-replikë nëse pajtohet z. Tahiri t'ia shtojë gjithashtu një minutë shtesë nëse do. A dëshiron të përfundojë ministri fjalën?

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit për kohën shtesë!
Sa u përket bizneseve, pra janë 5832 biznese, të cilat kanë shfrytëzuar platformën Superpuna për të ofruar vende pune për këta të rinj e të reja.

U përmendën edhe rrugët, pra që tash e sa kohë kanë mbetur. Ministri Vitia e tha një gjë pak më herët, për shumë projekte që po pretendoni që i keni nisur ju dhe ne po i vazhdojmë, në fakt shumë më mirë të mos i kishit nisur, sepse i keni nisur keq.

Për rrugën Dollc - Gjakovë, marrëveshjen a kontratën e keni bërë ju sa keni qenë në Qeveri. Paratë janë në buxhet, pse s'po kryen punë operatori ekonomik që e keni përzgjedhur ju? Pse s'po ecën puna? A keni përgjigje për këtë? Pse keni përzgjedhur operatorë ekonomikë, të cilët tash s'po i kryejnë punët?

Sa i përket reformës sociale e pensionale, po faleminderit shumë për mbështetjen për marrëveshjen ndërkombëtare, megjithatë më duhet t'jua rikujtoj që një vit e gjysmë ka pritur marrëveshja këtu dhe tani jemi duke punuar, por merr pak kohë.

KRYESUESJA: Kundër-replikë, dy minuta i ka deputeti Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, nënkryetare!
Unë e kam edhe një pyetje për ministrin: a bën të na tregosh sa i është rritur paga Kryeministrit Albin Kurti? Edhe në sektorin publik, kujt i janë rritur pagat më së shumti? Unë po të tregoj ty. Kryeministrit të Kosovës i është rritur paga më së shumti, 780 euro. U është rritur paga ministrave, ty të është rritur paga, zotëri. I është rritur shefit të kabinetit tënd, u është rritur këshilltarëve tuaj, u është rritur zëvendësministrave, pra të gjithë të emëruarve politikë. Pagat janë rritur më shumë se secilit zyrtar. Policit ia ke zvogëluar me pesë euro. Jo ia ke zvogëluar. Dëgjomë! Unë po flas për policin që e fut kartën dhe e sheh sa para i ka marrë. Ti ia ke ndalur shtesat, o zotëri. Rregulloren a bën ta tregosh publikisht?

Po ta bëj pyetjen: Kur të ka ardhur rregullorja? Pse s'të ka ardhur rregullorja që e ke pasur gati prej kur është bërë Ligji i pagave? I ke mbajtur nëntë muaj pa rregullore, o zotëri! Pra, dil e trego pse ia rritët pagat vetes? Ju ia keni rritur pagën, ti personalisht vetes, Kryeministrit dhe e ke lënë shërbimin civil në nivelin më të ulët, policët i ke lënë në nivel tepër të ulët dhe nuk ke reflektuar. Asnjë fjalë nuk e fole që të pyeta për inflacion. Asnjë fjalë nuk e the për rritjen ekonomike. Si është e mundur pesë euro, dikush që e ka koeficientin 6 i është rritur 30 euro, dikush që e ka 8 e ka 40 euro, dikush që e ka 10 pra 50 euro. Për çfarë rritje je duke folur, o zotëri?

Gabimin, mbaje mend, ti do të mbahesh mend si ministri i Financave, unë nuk kam problem kur e ke një punë të mirë të ta them, ti do të mbahesh mend si ministri i parë që ka krijuar marrëdhënie transaksionale, pra ka bërë transaksione me qytetarët drejtpërdrejt dhe jo me vija institucionale buxhetore, siç është Ligji i pagave, punëtorët në arsim. Po ju ke dhënë subvencione 50 euro aty, njëqind euro aty.

KRYESUESJA: Vazhdojmë, se u pajtuan z. Tahiri, ia shtova një minutë të dy palëve. Vazhdojmë me deputetët e paraqitur në radhë. Për fjalë është deputeti Gramoz Agusholli.

GRAMOZ AGUSHOLLI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,
Miratimi i buxhetit të konsoliduar të Kosovës është njëri prej aspekteve tejet të rëndësishme të punës, të cilën e bën ekzekutivi kosovar, sepse ai lidhet direkt me jetën e qytetarit të Kosovës.

Si deputet që vij nga rajoni i Pejës dhe për më tepër i ndaj çdo ditë të njëjtat brenga dhe shqetësime me bashkëqytetarët e mi, kam vërejtur se Komuna e Pejës krahas nisjes së implementimit të projekteve që kanë rëndësi kombëtare, Projektligji për buxhetin e vitit 2024 ka lënë disa projekte, për të cilat nuk është ndarë buxhet. Për sqarim duhet të theksojmë se Projektligji për buxhetin 2024, të cilin e ka miratuar Qeveria e Kosovës, ka një vlerë prej 3.3 miliardë euro.

I kthehemi qytetit të Pejës, ku projektet si ndërtimi i stadiumit të qytetit, i cili do të duhej të ishte i gatshëm deri në fund të mandatit të kësaj Qeverie si dhe finalizimi i projektit të plotë të Qendrës Nacionale të Xhudos, janë pa asnjë diskutim projektet më të rëndësishme që po merr sporti pejan, i cili tashmë i ka edhe ambasadorët e tij e që e kanë ngritur lart flamurin e Kosovës e atë hiç më pak se deri te Lojërat Olimpike.

Me funksionalizimin e plotë të Qendrës Nacionale të Xhudos, e cila e ka një kosto prej rreth gjashtë milionë euro në total, Toni, Majlinda, Nora, Distria, Akili do ta kenë më të lehtë të përgatisin kampionë të rinj, djem e vajza që do të jenë burim frymëzimi dhe model se si edhe vendet e vogla mund të japin shumë nëse ata besojnë në ëndrrën e tyre.

Ndërsa, në mesin e projekteve të cilat parashihet të ndahen mjete në buxhetin e ri, janë edhe objektet e trashëgimisë sonë kulturore, sikurse është rasti me Konakun e Mahmutbegollëve, ku për vitin 2024 janë ndarë 150 mijë euro. Kjo në vazhdën për planin e restaurimin e këtij ambienti që përfaqëson traditën dhe kulturën e qytetit tonë.

Më pas, nga rrafshi i infrastrukturës rrugore, në Komunën e Pejës, në buxhetin e vitit 2024 parashihet që të ndahen 300 mijë euro për ndërtimin e rrugës Shtedim - Pod i Jakupit. Më pas, në

buxhetin e vitit tjetër janë paraparë 200 mijë euro për ndërtimin e rrugës Haxhaj - Stankaj, për të vazhduar më pas me asfaltimin e rrugës Bair - Ymeraj, e cila po ashtu ndodhet në komunën e Pejës, ku për vitin 2024 do të ndahen 200 mijë euro. Projekt tjetër në komunën e Pejës që është ndarë buxhet për vitin 2024, respektivisht janë paraparë 150 mijë euro është edhe ai për asfaltimin e rrugës Bogë-Tëbane.

Krahas kësaj atmosfere të investimeve të cilat pa dyshim se ka mungesa e hapësirë për përmirësim nga ana e ministrive të Kosovës, dua të them se një pjesë, për të mos thënë shumicën e përgjegjësisë e ka udhëheqja komunale e Pejës, e cila nuk po arrin të adresojë sa dhe si duhet nevojat e qytetarëve të Komunës së Pejës. Më vjen keq që ata e harxhojnë tërë atë energji për të kundërshtuar kryeministrin në politikat shtetërore, përderisa banorët e Pejës kanë probleme të shumta.

Dua të them që mungesa e sinkronizimit të nivelit lokal me atë qendror po e lë qytetin prapa. Ndonëse kanë filluar, janë disa projekte që nuk janë paraparë që t'u ndahet buxhet i ri për to për buxhetin e vitin 2024. Disa prej tyre janë zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës M9 Prishtinë - Pejë, rrugë për të cilën po diskutohet tash e sa vite e që ka një rëndësi shumë të madhe në lëvizjen e njerëzve dhe mallrave e që gjithashtu do të ndikonte në rritjen ekonomike dhe të turizmit në regjionin e Pejës. Madje, rregullimi i saj do të ulte edhe numrin e aksidenteve të shumta rrugore, sepse llogaritet njëri prej akseve që shumë aksidente përfundojnë edhe me fatalitet.

Ministria e Infrastrukturës nuk ka bërë sa është kërkuar, ndonëse prej premtimeve që janë bërë, kjo do të duhej tashmë të ishte punë e kryer. Njëlloj neglizhence e ka shoqëruar këtë dikaster, me theks të veçantë për këtë magjistrale që lidh kryeqytetin e vendit me komplet pjesën perëndimore të tij. Do të ishte mirë që dikush nga Ministria, ose vetë ministri Aliu, të na tregojë se cili do të jetë fati i këtij projekti? Kur do të përfundojë? A ka shpresë së paku brenda këtij mandati apo jo.

Çdo ditë e humbur në këtë drejtim i dëmton direkt banorët e asaj pjese. Më pas, për rehabilitimin e rrugës nacionale N9, segmenti Pejë - Kuçishtë - Çakor nuk ka mjete të ndara për vitin 2024, derisa janë vetëm mjetet e bartura prej 2 milionë eurove nga viti 2023.

Gjithashtu, mjete nuk janë ndarë në vitin 2024 as për projektin e ndërtimit të rrugës Drelaj-Leqinat. Nuk janë ndarë as për ndërtimin e rrugës Maja e Zezë-Rrethi i Vitomericës. Gjithashtu, edhe ndërtimi i rrugës - Shtupeq i Vogël - Varri i Sykut, faza e dytë nuk ka mjete të reja për vitin 2024, por vetëm mjete të bartura prej 200 mijë eurove nga viti 2023.

Po i përmend në renditje kronologjike edhe projektet e tjera për të cilat nuk është paraparë të ndahen mjete nga buxheti i vitit 2024. Ndërtimi i deponisë komunale, ndërtimi i fshatit të Lumëbardhit, ndërtimi i objektit të zyrave të parkut kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", infrastruktura, si dhe blerja e pajisjeve laboratorike si dhe pajisje të tjera të Universitetit të Pejës,

projekti i ndërtimit të çerdhes në Pejë. Në këtë projekt veç në vitin 2024 nuk janë ndarë mjete as për vitin buxhetor 2023. Dizajnimi dhe ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë.

Shpresoj se do të rishikohen dhe do të merren parasysh këto kërkesa dhe nevoja të banorëve të qytetit të Pejës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputetja Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, nënkryetare!
Të dashur kolegë deputetë,
Të nderuar ministra që po vazhdoni të jeni në sallë,
Të dashur qytetarë,
Nga loja gjuhësore e statistikore se si shpjegohet buxheti sot këtu për të tëra këto orë, do të thosha që shpjegimi nuk është fare në aspektin numerik, planifikimi një çik problem, e zbatimi problem shumë i madh. Sepse, për këto vite që jeni në pushtet ka pak projekte të prekshme e të dukshme për të përmirësuar jetën publike, që unë do t'i listoja këtu sot. Dhe, nuk do të ndalem aty, e nuk do të shkoj tutje.

Por, nëse e shikojmë në detaje projektbuxhetin e shohim që, ju përtej që keni ngecje në zbatim, sepse shumica e projekteve janë buxhete të bartura nga vitet e kaluara, ju nuk i qëndroni besnikë as planifikimit që e bëni vetë nga viti në vit, dhe do ta sqaroj pse.

Po ashtu e kam theksuar edhe vjet kur kemi folur për buxhetin e vitit 2023 dhe po e theksoj edhe njëherë sot këtu për buxhetin e vitit 2024 për manipulimin dhe mashtrimin që u bëhet komunave të Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës karshi buxhetimit të investimeve kapitale, duke favorizuar komunat që qeverisën nga Lëvizja Vetëvendosje dhe duke i penalizuar komunat e tjera.

Si e para, nga 49 milionë euro projekte të reja për investime kapitale, 42,87% të mjeteve të këtyre investimeve janë planifikuar vetëm për 4 komuna që ka në qeverisje Lëvizja Vetëvendosje. Domethënë, nga 38 komuna që i ka Kosova, gati gjysma e buxhetit të investimeve të reja kapitale shkon vetëm në katër komuna që qeverisën nga Lëvizja Vetëvendosje.

Çka do të thotë kjo? Komuna e Ferizajt ka minus 770 mijë euro më pak. Hani i Elezi minus 442 mijë euro më pak për investime kapitale nga viti i kaluar. Fushë Kosova mbi 564 mijë euro më pak. Komuna e Vitisë mbi 496 mijë euro më pak se vitin e kaluar. Komuna e Pejës mbi 271 mijë euro më pak e tutje. Por, nëse e shohim Komunën e Kamenicës, ka 2,1 milionë euro më shumë sesa vitin e kaluar. Pra, rritje për 6,86%.

Njëjtë Komuna e Shtimes, 2 milionë e 333 mijë euro më shumë se vitin e kaluar ose 7,63% më shumë.

Edhe Komuna e Prishtinës ka rritje me 2 milionë e 150 mijë. Pra, më pak se Komuna e Shtimes. Kryeqyteti i Kosovës ka rritje më pak se Komuna e Shtimes. Vetëm analizojeni fluksin e njerëzve këtu, aktivitetet që ndodhin këtu dhe jetën publike që ndodh këtu. Gjilani prin me 24% rritje, me 6 milionë e 800 mijë euro më shumë se krejt viti i kaluar.

Zakonisht investimet kapitale nëpër komuna nga niveli qendror bëhen me konsulta me komunat, por kjo nuk ka ndodhur me këtë Qeveri. Këtë mund ta shihni si problem të theksuar edhe në Raportin e Progresit, i cili për herë të parë përmend se bashkëpunimi i nivelit qendror me komunat duhet të përmirësohet.

Dua, po ashtu të theksoj se në programin qeverisë që kjo Qeveri ka paraparë grantin e katërt për komuna, po e citoj nga programi, që t'u mundësojë komunave autonomi për investime kapitale ndërmjet grantit të katërt: "Do të hartojmë kornizën ligjore, ku do të vendosen kriteret profesionale të cilat u mundësojnë komunave të konkurrojnë me idetë, projektet për zhvillim të gjithanshëm në sektorë si: turizmi rural, inovacioni, sportet, trashëgimia kulturore, arti, infrastruktura, sistemet e ngrohjes qendrore, furnizimi me ujë të pijshëm e të tjera e të tjera - po citoj prapë - për të arritur këtë do të hartojmë Ligjin për grantin e katërt", e mbyll citatin.

Kjo Qeveri me sa jam në dijeni ligjin e ka hartuar, ka qenë në proces, por e ka bllokuar vetë dhe nuk e ka sjellë në Kuvend. Në anën tjetër, arsimi ka qenë një nga shtyllat kryesore të kësaj Qeverie, të paktën gojarisht dhe si program qeverisës, e nëse e shohim buxhetin, Universitetit të Prishtinës i është ulur buxheti, përderisa 160 çerdhet e premtuara do të mbesin një kujtesë e bukur.

Pse po e them këtë? Edhe disa nga çerdhet që janë buxhetuar, këtu ka një lojë të dyfishtë se si trajtohen nëpër komuna projektet e çerdheve. Disa çerdhe, si çerdhet në Malishevë, Prishtinë, Gjilan, Pejë, Vushtrri, Fushë Kosovë, Mamushë, Ferizaj figurojnë në buxhet për çdo vit, por janë të buxhetuara me zero euro që nga viti 2022 deri në vitin 2024, dhe buxhetohen vetëm në vitin 2025 nga muaji i dytë, domethënë, kur fillon viti zgjedhor.

Njëkohësisht çerdhja në Shtim në anën tjetër, nga 300 mijë euro që janë të bartura nga viti 2023, çerdhja në Kamenicë 420 mijë nga viti 2023 po ashtu, dhe imagjinojeni, çerdhja në lagjen "Iliria" në Mitrovicë 200 mijë euro. Po bëj veç krahasimin e nevojës për çerdhe, numrit të fëmijëve në Komunën e Mitrovicës krahasuar me numrin e fëmijëve në Shtime dhe në Kamenicë.

Në të njëjtën kohë, participimi në projektet e IPA-s për vitin 2023 për ndërtimin e çerdheve prapë, është shfrytëzuar zero, asnjë cent nga 4 milionë e 810 mijë euro të parapara dhe tani të bartura në këtë vit. Domethënë, zero janë shpenzuar për ndërtimin e çerdheve nga buxheti i IPA-s.

Nëse flasim për ndërtimin e shkollave në zonat rurale ku ka fluks së të madh të njerëzve për shkak të migrimit të brendshëm, e sidomos në komuna të mëdha si Komuna e Prishtinës, e Fushë Kosovës dhe disa të tjera, kodi 0950 thotë kështu: "Të ndara kanë qenë në vitin 2023, 1 milion e 674 mijë euro dhe janë shpenzuar vetëm 94 mijë e 500 euro". Pra, 1 milionë e 580 mijë euro janë bartur në vitin 2024.

Domethënë, ju as paratë që i keni nuk i shpenzoni, e të tëra këto nevoja janë të theksuara.

Pak më herët, kolegia ime Ganimete e përmendi shkollën "Abdullah Shabani" në Mitrovicë. Ja prej këtij këtu, prej kodi meqë është i përgjithshëm do të mund t'i merrnit paratë dhe ta bënit atë shkollë.

E njëjta ndodh me digjitalizimin që kjo Qeveri është gojëplotë. Nga 6 milionë euro të parapara për vitin 2023, janë shpenzuar 0,0,0. Të gjitha janë bartur në vitin 2024. Kaq për zhvillimin e arsimit dhe përparimin e tij në aspektin përmbajtjesor, por edhe infrastrukturorë.

Në të njëjtën kohë po i referohem programit qeverisës, ku thuhet se do të hartojmë Strategji për specializim të mençur që do të jetë nga masat kryesore se si do ta funksionalizojmë parkun e trajnimeve dhe inovacionit në Prizren, gjë që do të jetë veç një ëndërr e bukur, sepse as që është e paraparë në buxhet.

Po ndalem pak te çështjet e banimit si e drejtë themelore e garantuar, jo vetëm me Kushtetutë, por edhe me të gjitha kartat ndërkombëtare. Dhe, si premtim qeveritar nga viti 2022 te Ministria e Mjedisit, e cila në fakte krejt fokusin e ka lënë në infrastrukturën e rrugore e që e ka pasur kritikë kryesore në kohën kur ka qenë në opozitë.

Po e theksoj nga programi qeverisë, citat: "Qeveria do t'i kushtojë rëndësi të veçantë edhe banimit social. Ndër të tjera, do të mundësojë banim të përballueshëm për 4 mijë familje". As ligji nuk është hartuar ende, e asgjë tjetër përveç fizibilitetit nuk ka ndodhur me këtë projekt tash e 3 vjet.

Para se të flas për buxhetimin për kulturë, dua të ritheksoj një copëz nga premtimet e programit qeveritar të Lëvizjes Vetëvendosje të miratuar këtu në Kuvend. Po citoj: "Qeveria do të angazhohet për përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe ligjore në institucionet kombëtare të kulturës, për konsolidim të kushteve të punës dhe veprimtarisë artistike. Në fazën fillestare me ndërhyrje emergjente dhe renovuese në ndërtesat kryesore dhe në të njëjtën kohë do të bëjmë konceptimin dhe themelimin e institucioneve të reja kombëtare të kulturës, Operës dhe Baletit, Teatri i ri Kombëtar, Muzeu i Artit Bashkëkohor, Rrejti i Kinemave të Kosovës. Po ashtu, synojmë dinamizimin e punëve për përfundimin e Muzeut të ish-Burgut të Prishtinës dhe Muzeut të Historisë së Natyrës".

Tashmë që po flasim, Teatri i Operës dhe Baletit vazhdon të buxhetohet duke mos ndodhur asgjë përveç një logoje. Teatri i ri Kombëtar ka qenë i buxhetor në vitin 2022, është larguar nga buxheti në vitin 2023 dhe në figuron as në buxhetin e vitit 2024.

Domethënë, këta edhe idetë e veta e fjalët e veta i përpinë. Teatri Kombëtar ekzistues përveç që është i mbyllur tash e dy vjet, ka edhe një gjë interesante për ta theksuar nëse e analizoni mirë buxhetin e vitit 2023 dhe 2024.

Në vitin 2023 në shtrirjen buxhetore, projeksionin buxhetor ndër vite, Teatri Kombëtar buxhetohet 400 mijë euro me vazhdim nga viti 2022 dhe në vitin 2024, 2 milionë euro. Nëse e shohim buxhetin sot për vitin 2024, e shohim që Teatri Kombëtar për vitin 2024 me këtë buxhet tani, i është lënë, jo 2 milionë euro siç ishte paraparë, por vetëm 890 mijë euro. Domethënë, as planifikimet që janë bërë vitin e kaluar si shtrirje buxhetore, nuk respektohen dhe manipulohen.

Për Rrjetin e Kinemave nuk po flas, sepse siç duket nuk ka as bazë se si të krijohet meqë është larguar nga draft-ligji për art e kulturë, e as për buxhetin për to nuk ka ndonjë gjë të theksuar. Paçka që këtë vit shohim një ide të re për një Muze të Filigranit në Prizren e që MKRS e ka paraparë të buxhetuar pa qenë as pjesë e programit dhe pa pasur as akt të themelimit.

Gëzohem kur shoh Muzeun e Luftës, por në anën tjetër, si ka mundësi që ka zero buxhet për Muzeun e Burgut dhe zero buxhet për Muzeun e Natyrës që kanë qenë pjesë e programit qeverisës të miratuar këtu. Njëkohësisht, çuditem se si nuk mendohet për muzetë privatë që janë: Muzeu Çavdarbasha, Shtëpia e artistit Musli Mullliqi dhe mjedise të tjera kulturore në Kosovë.

Gjithsesi, kultura ka rritje buxheti dhe unë i gëzohem kësaj pune. Mirëpo, kot krekosemi për rritje, për shembull, në film e në kinema...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën. 2 minuta!

ELIZA HOXHA: Kot flasim dhe krekosemi për rritje në film dhe në kinema për vitin 2024, kur sivjet në vitin 2023, drejtoresha e Qendrës Kinemaografike të Kosovës i ka privuar operatorët filmikë nga mundësia e mbi 800 mijë euro subvencione për veprat filmike, duke mos i shpallur subvencionet dhe duke i privuar filmbërësit nga kjo mundësi për të zhvilluar projektet e tyre. Prandaj, ato para as nuk janë harxhuar veç janë bartur në këtë vit.

Ministri i përmendi renovimet objektet ekzistuese të institucioneve në nivel kombëtar, mirëpo do t’i thosha ministrit që në vitin 2022 e deri në vitin 2024 janë paraparë 60 mijë euro, të cilat vetëm

kalojnë nga viti në vit në vazhdim dhe nuk ka ndodhur ndonjë renovim në Galeri Kombëtare, renovimi i paraparë është bërë për vitin 2025, 800 mijë euro.

Çfarë të flas për sport kur ne pretendojmë që të jemi pjesë e garave ndërkombëtare edhe në nivel të garave olimpike, por në anën tjetër kemi një stadium që ka qenë në një proces të gjatë i zgjedhur e ideuar deri te maketa dhe nuk buxhetohet stadiumi i ri kombëtar i Kosovës as këtë vit. Por, në anën tjetër ka 800 mijë euro për shtigjet e atletikës në Kamenicë.

I nderuar ministër,
Kam shumë qejf ta di nëse ka një klub të atletikës në Kamenicë? Dhe, nëse po, cilat janë rezultatet? Sa banorë i ka Kamenica, e sa sportistë i ka Kamenica për atletikë?

Kur jemi te kultura do të ndalem edhe te RTK, e cila për vitin 2024 e ka të njëjtë me vitin 2023. Nuk do të flas për RTK-në si medium, do të flas për aspektin kulturor dhe për festivalin i cili veç sa përfundoi.

MKRS vitin e kaluar ka ndarë 700 mijë euro përmes një memorandumi të mirëkuptimit, 300 mijë për festivalin dhe të tjera për kanalin e 4-të, që do ta kthente në kanal kulture...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Bahrim Shabani.)

KRYESUESI: Regjia, ia vazhdoni edhe një minutë, ju lutem!

ELIZA HOXHA: Faleminderit! Shumë faleminderit për mirëkuptim! Meqë shumë pak po flitet për kulturë, bile të kemi pak mundësi. Faleminderit!
Domethënë, buxheti është i ulët dhe këtë vit vazhdon të mbetet i njëjti. Në vend se të planifikohet buxheti për festivalin tani të integruar në buxhetin e RTK-së. Domethënë, nuk ka buxhet për festival as këtë vit dhe besoj dhe po supozoj që do të ndodhë e njëjta, ministër, edhe për vitin tjetër.

Unë e kam ritheksuar se kjo mund të krijojë mundësi për ndikim në përmbajtje programore, por do ta lë këtu, nuk do të flas meqë po flasim për buxhetin.

Sidoqoftë, në fund fare, çfarë mund të them. Dikush e përmendi nga ministrat që këtë viti janë subvencionet shtylla më e lartë, por janë investimet kapitale. Ka një logjikë të thjeshtë, nuk janë shpenzuar paratë për investime kapitale në vitin e kaluar dhe këtë vit është rritur shtylla. Por, në anën tjetër, ky buxhet duket buxhet për shtesat... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Ka replikë ministri Çeku.

MINISTRI HAJRULLA ÇEKU: U përmenden shumë projekte, por po i veçoj disa. Teatri Kombëtar i Kosovës, Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Muzeu Kombëtar i Kosovës, Galeria Kombëtare e Kosovës, Agjencia Shtetërore e Arkivave, të gjitha janë në proces të hartimit të projekteve të renovimit dhe të restaurimit. Në momentin që përfundojnë projektet, fillojnë ndërhyrjet rinovuese dhe restauruese dhe të gjitha janë buxhetuar. Pra, edhe Teatri Kombëtar është buxhetuar.

Në buxhetin e institucioneve publike, pra, buxhetin vjetor të tyre, unë i përmenda shifrat në cash, pra në tri vjetet e ardhshme. E thatë një të pavërtetë në lidhje me bllokimin e fondit të subvencioneve në QKK, zonja deputete, për shkak se Ligji i ri i kinematografisë që e keni votuar ju ka hyrë në fuqi, përcakton rregulla të reja, duhet edhe Rregullorja e Subvencionimit të miratohet që të hapet konkursi.

Kjo Rregullore i ka kaluar të gjitha fazat. Shumë shpejtë hynë në fuqi dhe shumë shpejtë hapet konkursi me rregulla të reja, e një nga ato rregulla është që financimi shkon deri në 80%, dhe kjo ua lehtëson punën filmbërësve. Ky diskutim është zhvilluar edhe me filmbërësit.

Edhe institucionet e tjera kanë rritje, por nuk po ndalem tek ato. I përmendët dy projekte. Stadiumi nacional do të bëhet, është pjesë e kontratës sonë me ICMG për Lojërat Mesdhetare. Maste plani i vitit të ardhshëm përfundimisht e përcakton lokacionin dhe fillon procedura për ndërtimin.

Ndërsa për atletikë, klubi i atletikës “Rogana” në Kamenicë ka dërguar sportistë edhe në Lojëra Olimpike. Pra, ka një traditë Kamenica për atletikë, prandaj edhe stadiumi i atletikës do të ndërtohet në Kamenicë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Kundër-replikë, deputetja Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: Ministër, ta sqarojmë se nuk kam asgjë kundër që ka një klub të suksesshëm në Kamenicë edhe nuk duhet të kenë hapësirë ku të ushtrojnë. Veç ta përfundoj.
KRYESUESI: Ju lutem deputetë, pak qetësi! Ju lus, se nuk mund të vazhdojmë kështu. Regjia, ia ktheni kohën.

ELIZA HOXHA: Faleminderit!
Askush nuk ka asgjë kundër që të bëhen shtigjet në Kamenicë. Kundër, absolutisht ka kurrkush kundër rritjes së buxhetit. Buxhetimi është bërë dhe mjetet po barten vit për vit, renovimi s’ka ndodh në Teatrin Kombëtar vazhdon projekti duke u bërë tash e 2 vjet. Të tjerat as nuk kanë

projekt. Ky është problemi i vonesave dhe moszbatimit të atyre që keni premtuar. Kaq mund të them.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju lus pak qetësi! Të dëgjojmë. Fjalën e ka Doarsa Kica-Xhelili.

DOARSA KICA-XHELILI: Faleminderit!
Duhet ta kemi parasysh që buxheti nuk është vetëm një përmbledhje numrash, por në fakt është shpërfaqje e aspiratave dhe vlerave që shpërfaq një qeveri. Por, kjo shpërfaqje e aspiratave dhe e vlerave duhet ta ketë një model mbi të cilin e bazon edhe mundësinë e arritshmërisë, të themi, të zbatimit të atij buxheti.

Dhe, kur dëgjojmë dhjetëra ndërtime të çerdheve, kur është dëshmuar tanimë një model i paarritshmërisë, në anën tjetër dëgjojmë për reforma në drejtësi pa buxhetim, i bie që po synohet të ndërtohet urë ku nuk ka lumë.

Fatkeqësisht, më herët ministri Murati foli për Prishtinën dhe nuk ka për herë të parë që kur flet për Prishtinën dezinformon. Dhe, nëse nuk gaboj ai vetë jeton në Prishtinë. Nuk e di në qoftë se shkon në Ferizaj ose jo, por me sa unë kam informacion, të shumtën e kohës qëndron në Prishtinë.

Dhe, duke qenë qytetar i Prishtinës, nuk e kam të qartë pse ka të mbetur aq halë në sy, ministër, në kuptimin negativ. Sepse në fund të fundit ti jeton në këtë qytet. Çdo mëngjes del në këtë qytet. Dhe, buxheti, të cilin, ju e thatë më herët, po e jep në vazhdimësi Qeveria për Prishtinën, më duhet t'jua rikujtoj që është buxhet i cili ka bazë ligjore. Pra, e ke Ligjin për kryeqytetin. Pra, nuk është zgjidhje e jotja në dëshiron ose jo t'ia japësh ato mjete Prishtinës, ke obligim ligjor në bazë të Ligjit për kryeqytetin që t'ia japësh.

Pyetja që duhet të shtrohet është: sa buxhet shtesë mbi atë që ta obligon Ligji për kryeqytetin ia ke dhënë ti në ndonjërin prej këtyre viteve me vullnetin tënd kryeqytetit të Republikës së Kosovës.

Dhe, të mos harrojmë ta cekim që përkundrazi, jo vetëm që nuk ia keni dhënë asnjë cent, por ju në fakt keni bllokuar projekte vitale për kryeqytetin. Dhe, kur flisni për fotografinë dhe thoni që dalim të parët bëjmë fotografi, të mos harroni që rrjeti i Termokosit për 40 mijë, 40 mijë qytetarë të Prishtinës është zgjeruar pa ndihmën tuaj vullnetare. Po e përsëris, 40 mijë qytetarë të Prishtinës e kanë rrjetin e zgjeruar të Termokosit pa ndihmën tuaj vullnetare. Pra, të mos referoheni në Ligjin për kryeqytetin, sepse e keni obligim ligjor.

Ju, para jush, pas jush nuk do të kenë tagër të vendosin lidhur me atë buxhet.

Tash dalim pak te rezervat shtetërore, ministër.

Është një pyetje së cilës nuk i jeni përgjigjur as ti dhe as ministrja tjetër që fatkeqësisht për momentin nuk është në sallë: pse e keni bojkotuar për shtatë herë me radhë Komisionin Hetimor për Rezervat Shtetërore?

Dhe, në qoftë se nuk jemi të qartë meqë nuk u përgjigjet as më herët, po e përsëris pyetjen: pse po e bojkotoni për shtatë herë më radhë Komisionin Hetimor për Rezervat Shtetërore?

5 deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje dhe 1 deputet nga Grupi Multietnik, pra 6 anëtarë që bojkotojnë numrat e mjaftueshëm për kuorum nuk vijnë që shtatë herë pa asnjë arsyetim. Dhe, megjithëse ligji na e lejon që t'i zëvendësojmë, ne e dimë nuk i votoni as zëvendësimet. Dhe, edhe nëse i votoni zëvendësimet, prapë e bojkotoni.
Një prej preteksteve tuaja ishte që i besoni prokurorisë. Edhe njëherë po e përsëris, që i besoni prokurorisë. Kësaj prokurorisë që e shani në vazhdimësi po i besoni më shumë se legjislativit si institucion i cili e ka tagrin që të themelojë Komision Hetimor Parlamentar paralelisht me çfarëdo hetimi eventual që mund të bëhet nga prokuroria.

Tash dalim pak te vet buxheti. Në drejtësi, për shembull, u fol edhe më herët që përtej faktit që dikush justifikohet me atë që janë dërguar projektligjet në Gjykatë Kushtetuese, pyetja ime shtrohet për juve kështu: cili nen...

KRYESUESI: Ju lutem për qetësi, deputetë!

DOARSA KICA-XHELILI: Përcakton që kur një ligj shkon në Gjykatë Kushtetuese nuk duhet të buxhetohet reforma që është synuar me atë projektligj?

Edhe njëherë po e përsëris, sepse s'po përgjigjeni në pyetjet tona: cili nen thotë që kur një ligj shkon në Gjykatë Kushtetuese u liron nga obligimi që ta buxhetoni projektligjin, veprimin, reformën dhe nismën që ju e synoni?

Pra, përveç që vetingu nuk është buxhetuar, ne e kemi edhe një problem me Akademinë e Drejtësisë që për të satën herë nuk po e merr buxhetin që do të duhej lidhur me peshën qenësore që ajo e ka për sistemin e drejtësisë.

Gjithashtu, një propozim shtesë do të ishte që ju duhet patjetër dhe me doemos të ndërveproni me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe të flisni për mundësinë e buxhetimin për gjyqtarë shtesë, sidomos të Gjykatës Komerciale, që të mos vijë situata sikurse herën e fundit që një rast që ka interes publik, të komprometohet e të kontaminohet politikisht, sepse i bie motrës apo vëllait të

një deputeti të Vetëvendosje, dhe jo vetëm, sepse fundja s'ka rëndësi, deputet, motër apo vëllai i kujt është.

Cilido aktor politik e kontaminon politikisht atë proces, qoftë po të ishte edhe imi.

Po flas tash pak për buxhetimin gjinor. Nuk ka ndryshime të shpenzimet bazike për strehimore për dhunë në familje, gjë që është kërkuar nga ana juaj, sepse ky buxhetim është i pamjaftueshëm.

Nuk ka buxhet për Qendrën e Krizave të Dhunimit që i trajton viktimat e dhunës seksuale. Nuk ka buxhet për këtë gjë dhe besoj e keni parë edhe reagimin e Rrjetit të Grave të Kosovës për këtë çështje.

Nuk ka buxhet për linjë telefonike, e nuk ka buxhet për punëtorë shtesë në secilin komunë nga 2, dhe në Komunën e Prishtinës nga 4, që ka qenë kërkesë, sërish po them, e këtyre institucioneve dhe e keni paraparë, në fakt, me Ligjin e fundit për barazi gjinore që megjithëse i ka dhjetëra shkelje kushtetuese dhe jo vetëm, ju e keni kaluar. Pra, ligjin që ju vetë e keni kaluar tani nuk po e buxhetoni. Nuk është rritur buxheti për Zyrën e mbrojtjes dhe asistencës së viktimave në përputhje me nevojën që është shfaqur në terren, pra në përputhje me numrin e viktimave për komunë. Dhe, për fund, ministër, vitin e kaluar pata kërkuar me mirësjellje nga ju, meqë çdo propozim, amandamentim tonë e rrëzoni, kam kërkuar që të parashihni buxhet për Linjën e jetës që, përsëris, funksionon, ka funksionuar në fakt vetëm me mbështetje financiare nga donatorë të huaj.

Ju kam treguar që është rritur numri i tentativave për vetëvrasje në Kosovë, numri i njerëzve me gjendje të rënduar psikologjike, të cilat nuk duan medoemos të shkojnë në institucione private, por kanë dashur ta kenë një numër telefonik si çdo shtet zhvillimor demokratik që të thërrasin, ua kam kërkuar duke e ditur që asnjë propozim amendament nuk e kaloni, ua kam kërkuar me mirësjellje. Ka qenë gjë që bëhet.

Për t'jua dhënë shembullin pse ka qenë gjë që bëhet, po jua them një fakt, Forumi Rinor i Lidhjes Demokratike të Kosovës udhëhequr nga Paris Guri, e ka nisur ciklin e vizitave për shëndetin mendor tanimë dy muaj, emëruar me ty dhe ka arritur që këtë linjë telefonike që me gjithë buxhetin që e keni, nuk keni arritur ta bëni, ta krijojë në Istog. Dhe, a di çka? Nga data 10 tetor qindra thirrje telefonike i kanë pranuar dhe tashmë 18 persona marrin asistencë të vazhdueshme nga psikologët që i ka angazhuar Komuna e Istogut.

Tash mendojeni sa e sa raste që nuk kemi arritur t'i parandalojmë, i keni në lëkurën tuaj, për faktin që nuk ju ka dukur e rëndësishme kjo çështje.

Po e përsëris, qindra telefonata nga data 10 tetor, me 18 persona që vazhdueshëm tanimë trajtohen nga Qendra e Thirrjeve në Istog, e cila u mobilizua e u aktualizua sepse një Forum Rinor i LDK-së me përkushtimin që kishte dhe ciklin e vizitave “Me ty” arriti ta bëjë për diçka që ty t’u ka dukur plotësisht e parëndësishme. Andaj, e ke mundësinë e fundit që tani këtë ta bësh si lloj përmirësimi, edhe moral, etik edhe politik për vitin e ri buxhetor 2024 që kjo të jetë në nivel qendror, meqë nevoja për njerëzit që të thërrasin dhe gjejnë një lloj prehje profesionale është e domosdoshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Tash, fjalën e ka kërkuar deputeti Besim Muzaqi.

BESIM MUZAQI: Faleminderit, kryesues!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të dashur qytetarë,
Kolegët opozitarë po tentojnë që përmes keqinterpretimit dhe krahasimeve joadekuate të linjave buxhetore të shkaktojnë konfuzion te qytetarët e Republikës.

Fakti që kemi një projektbuxhet rekord si për nga shifrat 3 miliard e 314 milionë Euro, po ashtu edhe gjithëpërfshirës për nga shpërndarja fletë shumë për atë se për çka ne qëndrojmë dhe angazhohemi si Lëvizje Vetëvendosje, si mazhorancë me besim të paparë ndonjëherë në demokracinë tonë parlamentare dhe si Qeveri e drejtë, e përgjegjshme, transparente dhe e kujdesshme sidomos për ata që kanë nevojë më shumë.

Pra, edhe përmes ndarjeve buxhetore ne kemi dëshmuar përkushtim për të zvogëluar pabarazinë. Përkundër që ne jemi orientuar në politika të majta, përmes të cilave ndihmohen ata që më tepër kanë nevojë si në asnjë vend të Ballkanit Perëndimor dhe në rrallë raste në Evropë, ne kemi shënuar një rritje ekonomike cilësore mbi 5% ku bruto produkti vendor kalon 10 miliardë euro duke iu afruar dyfishimit brenda më pak se tre vjetësh qeverisje.

Krejt kjo duke qenë se qytetarët e kanë rritur besueshmërinë në institucione. Ata nuk hezitojnë të paguajnë tatimet, të raportojnë punësimet, të shmangin informalitetin në secilin nivel, sepse besojnë që paratë e tyre nuk vidhen sikur në të kaluarën. Fakti që buxheti i vitit 2024 në raport me vitin që po e lëmë pas, rritjen më domethënëse e ka orientuar te niveli lokal, pra te komunat, tregon që Qeveria Kurti angazhohet që qytetarëve t’ua kthejë tatimet dhe kontributet e paguara përmes investimeve në projekte kapitale e zhvillimore.

Nga 654 milionë euro për nivelin lokal në 2023, buxheti shkon në 743 milionë euro në vitin 2024, pra 89 milionë euro më shumë për komunat. Rritja e të hyrave buxhetore është ngritur kryesisht nga ATK mbi 115% dhe institucionet e tjera të nivelit qendror, por të mirat po u kthehen qytetarëve në buxhetet komunale.

Në vitin 2021 buxheti për përkrahje të komunave përmes garantit të performansës ishte 3 milionë euro dhe i njëjti ka qenë i bllokuar nga Qeveria Hoti. Tashmë në MAPL kemi 30 milionë euro në dispozicion për 4 vjetët e ardhshme dhe të njëjtat ndahen sipas kritereve të rregulluara me ligj përkatës dhe jo me Rregullore të manipulueshme sikur qeveritë e kaluara. Kryetarët e komunave të vijës së komunikimit me opozitën e këtu të mos ankohen për buxhet, veç le të punojnë e mos ta keqpërdorin.

Nuk qëndrojnë akuzat se Qeveria po i bllokon apo nuk po i mbështet me buxhet komunat, është pikërisht e kundërta e kësaj. Qeveria i inkurajon komunat të realizojnë projekte, respektivisht të shpenzojnë buxhet. Si qenka e mundur nga njëra anë të ankohesh për mospërkrahje buxhetore, pra që s'kanë para, e nga ana tjetër, nuk arrijnë ta shpenzojnë buxhetin e investimeve kapitale as përgjysmë. Të hyrat totale komunale nga koha para pandemisë COVID-19, në vitin buxhetor 2019 ishin 531 milionë e 654 mijë e 853 euro, ndërsa tani para vetes kemi projektbuxhetin me të hyra totale për nivelin lokal prej 742 milionë euro.

Pra, komunat e Kosovës në raport me vitin 2019 do të kenë 211 milionë euro më shumë në vitin 2024 se sa në atë 2019.

Le të ma thotë kushdo nga kolegët opozitarë ndonjë rast, ku ndonjëri nga kryetarët e komunave që vijnë nga partitë e tyre ka ardhur me një projekt të përgatitur dhe i njëjti është refuzuar nga qeveria. Ma thoni një, vetëm një, por jo, s'ka asnjë të tillë. Të vijnë më dëshira në vend të ideve apo fotografi të bukura në vend të projekteve sikur rasti për stadiumin në Therandë, nuk është qasje serioze. Duhet të vijnë me arsyeshmëri, analizë financiare të mirëfilltë, projekt të detajuar, gatishmëri për realizim dhe sigurisht Qeveria do t'iu ndihmojë me financim. Apo rasti i komunës prej nga vijë unë, Vushtrrisë, ku kryetari i komunës nuk ndalet duke u ankuar kinse Qeveria nuk po e mbështet me buxhet, ndërsa deri në fund të muajt shtator ka shpenzuar vetëm 16% të buxhetit të ndarë për investime kapitale. Dhe ky është viti i dytë i dështimit skandaloz në realizim të shpenzimit të buxhetit për investime kapitale atje.

Kurse nga pjesa sado e vogël e realizimit të buxhetit kur u auditua nga Auditori i Përgjithshëm nga 5 kontrata të audituara, në të pestat janë gjetur parapagesa për punë të pakryera në kundërshtim me ligjin. Për shkelje të tilla do të duhej të reagonit edhe ju kolegë deputetë nga opozita, por keni zgjedhur të heshtni, sikur po hesht edhe prokuroria.

Megjithatë, ne kemi ndarë për Vushtrrinë për vitin 2024 buxhet prej 26.8 milionë, euro që janë afër 3 milionë euro më shumë se viti 2023 që kishte buxhet prej 23,4 milionë euro, apo krahasuar me vitin 2019 rritja e buxhetit është 7.65 milionë euro. Në Komunën e Mitrovicës së Jugut është kryetar një ekspert i financave nga PDK, por realizimi i buxhetit po e nxjerr ndryshe. Vetëm 43% ka realizuar buxhet në 9-mujorin që lamë pas. Pastaj, Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 e ka të kualifikuar. Skandaloze, apo jo?!

Atje është edhe një situatë tejet e rëndë pas një rrëshqitje masive të tokës në lagjen Bajr, ku dhjetëra shtëpi janë bërë të pabanuara dhe më shumë se aq janë bërë të pasigurta për të qëndruar në to. Ndërsa, nga Komuna e Mitrovicës nuk kemi kërkesë me projekt për ta stabilizuar dheun apo ndihmuar ata banorë.

Megjithatë, për Komunën e Mitrovicës së Jugut projektbuxheti parasheh rritje mbi 3 milionë euro duke ia ngritur buxhetin nga 25 milionë, në 28,4 milionë euro apo në raport me vitin 2019, Mitrovicës i janë ndarë 8,7 milionë euro më shumë. Prishtina në buxhetin 2024 ka 123.7 milionë euro, apo 17,3 milionë euro më shumë se viti 2023 apo 36 milionë euro më shumë se viti 2019, meqenëse po duam të mos bëjmë krahasime me vitet kur ishte pandemia.

Por, zor Qeveria t'ua kryejë edhe punët që kryetari nuk i kryen dot vetë. Veç 14% të buxhetit për investime kapitale e ka realizuar në 9-mujor. Të mos na lavdërohet askush që po realizon pjesën e buxhetit që është e dedikuar për paga dhe shtesa, sepse ajo pjesë veçse është e parakontraktuar për realizim, mjafton të mos keqpërdoret. Thërras të gjithë deputetët ta votojnë Projektbuxhetin 2024, sepse është buxheti më mirë i përgatitur kundruall nevojave qytetare e shtetërore.
Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhje e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)

KRYESUESJA: Po, deputete Ganimete Musliu. Repikë, a po?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!
Sinqerisht kur po i dëgjoj deputetët e pushtetit duke i lexuar letrat që ua ka dhënë Deona, po mendoj a i kemi dy projektbuxhete a e kemi një. A e keni edhe ju atë projektbuxhet që e kemi edhe ne, o vëlla, se neve shifrat ndryshe po na dalin.

Më flet deputeti për barazi, 5 çerdhe në Podujevë që qeveris Lëvizja Vetëvendosje, një çerdhe në Prizren, edhe atë e ka paraparë të fillojë në vitin 2025 që është vit zgjedhor. Më flet deputeti për barazi, domethënë 400 mijë euro ndahen për çerdhen në Kamenicë, me atë numër të popullsisë që qeveris Lëvizja Vetëvendosje, 200 mijë për çerdhen në Mitrovicë, ku qeverisë Partia Demokratike, e që dihet që numri i qytetarëve në Mitrovicë dhe nevojat e kërkesat në Mitrovicë janë shumëfish më të mëdha se në Kamenicë. Ju bëni hajgare, thoni buxheti më i mirë.

Sinqerisht jeni për çudi, merreni, printojeni, dërgojeni te ndonjë dizajner, e atë 3-miliardëshin le t'ua rregullojë mirë e futeni në kornizë, veç edhe ajo ju ka mbetur. Sikur do ligje që i patëm miratuar që i reklamonit në holl të Kuvendit, unë ju rekomandoj që këtë shifrën 3 miliardë euro të buxhetit merreni futeni në ram, qiteni nëpër bilborda nëpër krejt Kosovën, se veç kjo ju ka mbetur. Unë s'kam parë kurrë në këtë Kuvend njerëz që pa fije turpi dalin e arsyetojnë

dështimin, diskriminimin, pabarazinë, unë veç te ju kam parë. Po do të dilni në zgjedhje, qytetari ka për t'ua treguar vendin.

KRYESUESJA: Kemi kundër-replikë, Gane, edhe Llapi ka të drejtë të ketë gjëra të mira, nuk e di ku është problemi. Kundër-replikë!

BESIM MUZAQI: Faleminderit për fjalën, nënkryetare e Kuvendit, atëherë unë dua t'i them deputetes Musliu që nëse dikush duhet të turpërohet, duhet të turpërohen ata që për 20 e sa vjet kanë krijuar pabarazinë në këtë vend dhe sigurisht që qeveria jonë e drejtë është duke tentuar të rikthejë barazi.

Për sa i përket asaj se çfarë buxheti po lexojmë ne e çfarë po lexojnë këta, në fakt ne jemi, gjegjësisht unë i referohem fjalimit tim që secila shifër mund të verifikohet dhe përveç asaj, i them edhe një që kryetarët e komunave, gjegjësisht kryetari i Komunës ku unë jetoj në Vushtrri nuk ka shprehur gatishmëri që të sjellë projekte, edhe pse i kemi ofruar si deputet. Personalisht i kam thënë vetë që të sjellë një projekt për çerdhe dhe nuk ka vepruar në atë drejtim. Ç't'i bëj unë? Qytetarët kanë nevojë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: E nderuar, veç pak, e di unë kush ka e çka ka të drejtë këtu. E para, Gane unë replikova me ty, nëse ne nuk mund të komunikojmë me njëri-tjetrin, merre fjalën, hajde kundër replikë.

GANIMETE MUSLIU: Sarandë, me gjithë respektin që kam, në momentin kur ti e ke telefonin ndezur, ma përmend emrin, unë kam të drejtë të replikoj, ti ke të drejtë të kundër-replikosh. Besoj që këtu s'ka asgjë të keqe.

Edhe një herë po e them, unë i gëzohem çdo investimi në Kosovë. E thashë edhe në pjesën e parë të fjalimit tim. U gëzohem investimeve në Kamenicë, Gjilan, Shtime e gjithkund, ama nuk mund ju të thoni qe këtu ka barazi dhe ky është buxhet i barazisë.

Sinqerisht po ju them, ju nuk mund t'i flisni askujt për hajni, se keni vjedhur edhe në kaçak të pulave. Lëreni më, se nuk ju beson më populli. Unë e përgëzoj investimin në komuna.

KRYESUESJA: Gane ke kundër-replikë ndaj meje, specifikisht që ka të bëjë me Llapin.

GANIMETE MUSLIU: Me të njëjtën qasje, si në Llap, t'u drejtohen të gjitha komunave të tjera, vetëm atëherë mund të thuhet që ka buxhet të mirë. Kaçak të pulave keni vjedhur.

KRYESUESJA: Vazhdojmë! Tani e ka fjalën Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zonja kryesuese!
Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar, i mbetur,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Janë thënë shumë gjëra sot prej diskutimeve të para e prej një ekspozeje të vobektë e të varfër të kryeministrit në raport me Projekt-buxhetin e vitit 2024. Ndërkohë që po them është njëri prej buxheteve më jodinjitoz që e kemi parë në historinë e re të Kosovës. Një buxhet diskriminues, një buxhet i cili nuk bën fjalë për zhvillim e transformim të Kosovës, një buxhet që është buxhet i frikës e jo i sigurisë së qytetarëve të Kosovës, buxhet i izolimit e assesi i integrimit.

Në fakt, nuk është as buxheti i cili është proklamuar gjatë në programin qeverisës të kësaj Qeverie të zgjedhur para tre vjetësh, kur Kryeministri Kurti pas betimit të tij si kryeministër u deklarua se ishte datë historike edhe përgjegjësia e tij në raport me qytetarët e Kosovës do të jetë përgjegjësi historike. E në fakt, sot po shohim, jo që s'ka përgjegjësi historike, po s'ka fare llogaridhënie në raport me shqetësimet, të cilat sot i kanë qytetarët e Republikës së Kosovës e të cilat nuk janë aspak të reflektuara në këtë buxhet elektoral, buxhet zgjedhor, buxhet të proklamues, por assesi buxhet zhvillimor, për të cilën u provua sot që të trumbetohet.

Pra, u përmendën 160 çerdhe, të cilat në programin qeverisës i keni proklamuar dhe i keni premtuar. Në fakt, i ka rënë nga dyzet çerdhe për vit e katër mijë banesa për çifte të reja. Ta keni parasysh, të nderuar kolegë deputetë, në projektbuxhetin e vitit 2021 kanë propozuar një amendament për një çerdhe në komunën e Skenderajt, dhe në mesin e 35 amendamenteve të refuzuara të kolegëve të mi opozitarë, ka qenë amendamenti i vetëm që ka marrë mbështetjen e shumicës parlamentare. Dhe po, u provua të thuhet që ne po e mbështesim opozitën, në kur e njëjta parti që udhëheq me shumicën parlamentare nuk i ka kryer as për së afërmi obligimet në raport me çerdhet, të cilat i ka premtuar, e të cilat lidhen edhe me çështjet e punësimit, që i përmendi kryeministri.

Në rregull, për bursat për të cilat u tha se po jepen për gratë. Në rregull për punësimin dhe zhvillimin ekonomik, por ta keni parasysh, vetë 17 për qind e grave sot janë të përfshira ose të punësuara në tregun e punës. D.m.th. të dhënat flasin se ato janë më të nënpaguara se burrat.

Ndërsa, faktorët që u mundësojnë grave të përfshihen në tregun e punës, natyrisht që prej tyre janë edhe mundësitë që ato t'i kenë fëmijët nëpër institucione parashkollore dhe ka një mungesë të theksuar. Si pasojë e këtyre, detyrohen që fëmijët t'i çojnë nëpër institucione private, ku kostoja është e lartë dhe kjo Qeveri nuk e ka përmbushur as për së afërmi obligimin e saj. Ndonëse ka premtuar dhe ka ndarë 3,2 milionë euro për një projekt të çerdheve modulare në shtatë regjione të Kosovës.

Pra, sa çerdhe mund të ndërtohen deri në fund të mandatit qeverisës, le të na e thotë sot Qeveria, a mund të ndërtohen pesë, a do të ndërtohen apo pesëmbëdhjetë sot, bazuar në proklamimet e Qeverisë?

U përmendën investimet kapitale dhe çfarë kemi parë? Pak realizim, e pritshmëri pak. Çka të themi, kur deri më datën 30 shtator të këtij viti, Qeveria ka shpenzuar vetëm 29% të buxhetit të ndarë për investime kapitale, apo 263 milionë euro. Ndërkohë, që plot kategori të shoqërisë sonë, duke filluar prej policëve deri te minatorët, së fundmi te zjarrfikësit, po injorohen nga Qeveria.

Zjarrfikësit sapo kanë paralajmëruar protestë për mospërmbushjen e shumë obligimeve nga Qeveria në raport me kushtet e rënda të punës, pagat, orët e papaguara, e shumë të tjera.

Në raport me policinë, e dini deklaratën e kryeministrit, thotë: “Secili pjesëtar i Njësisë Speciale ka pajisje në vlerë prej afro 10 mijë eurosh”, në kohën kur atij i kërkohet që të mbulohen shpenzimet e rrezikshmërisë. E njëjta ka ndodhur me minatorët.

Para tre vjetëve kryeministri premtonte kushte më të mira për ta, ndërkohë që në grevën të cilën e kemi parë të gjithë, kanë munguar madje edhe vizitat dhe takimet me ata njerëz, të cilët kanë kërkuar kushte dhe dinjitet, e në fakt këtë dinjitet po e shohim fare pak, për të mos thënë aspak nga kjo Qeveri.

E në anën tjetër, është paradoksale të thuhet që janë paguar rreth 1 milion euro për serbët të cilët nuk kanë vijuar punën për vitin 2022 dhe 113 milionë euro për energjinë që serbët në veriun e Kosovës nuk e kanë paguar gjatë vitit 2022 dhe vitit 2021.

Pra, gojën që s’kemi buxhet, që 150 euro janë të mjaftueshme për shtesat për policët, ndërkohë që miliona euro të paguara, ose 1 milion euro të paguara për serbët që nuk kanë vijuar punën në vitin 2022 dhe 113 milionë euro për energjinë elektrike në pjesën e veriut për vitin 2021 dhe 2022.
Të mos harrojmë, ky buxhet nuk reflekton nevojat e qytetarëve, sepse çmimi i energjisë për ta është rritur dy herë. Pra, është ngritur 100%, e një herë tjetër 15.4%.

Shëndetësia, meqë e kemi, ose s’e paskemi ministrin këtu. Në ekspozenë e tij qeverisëse Albin Kurti na thoshte se në vendin tonë askush nuk duhet të falimentojë nëse sëmurët. E kishte fjalën sigurime shëndetësore, përderisa proklamonte angazhimin e tij qeverisës në krye të qeverisës në krye të Qeverisë Kurti.

Paramendojeni, të njëjta premtime sot i kemi boshe, as s’ka sigurime shëndetësore diku në horizont. Ministria e Shëndetësisë ka shpenzuar vetëm 8% të buxhetit për investime kapitale,

ndërkohë çfarë shohim sot nëpër spitalet tona, i shohim listat e pritjes për shërbime mjekësore e shëndetësore në QKUK janë zgjatur për muaj e vite.

Sot, të sëmurët me zemër, ata të cilët kanë sëmundje kardiovaskulare e kanë nevojë për trajtim, stendim apo operim, duhet t’u drejtohen institucioneve private me kosto të larta për shkak të pamundësisë të trajtohen brenda institucioneve publike.

Kjo nënkupton se ata duhet të paguajnë me mijëra euro nga buxheti i tyre i varfër, apo edhe të futen në kredi për të arritur që të trajtohen. A po e kuptoni, të nderuar kolegë deputetë, qytetarë të Kosovës, në cilën gjendje jemi sot, dhe a është kjo zgjidhja e duhur, a është ky dinjiteti, a kjo është kjo barazia, është kjo drejtësia për të cilin foli sot kryeministri.

Cila drejtësi është sot për minatorët? Cila drejtësi është për policët? Cila drejtësi është sot për punëtorët e ndërtimtarisë? Pra, çfarë planifikimi e çfarë Qeverie është kjo? A është Qeveri e luksit? Ndërkohë që po flasim, luksi i kësaj Qeverie nuk po ndalet.

Ta keni parasysh vetëm brenda Ministrisë së Kulturës janë ndarë 500 mijë euro për automjete. Në një ministri tjetër, 200 mijë euro të tjera për automjete.

Nëpër agjenci të tjera qeverisëse, të cilat mbahen në kuadër të Qeverisë, janë me mijëra euro të cilat janë të ndara për automjete për luksin dhe për mallra e shërbime për të cilat sot u tha se nuk qenkan luks. E thanë po këta ministra.

Shpenzime janë rritur për mallra dhe shërbime në 25 milionë euro nga një Qeveri e cila ka thënë se do të ndalet luksi, do të ndalet gjakderdhja financiare. Sot, shpenzimet po shihet se po rriten. U përmend edhe koeficienti i pagave, ndërkohë që u tha që ka një rritje nga 105 euro në 110.

Megjithatë, më thoni për çfarë rritje mund të bëhet fjalë në këtë fazë të rëndë të inflacionit, i cili ka qenë më i larti ndonjëherë dhe sa do të reflektohet kjo në nevojat që i kanë sot qytetarët e Kosovës.

Sa për diskriminim e komunave, ky është shumë evident. Është i partizim më i saktë, partizim më i prerë, më cezarian sesa që kemi parë në këtë ndarje të buxhetit nuk ka pasur asnjëherë. Dhe, po, e shihni dhe a mund të na tregojë dikush sot se çfarë problemi ka kjo Qeveri me komunat e Republikës së Kosovës? Pse po diskriminohen këto komuna të cilat nuk udhëhiqen prej Vetëvendosjes? Pse po diskriminohen qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët jetojnë në ato komuna ku ju nuk keni pushtet?

Si është e mundur, kolegë deputetë, që gjysma e mjeteve të parapara nga komunat për komuna shkojnë për vetëm 4 komuna të cilat qeverisen nga Lëvizja Vetëvendosje. Po çfarë lloj drejtësie apo planifikimi është ky, më thoni ju mua.

E përmendi Komunën e Vushtrrisë e të Mitrovicës në kohën që një komunë e vogël që qeveriset prej Vetëvendosjes janë të ndara 1.1 milion euro, ndërsa Skenderaj i ka vetëm 15 mijë euro. Kjo nuk është drejtësi, kjo nuk është barazi. Ky është diskriminim i plotë që ne e shohim, ashtu siç e kemi parë edhe te diskriminimi për çështjen e vërshime që u desh një vit që në fund Qeveria të marrë vendim për t'i kompensuar ata qytetarë të komunës së Skenderajt, Mitrovicës, Klinës, Podujevës për dëmet që i kanë pasur nga vërshimet.

Kryeministri Kurti po pretendon se ka ndarë miliona euro për punësim. Unë po ia kujtoj kryeministrit se gjatë qeverisjes së tij, 200 mijë qytetarë e kanë lëshuar Kosovën. Për 2 vjet, kolegë deputetë, 200 mijë qytetarë e kanë lëshuar Kosovën, dhe ky është raporti i Bankës Qendrore të Kosovës që thotë se vetëm në tremujorin e parë të vitit 2023...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Do të thotë, raporti i Bankës Qendrore të Kosovës na e tregon qartë se vetëm në tremujorin e parë të vitit 2023 janë mbyllur gjithsej 446 ndërmarrje, ndërkohë që gjatë tërë vitit pritet të mbyllen më shumë se 2 mijë ndërmarrje.

E në fillim të këtij viti kishte 10 mijë punëtorë më pak Kosova. Pra, në këtë rast dua t'i përmend edhe kushtet e rënda të punës që i kanë punëtorët. 18 vdekje për shtatë muaj kanë ndodhur në vendin e punës, kryesisht në sektorin e ndërtimtarisë. Sektori privat është pothuajse në mëshirën e fatit.

Pra, cilat janë kushtet që sot punojnë punëtorët? Cilat janë pagat që ata i kanë? A kanë sigurime shëndetësore këta punëtorë? Sa inspektorë i ka shtuar kjo Qeveri? Përkundrazi, Qeveria e ka ulur buxhetin për Inspektoratin e Punës 14% në kategorinë paga dhe shtesa.

Ju vetëm që nuk i përmirësoni kushtet e punëtorëve, por ju edhe i luftoni sindikatat. Kjo tregon për natyrën autoritare që e ka kjo Qeveri, dhe natyrisht buxheti është komplet manifestim i kësaj mendësie autoritare.

Pra, janë të gjitha këto shifra për të cilat tashmë ka dëshmi. Dhe, krejt në fund, për mua ishte e habitshme lehtësia me të cilën kryeministri sot tha se ka emigrim, por s'ka zbrazje të Kosovës. Kryeministri besoj që i di shifrat qartë, kryeministri është i informuar saktë se sa qytetarë e kanë

lëshuar Kosovën. Cila është shpresa me të cilën ai i ka joshur në qeverisjen e tij. Cilat janë barometrat që flasin për këtë ikje dhe për këtë humbje të shpresës, dhe sa për qind e qytetarëve sot e shohin opsion ikjen në 1 janar. Dhe, mua më befason lehtësia me të cilën ai sot deklarohet se nuk mund të flitet për emigrim ose zbrazje të Kosovës, ndërkohë që i njëjti heziton ta bëjë regjistrimin e popullsisë, sepse i njëjti u frikësohet këtyre shifrave.

KRYESUESJA: Ministri Murati, replikë!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!
Sa u përket çështjeve që u ngritën me të vërtetë ka shumë pasaktësi, por po u referohem disave të fundit që u thanë.

Çështja për punëtorët në sektorin privat, por edhe në përgjithësi në tregun e Republikës së Kosovës, aktualisht janë 412 mijë persona që punojnë dhe janë të deklaruar në Administratën Tatimore. Kjo është shifër zyrtare e verifikueshme. Dhe, nuk e di se ku e keni gjetur këtë shifrën, ku 10 mijë më pak janë, sepse u tha edhe më herët që është zvogëluar numri.

Ose, kur flisni për mbyllje të ndërmarrjeve, të na tregoni edhe sa janë hapur, sepse mbyllje ka në vazhdimësi. Ka persona që e mbyllin biznesin individual, sepse bëhet shpk, mirëpo na tregoni edhe në anën tjetër, pra sa biznese, sa ndërmarrje janë hapur brenda një viti kur flisni për atë se sa janë mbyllur.

Kurse sa i përket Inspektoratit të Punës, e kemi gjetur me 22 inspektorë. Pra, për 20 vjet i keni punësuar 22 inspektorë të punës. Me gjitha sfidat që ka Ligji për zyrtarë publikë, që ka pasur ai vjetri, kemi arritur ta shtojmë numrin, ta trefishojmë në 60 sosh, dhe do të vazhdojë rritja e numrit të inspektorëve të punës edhe gjatë ditëve e muajve në vijim, mirëpo e kemi trefishuar. Ju e keni lënë me 22 sosh.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë, deputetja Deliu-Kodra!

BLERTA DELIU-KODRA: I nderuar ministër!
Se kjo Qeveri e ju jeni kampion të manipulimeve me shifra, kjo nuk është tashmë e re. Ju kemi parë në vazhdimësi dhe po flisni për Inspektoratin, ndërkohë që kryeinspektori në atë institucion që ju i referoheni është i zgjedhur në formë të kundërligjshme.

Keni emëruar militantë partiakë e politikë. I keni mbushur bordet e ndërmarrjeve me militantë, ndërkohë që shifrat e Bankës Qendrore, të cilave iu referova unë, janë shifra legjitime. Të njëjtat i thotë edhe raporti për vendin. Janë shqetësime reale që qytetarët e Kosovës po i mbyllin bizneset për shkak të pasigurisë, për shkak të mungesës së drejtësisë dhe kushteve të rënda me të

cilat sot përballet veçanërisht sektori privat, për të mos folur edhe për koeficientin për të cilin unë dhashë sqarimet e mia. Pra, për manipulime me shifra jeni kampion dhe për këtë nuk jua kalon askush.

Për të tjerat, besoj që dëshmitarë janë qytetarët e Kosovës.

KRYESUESJA: I kemi edhe dy replika. Ministri Çeku e ka fjalën.

MINISTRI HAJRULLA ÇEKU: Pasi u përmend një buxhet i Ministrisë së Kulturës për blerje të veturave. Vetëm për sqarim. Teatri Kombëtar, Filarmonia Kombëtare, Opera e Kosovës, Galeria Kombëtare, Galeria e Ministrisë, Ansambli Shota, Baleti Kombëtar, Biblioteka Kombëtare, Inspektorati i Trashëgimisë, Agjencia e Arkivave, Instituti Arkeologjik i Kosovës, Muzeu Kombëtar i Kosovës, Instituti i Kosovës për Monumente, Agjencia Antidoping, Qendra Kinematografike, Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në 7 zona, në themelim me ligjet e reja, Agjencia e Sportit, Agjencia e Rinisë, Inspektorati i Sportit.

Pra, 25 institucione të varësisë i ka Ministria e Kulturës, të cilat janë të terrenit dhe kanë nevojë për vetura. Nuk është buxhetim i luksit, por i nevojave bazike që këta t’i kryejnë punët e tyre në terren, prej monitorimit, inspektimit e shumë të tjerave.

Ndërsa sa për barazi e pabarazi, dëgjova shpesh që buxheti nuk është i balancuar në territor dhe e bëra një shikim të shpejtë në buxhetin tonë se mos është e vërtetë që veç në komunat ku qeverisë Lëvizja e paskemi dërguar buxhetin.

Po e kaloj shumë shpejt, janë kështu: stadium “Adem Jashari” në Mitrovicë, 12 milionë, stadiumi në Gjilan, 15 milionë, stadiumi në Pejë, 14,5 milionë, Qendra Nacionale e Xhudos në Pejë, 6 milionë, renovimi i stadiumit në Gjakovë, 4 milionë, renovimi i Pallatit të Rinisë në Prishtinë, 12,5 milionë, stadiumi në Ferizaj, 12,1 milionë, shtegu i atletikës në Kamenicës, 3,5 milionë, kompleksi multi sportiv në Prishtinë, 3,5 milionë, kompleksi multisportiv në Prizren, 2,3 milionë, Muzeu i Artit Bashkëkohor, Teatri Kombëtar në Prishtinë, 11 milionë. Pra, pjesa dërmuese janë në të gjitha komunat ku nuk qeveris Lëvizja Vetëvendosje.

KRYESUESJA: Kundër-replikë!

BLERTA DELIU-KODRA: Zoti ministër Çeku,
Unë meqë vij nga komuniteti artistik, nevoja kanë edhe Teatri Kombëtar, edhe Ansambli Shota, edhe institucionet e tjera, por më thoni ju mua kur ndahen 500 mijë euro vetëm për automjete, në kohën kur kryeministri deklarohet se i mungon buxheti për çështje të pagave, nuk diskutohen pensionet, është destinim i gabuar i Qeverisë dhe nuk mund të flitet për barazi.

Ta keni parasysh, keni harruar deri sa edhe xhipat e zinj i keni përmendur. Dhe, kjo është e turpshme. Ju i keni akuzuar për vite të tëra sigurimin, të cilin e kanë pasur zyrtarët e lartë të shtetit. Dilni sot rrugëve të Prishtinës, sot në këtë tollovi të trafikut mezi kam mbërritur të ofrohem te banesa ime, pikërisht për shkak të këtyre shpenzimeve të larta që ju i keni, e të cilat janë shpenzime të luksit.

Sa për stadiumin “Adem Jashari” në Mitrovicë asgjë nuk ka ndodhur, ju keni zvogëluar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Gjithashtu, edhe ministrja Rizvanolli ka kërkuar replikë.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Sa i përket punësimit të grave, besoj që të gjithë pajtohemi që është sfidë. Por, besoj që edhe ju pajtoheni që kurrë më shumë nuk është bërë për punësimin e grave dhe kurrë për një periudhë kaq të shkurtër nuk ka pasur kaq shumë progres në punësimin e grave.

Përderisa në vitin 2019 norma e punësimit ka qenë 13,9% dhe 14,1% në vitin 2020, kjo është rritur në 16,5% dhe 18,4% në vitet 2021 dhe 2022. Do të thotë, 4,5 pikë të përqindjes, ose 1/3-ta më shumë sesa ka qenë. Kjo është sigurisht rezultat i shumë ndërhyrjeve, duke filluar nga grantet për biznese të grave, bursat për gratë dhe vajzat në STEM, dhe gjithashtu promovimin e grave në secilën pozitë, edhe në pozita vendimmarrëse, edhe në numër rekord të grave në borde, edhe të ndërmarrjeve publike, edhe të institucioneve të pavarura.

Sa për minatorët, nuk besoj që keni të drejtë morale të flisni. Keni dashur dhe doni të privatizoni Trepçën, t’i shisni mbetjet dhe asetet dhe ky është qëllimi juaj. Andaj, nuk besoj se mund të flisni shumë për këtë.

KRYESUESJA: Kundër-replikë!

BLERTA DELIU-KODRA: Ministër Çeku,
Sapo më informojnë që veturat 3Z të ministrisë suaj, ...

KRYESUESJA: E nderuar, kundër replikën e ke me ministren Rizvanolli.

BLERTA DELIU-KODRA: ...voziten prej këshilltarëve dhe aktivistëve politikë të Lëvizjes Vetëvendosje dhe kjo është legjitime, këtë mund t’jua konfirmoj.

Sa i përket punësimit të grave, gjatë vitit 2022 përqindja e punësimit nga mosha 15 - 64-vjeçare ishte 18,4% për gra dhe 49,4% për burra. Dhe, ky është një dallim i madh prej 31%, zonja ministre.

Unë i gëzohem çdo avancimi në agjendën e punësimit të grave dhe i inkurajoj edhe bursat, për të cilat ju folët. Por, pse kjo qeveri ka marrë mbështetjen më të madhe të grave ndonjëherë dhe që edhe gratë brenda Kuvendit të Kosovës janë larguar prej punës, këtë e kanë thënë zyrtarë të Lëvizjes Vetëvendosje, nuk po e them unë. Prandaj, nuk mund të shquheni për gardianë të barazisë, të punësimit e të drejtësisë asnjëherë.

KRYESUESJA: Replikë, ministri Vitia!

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, nënkryetare!
Tash më duhet të përsëris edhe një herë atë që e thashë. Besoj që isha i qartë edhe herën e parë. Sigurimet shëndetësore nuk janë buxhet, as nuk është diçka që buxhetohet për sigurimet shëndetësore. Sigurimet shëndetësore janë para që mblidhen nga pagat e qytetarëve dhe nga punëdhënësit e tyre. Domethënë, të sqarohet njëherë kjo temë, se për besë po vijmë në një... të mos përdor asnjë terminologji, por kaq pak duhet të kuptohet.

Këto që i përmendët, deputete e nderuar, a i keni ditur edhe më herët, apo ju ka rënë ndërmend vetëm këto dy vjetët e fundit, sepse të gjitha këto probleme që janë në Qendrën Klinike Universitare, me të gjitha problemet që i përmendët me investime në nyje sanitare e ku të di unë, andej këtej, probleme me barnat e të gjitha këto, si nuk ju ka rënë ndërmend më herët?

Në 2019-tën e kemi gjetur, ka qenë 200 milionë euro buxheti, në 2024-tën është 345 milionë euro buxheti dhe ju e dini shumë mirë se vetëm ne mund ta bëjmë këtë, se përndryshe për njëzet e sa vjet i kishit bërë ju këto. Po tash, sinqerisht, për dy vjet që po na kërkoni t'i bëjmë gjithë këto, po na... po dy vjet të pandemisë, pyeteni zotin Zemaj, se edhe zoti Zemaj ka qenë ministër në pandemi. Për dy vjet që po na kërkoni t'i bëjmë këto, ne prapë do t'i bëjmë, po faleminderit sinqerisht për besimin dhe faleminderit sinqerisht për krejt këtë besim që e kemi në punën tonë, në të cilën sinqerisht edhe para qytetarëve do ta dëshmojmë që do t'i bëjmë.

KRYESUESJA: Kundër-replikë, deputetja Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Zoti ministër,
Unë për çështje të sigurimeve shëndetësore po i referohem deklarimit të kryeministrit në kohën kur është votuar Qeveria juaj. Askush nuk guxon të falimentojë, nëse sëmuret, sepse duhet të ketë sigurime shëndetësore, e ka thënë këtu Albin Kurti, nuk e kam thënë unë.

Dhe, po i referoheni çështjes së buxhetit të qeverisjes sonë, kur ne kemi pasur buxhetin diametralisht më të ulët, sesa ju që e keni sot. Pa krahasueshëm më të ulët. Partia Demokratike e Kosovës ka qeverisur me Ministrinë e Shëndetësisë për dy vjet dhe le të më korrigjojë dikush, nëse qeverisja e zotit Uran Ismaili nuk ka qenë prej qeverisjeve më dinjitoze, më të mira, ku listat e pritjes për të gjithë pacientët, qoftë në shërbimet kardiovaskulare, qoftë në shërbimet e trajtimit të pacientëve me kancer, kanë qenë në pritjen më të ulët ndonjëherë. Shihni sot, takoni pacientët, besoj e dini, zoti ministër, për çfarë po flas.

KRYESUESJA: Tani e ka radhën deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!
Ministra,
Kolegë deputetë,
Nënkryetare e Kuvendit,
Ju kisha lutur pak për qetësi, nëse mundeni. Nëse s’mundeni, vazhdoni, unë komunikoj me ministrat këtu që i kam.

U mundova të marr sa më shumë dokumente zyrtare, ato që janë në ueb faqet e ministrive të linjës dhe me krahasuar me 8,5 miliardë të këtyre tre vjetëve të buxhetit, shpenzimet, të arriturat, sfidat, ngecjet, besa edhe ku mundemi ne atje, Kuvendi i Kosovës, të ndihmojë sado pak në interes të qytetarëve.

Unë po mendoj se është keq për një qeveri kur nuk dialogon me askënd dhe bën buxhet për të gjithë, ose kur kjo qeveri i shpall luftë çdo sektori, ndërsa projekton buxhet për të njëjtin. Edhe me keq është për këtë qeveri, që nuk dëgjon, por në shumë raste vetëm hamendëson.

Është keq e më keq për një qeveri që ndërton kriza e pastaj synon që ta blejë paqen sociale me lëmoshë financiare, e këtu kemi shumë raste. Një qeveri që nuk flet me mësuesin, një qeveri që nuk flet me prindërit dhe një qeveri që nuk flet me sindikalistët. E më e keqja për këtë qeveri, në kohët nëpër të cilat po kalojmë, është se nuk flet me policin dhe as me strukturat e tjera të sigurisë. Tash së fundmi, nuk komunikon as me sindikatat e tyre. Qeveria që i lufton është ajo qeveri që i dëmton krejt. Qeveria që nuk flet me mjekun, qeveria që nuk flet me infermierin, pacientin dhe sindikalistin.

E duke pasur një buxhet në rritje, që ishte dashur të përkthehet në aspekt pozitiv, po të bisedohej me mjekun nuk do të kishim largim të mjekëve nga Kosova. Dhe, tash këtu unë e ngre si pyetje dhe si shqetësim buxhetor menaxherial me ministrin e Shëndetësisë. Vetëm në këtë vit nga Kosova janë larguar 7 mjekë specialistë, 16 specializantë dhe 123 doktorë të mjekësisë. Arsyet pse e kanë lëshuar Kosovën janë, siç kanë theksuar ata vetë, kushtet e punës, punësimi dhe

ambienti i punës, ose edhe të ardhurat nga vendi i punës. Këto janë nga Oda e Mjekëve të Kosovës.

Qeveria që i sulmon ndërmarrësit dhe nuk ka ndjeshmëri as për konsumatorët që po vazhdojnë të përballen me inflacionin, është qeveri e keqe, qeveri që me qasjen e saj ndikon në rënien e fuqisë blerëse. A më shumë është blerë vitin e kaluar, shporta familjare, apo sivjet? Këtë përgjigje mund ta jepni edhe me buxhetin për vitin 2024.

Qeveri që arrin të ketë rënien më të madhe ekonomike, e thanë ekspertët ekonomikë, nga viti në vit, ose nga vitet paraprake. Është shumë keq për një qeveri, që mbi 8,5 miliardë euro i ka pasur në shfrytëzim për tre vjet, ndërsa gjithë ditën po flasim këtu, asnjëri nga ministrat me kompetencë nuk mundën ta bindin Kuvendin, as ju, për ndonjë projekt të madh kapital, përjashto atë urën në Staradran, që tashmë është bërë temë duke e përmendur.

Gjithë ditën ne flasim për përmbushjen e obligimeve për investime kapitale, ndërsa unë këtu, pasi që i paskam këta ministra, më vjen keq që nuk janë ndoshta edhe të tjerët. Ministria e Ekonomisë deri më 1 tetor i ka 7% të investimeve kapitale, Ministria e Shëndetësisë vetëm 8% të shpenzuara, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit vetëm 10%, Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal 0%, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 0%. Nëse ka ndodhur ndonjë zhvillim i madh në nëntor, ndonjë investim i madh, atëherë ministrat mund të dalin dhe të diskutojnë.

Qeveria, jo kjo, po të gjitha qeveritë, që të pasurin e bënë më të varfër, ndërsa të varfrin e bënë edhe më të varfër, nuk është e mirë, është e keqe. Besoj që pajtoheni të gjithë. Qeveria që vjen në pushtet mbi premtimet se do ta ndihmojë të varfërve, do të ulë luksin qeveritar dhe vepron të kundërtën, nuk është e moralshme. Në nëntëmujorin e këtij viti në shpenzimet janar - tetor 2023 njëzet e shtatë milionë janë shpenzuar për luksin qeveritar, gjashtë milionë më shumë se në vitin 2022, trembëdhjetë milionë më shumë se në vitin 2021. Për çfarë e kanë rritur luksin, nevojat, prapë këta duhet të përgjigjen.

Po, me gjashtë milionë më shumë dhe me trembëdhjetë milionë më shumë ndoshta do të ishin zgjidhur shumica e problemeve që po flasim. Nuk do të kishim pasur protesta të policëve, nuk do të kishim pasur protesta të zjarrfikësve, të cilët me nga tre-katër orare duhet ta mbajnë punën e tyre.

Andaj, kjo mendësi e tillë është gjykuar shpeshherë në të kaluarën. Është thënë që jeta luksoze nuk u takon qeveritarëve dhe duhet të barazohesh, ose të jetosh me hallet e qytetarëve.

Qeveria që propozon buxhet tepër të dobët, i thamë që janë 100 milionë, është rekord nga viti i kaluar, ndërsa më të dobët e ka dëshmuar që e ka realizimin. E këto janë sukseset matëse që

duhet t'i ketë një qeveri. Nuk duhet të sillet varësi për lëmoshë financiare, por të sigurojë mirëqenie për të gjithë.

Qeveria që nuk di pë buxhet, nuk ka projekte, edhe ato pak që i propozon po shihet se vetë nuk i realizon. Është keq për një qeveri që me anë të shpërndarjes së lëmoshës financiare praktikisht synon vetëm blerjen e votës, jo mirëqenien e qytetarëve të vendit.

E fundit, është keq për një qeveri që fut vendin nën sanksione, e vret ekonominë, e vret mirëqenien, e vret shpresën dhe shndërrohet në sponsorizuesen kryesore për ikjen e qytetarëve nga vendi. Me një fjalë, ky buxhet edhe nga replikat dhe kundër-replikat më shumë pasqyrohet për të blerë pushtet, e jo për të zhvilluar shtet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Vendenis Lahu.
Të nderuar, kemi disa replika. Kërkoj falje! Ministri Vitia dhe ministri Krasniqi.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryesuese!
Zoti Zemaj, deputet Zemaj, faleminderit për krejt shqetësimet.
Ju thatë në një moment që ne nuk dëgjojmë, por hamendësojmë. Kjo më bjen në një përfundim tjetër, që ju i keni dëgjuar njerëzit e gabuar pra. Ose, keni marrë militantë, ose dikënd, por i keni dëgjuar komplet njerëzit e gabuar.

Ju folët për ikjen e mjekëve, zoti Zemaj, po ju, me sa di unë, i keni hapur mbi 1500 specializime dhe patët thënë që kjo u rregullua njëherë e mirë për të mos ikur mjekët. Po, mjekët po vazhdojnë të ikin.

Po tash, a keni ndonjë informatë, sa kanë ikur në kohën e LDK-së, të PDK-së, apo kur keni qenë bashkë, se çdohetë ashtu ka qenë me juve. Edhe, çka është tjetra e rëndësishme, zoti Zemaj, që fola sot dhe thashë do të flas me shifra, vetëm t' ju tregoj disa çështje që kanë ndodhur dhe nuk është fatkeqësia që kanë ndodhur atëherë, po që po përballemi akoma me problemet që kanë ndodhur në atë kohë.

Në kohë pandemie 1 500 specializime, ku merren nga rajonet mjekët dhe lihen qytetarët në mëshirë dhe shkohet e bëhet kaos në QKUK. Në kohë të pandemisë, domethënë buxhetin e 2021-tës, nga 121 milionë euro në 2019-tën që ka qenë buxheti në SHSKUK, ju e bëni në 104 milionë. E ulni kush e di sa, llogarit vetë. E ulni buxhetin nga fondi i sigurimeve shëndetësore nga 2019-ta e 2020-ta, prapë në 2021-tën.

Sa i përket grantit specifik, që u përmend shumë për komuna, ju nuk ia keni shtuar asnjë cent, nga 61 milionë qysh ka qenë, 61 milionë e keni lënë. Kurse sivjet, zoti Zemaj, është 82 milionë euro. E për më... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Po ia shtoj kohën, por atëherë do ta ketë një minutë shtesë edhe zoti Zemaj.

MINISTRI ARBEN VITIJA: A po? Dhe për fund, në kohë pandemie, në vitin 2021, buxheti nga 36 milionë euro në listën e barnave esenciale është zbritur në 21 milionë euro, zoti Zemaj.

Edhe kjo klisheja me Odën e Mjekëve, edhe me këto informata, kur i keni dëgjuar më herët, ose kur i keni përmendur më herët, ose çfarë bashkëpunimi keni pasur më herët me ta, zoti Zemaj? Për besë... Jo, ne nuk e bëjmë atë. Mund t'i thoni zotit Zemaj t'i mbyllni, mirëpo ne bashkëpunojmë dhe bashkëpunojmë korrekt, edhe kritikat, edhe sugjerimet, edhe këshillat i marrim bashkë, edhe bashkëpunojmë bashkë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Zemaj, kundër-replikë!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!
Ministër,
Njerëzit që punojnë ndonjëherë edhe gabojnë, po dikush që nuk punon hiç dhe nuk e lëviz as rezën e derës, ai s'gabon kurrë, se s'punon kurrgjë. Tre vjet, tre ministra, duke përfshirë edhe Kurtin të vetemëruar si kryeministër në komitetin ekzekutiv, rezultatin fatkeqësisht, me dhembje e them, e keni zero. Investimet kapitale njëmbëdhjetë projekte, duke përfshirë edhe Sistemin informativ shëndetësor zero. Krenaria më e madhe e Kosovës, mjekët janë duke të dëgjuar, mjekët e rinj janë duke të dëgjuar. Krenaria më e madhe për Kosovën, edhe ato njëzet vjet dhe atyre regjimeve, është dhënia e specializimeve dhe mbajtja e atyre bijave dhe bijve të prindërve që i kanë shkolluar me mund e sakrificë në Republikën e Kosovës.

Edhe unë jam shumë... po ikin, se ti s'po ua plotëson kushtet e punës. Ti s'po ua paguan orët shtesë, ti nuk po ua paguan ndërrimin e natës, ti po i injoron, ti nuk i pranon në takim për të biseduar, ose njerëzit përgjegjës. Domethënë, jo militantët, mjekë janë ata, mjekë janë. 1 500 mjekë, ka deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje janë të shkëlqyeshëm specializantë. Gabim e ke, nuk janë militantë, janë bijë dhe bija të prindërve, të cilët njëqindmijë euro u ka kushtuar nga buxheti i tyre i varfër për t'u shkolluar. Unë i kam ndalur në Kosovë. Krenar jam unë, Lidhja Demokratike, Qeveria Hoti, po besoj edhe qytetarët e Republikës së Kosovës. Edhe ajo është vërtetuar me mbështetje popullore.

Gabim e ke, ministër. Sa i përket Odës, unë vetëm u thirra në statistika zyrtare, se odat që kanë orientim militant, unë ua kam kallëzuar adresën dhe vendin me vakt, edhe atë e di ti, e dinë edhe ata, edhe atyre të tjerëve, edhe tash ua kam treguar, edhe ndryshimet, disa kishin bërë mirë që ishin larguar disa militantë, disa keqpërdorues ndër vite që e kanë keqpërdorur e kanë krijuar monopol...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: E kemi edhe një replikë nga ministri Krasniqi.

MINISTRI ELBERT KRASNIQI: Faleminderit, kryesuese!
Zoti Zemaj,
E di që e di që asaj që iu referove nuk është e saktë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal paguan fatura aq sa punojnë komunat. Prej buxhetit që kemi për investime kapitale komunat e udhëhequra prej LDK-së kanë këtë renditje me projekte: Obiliqi 2; Lipjani 9; Peja 3; Vitia 3; Istogu 1; Fushë-Kosova 1. Me mjete buxhetore Obiliqi 300 000, Lipjani 600 000, Peja 300 000, Vitia 300 000, Istogu 600 000, Fushë-Kosova 70 000. I bie që komunat e LDK-së nuk kanë punuar.

Unë nuk desha krejt ditën sot kështu ta paraqes këtë përqindje të vogël të investimeve kapitale, mirëpo ministria jonë, Ministria e Pushtetit Lokal, paguan faturat që komunat implementojnë projektet.

Do të thotë, sa ata punojnë, ne paguajmë. E vërtetë që tash nuk paguhet një punë që nuk kryhet, e vërtetë që tash nuk fillon një projekt pa planin detaj, kjo po i vonon komunat, për shkak se kanë jo shumë kapacitete për t’i bërë projektet detaje.

Mirëpo, prej atyre pesë milionë eurove për investime kapitale, janë diku mbi 13 - 15 projekte që janë në komunat ku LDK-ja është duke udhëhequr. Po 0% po thotë investime kapitale, tash a keni kapacitete, a s’keni kapacitete? Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë, deputeti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: O ministër!
Unë po flas për lisa, ti për fshisa. Qy more ku e ke ministrin e Financave, raporti zyrtar nëntëmujor i shpenzimeve, nuk është imi. Thuaj atij, pse i ke shkruar zero shpenzime kapitale. E ke në raport zyrtar, unë e mora në ueb faqe të Ministrisë së Financave. Po s’është kah më intereson. Qe ku e ke ministrin e Financave, thuaj: “Pse ma ke shkruar implementimin zero deri më 1 tetor 2023?”

Ky është raporti i shpenzimeve. Nuk e kam shpikur unë, mua mos m’u drejto. Unë iu referova vetëm statistikave, sikur për kolegët ministra, po asnjë... Dhashtë Zoti, në nëntor e dhjetor 100% e bëni dhe do të isha i kënaqur.

Po, ky është raport zyrtar i Ministrisë së Financave. Nëse Ministria e Financave ka gabuar, unë të kërkoj falje ty, se je burrë i mirë, je djalë i mirë, e ke mjekrën të mirë...

KRYESUESJA: Ministri Murati e ka kërkuar fjalën për disa sqarime.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, nënkryetare!
Meqenëse, zoti Zemaj ma përmendi emrin dhe m'u referua dhe iu referua edhe raportit që e publikon vetë Ministria e Financave, më lejoni edhe një herë ta sqaroj atë që e tha ministri Krasniqi, e që me gjasë nuk e kuptuat.

Projektet kapitale në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal bëhen me memorandume bashkëpunimi, me komuna specifike dhe ato komuna kryejnë punë, vjen fatura për punën e kryer, e dërgojnë në MAPL për pagesë, ministria i paguan. Mosshpenzimi në MAPL, i bie që komunat nuk kanë kryer punë, komunat ku edhe ju qeverisni. Pra, këtë sqarim e dha ministri Krasniqi, e që shpresoj që kësaj here, herën e dytë, po e kuptoi.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Zoti Zemaj, replikë!

ARMEND ZEMAJ: Të kërcejë njeriu në dasmë të huaj, pa të ftuar hiç, veç te ti bën vaki. A ndoshta kështu e ke vetvetiu nga natyra, ta banalizosh debatin.

KRYESUESJA: Deputetë, qetësi, se nuk po dëgjohet asgjë. Të nderuar deputetë!

ARMEND ZEMAJ: Ndoshta e ke prej natyre ta banalizosh debatin. Unë e dëgjova ministrin. Unë e përmenda raportin tuaj financiar zyrtar, që është zero. A i raportojnë këtij komunat, a i çojnë faturat, është punë e tij, nuk është punë e deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Po, ti po të ishe i përgjegjshëm, ministër, si rregullator i financave, ti ua tërheq vërejtjen ministrave tu pse e kanë zero, ose me përqindje të ulët shpenzimet për investime kapitale. Ju kërkon llogari, jo të barten mjetet, 90% të mjeteve, nga viti në vit. Domethënë, kjo është përgjegjësia jote, nuk është përgjegjësia jote të arsyetosh ministrat, komunat, kush çon fatura ditën a natën. Bëhu pak i sinqertë dhe bëhu pak serioz. Mos u mundo gjithmonë, prejse je këtu, mundohesh ta banalizosh çdo deputet, ose çdo debat. Je ministër i Financave, nuk je aty veç sa për të gjuajt fjalë e t'i kënaqësh nja dhjetë militantë këtu, ose jashtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYESUESJA: Vazhdojmë me diskutimet. Tani në radhë është Vendenis Lahu.

VENDENIS LAHU: U përmendën investime në Llap. Është e vërtetë që në dy projektbuxhetet e vitit të kaluar ka pasur investime në Llap. Do të ketë edhe këtë vit e sigurisht se do të ketë edhe vitin tjetër dhe vitet e tjera. Faleminderit, e nderuar kryesuese!

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë, nuk mund ta dëgjojmë kolegun fare, për shkak të zhurmës që është në sallën plenare. Është e disata herë që e tërheq vërejtjen e njëjtë dhe mendoj që është

joserioze nga ana e deputetëve, që t'jua rikujtoj kaq herë se duhet të mbajmë qetësi e ta dëgjojmë kolegun kur flet.

Po, po, po flas për të dyja palët, edhe pozitë, edhe opozitë.

A mund të mbajmë pak qetësi?

VENDENIS LAHU: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!
Të nderuar deputetë,
Ministra
Të dashur qytetarë,
Projektligji për Buxhetin është një nga projektligjet esenciale që i vjen Kuvendit për vlerësim dhe miratim. Ky buxhet që na është paraqitur sot është më i madhi si vlerë financiare, që u është prezantuar deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Vendi ynë, pa dyshim, se ka probleme të shumta e të natyrave të ndryshme, të cilat do të mund të gjenin zgjidhje në planifikimin buxhetor për vitin 2014 dhe vitet në vijim. Por, po ashtu duhet ta kemi parasysh se edhe ky buxhet i rritur i vendit nuk mund t'u japë përgjigje të gjitha nevojave e në fakt, ndoshta edhe një buxhet dyfish, apo trefish, më i madh nuk do të mjaftonte. Dhe kjo, pasi ta kemi të qartë do ta kemi parasysh pasqyrën reale se ku qëndrojmë, jo domosdoshmërisht, është gjë negative.

Në sektorin e shëndetësisë kemi një buxhet të shtuar për SHSKUK. Pra, kemi një rritje prej rreth 25% dhe me këtë rritje ne presim që të reflektohet në përmirësimin e shërbimit dhe kushteve të punës në QKUK.

Kemi shtim të financimit për listën e barnave esenciale dhe njëkohësisht rritjen e numrit të barnave brenda asaj liste, përfshirë këtu edhe barnat që tanimë kohëve të fundit kanë dalë në prodhim dhe për të cilat ka evidencë të saktë mjekësore, se ndikojnë jashtëzakonisht shumë në shëndetin e pacientëve tanë.

Nga buxheti për shëndetësi kemi një sasi të konsiderueshme të mjeteve financiare të ndara edhe për përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore në nivel terciar, por edhe në atë primar e sekondar. Në këtë kontekst, përfundimi sa më i shpejtë i objektit të ri të qendrës emergjente të QKUK-së është i mirëpritur.

Gjithashtu, edhe objektet e reja të QKMF-ve nëpër komuna, objekteve të cilat tashmë janë të buxhetuara, mendoj se e çojnë infrastrukturën shëndetësore drejt një përmirësimi të ndjeshëm, i cili do të mundësonte kalimin në një fazë të re të zhvillimit të shëndetësisë në vend.

Besoj se duhet bërë ndoshta edhe një master-plan për nivelin sekondar të shëndetësisë, në mënyrë që ta rrisim efiçencën e spitaleve rajonale, sepse për momentin efiçienca e tyre nuk është brenda kapaciteteve maksimale të cilat ata i kanë. Dhe kjo, pastaj shkakton çrregullim të sistemit shëndetësor, sidomos të nivelit terciar, të cilin e ngarkon dhe e mbingarkon.

Mendoj se jemi në një fazë, kur nuk na duhen vetëm objektet e reja, spitalet e reja, por më shumë se kurrë na duhet t'i funksionalizojmë maksimalisht ato që i kemi, të ofrojmë shërbime të caktuara në vendet ku ka nevojë dhe të fitojmë shkathtësi të reja e të përvetësojmë metoda të reja të avancuara të trajtimit, në mënyrë që pacientët të marrin trajtimin më të mirë të mundshëm.

Në buxhetet e ardhshme do të ishte mirë të kemi ndoshta edhe kod buxhetor për trajnime për procedura të avancuara për profesionistët tanë në vendet me shëndetësi të zhvilluar dhe pse jo, edhe për specializime të profesionistëve të rinj jashtë vendit, të cilët pastaj do të obligoheshin të kthehen në vend dhe të ofronin përvojën dhe njohuritë e fituara gjatë specializimit jashtë vendit në Kosovë.

Në planin infrastrukturor buxheti i prezantuar mundëson vazhdimin e shumë projekteve të rëndësishme, që janë në zhvillim e sipër. Rruga Prishtinë – Mitrovicë, e filluar para shumë kohësh, e papërfunduar ende, tashmë është në procedura të prokurimit. Pastaj, vazhdon puna në magjistralen Podujevë - Prishtinë, e që vitin e kaluar, këso kohe, në këtë Kuvend, u bë goxha shumë zhurmë nga shumë deputetë, se buxheti i vitit 2023 nuk e mundëson përfundimin e këtij projekti brenda afateve të parapara, e kështu duke tentuar rolin e shpëtimtarit për qytetarët llapjanë. Por, sot nga terreni shohim se situata është krejt ndryshe dhe kjo rrugë është në rrugë shumë të mirë që të përfundojë në më pak se 400 ditë prej nënshkrimit të kontratës.

Kemi po ashtu edhe projekte të tjera, siç është vazhdimi i punëve dhe buxheti i ndarë për autostradën e Gjilanit, e cila lidh Anamoravën, pastaj rrugën e shumë përfolur Dollc - Gjakovë, si dhe projekte të tjera të rëndësishme në infrastrukturë, në bashkëpunim edhe me komunat.

Po ashtu, gjë pozitive dhe e rëndësishme është edhe planifikimi për rehabilitimin dhe funksionalizimin e linjave hekurudhore të disa qyteteve të vendit.

Në planin sportiv ky buxhet mundëson investime në terrene sportive dhe në infrastrukturë tjetër të nevojshme për sport, të cilat sigurisht se nuk mjaftojnë për të përmbushur obligimet që i kemi marrë në momentin kur kemi fituar organizimin e Lojërave Mesdhetare, ngjarje kjo jashtëzakonisht e rëndësishme për vendin.

Prandaj, investimet në infrastrukturën sportive, këtë vit dhe viteve të tjera, duhet të jenë pjesë e një plani master shtetëror sportiv për Lojërat Mesdhetare 2030. Dhe, në këtë mënyrë do të mund

të bëjmë investime që do të rrisin nivelin infrastrukturor në vendin tonë për njëzet apo tridhjetë vjetët e ardhshme.

Po ashtu, ky buxhet paraqet një rritje të ndjeshme edhe në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë, rritje kjo prej 22% nga viti i kaluar dhe dyfishim e trefishim në raport me buxhetet për mbrojtje të viteve të mëparshme. Kjo rritje është shumë e nevojshme, sidomos kur përgjithësisht në botë kemi rritje të pasigurisë dhe kriza politike, të cilat kanë tendencë jashtëzakonisht të madhe të përshkallëzimit.

Jam i vetëdijshëm se këto janë vetëm disa nga sfidat me të cilat përballemi çdo ditë e vetëm disa nga kërkesat e nevojat e shumta të qytetarëve, të cilat janë adresuar në këtë buxhet, pa lënë anash edhe të tjerat që u përmendën nga kolegët tanë.

Po ashtu, dua të potencoj se meqë më parë u përmend trajtimi i sëmundjeve kardiovaskulare, e meqë unë jam çdo ditë në kontakt me pacientë që kërkojnë ndihmë në QKUK, pra në kardiologji, nuk është e vërtetë se pacientët që kanë nevojë për trajtim akut të stentimit u bie të presin. Ata presin vetëm për kohën, për të cilën e bëjnë rrugën deri në njësitë koronare dhe pastaj stentimi është i menjëhershëm.

Sigurisht se ka lista të pritjes, sepse listat e pritjes janë në gjithë botën, për shkak se shumë nga patologjitë, shumë nga lezionet nuk janë lezione që kërkojnë intervenim të menjëhershëm.
Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Hisen Berisha.

HISEN BERISHA: E nderuar kryesuese,
Të nderuar të pranishëm,
Të dashur qytetarë,
Qeveria sot na e ka sjellë projektin e buxhetit me 3,314 miliardë. Po i bie me një rritje prej 1,2%, 102 milionëve, që shkon diku afër 3%-shit, që tregon se Kosova do të ketë regres ekonomik. Pra, do të kemi ramazan edhe këtë vit, do të agjërojmë.

Duke marrë parasysh shkallën e inflacionit që ka shkuar edhe në 30% dhe s’ka trende të rënies, atëherë unë mendoj pastaj suficitin e trashëguar, mendoj se ky buxhet inflacioni i tij është dashur të mbërrijë deri në 4 miliardë. Por, ky projektbuxhet po shihet se ka keqmenaxhim dhe rënie të fuqisë së konsumit dhe kjo është si pasojë e mos ndarjes së të ardhurave të Qeverisë në mënyrë të barabartë dhe keqmenaxhim të financave publike, u tha nga shumë komentues të mëhershëm.

Prandaj, buxheti është projektim ligjor dhe nuk mund të vidhet, mirëpo ju e bëni edhe këtë. Në tetorin e vitit 2022 Banka Qendrore raportoi se janë 800 milionë në Thesar e deri në fund të vitit

me siguri se ka mbërritur miliardën. Më vonë, këtu u tha se janë vetëm 35 milionë. Tani, shtrohet pyetja, se ku shkuan këto 600 milionë dhe kush po rrenë këtu? Ju, apo Banka Qendrore? Cilët po e thoni të vërtetën?

Prandaj, unë e ftoj prokurorin e shtetit të nisë urgjent hetimin për Qeverinë e Kosovës dhe për të hetuar këto keqpërdorime që po pretendoj dhe keqmenaxhimin e buxhetit, si dhe si u shpenzuar këto 8 miliardë që i keni deklaruar, pasi që kanë dështuar investimet kapitale. Ju po provoni ta lidhni me vitin 2019, edhe pse s'është parimore, por këtë po e bëni, sepse jeni të kompleksuar nga dështimi juaj në çdo aspekt të zhvillimit të shtetit.

Një gjë mund t'jua them, meqenëse po i referoheni të kaluarës, kurrë Kosova nuk do të ketë proces më të mirë e më të shpejtë të zhvillimit dhe të demokratizimit sesa procesi e periudha që është udhëhequr nga Qeveria e Pavarësisë, pra nga viti 2008 deri në vitin 2014.

Dhe, duke e parë si keni qeverisur ju, lirish po jua shtoj edhe vitet deri në vitin 2018, apo 2019 dhe po t'i mbledhim shumat buxhetore nga sa fillon atje, me 600, apo 700 milionë, e deri në vitin kur ju keni ardhur në pushtet, që i keni fituar zgjedhjet në 2019, i bie diku që për gjithë ato dy-trembëdhjetë vjet janë shpenzuar 15.8 miliardë. Dhe, çfarë është bërë? Çfarë është arritur për ato vite? A është bërë pavarësia me lobime e takime diplomatike që kanë shkaktuar shpenzime? Janë bërë njohjet me lobime dhe arritja e njohjeve deri në 117 sish. Janë marrë rrugë me 11% asfalt, janë dorëuar me 58% rrugë të asfaltuara me dy autostrada dhe dy superstrada në fillim.

Shkolla: brenda një mandati janë ndërtuar 460 shkolla. Ambulanca dhe spitale në çdo qytet dhe fshat, por edhe QKUK-ja ka bërë që mos të shkojnë më nëpër spitale private e të shpenzojnë qytetarët e varfër.

Energjia ka qenë me reduktime tmerruese, por është kthyer, e keni marrë me 24 orë rrymë, me 900 Mw licenca dhe autorizime. Pagat: rritja e mbi 100% në të gjithë sektorët, sepse nuk është lejuar që të punojnë punëtorët e Kosovës me ndihma sociale. Koncentrimi i madh ka qenë në zonat rurale, afër 70%. Sot është e kundërta, edhe për bizneset, edhe për qytetarët.

Në diplomaci shtrihet në çdo shtet që na ka njohur nga 117 njohje. Në ushtri është bërë rishikimi strategjik i sektorit të sigurisë dhe kemi ardhur te raporti final për forca të armatosura të Kosovës, është bërë plani gjithëpërfshirës i tranzicionit në vitin 2015. Në vitin 2018 kapacitetet e plota operacionale për fushën e mbështetjes ushtarake të autoriteteve civile në vitin 2013, kurse kapacitetet fillestare për operacione ndërkombëtare janë arritur po ashtu, dhe po zhvillohen kapacitetet për mbrojtje të integritetit territorial.

Policia, segmenti i parë që ka arritur kapacitetet e plota operacionale dhe i ka marrë përgjegjësitë e veta sipas misionit nga policia ndërkombëtare. Shtrirja e sovranitetit në çdo pjesë të territorit

dhe vendosja e pikave doganore 1 dhe 31 dhe ndalja pro liferimit, që cenon sigurinë nacionale. Po jua rikujtoj, se në vitin 2008 në veri për herë të parë ka filluar kthimi i shqiptarëve dhe po ashtu kanë filluar investimet në infrastrukturë dhe ndërtimin e shtëpive. Është rrëzuar ai muri ndarës dhe s'është kthyer asnjëherë. E kemi ndalur edhe atë farë trenin dhe s'është tërhequr më Qeveria. Qeveria e Pavarësisë ka ndalur investimet ruse në Luginën e Diellit, në veri. Ka kthyer sovranitetin, duke vendosur pikat 1 dhe 31.

Hajde ta marrim buxhetin tuaj për këto vite sa qeverisët bashkë me këtë që po doni ta miratoni sot. Kap shifrën diku 14 miliardë e 133 milionë, që është e përafërt me atë të të gjitha viteve të qeverive të tjera. Dhe, çfarë kemi? Pavarësinë me statutin që ndan sovranitetin politik në ¼-ën e territorit me Serbinë, njohje asnjë, edhe pse është hequr moratoriumi që shumë e keni goditur. Rrugë, pa mirëmbajtje dhe janë bërë të pakalueshme dhe të rrezikshme. Aty ku po bëni investime, po bëni krim infrastruktural dhe ai duhet penalizuar.

Rrugën e Dollcit në Gjakovë e përmendët shumë herë. Ju kam pararlajmëruar një herë dhe po ju them edhe tash, prapë është bërë e pakalueshme dhe asfalti që është vendosur në gusht, sot është hapur gropa, e di grupi i deputetëve të Gjakovës, që kërkonin të shtrohet për dy javë.

Në Podujevë thatë keni ribërë atë farë projektin. Pse atëherë thoshit të punoni në tri turne, sa të jenë mërgimtarët këtu. Digat, njëzet e dy projekte i kemi trashëguar prej asaj 'dërzhavës' së kaluar, mos u ktheftë kurrë, dhe një projekt për një digë të re në fshatin Kralan dhe Rakovicë ua kanë sjellë përfaqësuesi i komunitetit, zoti Kelmendi, me dy inxhinierë të KRU-së Gjakovë, dhe asgjë keni denjuar ta merrni në dorë.

Shkollat, pa mirëmbajtje po edhe pa nxënës, të larguar nga Kosova, dhe shifrat janë alarmante, e s'po dua as t'i përmend, kjo është fitore e Serbisë.

Ambulancat e spitalet, degraduar me infrastrukturë, listat e barnave esenciale mund të jenë, por të gjithë ne i blejmë edhe ato shumë vijnë nga Serbia, edhe të skaduara.

Energjia, nga 24 orë rrymë kemi pasur reduktime edhe verës. Blerje korruptive përmes kompanive dhe bizneseve serbe, siç është GEN-i. Nga 60 euro megavatin që e kemi pasur, e kemi tani me 200 - 300 euro megavatin.

Bizneset, në vitin 2019 kanë qenë të evidentaura 198 896 biznese. Gjatë periudhës së qeverisjes suaj janë mbyllur 33 000 biznese, i keni të evidentuara se i keni hapur në periudhën '19 - '23 tridhjetë e dy mijë biznese, kurse ATK-ja thotë se paguajnë tatim 57 500 biznese, ministër.

Koncentrimi, jo më nga zonat rurale në ato urbane, po në mërgim diku jashtë.
Diplomacia, e dështuar dhe e papërfillshme, jo e konsiderueshme.

Pagat, talleni me qytetarët dhe me të gjitha kategoritë.

Invalidët nuk i keni trajtuar dhe që nga viti 2019 Ferat Ademaj e shumë Ferata të tjerë, që janë pa këmbë e pa sy, as proteza, as mbështetje.

Veteranët i keni fyer, duke i lënë edhe jashtë pagës minimale, që kanë të drejtë ligjore. Familjet e dëshmorëve vazhdoni t'i fyeni me atë se... me çmimore.

Shtrirja e sovranitetit, tani e keni kthyer vetëm në rrugë magjistrale, në rrugë kryesore, nëpër brendi të territorit mund të përdoren edhe fora të armatosura, siç është rasti i Banjës. Policia, veç shiheni, takimin e fundit pse ndodhi dhe protesta e njësive elite tregon vetë se ku jemi.

Ushtria, edhe sa i përket rritjes së një ushtrie dhe sigurimit edhe në Ministrinë e Mbrojtjes e në Polici nuk i plotëson nevojat për siguri, sepse ju e dini mirë që ka rritje 100% të blerjeve, ka rritje të inflacionit. Prandaj, veç po jua jap disa shembuj. Një autoblindë në vitin 2018 që ka kushtuar 400 mijë euro, sot kushton 1 milion e dyqind mijë euro. Studentët, oficerët që kanë shkuar në studime nëpër qendra shkollore të NATO-s nëpër botë, përpara është kompensuar shkollimi, janë mbuluar me financa, tani vetëm në muajin e parë. Kam me emra konkretë oficerë ushtarakë që kanë marrë kredi personale për të vazhduar shkollimet nëpër këto qendra, në të mirë të Forcës.

Pra, projektet. 50% e projekteve barten nga viti 2019, 2021 deri në vitin 2023. Nuk po dua të shpralloj sistemin, veç a e keni ndërtuar shtabin? Qe, veç një element po ta jap. Pra, keni pasur një auditim. Ka pasur Ministria e Mbrojtjes dhe është opinion i kualifikuar. Ju e dini mirë çfarë do të thotë. Pra, është shumë shqetësuese të gjeturat që evidentohen në këtë raport.

Pastaj, duhet të na shpjegoni, çfarë po ndodh me Fondin e Sigurisë? Ku po destinohen? Sa po mbështesin Forcën? Kanë të drejtë ta dinë edhe qytetarët, taksapaguesit, por kontributdhënësit më së shumti.

Pra, pretendimi se keni blerë armatim mund t'i falënderoheni zotit Meha sa ishte, por ai e braktisi këtë, se s'deshi të jetë pjesë e këtyre dështimeve.

Ju keni krijuar një sistem të burokratëve, komisarëve partiakë, qeveritarë, që punojnë si operativë të byrove politike këtyre herë, për të shtypur punëtorët dhe armiqtë e klasës, që besoj se veç keni hyrë në spiralen e shpërbërjes. Ju manipuluat me atë qeverisjen e drejtë dhe tani çdo ditë po zhvisheni dhe po ekspozoheni çdo ditë. Ju për këto tre vjet plus qeverisjeje jeni dëshmuar se jeni veç makinë e propagandës, prandaj ju do të jeni viktimë e vetë mekanizmave ideologjikë që po i ndërtoni dhe nuk mund të largoheni, vetëm po fundoseni bashkë me to. Kjo është bërë imperativ.

Sot vendit po ia bëni jo vetëm tradhtinë politike me statutin që një të katërtën e territorit do ta ndani sovranitetin me Serbinë, pra më shumë sesa që keni pretenduar kur kërkonit votën, por edhe po e sillni një buxhet i cili do ta varfërojë këtë popull dhe përmbush doktrinën tuaj: varfëroje, pastaj sundo! Asgjë më shumë nuk sjell ky buxhet.

KRYESUESJA: Replikë ministri Çeku.

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: Faleminderit, kryesuese!
Unë e dëgjova me shumë kujdes fjalimin paraprak të z. Berisha dhe në njëmbëdhjetë minuta ai na shpjegoi se sa i keq është buxheti i vitit të ardhshëm.

Unë e kam vetëm një pyetje nëse mund të na e sqarojë z. Berisha: cili është propozimi i PDK-së? Çfarë duhet të bëjmë me këto 3,3 miliardë vitin e ardhshëm? Faleminderit!

KRYESUESJA: Replikë, ministri Vitia!

MINISTRI ARBEN VITIA: Sinqerisht nuk desha replikë.
Faleminderit zonja kryesuese!
Të dashur deputetë,
Po është mirë të mos e shfrytëzojë z. Berisha këtë vend dhe këtë pozitë për të folur çka t’i jep truri pa e analizuar fare. Sinqerisht është e dhimbshme. E para, të thuash që deri 2018-2019 shëndetësinë e paskeni bërë Zvicër dhe qenka shkatërruar për një vit dy, kë po e mashtroni, a veten a qytetarët, z. Berisha?

E dyta, z. Berisha, pesha e fjalës ka shumë rëndësi, sidomos në këtë tempull të demokracisë qysh e quani ju zakonisht e që është në fakt, është dashur të kesh kujdes. Thoni që të gjitha barnat që vijnë, shumica vijnë nga Serbia dhe me afat të skaduar, duhet pasur shumë kujdes kur flisni diçka të tillë, z. Berisha, sepse krijoni një huti si deputet i zgjedhur i qytetarëve para qytetarëve. Po është gënjeshtër, o z. Berisha! Ju kisha lutur që të keni pak kujdes me fjalën tuaj, se si parlamentar, besomëni që duhet ta keni mbi supe edhe barrën e fjalës së thënë, pa çka që jemi kundërshtarë politikë, nuk duhet të bini në nivelin që keni rënë z. Berisha!

KRYESUESJA: Kundër-replikë!

HISEN BERISHA: Dëgjo, ministër, me gjithë respektin, dikush i imi që lavdëron për punën kur ke punuar në Qendër të Mjekësisë Familjare, por kjo që the ti, moralizimi që u përpoqe të më bësh, unë kur të duash hajde ta dëshmoj barna të Serbisë me afat të skaduar. Kur të duash. Bile edhe mungesë të tyre të theksuar. Unë kur flas, e analizoj mirë.

Unë kur flas për rrugën, kam shkuar e kam incizuar vetë me telefon rrugën, ditën dhe natën. Prandaj, nuk flas kurrë, fjala ime gjithmonë do të peshojë në të vërtetën. Kjo që thatë ju është tendencë moralizimi, sepse nuk mund ta kundërargumentoni. Kur të duash, eja shkojmë në Gjakovën time, ta qes edhe një drekë, atje një tavë të Gjakovës, edhe të kallëzoj barnat, edhe të tregoj rrugën, edhe të gjitha çka fola.

KRYESUESJA: Ministri Murati, gjithashtu replikë!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit e nderuar nënkryetare!
Vetëm për të vazhduar atë që e foli edhe ministri Vitia, nëse ka çështje të tilla apo situata të tilla, i nderuar deputet Berisha, e keni përgjegjësi dhe obligim që të raportoni te organet përgjegjëse. Kjo deklaratë që e dhatë, pra ju ose duhet ta lajmëroni rastin te organet përgjegjëse. Duhet t'i lajmëroni Inspektoratin apo edhe Doganën, në këtë rast bëhet fjalë edhe për kontrabandim, ose duhet të jepni llogari për shpifje dhe deklarata të rrejshme. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë!

HISEN BERISHA: Nuk je i denjë të replikoj me ty. Ti je njeriu që ke thënë me gjashtëmbëdhjetë milionë e kishe çliruar Kosovën me mercenarë. Nënë e motër e grua ia kishe çuar dikujt me t'i dhanë gjashtëmbëdhjetë milionë. Ti ke ky, me ty s'meriton të debatohet. Por, unë u kam thënë organeve, kam kurajë t'ju thuash organeve, kurse ti je veç një mashtrues. Asgjë më tepër. Ti gënjeve këtu edhe borxhin publik e kemi më të ulët...

KRYESUESJA: Ju lutem, kujdes me gjuhën!

HISEN BERISHA: Për vitet e Qeverisë së Partisë Demokratike kur shtetin e ka marrë në zero, borxhi publik është më i ulët se ky që e ke sot. Prandaj, shih pozicionin tënd.

KRYESUESJA: Tani e ka radhës deputetja Rrezarta Krasniqi.

RREZARTA KRASNIQI: Faleminderit nënkryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë,

KRYSUESJA: Ju lutem pak qetësi, ta dëgjojmë kolegen!

RREZARTA KRASNIQI: Sot çdo shtëpi dhe çdo qytetar është i goditur nga inflacioni i lartë në ekonomi, ndërkohë Qeveria Kurti po vazhdon të bëjë edhe më të papërballueshme për shumë, duke shpërfillur nevojat reale të tyre. Këtë po e them duke u ndërlidhur edhe me Projektbuxhetin për të cilin po flasim sot. Është faktike se buxheti për vitin 2024 në krahasim me atë të 2023 ka

një diferencë prej njëqind milionë euro, gjë të cilën pushteti po tenton ta shesë si sukses para qytetarëve, por realiteti flet krejt diçka ndryshe. Kosova është në pozicionin e njëjtë që ka qenë, mos edhe më keq.

Duke e analizuar diferencën e buxhetit, ajo nuk sjell përparim për qytetarët tanë. Për më shumë, duket si një tentativë për të mbuluar dështimet, mangësitë dhe problemet e mëdha me të cilat ballafaqohet vendi ynë në këtë periudhë të kësaj qeverisje.

Për ta thënë më thjesht dhe më qartë, ky është një buxhet i orientuar pa zhvillim. Thelbi i projekteve dhe alokimeve financiare nxjerr në sipërfaqe mungesën e një strategjie të qartë dhe inovative, që do të përcaktonte një rrugë të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik në vend.

Nëse e bëjmë një analizë më të detajuar del se shumica e përfitimeve janë rezervuar disa pakica privilegjesh, ndërsa shumica e qytetarëve i pret një situatë e njëjtë në kushtet e tyre jetësore, ndonëse më të rënduara. Kjo për faktin se këta pushtetarë kanë harruar se rreth dhjetë për qind e familjeve jetojnë me më pak se dy euro në ditë. Merreni me mend se çfarë jetese mund të bëjnë ata, ndërkohë që Kryeministri Kurti me njëzetepesë këshilltarët e tij i terrorizon me xhipat e zinj, për të cilët pat ndërtuar një narracion të frikshëm e negativ. Sot ata me xhipa kanë harruar se dikush është në trotuar e dikush lufton për mbijetesë.

Le të kthehemi prapë te buxheti. S’ka rritje të pagave. Pagat, pensionet dhe pagesa për fëmijët janë në nivel të njëjtë. Nuk parashihet rritje për asnjërën prej kategorive nga skemat pensionale. Fatkeqësisht, lista e të harruarve nga ky pushtet është e gjatë. Në mesin e tyre janë edhe familjarë e të pagjeturve.

Rritja e koeficientit për pesë euro, rritjen e koeficientit për pjesëtarët e Policisë e Kosovës, mjekët, mësimdhënësit, zjarrfikësit, shërbyesit civilë, gjyqtarët e kategoritë e tjera vitale për shtetin, Qeveria duket se po e sheh si një akt mirënjohës për kontributin e tyre, por në praktikë është një shifër e vogël që shpeshherë ofendon vlerën dhe angazhimin e tyre që kanë një rol kyç në shoqëri.

Me rritje prej vetëm pesë euro për kategorinë e profesionistëve, nuk mund të quhet një përmirësim substancial.

Investimet kapitale. Në fushën e investimeve kapitale kemi thjesht bartje nga viti 2023 në vitin 2024 për nëntëdhjetë për qind të projekteve, gjë që shfaq një mungesë të qartë të vizionit për të ardhmen për këtë Qeveri. Pra, shumica e projekteve janë thjesht përsëritje të atyre të kaluara, duke treguar mungesën e një strategjie zhvillimore. Rritjet janë reale vetëm te luksi. Bazuar në të dhënat, Projekt=Buxheti i vitit 2024 rritjen më të madhe buxhetore kjo Qeveri e ka bërë te mallrat e shërbimet, e cila e shfaq rritjen e luksit qeveritar më shumë se çdo qeveri tjetër.

Ministria e Mbrojtjes, duke analizuar investimet në fushën e mbrojtjes, del në pah një mungesë serioze e përkushtimit ndaj sigurisë kombëtare. Për sigurinë janë planifikuar të ndahen 153 milionë euro, një buxhet minimal, i nënvlerësuar për ta, sepse në atë vlerë përfshihen pagat, ushqimet, investimet, trajnimet, veshmbathjet, karburanti dhe çdo të mund të bëhej me këtë vlerë për blerjen e armatimeve të reja për fuqizimin e ushtrisë. Merreni me mend, kjo ndodh në kohën kur shtetet fqinje, Serbia dhe të tjerat, kanë ndarë dhjetëfish më shumë buxhet sesa vlera te ne për ushtrinë e saj, ndërkohë që Qeveria Kurti ka planifikuar të shpërfillë atë.

Infrastruktura. Edhe në infrastrukturë duket se ka vetëm bartje të projekteve nga vitet paraprake, ndërsa nuk shihet ndonjë projekt serioz për të zgjidhur dhe për të përmirësuar rrugët dhe autostradat tona.

Folët me statistika për zgjerimin e rrugës dhe magjistrales Prishtinë-Mitrovicë, projekt që ka nisur nga viti 2010, janë bartur 2,5 milionë nga viti 2023 pa caktuar një afat kohor për përfundimin e punimeve, gjë e cila po shkakton shumë vështirësi për qytetarët dhe bizneset e asaj ane.

Projektet nga Ministria, shpërndarja e parave për projekte nga ministria nuk është fare e drejtë. Pesëdhjetë për qind e buxhetit të ministrive shkon për disa komuna të veçanta, për faktin se ato udhëhiqen nga partia në pushtet Lëvizja Vetëvendosje dhe pesëdhjetë të tjera janë orientuar nga komunat e tjera. Qeveria nuk duhet harruar as Komunën e Vushtrrisë. Fatkeqësisht, e kemi një Qeveri që nuk përfill nevojat për kërkesat e komunave, shoqërisë civile dhe opozitës.

Projektet adekuate dhe propozimet tona janë lënë anash, sepse Qeveria ka vendosur t'i nënshtrohet interesave të ngushta dhe kjo është një shkelje e qartë e principeve demokratike. Për më keq, pasojat e kokëfortësisë së kësaj Qeverie janë duke u bartur edhe në fondet IPA, të cilat janë goditur nga masat sanksionuese të marra nga Bashkimi Evropian.

Ndërkohë, çka i bën mashtruesit, në vazhdimësi dolën para qytetarëve dhe gënjyen se po ndodh një rritje ekonomike e po punësohen me qindra e me mijëra persona. Veç për të qenë korrekt edhe me veten, do të duhej që më në fund të tregonin se ato punësime kanë ndodhur në Gjermani dhe në vendet e tjera të Evropës.

Qytetarë të dashur,
Ky pushtet e ka dëshmuar se di vetëm t'i mashtrojë e për rrjedhojë t'ju varfërojë. Varfërimi i popullit është investimi i vetëm i këtij pushteti të keq. Këta kanë harruar se Qeveria e ka për obligim që të jetë shërbëtore e popullit e jo shërbëtore e interesave politike. Faleminderit!

KRYESUESJA: Replikë, ministri Murati!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!
Deputetja e nderuar prezantoi një listë kritikash për secilën prej kategorive se si është gabim, si është keq dhe si nuk do të duhej të ishte. Prandaj, unë kam një pyetje, a mundet deputetja e nderuar të na tregojë cili do të ishte kompozicioni i duhur i buxhetit, pra ky 3.3 miliardë euro si do të duhej të shpërndahej, sa milionë për pagat, sa milionë për mallra e shërbime, sa milionë për subvencione dhe sa për investime kapitale. Ju lutem!

KRYESUESJA: Kundër-replikë!

RREZARTA KRASNIQI: Faleminderit nënkryetare!
Po ministër, nuk mund t'ju mësojmë prej tash. Kur të vijmë në pushtet, ju tregojmë se çfarë bëjmë ne.

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Jahja Kokaj.

JAHJA KOKAJ: Unë dola t'i them disa fjalë, me siguri jo për temën për të cilën sot jemi bashkuar, e cila është për buxhetin për vitin vijues, po desha t'ju them disa fjalë për metodologjinë e punës së sotme, e cila ka filluar para njëmbëdhjetë orësh. D.m.th. në një punë maratonike njëmbëdhjetë orëshe, unë konsideroj që bisedat të cilat u zhvilluan këtu, me një përqindje të madhe ishin biseda të cilat kishin pak ose aspak të bëjnë me temën e rendit të ditës.

Prandaj, unë konsideroj që metodologjia e punës duhet të jetë e fokusuar në rendin e ditës, se bisedat të cilat ishin për gjithçka, praktikisht ishte nihilizim, ishte injorim, ishte degradim, ishte ajo që s'dua ta them më tutje, për temën e cila është shumë me rëndësi, për ardhmërinë monetare, ekonomike e cila do të zhvillohet në vitin vijues.

Prandaj, unë me modestinë time që e kam dhe me të cilën mburrem, duke respektuar të gjithë të pranishmit, apeloj që të koncentrohemi në një temë dhe se pas tri orësh që kemi çdo mbledhje, të bëhet një pauzë. Të bëhet një pauzë, për arsye se t'jua jap një lajm të cilin do ta përsëris disa herë. E kam thënë një herë, në dhomat e mbyllura si kjo, koncentrohet radoni, i cili shkakton kancer, kancer i cili është në radhë të parë i rrezikshëm për gjirin me siguri edhe të zonjës e cila me shumë respekt kam që qesh atje, po që shkakton kancerin e gjirit.

Në qoftë se vazhdojmë kështu nën rrezikimin e radonit, në zvogëlimin e oksigjenit, me një metodologji e cila degradon për të cilën na kanë zgjedhur qytetarët ta trajtojmë me përgjegjësi të madhe, ma merr mendja që ky diskutim, thënë nga pikënisja ime modeste, ndoshta do të ketë një impakt që edhe diskutantët të përmbahen nga bisedat arbitrare, se ne për sot nuk është e thënë që të gjitha temat, edhe nesër do të kemi mbledhje, pasnesër e kështu me radhë. Të gjitha, ama bash të gjitha u diskutuan kështu, duke u reflektuar pastaj me replika e biseda e kundërshtime të cilat

pothuajse nuk ishin në mënyrë minimale tangonin apo ishin të lidhura me temën konkrete, pra për buxhetin e vitit të ardhshëm, apo s'ishin fare.

Me shpresë të madhe që më mirëkuptoni për këtë thirrje dhe desha t'ju përshëndes në fillim nuk e bëra juve minsitra. Faleminderit për fjalën e dhënë! Ju kolegë dhe ju qytetarë e respektuar që tash e njëmbëdhjetë orë na përcillni, ju falënderoj dhe shpresoj që kolegët e mi në të ardhmen do të jenë më racionalë dhe do të veprojnë në mënyrë pak më të mençur! Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, i nderuar! Tani në radhë është deputeti Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit nënkryetare!
Kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,
Qytetarë të nderuar,
Dua ta akceptoj çfarë tha kolegu profesor Kokaj pak më herët, që vërtet do të duhej të bëhej një pauzë. Në fillim do të duhej ta thoshe profesor, kur ka qenë ora 14:00. Tash është vonë, kanë mbetur veç edhe një ose dy diskutues. Kjo dihet që është ngutia për ta votuar këtë projektligj të buxhetit të vitit 2024. Zakonisht, kjo është dëshmuar deri tash që esenciale është deputetët të jenë këtu dhe ta votojnë këtë projektligj. Për këtë arsye s'ka pasur as pauzë, për këtë arsye ka ngarkesë të tillë.

Dihet që pas Kushtetutës, ligji më i rëndësishëm që ka një shtet është ligji mbi buxhetin. Në kuadër të kësaj, është shumë normale që ministrat e mbrojnë këtë projektligj të buxhetit. Është e çuditshme dhe nuk ka qenë shumë në rregull këtu që deputetët të përplasen me deputetët e opozitës për qëndrimet e tyre për buxhetin. Vërtet kjo është po e dimë që po funksiononi në bazë të preferencave dhe në bazë të diktateve, po nuk është në rregull. Secili deputet e ka atë të drejtë që të thotë atë çfarë ai e ka parë dhe e dëshmon këtu.

Shihet që te ministrat, edhe një pjesë e deputetëve çfarë është karakteristikë për këtë Qeveri dhe këtë Parlament është arroganca e pushtetit. Normalisht që këtu ka pasur shumë Qeveri dhe shumë deputetë, po ministrat kanë qenë ata që kanë ofruar sqarime dhe normalisht nëse ka pasur diçka që s'është në rregull, e kanë dëshmuar. Po jo për të fyer deputetët, jo për t'i quajtur gënjeshtarë, mashtrues etj. Nuk ju bën nder dhe nuk e kuptoj pse po e bëni.

Buxheti për mua si deputet nuk është buxhet i zhvillimit ekonomik. Është buxhet edhe i regresit. Buxhet që tkurr ekonominë e Kosovës dhe e mirëmban gjendjen e rëndë socio-ekonomike të qytetarëve tanë. Buxhet që nuk i investohet në ekonomi në mënyrë që pastaj të mundësojë ciklin e zhvillimit ekonomik, buxhet që shpërndan më lusin qeveritar e të pushtetarëve sesa për nevojat e jetës së qytetarëve.

Unë si e kuptoj këtë Projektligj për buxhet, meqë ka zgjedhje tash në regjion dhe në Serbi, meqë viti tjetër është në zgjedhje edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe për Parlamentin Evropian, është buxhet që tenton realisht që të komunikojë me ato shtresa që janë potencialisht mbështetës në fushatën zgjedhore. Përderisa Qeveria Kurti i mban në sirtar më shumë se gjashtëqind milionë euro, ajo është dorëlirë kur bëhet fjalë për shpenzimet e luksit dhe për mallra e shërbime për vete. Kjo është në buxhet.

Buxheti në këtë kategori për vitin 2024 rritet për 24 milionë euro. Shpenzimet për mallra e shërbime janë 518 milionë euro. Ndërsa në vitin 2023 kanë qenë 493,5 milionë euro. Që nga viti 2021, shpenzimet për mallra e shërbime janë rritur për 187 milionë euro. Këto janë shifra të Qeverisë, te vetë Ligji për buxhetin. Ndërkohë që janë paguar, u tha më herët, një milionë euro për serbët që nuk e kanë vijuar punën dhe 113 milionë euro për energjinë që e kanë shpenzuar gjatë vitit 2022-21. Realisht, nëse këto janë paguar, atëherë është vazhdimësi e pagesave të tilla. Atëherë, pse janë ulur të hyrat buxhetore dhe ndarjet buxhetore saktësisht për kategoritë e dala nga lufta dhe të burgosurit politikë?

Pensionet e kompensimit për veteranët dhe invalidët e luftës, në përgjithësi për vitin 2024 janë planifikuar në shumën 117,3 milionë euro. Krahasuar me vitin 2023, ka një rënie prej 3,3 milionë euro.

Kompensimi për të burgosurit politikë në vitin 2023 ka qenë 5,3 milionë euro. Në projektbuxhet për vitin 2024 janë paraparë 3 milionë euro, apo dy milionë euro më pak. E dimë që janë kompensuar një pjesë e të burgosurve politikë, po unë që i kam mbajtur gjashtë vjet burg nuk jam kompensuar. Pse është ulur ai buxhet?

Të hyrat e buxhetit janë 3,028 miliardë euro prej të cilave, 2,7 miliardë euro janë nga tatimet dhe taksat e qytetarëve, që paguajnë qytetarët. Ndërsa shpenzimet janë 3,31 miliardë euro.

Rritja ekonomike, në bazë të Bankës Botërore, për Kosovën për 2023 ka parashikuar rritje ekomomike për vetëm 3,7 për qind. Sipas vlerësimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2023 është rritur 3,9 në terma realë, ndërsa në vitin 2024 pritet të rritet 4,6. Ndërsa Banka Botërore thotë 3.9 respektivisht 4 për qind për 2024. Këto janë shifra që ne duhet respektuar.

Koeficienti i pagave. Vlera monetare e koeficientit për Ligjin e pagave në sektorin publik është 110 euro. Neni 32 i Ligjit për buxhetin. Marrë parasysh inflacionin që sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës për tërë vitit 2023 janar-shtator ishte 5,8 për qind, rritja e pagave është 4,7 për qind, pra nuk e mbulon as inflacionin.

Shpenzimet kapitale dihen, nuk do të flas shumë për to. Dihet, u fol për Ministrinë e Mbrojtjes për Policinë, i akceptoj të gjitha vërejtjet dhe kritikat.

Ministria e Punëve të Jashtme e ka një rritje buxhetore për zyrën e ministres për gjashtëdhjetë mijë euro, nga 565 mijë euro, në 624 mijë euro për 2024, kjo është e vetmja rritje buxhetore te Ministria e Jashtme.

Te Ministria e Shëndetësisë është harxhuar vetëm tetë për qind e shpenzimeve kapitale nga faktikisht 23,7 milionë euro, janë shpenzuar vetëm 1,8 milion. Shërbimi Spitalor Universitar i Kosovës i ka harxhuar 32 për qind nga 14 milionë euro. Për mua është shumë me rëndësi nuk figuron ministra të linjës dhe ju ministër i financave, Spitali Regjional i Ferizajt. Vetëm është bartur ajo pjesë e shumës, që në fakt është bartur qe disa vite. Nuk mund të mbulohet me QKMF. E ka vendin e vet, po Spitali Regjional i Ferizajt është spital regjional dhe mbulon pesë komuna dhe një komunë tjetër që nuk është pjesë e regjionit dhe është vërtet non sens se si nuk është paraparë që së paku për vitin vijues buxhetor të fillojë seriozisht dhe të përmbyllet ai spital regjional.

Te komunat, realisht u tha më herët, nuk është askush kundër investimeve nëpër komuna kushdo që i qeveris. Edhe ato katër komunat që i qeverisin të zgjedhurit nga qytetarët, anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje. Po ka diskriminim. Këto diskrimime janë të qarta. Ka komuna të cilat jo vetëm që nuk ka projekte të reja kapitale, por edhe ato që kanë qenë janë shkurtuar. Lista e komunave që kanë shkurtime buxhetore në kategorinë e investimeve kapitale është e gjatë. Ferizaj ka 800 mijë euro më pak, Hani i Elezit rreth gjysmë milion më pak, Vitia rreth gjysmë milion euro më pak, apo Vushtrria 330 mijë euro më pak. Këto janë fakte. Ferizaj është dëmtuar edhe sa u përket subvencioneve dhe është shkurtuar nga 300 mijë euro që kanë qenë përpara 400 mijë euro. Në total, Komuna e Ferizajt është dëmtuar për 1,4 milion euro.

E kemi parasysh edhe një çështje, çështjen e trajtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza. Realisht, unë kam pritur që këtë vit buxhetor, kjo Qeveri dhe ministri i Financave do të ndajë buxhet për impiantin për Ferizaj, Kaçanik dhe më gjerë.

Te Komuna e Kaçanikut, ndërtimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Edhe një minutë që ta përfundojë fjalën.

ELMI REÇICA: Ndërtimi i shkollës së mesme Emin Duraku në Kaçanik, afër njëmijë nxënës. Ndërtimi i çerdhes së vjetër në Kaçanik dhe në Rekë në sallën e edukatës fizike në Dubravë,

asnjë nga këto nuk janë futur në buxhetin e vitit 2024. Edhe pse Komuna në bazë të informacioneve të mia që i ka dërguar në e-mail adresën time zyrtare, kanë bërë kërkesë.

Restaurimi i shkollës Gjon Sereçi në Ferizaj, janë ndarë 450 mijë euro, ndërsa ndërtimi i rrugës Bibaj, kyçja R6, Driton Islami në Ferizaj edhe 49 mijë euro nga viti 2023 janë bartur. E kam pas bërë një kërkesë këtu në bazë të pyetjeve parlamentare për një shkolë në Doganaj dhe një në Pozharan. Vërtet ajo në Pozharan është hequr fare.

KRYESUESJA: Replikë, ministri Vitia!

ARBEN VITIA: Faleminderit, kryesuese!
Faleminderit deputet Reçica,
Jam shumë dakord me juve që ne ministrat duhet dhënë shpjegime për çdo kritikë, për çdo këshillë, sugjerim e pse jo edhe shpjegime, natyrisht sepse kjo është puna jonë. Mirëpo, më ka rënë shpeshherë të më ofendojnë personalisht dhe nuk e kam kthyer kritikën. Kur thuhen gjëra të tilla të pavërteta që mund të ndikojnë edhe në percepcionin publik se çfarë barnash paskemi këtu ose jo, për besë nuk di si t’i them ndryshe z. Reçica, kështu që mund t’ju pyes edhe juve: a po i mbështetni të pavërtetat që u thanë më herët nga deputeti paraprak? Unë besoj që nuk është korrekte ajo që u tha.

Të mos ju mbes borxh, Spitali i Ferizajt, po z. Reçica, edhe unë jam për t’u mbyllur kjo salltë e filluar qysh nga viti 2013. Edhe e a di pse do të mbyllet? Pavarësisht që është 500 mijë euro buxheti për vitin e ardhshëm, deri në 2026 kur planifikohen krejt dhe nëse nuk gaboj deri 19 milionë euro për t’u përmbyllur dhe do të bëhet një nga spitalet më moderne. A e di pse do të mbyllet? Sepse më në fund është në binarët ligjorë. Që nga 2013 e deri tash nuk ka qenë në binarët ligjorë. Besoj që ju e dini këtë, z. Reçica.

Po tash është në binarë që nuk ka kthim prapa. Kjo do të mbyllet. Edhe pajtohem që nuk e zëvendëson QKMF-ja këtë, mirëpo ju kisha lutur, pyeteni edhe kryetarin Agim Aliu me të cilin kemi pasur disa takime për ta shtyrë procesin përpara, sepse jam po ashtu si ju i brengosur dhe jam i vendosur që edhe QKMF-ja, edhe Spitali i Ferizajt të mbarojnë sa më shpejt, sepse jo vetëm Ferizaj, po edhe komunat e tjera përreth meritojnë shërbime të tilla të mira shëndetësore. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë!

ELMI REÇICA: Më shumë sqarim.
Edhe një herë po e them, ministër. Secili deputet e ka të drejtën e fjalës. Nuk e ka të drejtën askush ta fyejë askënd. Çfarëdo që thuhet, secili argument, je ministër dhe do duhej të komunikosh me argumente. Jo me fjalë të tjera. Për Spitalin e Ferizajt, realisht spitali ka filluar

së ndërtuari ju e dini më 15 qershor 2017 dhe atëherë është e vërtetë që e ka edhe historinë, mirëpo nuk mjaftojnë 500 mijë euro dhe duhet ta kesh parasysh që është objekt i rëndësisë së veçantë. Është i vetmi regjion që nuk ka spital regjional si ndërtesë. Është në kushte të tmerrshme dhe ju e keni parë edhe vet si funksionon Spitali Regjional i Ferizajt.

KRYESUESJA: Tani e ka fjalën deputeti Dimal Basha.

DIMAL BASHA: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!
Nuk desha të lidhem të them të drejtën, mirëpo meqenëse u fol këtu për disa argumente që nuk qëndrojnë, për të mos thënë të pavërteta, unë besoj që po i filloj disa argumente që po i kërkon vetë z. Reçica për Ferizjan, se ka shumë propagandë në Ferizaj ku flitet për qytetin dhe është një propagandë ku thuhet se Qeveria nuk po investon.

Për spitalin e shpjegoi ministri, edhe me rëndësi për spitalin është të dihet që aty kanë qenë të parapara vetëm nëntë milionë euro për t'u përfunduar spitali brenda e jashtë, a nëntë milionë euro kati i parë nuk përfundon. Ministri po thotë edhe njëzet milionë euro të tjera i kemi të zotuara veç le të përfundojë. Pra, veç fakti që kanë qenë të parapara nëntë milionë euro dhe është dashur të ndërpritet kontrata, tregon që aty ka pasur dallavere prej fillimit. Për më tepër, nuk ka qenë baza ligjore, tash është kryer baza ligjore dhe është duke u punuar në atë proces.

E dyta, çerdhja në rr. Rexhep Bislimi që ka pas mbetur gërmadhë nga komuna e qytetit, është duke u përfunduar me mjetet e Ministrisë së Arsimit. Këto janë fakte, 700 mijë euro plus i ka dhënë Ministria e Arsimit që të përfundohet ajo çerdhe.

QKMF-ja 2,5 milionë euro, 2,25 milionë euro janë investim i Qeverisë Kurti, respektivisht Ministrisë së Shëndetësisë. Është filluar puna, paratë e mjetet janë duke ardhur prej Qeverisë.

Qendra Multifunksionale ka mbetur gërmadha aty, aty prapë është niveli qendror 700 mijë euro të ndara për t'u përfunduar.

Gjimnazin e vjetër që ka pas qenë synim i mafisë së betoni për t'ia futur flakën e ta kallë e ta bëjë banesa, është gati në përfundim të restaurimit, kjo si pasojë e investimit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sportit, që i ka kushtuar Qeverisë Kurti 250 mijë euro. Kjo ka qenë me një zotim të ministrit Çeku, një punë marramendëse që është bërë pas ndezjes, e që është në përfundim e sipër.

Shkolla Gjon Serreçi, ka qenë në projekt Komuna për ta rrënuar atë shkollë, sot ajo shkollë janë ndarë 450 mijë euro, z. Reçica, për ta restauruar dhe është në përfundim e sipër, mirëpo mjete ka sa të duash.

Kjo varet prej ecurisë së punimeve që bëhen. Tash, për qytetarët e Ferizajt, “Gjon Serreçi” është në projektim e sipër. Pra, janë duke punuar në projektimin që pastaj të hidhet në tender.

Shkolla që është duke u ndërtuar në rrugën “Zenel Hajdini” te stadiumi i vjetër “Ismet Shabani”, që ka kushtuar mbi 2 milionë euro, janë mjete të Qeverisë Kurti, që është duke u përfunduar.

Stadiumi i qytetit. Është folur për stadiumin e qytetit me vite të tëra, që 20 vjet. Është e parë që ministri Çeku e fut në buxhet dhe i zoton 12.1 milionë euro për stadiumin e qytetit të Ferizajt. Është hera e parë që zotohet, dhe për më tepër, është në përfundim studimi i fizibilitetit, pastaj bëhet projektimi dhe do të bëhet edhe stadiumi. Pra, kur i ke paratë bëhet edhe stadiumi. Me fjalë nuk janë bërë që 20 vjet.

Argument tjetër. Unë mendoj që edhe projektet e tjera, sikurse që e kemi restaurimin e kishës katolik, xhamisë së madhe, krejt këto janë mjete të Qeverisë që janë zotime që të bëhen projekte, komplet mjete të Qeverisë Kurti. Me fjalë të tjera, Buxheti i Republikës, i Qeverisë është komplet i investuar në Ferizaj dhe e tha edhe ministri më herët, është prej komunave që ka marrë më së shumti investime nga Qeveria qendrore.

Qytetarët s’i dinë këto, por po mendoj që kur të përfundohen punët do ta shohin se kush duke bërë punë. Ndërkaq, Komuna e Ferizajt komplet investimet kapitale i ka dërguar në një birë, atë birë që e quan nënkalim dhe e ka ndarë qytetin në dy pjesë. Sot, krejt bota trenin shkon e futë nën tokë, njerëzit rrinë përmbi, ai na ka futur neve ndër tokë, treni është përmbi edhe e ka ndarë me një muri, edhe komplet projekti është aty.

Nuk asnjë cent as për wc për pastrimin e tualeteve nëpër shkolla. Asnjë investim të vetëm. Prandaj, edhe reagimin e ka bërë komuna me foto, ku ne i kemi vizatuar projektet.

Unë pajtohem, e kam thënë edhe publikisht, Komuna e Ferizajt ka mundur ta vizatojë edhe ka pasur ide, veç pula s’kanë pasur kurrë. Kështu që, komplet mjetet e projekteve madhore që janë në qytetin e Ferizajt vinë prej Qeverisë Kurti, dhe këto janë argumente me fakte. Faleminderit!

KRYESUESJA: Replikë, Elmi Reçica!

ELMI REÇICA: Dua vetëm disa sqarime. Ne desha të hyjë në një pjesë të projekteve që janë, thjesht, asfalt. Zgjerimi i rrugës për Bibaj pret me vite të tëra. S’ka filluar fare. Zgjerimi i rrugës Prelez-Fshat i Vjetër, paguhen taksa, paguhen kamata, paguan ky shtet, ndërsa s’janë përfunduar as 200 metra atje.

Dhe, vazhdon kjo odiseadë, jo vetëm në këtë qeverisje, por edhe në atë paraprake. Dhe, këtë e di edhe Dimali edhe të gjithë të tjerët. Për spitalin u morëm veshë.

Në Qeverinë e PDK-së, po Ferizaj ka qenë qyteti i 13-të i trajtuar në Buxhetin e Kosovës, para se të vijë PDK-ja në qeverisje. Sot, është qyteti i dytë për nga kontributi në Buxhetin e Kosovës. Është bërë gjatë qeverisjes së PDK-së në nivel qendror dhe në nivel lokal.

Dhe, shkollën “Gjon Serreçi”, unë kam qenë ai që kam bërë pyetje parlamentare, por meqë e keni vendosur për ta renovuar, atëherë ndani mjetet. Ju e dini shumë sa është zvarritur renovimi i kishës katolike. Kam bërë pyetje parlamentare. Këto janë gjatë qeverisjes qendrore të Lëvizjes Vetëvendosje.

Të tjera. Ka shkolla profesionale që kanë mbetur që sa kohë nuk është duke u zhvilluar asnjë projekt. E dimë që investimet kapitale të nivelit të lartë vijnë në bashkëpunim me qeverisjen qendrore. Nuk mund t’i bëjë dhe nuk ka kapacitete asnjë komunë. Ju që jetoni aty bashkë me mua...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Kundër-replikë, Dimal Basha!

DIMAL BASHA: Po pajtohem me zotin Reçica që duhet edhe po tregon që edhe qeveritë e mëparshme kanë investuar në Ferizaj. Unë s’po them që s’ka pasur investime, mirëpo Ferizaj prej investimeve që ka pasur, ka përfunduar pa stadium, pa spital, pa renovim të shkollave, pa renovim të kishë, pa renovim të gjimnazit të vjetër që mbi 20 vjet ka qenë i parenovuar.

Edhe sot, prapë e thashë sot, edhe QKMF-ja është ndërtuar prej kësaj Qeverie. Edhe për spitalin janë ndarë mjete prej kësaj Qeverie. Dhe, krejt çka është bërë, prapë po them, e ka ndarë komplet qytetin në dy pjesë me një muri të madh.

Unë e kuptoj zotin Reçica që doni ta ndihmoni zotin Agim Aliu, mirëpo nuk mundeni, dhe me një arsye të vetme, ai mbi 20 milionë euro borxh e ka futur komunën, është duke e falimentuar. Ia ka bllokuar komplet fondet Thesari për shkak të borxheve që i ka.

Dhe, ministri vitin e kaluar edhe pagat është dashur t’ia paguaj komunës për shkak se s’ka pasur mjete as për paga. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ministri Çeku e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI HAJRULLA ÇEKU: Faleminderit, kryesuese!
Për sqarim, zoti Reçica. Buxheti për shkollën “Gjon Serreçi” është ndarë dhe jemi në fazën e angazhimit për hartimin e projektit të restaurimit. Në momentin që e kemi projektin, e dimë edhe

shumë sa kushton restaurimi edhe vazhdojmë me realizim. Pra, faza e parë, hartohet projekti, faza e dytë, realizohet, dhe të gjitha fondet i kemi. Kjo e para po bëhet me buxhet të Ministrisë së Arsimit, ndërsa pjesa tjetër e fondeve janë në Ministri të Kulturës për ndërhyrje restauruese në objektet e trashëgimisë kulturore. Pra, kemi buxhet, vetëm po e presim hartimin e projektit të restaurimit.

KRYESUESJA: Vetëm një moment, për shkak që kemi replikë, dhe pastaj ta jap fjalën ministre. Replikë, Elmi Reçica

ELMI REÇICA: Faleminderit, ministër!
Unë asgjë s'po kërkoj më tepër vetëm ta realizoni atë që e keni dëshiruar, e kanë dëshiruar deputetët nga Ferizaj, dhe ju e keni në projekt. Vetëm kaq. Të mos mbeten, sepse kjo është duke u zvarritur nga viti në vit.

Dhe, pikërisht deputetët e Vetëvendosjes shpesh kanë shkuar dhe kanë bërë incizime në atë shkollë në çfarë gjendje është. Kjo është esenciale. Këtë po e kërkoj, asgjë tjetër.

KRYESUESJA: Tani radhën e ka Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryesuese!
Meqenëse kam folur edhe në emër të grupit parlamentar, dua t'i ritheksoj dhe disa komente që realisht u nxorën gjatë debatit në përgjithësi në këtë lexim të parë të Ligjit të buxhetit për vitin 2024.

E thamë shumë herë që ky buxhet është i rëndësishëm, jo vetëm për Qeverinë, jo vetëm për Kuvendit, por për shtetin e Kosovës për arsye se direkt apo indirekt varet edhe ekonomia e vendit. Dhe, në këtë aspekt duhet të kenë kujdes se çfarë planifikimesh bëhen nga Qeveria dhe nga Kuvendi.

Edhe nëse Qeveria e Kosovës mund të bëjë gabime edhe teknike, por edhe përmbajtjesore, Kuvendi i Kosovës duhet të reflektojë dhe t'i përmirësojë ato gabime. E kam thënë edhe në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, me të vërtet ka gabime aq të mëdha, sa nuk dihet edhe projektet se në cilën komunë ekzistojnë apo ku do të implementohen.

Prandaj, edhe në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere duhet të kemi kujdes dhe t'i përmirësojmë këto gabime teknike. Por, gjithsesi kur është fjala te pjesa, ku edhe ministri i Financave lëvdohej që ka rritje të punësimit, duhet ta kundërshtoj prapë edhe pse e kam kundërshtuar me qindra herë.

Unë e përgëzoj që ka formalizim të punësimit, por nuk ka rritje të punësimit. Ky është realitet. Në këtë aspekt tregojnë edhe faktet që emigrimi është alarmant. Ky alarm nuk duhet të jetë vetëm për pozitën, por duhet të jetë edhe për opozitën dhe për të gjitha institucionet e vendit.

Çfarë po bën Qeveria e Kosovës? Çfarë po nën Kuvendi i Kosovës që ta ndalojë këtë emigrim? Të bëjë politike që të ketë investim në hapje të vendeve të reja të punës. Të investojë në industri të prodhimit. Të investojë në industri të teknologjisë, dhe kësisoj të përmirësojmë dhe të arrijmë një besim, sidomos te gjeneratat e reja që ata të mos e shohin si alternativë të vetme emigrimin nga Kosova.

Në këtë aspekt, sigurisht që pres që edhe Qeveria të reflektojë, por edhe nëse ne si deputetë të opozitës bëjmë amendamentime të ndryshme, e kemi parë edhe nga e kaluara, nuk shohim ndryshime dhe reflektime. Prandaj, është e vështirë edhe për neve, qytetarë të nderuar, të bëjmë amendamente në kuptimin që ato respektohen edhe nga shumica parlamentare pasi që duhet të kalojnë me shumicë të Kuvendit.

Gjithsesi, edhe po të planifikohet kemi një realitet të hidhur, sepse buxheti që planifikohet nga vetë Vetëvendosja, nga vetë kjo mazhorancë dhe nga Qeveria shihet me një kritikë të madhe, jo vetëm nga opozita, por edhe nga ekspertë të ndryshëm, sepse s'kemi implementim.

Po të kishin investuar dhe realizuar të gjitha ato planifikimet e buxhetit që i kanë pasur nga Qeveria Kurti 1 e 2, besoj që do të hapej rrugë e re që të ketë edhe planifikime edhe më të mëdha buxhetore dhe investime të reja kapitale për qytetarët e vendit. Por, ja që nuk i kemi. Prandaj, e kemi shumicën e projekteve që janë në vazhdimësi.

Kemi vetëm një numër të vogël prej rreth 49 milionë euro që janë projekte të reja. Vetëm 49 milionë euro janë projekte të reja dhe ato kryesisht dihet qartë që shkojnë në komunat me shumicë ku ka fituar edhe Vetëvendosja. Në rregull është. E kuptoj këtë pjesë që doni të investoni edhe në komunat që ju fitoni, por nuk e kuptoj në aspektin përmbajtjesor dhe të shërbimeve të qytetarëve, sepse krahasimisht kur e marrim Prishtinën apo Prizrenin me një komunë më të vogël që ka fituar, Vetëvendosja sigurisht që nuk përkon me realitetin e investimeve dhe performansën që duhet të jetë në drejtim të qytetarëve të cilët kanë mbështetur një subjekt tjetër politik.

Por, të mos harroni ju si Vetëvendosje sidomos, që pavarësisht pse kanë votuar në komuna në zgjedhje lokale parti të tjera, ju në shumë komuna ju e keni pasur besimin më të madh sesa ato parti që kanë fituar në ato komuna që tash qeverisen nga partitë e tjera. Dhe, nëse ju ato komuna i lini në harresë, sigurisht që edhe qytetarët në ditët e ardhshme që do të ketë edhe zgjedhje do t'i harrojnë dhe do t'iu gjobitin, nëse mund të them kështu, për mos mbështetje të projekteve të cilat domosdoshmërisht duhet të ishin mbështetur nga Qeveria.

Sidoqoftë, kemi disa informata dhe keqinformime të përgjithshme nga ministri i Bujqësisë, dhe duhet ta them me keqardhje se edhe pse ka pasur një rritje të vogël aty, nuk reflektojnë në mbështetje reale për fermerët dhe bujqit në Kosovë.

Së pari, e kemi një vonesë totale të hapjeve dhe të thirrjeve të granteve për bujqit. Në vitin 2022 thirrja e parë që është hapur ka qenë në korrik, ndërsa në vitin 2023 thirrja është hapur në fund të muajit shtator, që është me të vërtet qesharake. Dhe, ku mundet një fermer të ketë një planifikim të duhur. Por, edhe nëse fiton atë grant, sigurisht që të gjitha ato do të realizohen në vitet në vijim dhe sigurisht që nuk do të ketë mbështetje të duhur dhe adekuate për fermerët e Kosovës.

Kur e dimë që të gjitha investimet në pjesën e bujqësisë janë trefishuar, ndoshta edhe pesëfishuar, dhe në këtë aspekt nuk kemi asnjë mbështetje.

Shpenzime buxhetore që janë planifikuar rreth 3 miliardë e 314 milionë euro krahasuar me vitin e kaluar janë vetëm 75 milionë euro më shumë sesa në vitin 2023. Pra, 2.3% më shumë. Kjo është për t'u thënë qytetarëve të Kosovës se kaq kemi mundësi të rrisim këtë buxhet. Ndërkaq, duke llogaritur edhe inflacionin kjo rritje edhe më tutje.

Në përgjithësi kemi e kemi thënë edhe këtë pjesën që realisht kemi një rritje të ekonomisë vetëm për shkak të të hyrave në kufi, dhe sigurisht që kjo prapë do të kritikohet në vazhdimësi, sepse Qeveria Kurti nuk ka arritur ta realizojë ndryshimin e madh që vetë e ka premtuar në disa fushata të caktuara, që të hyrat dhe thesarin ta mbushë në brendësi të vendit, duke i lehtësuar kështu edhe bizneset e caktuara.

Prandaj, sigurisht që ne edhe jemi në dilemë a do të bëjmë amendamente të ndryshme, sepse shohim që nuk ka asnjë mbështetje as për projektet konkrete të cilat janë në të mirë të qytetarëve, jo vetëm në aspektin e punësimit, por edhe në aspektin e mirëqenies sociale, qysh janë edhe ujësjellësit e ndryshëm në qytete të ndryshme.

KRYESUESJA: Tani në radhë është Valon Ramadani.

VALON RAMADANI: Faleminderit, e nderuara nënkryetar Bogujevci!
Të nderuar anëtarë të Kabinetit,
Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë,
Sot, dëgjuam nga aktorë të ndryshëm të opozitës që kinse Qeveria jonë i ka ndaluar mjetet për komunat dhe që nuk po ka buxhet për to. Pati edhe pretendime që gjoja po bëhen favorizime për disa komuna të caktuara, e që është dezinformatë dhe është propagandë dhe është pa fakte e argumente për shkak të mllefit të opozitës për sukseset e Qeverisë.

Për ta argumentuar këtë, po i lexoj disa statistika për komunat dhe ndarjet buxhetore për to, të bëra me Projektligjin e buxhetit për vitin 2024, duke e krahasuar atë me vitin e fundit, të themi, të gjendjes normale ekonomike, pra, COVID-19, në të cilin vit me Qeverinë nuk udhëhiqte Lëvizja Vetëvendosje.

Këto të dhëna i referohen granitit qeveritar për investime kapitale komunale, aty ku më së shumti po ka ankesa e kritika në këto dy vjet që krahasohen.

Për shembull, për kryeqytetin buxheti total është 122 milionë euro, nga to 83.9 milionë janë nga Qeveria. Pra, investime kapitale komunale në vitin 2019, Qeveria qendrore kishte ndarë buxhet prej 9.2 milionë euro, kurse për vitin 2024, Qeveria jonë ka ndarë 14 milionë euro, ose një rritje prej 57% të të hyrave nga Qeveria.

Komuna e Ferizajt për vitin 2024 ka buxhet total 41,1 milionë euro, nga to 35,7 milionë janë nga Qeveria apo 87% të totalit. Pra, kjo komunë ka buxhet në investime kapitale komunal në këtë vit. Ndërsa, në vitin 2019 ka marrë nga Qeveria buxhet në vlerë prej 6 milionë e 325 mijë e 723 euro, kurse për vitin 2024 asaj i janë ndarë nga Qeveria 8 milionë e 265 mijë e 104 euro. E shprehur në përqindje, kjo paraqet një rritje prej 30,66%, kurse sa u përket të hyrave vetjake që grumbullon Komuna e Ferizajt, ka pasur një rënie prej mbi 16%.

Komuna e Suharekës do të ketë buxhet mbi 22 milionë euro. Prej tyre 19,8 milionë euro janë nga grantet qeveritare. Kjo komunë në vitin 2019 kishte pasur të ndara nga buxheti qeveritar 4 milionë e 192 mijë e 278 euro për investime kapitale komunal. Ndërkaq, e njëjta në vitin 2024 do të marrë nga Qeveria buxhet prej 4 milionë e 988 mijë e 761 euro. Kjo është rritje prej 19% e buxhetit qeveritar.

Më tej, Komuna e Shtimes parashihet të ketë buxhet rreth 10 milionë euro, me 9,3 milionë euro nga Qeveria. Në vitin 2019 i ishin alokuar 1 milionë e 655 mijë e 461 euro. Ndërsa, për vitin që vjen granti qeveritar i kësaj komune është 2 milionë e 286 mijë e 425 euro investime kapitale komunale. Pra, ka një rreth 38,11%.

Peja do të ketë 37.4 milionë buxhet, nga to 32.1 milionë vijnë nga Qeveria, ndërsa në vitin 2019 ka përfituar shumën prej 4 milionë e 856 mijë e 619 euro, dhe me një rritje prej 34,3% për vitin 2024 ajo do të marrë financim si grant qeveritar prej 6 milionë e 521 mijë e 628 euro.

Komuna e Prizrenit ka buxhet në vlerë prej 65,2 milionë nga të cilat 55 milionë euro vijnë nga Qeveria. Prizreni ka marrë si grant qeveritar në vitin 2019, 13 milionë e 620 mijë e 353 euro për investime kapitale lokale, tani në vitin 2024 ai do të marrë shumën prej 17 milionë e 418 mijë e 344 euro, që përkthehet në rritje prej 28%.

Pra, performansën e tyre Qeveria ka ndarë këto. Mirëpo, Podujeva do të ketë buxhet të përgjithshëm në vlerë prej 31 milionë euro. Në vitin 2019 kishte të ndara nga Qeveria për investime kapitale komunale, 5 milionë e 875 mijë e 51 euro, ndërsa për vitin 2024 i janë ndarë 7 milionë e 907 mijë e 236 euro, që i bie rritje rreth 34%.

Zubin Potoku ka 3.4 milionë buxhet me 3.3 milionë që vijnë nga Qeveria. Në grantin për investime kapitale komunale ka pasur rritje nga 576 mijë e 152 euro në vitin 2019, ndërsa në 743 mijë e 448 euro grant qeveritar për vitin 2024. Pra, ka rritje rreth 30%.

Nëse këto të dhëna i shikojmë në raport të përqindje së grantit qeveritar ndaj totalit të buxhetit të komunave, në secilën prej tyre, kjo përqindje është dukshëm më e lartë për vitin 2024. Pra, në krahasim me vitin para pandemisë me vitin 2019.

Në total kemi rritje të buxhetit për komunat për 40% apo nga 531 milionë e 654 mijë e 851 euro në 742 milionë e 915 mijë e 126 euro. Pra, rritje mbi 200 milionë euro.

Kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë,
Siç më dëgjuat, këto statistika që i lexova, ku shfaqet rritja e mbështetjes financiare nga Qeveria, nuk është vetëm në komunat që udhëhiqen nga Lëvizja Vetëvendosje, por pa asnjë dallim. Madje, rritjen më të madhe, për shembull, e pati Mitrovica dhe Gjakova, e pikërisht këto të dyja komuna, ku kryetarët nuk vijnë nga subjekti i Lëvizjes Vetëvendosje.

Thënë të drejtën, kjo është gjë normale. Kjo do të thotë se ne komunave nuk ua shikojmë partinë e kryetarëve, por nevojat e qytetarëve. Aty ku duhet më shumë, ndahet më shumë buxhet. Proporcionalisht sipas madhësisë së komunës, sipas numrit të banorëve, sipas nevojave të tyre e kështu me radhë. Pra, jo për politikë, por për qeverisje.

Buxhet ka pasur edhe më herët, por ia nuk rritej, sepse për fat të keq, vidhje. Ndërkaq, tash vetëm menaxhohet. Dikush mund të thotë se rritja ka ndodhur, sepse është rritur buxheti, por edhe buxheti nuk rritet vetvetiu. Ai rritet në këtë masë kur qeveriset mirë e mençur. Këto arrihet duke krijuar besim te qytetarët dhe bizneset, sepse siç ka ndodhur në 2 vjetët e fundit, kur ata i besojnë shtetit dhe e dinë se paratë e tyre nuk keqpërdoren, por kthehen prapë tek ta.

Nuk hezitojnë të regjistrojnë ekonomitë e tyre, të kontribuojnë në shtet. Pra, jo rastësisht kemi një rritje të të hyrave tatimore dhe atyre doganore. Kjo është vetëm falë reflektimit pozitiv të mirëqenies nga Lëvizja Vetëvendosje, e nga kryeministri Kurti.

Qytetari e ka parë se kjo qeverisje, këto para i kthen prapë te qytetarët, e nuk i dërgon tek oligarkët e biznesmenët kontroversë që në xhepat e tyre i mbanin duart politikanët e korruptuar, që u tregonin se u është tharë fyti. Faleminderit!

KRYESUESJA: E nderuar, mund ta marrësh replikë, vetëm nuk mundemi secilit deputet në secilin fjalim që ka referim të përgjithshëm t'i referohemi me replika. Nuk funksionin, nuk e kemi pasur praktikë. Sido që të jetë, po ta jap prapë mundësinë, por edhe ti t'i respektosh rregullat e Rregullores së Kuvendit.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetare!
Jam shumë e vetëdijshme që jam duke i respektuar të gjitha rregullat që i ka ky Kuvend. Në momentin që një deputet juaji akuzon me akuza të pabaza, normal që edhe ne do të dalim këtu edhe do të replikojmë.

Nëse dikush është rekord i propagandës, atëherë rekordmenë jeni ju. Ju jeni fabrikë e propagandës. Ju keni investuar miliona në propagandë që ta shkatërroni këtë vend. Dhe, mua më vjen shumë keq që ju sot deputetët e opozitës, të cilët...

KRYESUESJA: A mund të replikosh me deputetin, ju lutem!

GANIMETE MUSLIU: ...të cilët adresuan shumë çështje, i quani propagandues. Edhe sikur të doni, nuk guxoni t'i ndalni disa gjëra, sepse ky vend ka ligje, ka rregulla. Për shembull, s'mundeni more t'ia ndalni ju Prishtinës ose kryeqytetit gjërat që i garantohen me Ligjin e kryeqytetit. Por, ju po bëni hajgare në këtë Kuvend.

Edhe sot gjatë gjithë kohës u munduam të jemi shumë të arsyeshëm, të mos e ofendojmë askënd, vetëm me fakte e me argumente, duke e argumentuar çdo fjalë që e kemi thënë në Kuvend. Dhe, ju që keni shpenzuar miliona në propagandë për shkatërrimin e këtij vendi, vini e quani opozitën propaganduese, kjo është e pafalshme dhe e pa tolerueshme. Dhe, kërkoj prej jush si kryesuese e kësaj seance, herëve të tjera t'ua tërhiqni vërejtjen deputetëve kur shpifin në këtë formë ndaj opozitës.

Unë e di që jeni lodhur, sepse e keni obligim që ta çoni dorën sot. E di që brenda vetes e ndieni thellë që ky ligj është i pabarabartë. Ky ligj është diskriminues. Ky ligj, ky buxhet vetëm për qytetarë të Kosovës nuk është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: E nderuar, është hera e dytë që e shfrytëzon foltoren për replikë me individë në raport me deputetët, dhe u referohesh temave të përgjithshme. Kundër-replikë, Valon Ramadani, dhe me kaq e mbyllim këtë seancë.

VALON RAMADANI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare Bogujevci!
Unë e kuptova saktë pse deputetja Musli kërkoi replikë, dhe arsyeja kryesore, mendoj, që pse kërkoi replikë deputetja Musliu është se ia përmenda hajninë partisë saj që e kanë gërryer këtë vend edhe kanë vjedhur sa kanë mundur këtë vend.

Arsyeja pse e pa të nevojshme që të reagojë shpejtë, është se kanë mizën pas veshit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Mirë! Kaq, përfundojmë me diskutime. Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur për fjalë. Ju lutem që të gjithë të uleni nëpër vendet tuaja! Deputetë të nderuar, ju lutem të uleni!

Gjithashtu, ju kisha lutur që gjatë votimit për shkak që t'ia lehtësojmë punën stafit të Kuvendit, të jeni pak më të vëmendshëm!

62 deputetë jemi të pranishëm.

Të nderuar deputetë, ju lus që me ngritje dore të deklaroheni për Projektligjin nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

Kush është për?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

Konstatoj se me 62 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

Kërkohet nga Komisioni Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere, si dhe komisionet e tjera parlamentare sipas fushave që mbulojnë, që në bazë të nenit 81 të Rregullores së Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Më këtë i mbyllim punimet e kësaj seance. Shihemi në seancat e radhës!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë